

Gjykata Themelore e Mitrovicës

P 98/14

30 Mars 2016

Tabela e përmbajtjes

| | |
|---|-----|
| PJESA E PARË: DISPOZITIVI..... | 3 |
| PJESA E DYTË: ARËSYETIMI | 22 |
| I. RRJEDHA PROCEDURALE..... | 22 |
| I. A. HISTORIKU PROCEDURAL | 22 |
| I. B. KODI I PROCEDURËS | 24 |
| I. C. KOMPETENCA..... | 24 |
| I. D. PROVAT E PARAQITURA..... | 25 |
| I.E. PRANUESHMËRIA E PROVAVE DHE PROPOZIMET E TJERA PROCEDURALE..... | 43 |
| I. E.1. Përfaqësuesi i palës së dëmtuar..... | 44 |
| I.E.2. Rregullat lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve | 45 |
| I.E.3. Zbatueshmëria e parimit <i>ne bis in idem</i> | 46 |
| I.E.4. Pranueshmëria e deklaratës së dëshmitarit të ndjerë N. A. 2 dhe propozimet e tjera të provave..... | 50 |
| I.E.5. Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarëve..... | 53 |
| I.E.6. Deklaratat e dëshmitarëve nëpërmjet video-lidhjes..... | 54 |
| I.E.7. Dëshmitarët e mbrojtur..... | 55 |
| II. ARSYETIMI LIGJOR | 56 |
| II. A. PIKA 1: NGJARJET E 14 PRILLIT 1999 NË MITROVICËN JUGORE: | 57 |
| II. A. 1 Faktet..... | 57 |
| (d) Roli i O. I. në ngjarjet e 14 prillit 1999 në Mitrovicë..... | 93 |
| (e) Analiza e kushteve të konfliktit të armatosur, statusi civil i popullatës së vënë në shënjestër dhe lidhja me konfliktin e armatosur..... | 102 |
| II. A. 2. LIGJI | 111 |
| II. B. PIKA 2: NGJARJET E 3 SHKURTIT 2000 NË VERI TË MITROVICËS | 125 |
| Nënkapitulli B1: Analiza në lidhje me të pandehurit O.I. dhe D. D.: | 127 |

| | |
|---|-----|
| II. B1. 1. Faktet..... | 127 |
| (a) Dëshmitë në lidhje me ngjarjet e 03 shkurtit 2000 në veri të Mitrovicës:..... | 130 |
| (b) Dëshmia në lidhje me pozitën e O. I. brenda Rojeve të Urës | 175 |
| (c) Dëshmia në lidhje me pozitën e D. D. brenda MPB-së | 181 |
| (d) Dëshmia në lidhje me planifikimin apo koordinimin e përbashkët të sulmeve ndërmjet O. I. dhe D. D. : | 183 |
| II. B1. 2. Ligji..... | 186 |
| Nënkapitulli B2: Analiza në lidhje me të akuzuarit N. V1., I. V. dhe A. (S.) L. : | 188 |
| II. B. 2.1. Faktet..... | 188 |
| II. B. 2.2. Ligji | 192 |
| III. LLOGARITJA E PARABURGIMIT..... | 193 |
| IV. SHPENZIMET PROCEDURALE | 193 |
| V. KERKESAT PASURORE JURIDIKE | 194 |

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, në Trupin Gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it, Roxana Comsa, si Kryetare të Trupit Gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Vitor Pardal dhe Nuno de Madureira si Anëtarë të Trupit Gjykues, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Asja Zujo, si zyrtare regjistruese, në rastin penal kundër:

1. **O. I.**, emri i babait _____, emri i nënës _____, i lindur më _____ në _____, me vendbanim në _____, Serb i Kosovës;

I akuzuar sipas Aktakuzës PPS 04/2013 me veprat penale për:

Krime lufte kundër popullatës civile, për shkelje serioze të nenit 3 § 1(a) i përbashkët për katër Konventa të Gjenevës të 12 gushtit 1949 lidhur me Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë Lufte dhe nenin 4 § 2(a) të Protokollit Shtesë II lidhur me Mbrojtjen e Viktimave në Konfliktet e Armatosura Jo-Ndërkombëtare të 8 qershorit 1977, në pajtim me nenin 152 § 1 dhe 2.1 në lidhje me nenet 16 dhe 32 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe i dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës sipas nenit 142 të Kodit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të 28 shtatorit 1976 (i publikuar në gazetën zyrtare të RSFJ-së nr. 44 të 8 tetorit 1976) (KPRSFJ-së);

Dhe më tutje në bashkëkryerje me:

2. **D. D.**, emri i babait _____, emri i nënës _____, i lindur më _____ në _____, me vendbanim në _____, serb i Kosovës;

Me veprën penale të:

Nxitjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkë-kryerje dhe në pajtim me nenin 179 (1.10) në lidhje me nenin 31 dhe 32 të KPK dhe i dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 Paragrafit (2) të LPKSAK-së në lidhje me nenet 22 dhe 23 të KP të RSFJ-së;

Nxitje për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, duke rezultuar në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 (1.10) dhe nenin 189 (2.1) dhe (5) në lidhje me nenet 28, 31 të KPK-së, dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në

kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafit (2) dhe nenit 38 paragrafit (2) të LPKSAK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KP të RSFJ-së;

Nxitje për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 (1.10) në lidhje me nenet 28, 31 dhe 32 të KPK-së, dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafit (2) të LPKSAK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KP të RSFJ-së.

Dhe

3. **N. V.1**, emri i babait _____, emri i nënës _____, i lindur më _____ në _____, me vendbanim në _____, serb i Kosovës;

4. **I. V.**, emri i babait _____, emri i nënës _____, i lindur më _____ në _____, me vendbanim në _____, serb i Kosovës;

5. **A. (S.) L.**, emri i babait _____, emri i nënës _____, i lindur më _____ në _____, me vendbanim në _____, serb i Kosovës;

Që të tre ngarkohen sipas Aktakuzës PPS 04/13 me:

'Vrasje e rëndë' në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 (1.10) në lidhje me nenin 31 të KPK-së dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafit (2) të LPKSAK-së në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së;

'Vrasje e rëndë në tentativë' në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, duke rezultuar në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 § 1.10 dhe 189 § 2.1 dhe 5 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK-së dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 dhe nenit 38 § 2 të LPKSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së;

'Vrasje e rëndë në tentativë' në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 § 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK-së dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 të LPKSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor më 18 dhjetor 2014, më 21, 22, 23 dhe 26 janar 2015, 18-26 shkurt 2015, 11, 24-30 mars 2015, 22-27 prill 2015, 5-8, 11-14, më

20 maj 2015, 15, 29, 30 qershor 2015, 2, 6-9, 13-15, 21-23, 28-31 korrik 2015, 3 dhe 4 gusht 2015, më 10, 11, 15, 16, 17, 21 shtator 2015, më 6-8, 13, 14, 20, 21, 27, 28 tetor 2015, më 10, 17, 19, 20, 23 dhe 24 nëntor 2015, më 1, 2, 4, 8-10, 15 dhe 17 dhjetor 2015, dhe më 18 janar 2016 në praninë e të Pandehurve, Avokatëve Mbrojtës përkatës dhe Prokurorit të PSRK-së. Palët e dëmtuara dhe një përfaqësues nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave ishin të pranishëm gjatë seancave të caktuara sipas procesverbaleve. Seancat e Shqyrtimit Gjyqësor ishin të hapura për publikun, përveç seancave të mbajtura më 28, 29 dhe 30 korrik 2015 dhe pjesërisht më 10 shtator 2015 dhe më 27 tetor 2015 të cilat ishin shpallur të mbyllura për publikun;

Pas këshillimit të Trupit Gjyqësor dhe votimit të mbajtur më 19 dhe 20 janar 2016;

Në pajtim me nenet 359 – 366 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të shpallur në publik dhe në praninë e të Pandehurve, Avokatëve Mbrojtës dhe të Përfaqësuesit të palëve të dëmtuara, Palëve të Dëmtuara dhe Prokurorit, siç është regjistruar në procesverbal;

Nxjerr si në vijim:

AKTGJYKIM

I. Pika 1: Ngjarjet e 14 prillit 1999 në jug të Mitrovicës:

A. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Gjatë viteve 1998-1999 ka pasur një konflikt ndërmjet Forcave Serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila u intensifikua me përfshirjen e NATO-së dhe bombardimin e saj që filloi më 24 mars 1999.
2. Kundër këtij zhvillimi, më 14 prill 1999 Forcat Serbe organizuan një operacion të spastrimit në jug të Mitrovicës, me qëllim të dëbimit dhe vrasjes së Shqiptarëve etnik.
3. Atë ditë, diku rreth orës 12h00 një numër i familjeve shqiptare që jetonin në rajonin e rrugës Miladin Popoviç (tani e quajtur rruga Ahmet Selaci) dhe rrugës Njegosh (tani të krijuara rruga "Mehmet Gradica" dhe rruga 11 Marsi) ishin larguar me forcë nga shtëpitë e tyre nga Forcat Serbe dhe ishin grumbulluar së bashku jashtë në rrugë.
4. Gra, fëmijë dhe të moshuar më pastaj ishin ndarë nga meshkujt e mbetur, duke u shtyrë në drejtim të stacionit të autobusëve në Mitrovicë dhe ishin urdhëruar për të shkuar në Shqipëri.

5. Një numër prej 15 meshkujve shqiptarë ishin grumbulluar së bashku dhe ishin përcjellë nga ushtarët tek një mur i një shtëpie që gjendej në rrugën e Njegoshit. Ata ishin: F.M., I.M.1, Xh.S., B.F., M.M.1, I.M.2, S.P., K.A., L.A.1, A.A.1, B.A., S.K.1, M.S. (F.), Sh.K.1 dhe Sh.K.2
6. Atje, ata ishin mbështetur për muri dhe ishin marrë përsipër nga një grup i paramilitarëve/policëve të armatosur dhe janë mbajtur atje për afro një orë me duar të lidhura pas qafës. Gjatë asaj kohe grupi i paramilitarëve/policëve i pyesnin ata për UÇK-në. Disa nga meshkujt e arrestuar ishin kërcënuar dhe sulmuar.
7. Pastaj i tërë grupi, të përcjellë nga paramilitarët/policët, vazhduan përgjatë rrugës derisa arritën në rrugën kryesore – rrugën Miladin Popoviç, ku ishin ndaluar.
8. Para tyre, në kryqëzimin e rrugëve mes rrugës Miladin Popoviç dhe Rrugës për Bajr gjendej një pikë kontrolli e policisë/paramilitarëve.
9. Gjashtë prej tyre ishin ndarë nga të tjerët, ishin lënë të lirë të shkojnë dhe u ishte thënë të shkojnë në Shqipëri. Ata ishin: L.A.1, K.A., B.A., S.K.1, I.M.2, Sh.K.2. .
10. Nëntë të tjerët ishin përcjellë nga policët/paramilitarët në rresht në rrugën Miladin Popoviç, drejt punktimit të kontrollit. Ata ishin: F.M., I.M., Xh.S., B.F., M.M.1, S.P., A.A.1, M.S. (F), dhe Sh.K.1.
11. Në atë rast **O. I.** ishte pjesë e grupit të pranishëm të paramilitarëve/policëve në atë pikë kontrolli.
12. Ai kishte të veshur uniformë të kaltër dhe ishte i armatosur.
13. Para se këta nëntë meshkuj të lartpërmendur në pikën 10 të kalojnë nëpër pikën e kontrollit, një pjesëtar i njësisë serbe të policisë/paramilitarëve i cili po i përcillte ata e pyeti **O. I.** diçka në mes rreshtash “Çka do të bëjmë me ta, shef?”, në të cilën **O. I.** u përgjigj diçka kështu : ”Pse po më pyet mua, zbatoji urdhrat!”
14. Nëntë shqiptarët pastaj ishin përcjellë nëpër pikën e kontrollit dhe ishin dërguar disa metra më tutje në rrugën për Bajr, ku ishin ndaluar.
15. Paramilitarët/policët i morën ata dy nga dy, duke filluar nga fundi i rreshtit, drejt shtëpive që gjendeshin në të dyja anët e rrugës dhe i qëlluan ata. Ishin qëlluar katër meshkujt në vijim: S. P., F. M., A. A.1 dhe M. S. (F.).
16. Derisa po zhvilloheshin këto ngjarje, mbërriti një automjet i tipit Pitzgauer me një person të uniformuar i cili dha një urdher i cili i ndaloi gjuajtjet.
17. Ky person pastaj përcolli pesë meshkujt e mbetur prapa në rrugën Miladin Popoviç në drejtim të stacionit të autobusëve. Këta ishin: I. M., Xh. S., B. F., M. M.1 dhe Sh. K.1 .
18. Në stacionin e autobusëve, ata u ribashkuan me familjet e tyre dhe së bashku ata shkuan në Shqipëri.
19. **O. I.** ishte në dijeni për operacionin e dëbimit dhe vrasjes së Shqiptarëve civil etnik; në atë ditë, duke vepruar siç u përshkrua më lart, ai me vullnet iu bind planit, duke ditur se kjo do të rezultojë në vrasje.
20. **O. I.** ishte plotësisht kompetent në aspektin mendor.

21. Në atë kohë, **O. I.** ishte një figurë e mirënjohur në Mitrovicë, me të dhëna të suksesshme sportive në sporte luftarake, me ndërmarrje të ndryshme komerciale dhe një pozitë me rëndësi në një konglomerat industrial shoqëror i quajtur 'FERRONIKEL'. Ai gjithashtu fliste rrjedhshëm gjuhën shqipe.

B. Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Kur ka ndërmarrë një gjë të tillë, **O. I.** ka vepruar në cilësinë e një udhëheqësi të një njësie paramilitare/policore serbe.
2. **O. I.** "ka nxitur grupin e paramilitarëve/policëve duke i urdhëruar ata për "të kryer vrasje".

C. Prandaj, duke pasur parasysh nenin 3 paragrafin 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,

O. I. është **GJETUR FAJTOR** për veprën penale të "Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile" të dënueshme sipas nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së) dhe në shkelje të nenit 3 § 1(a) e përbashkët për katër Konventa të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 lidhur me Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë Luftë dhe nenit 4 § 2(a) të Protokollit Shtesë II lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktit të Armatosur Jo-Ndërkombëtar të datës 8 qershor 1977.

D. I akuzuari **O. I. DËNOHET**

me 9/nëntë/vjet burgim.

Pika 2: Ngjarjet e 3 shkurtit 2000 në veri të Mitrovicës

II. Për sa i përket të akuzuarit O. I., me të dhëna personale si më lart.

Për nënpikën Ad. 1.

A. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Më 03 shkurt 2000 në veri të Mitrovicës, në orët e mbrëmjes, ka ndodhur një shpërthim në kafiterinë "Bel Ami", duke lënduar një numër serbësh.
2. Pak kohë më vonë, në orët e natës, grupe spontane të serbëve hynë në ndërtesën që ndodhej në rrugën Knjaz Miloš, rrugën Lola Ribar, rrugën Tanaska Rajić, rrugën Sutjeska

dhe rrugën Kralja Petra e banuar nga familje të kombësisë shqiptare, me qëllim të dëbimit të tyre dhe kanë vrarë personat në vijim:

- a. N. A. 1
- b. N. XH.
- c. S. A. 1
- d. R. C.
- e. M. S.1
- f. S. B.
- g. N. V. 2
- h. Sh. V.
- i. B. R. 1
- j. N. S. 1(S.).

B. Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. I pandehuri **O. I.** ka pasur cilësinë e një udhëheqësi të grupit paramilitar të quajtur si “Rojet e Urës”.
2. Në atë rast, i pandehuri **O. I.** ka vepruar në bashkëkryerje me **D. D.**, pas një plani të përbashkët më parë të pajtuar, as me qëllimin për të detyruar shqiptarët etnik të lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të lënë territorin e veriut të Mitrovicës, as nuk i ka nxitur/urdhëruar grupin e policëve apo “Rojet e Urës” të sulmojnë disa ndërtesa që gjenden në rrugët e lartpërmendura dhe me forcë t’i pastrojë ato nga shqiptarët etnik.
3. Në atë rast grupet e policëve të Ministrisë së Brendshme të Republikës Federale të Jugosllavisë (MUP) apo “Rojet e Urës” ishin pjesë e grupit spontan të serbëve të cilët hynë në ndërtesat e lartpërmendura.

C. Prandaj

O. I. SHPALLET I PAFAJSHËM dhe **LIROHET NGA AKUZA**, sipas nenit 364 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3 të KPP-së, për veprën penale të nxitjes për kryerjen e veprës penale të Vrasjes së Rëndë në formë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare* në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 § 1.10 lidhur me nenin 31 dhe 32 të KPK-së dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 të LPKSAK-së në lidhje me nenin 22 dhe 23 të KP të RSFJ-së;

Lidhur me nën-akuzën **Ad.2.**

D. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Me 03 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” që ka lënduar disa Serbë.

2. Dikur më vonë, në mbrëmje, grupe spontane të Serbëve kanë hyrë në ndërtesat që ndodheshin në rrugën “Knjaz Millosh”, rrugën “Lola Ribara”, rrugën “Tanaska Rajica, rrugën “Sutjeska” dhe në rrugën “Kralja Petra”, të banuara me familje të kombësisë Shqiptare, me qëllim që të i dëbojnë dhe të i vrasin dhe ata i kanë lënduar personat në vijim:

- a. R. A.
- b. N. A. 2
- c. A. A. 2
- d. E. XH.

E. Nuk ka mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. I pandehuri **O. I.** e ka pasur cilësinë e udhëheqësit të një grupi paramilitarësh Serb të njohur si “Rojat e Urës”.
2. Në atë rast, i pandehuri **O. I.** ka vepruar në bashkëkryerje me **D. D.**, sipas planit të përbashkët të dakorduar më parë dhe as për qëllimin për të detyruar Shqiptarët etnik të i braktisin shtëpitë e tyre dhe të largohen nga territori i Mitrovicës veriore as që ka shtyrë/urdhëruar grupin e Policëve apo “Rojat e Urës” që të i bastisin disa ndërtesa që ndodheshin në rrugët e lartcekura dhe që më forcë të i pastrojnë prej Shqiptarëve etnik.
3. Në atë rast grupe të zyrtarëve të MUP-it ose “Rojat e Urës” ishin pjesë e grupit spontan të Serbëve të cilët hynë në ndërtesat e lartcekura.

F. Prandaj

O. I. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET NGA AKUZA** sipas nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të KPK-së, nga vepra penale e Shtytjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në mënyrë të privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare në bashkëkryerje, duke rezultuar me lëndime të rënda trupore në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179, paragrafi 1.10 dhe neni 189 paragrafi 2.1 dhe 5 në lidhje me nenet 28, 31 të KPK-së, dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafi 2 dhe neni 38 paragrafi 2 të KPKSAK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KPRSFJ-së;

Lidhur me nën-akuzën **Ad. 3.**

G. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Me 03 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” që ka lënduar disa Serbë.

2. Dikur më vonë, në mbrëmje, grupe spontane të Serbëve kanë hyrë në ndërtesat që ndodheshin në rrugën “Knjaz Millosh”, rrugën “Lola Ribara”, rrugën “Tanaska Rajica”, rrugën “Sutjeska” dhe në rrugën “Kralja Petra”, të banuara me familje të kombësisë Shqiptare, me qëllim që të i dëbojnë dhe të i vrasin dhe ata i kanë sulmuar personat në vijim:

- a. S. A. 2
- b. U. A.
- c. Sh.A.
- d. V. A.
- e. G. XH.
- f. G. R.
- g. M. H. 1
- h. H. R.
- i. H. S.1

H. Nuk ka mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. I pandehuri **O. I.** e ka pasur cilësinë e udhëheqësit të një grupi paramilitarësh Serb të njohur si “Rojat e Urës”.
2. Në atë rast, i pandehuri **O. I.** ka vepruar në bashkëkryerje me **D. D.**, sipas planit të përbashkët të dakorduar më parë dhe as për qëllimin për të detyruar Shqiptarët etnik të i braktisin shtëpitë e tyre dhe të largohen nga territori i Mitrovicës veriore as që ka shtyrë/urdhëruar grupin e Policëve apo “Rojat e Urës” që të i bastisin disa ndërtesa që ndodheshin në rrugët e lartcekura dhe që më forcë të i pastrojnë prej Shqiptarëve etnik.
3. Në atë rast grupe të zyrtarëve të MUP-it ose “Rojat e Urës” ishin pjesë e grupit spontan të Serbëve të cilët hynë në ndërtesat e lartcekura.

I. Prandaj

O. I. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET NGA AKUZA** sipas nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të KPK-së, nga vepra penale e Shtytjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare* në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179, paragrafi 1.10 në lidhje me nenet 28, 31 dhe 32 të KPK-së, dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafi 2 të KPKSAK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KPRSFJ-së;

III. Për të akuzuarin D. D., me të dhëna personale si më lartë,

Për nën-akuzën Ad. 1.

A. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Me 03 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” që ka lënduar disa Serb.

2. Dikur më vonë, në mbrëmje, grupe spontane të Serbëve kanë hyrë në ndërtesat që ndodheshin në rrugën “Knjaz Millosh”, rrugën “Lola Ribara”, rrugën “Tanaska Rajica”, rrugën “Sutjeska” dhe në rrugën “Kralja Petra”, të banuara me familje të kombësisë Shqiptare, me qëllim që të i dëbojnë dhe të i vrasin dhe ata i kanë vrarë personat në vijim:

- a. N.A.1
- b. N.XH.
- c. S.A.1
- d. R.C.
- e. M.S.1
- f. S.B.
- g. N.V.2
- h. Sh.V.
- i. B.R.1
- j. N.S.1 (S.).

3. I pandehuri **D. D.** ka pasur cilësinë e komandantit të Stacionit Policorë të Mitrovicës në Ministrinë e Brendshme të Republikës Federative të Jugosllavisë (MUP).

B. Nuk ka mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Në atë rast, i pandehuri **D. D.** ka vepruar në bashkëkryerje me **O. I.**, sipas planit të përbashkët të dakorduar më parë dhe as për qëllimin për të detyruar Shqiptarët etnik të i braktisin shtëpitë e tyre dhe të largohen nga territori i Mitrovicës veriore as që ka shtyrë/urdhëruar grupin e Policëve apo “Rojat e Urës” që të i bastisin disa ndërtesa që ndodheshin në rrugët e lartcekura dhe që më forcë të i pastrojnë prej Shqiptarëve etnik.

2. Në atë rast grupe të zyrtarëve të MUP-it ose “Rojat e Urës” ishin pjesë e grupit spontan të Serbëve të cilët hynë në ndërtesat e lartcekura.

C. Prandaj

D. D. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET NGA AKUZA** sipas nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të KPK-së, nga vepra penale e Shtytjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare* në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179, paragrafi 1.10 në lidhje me nenet 31 dhe 32 të KPK-së, dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafi 2 të KPKSAK-së në lidhje me nenet 22 dhe 23 të KPRSFJ-së;

Lidhur me nën-akuzën Ad. 2.

D. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Me 03 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” që ka lënduar disa Serb.
2. Dikur më vonë, në mbrëmje, grupe spontane të Serbëve kanë hyrë në ndërtesat që ndodheshin në rrugën “Knjaz Millosh”, rrugën “Lola Ribara”, rrugën “Tanaska Rajica, rrugën “Sutjeska dhe në rrugën “Kralja Petra”, të banuara me familje të kombësisë Shqiptare, me qëllim që të i dëbojnë dhe të i vrasin dhe ata i kanë lënduar personat në vijim:
 - a. R. A.
 - b. N. A. 2
 - c. A. A. 2
 - d. E. XH.
3. I pandehuri **D.D.** ka pasur cilësinë e komandantit të Stacionit Policorë të Mitrovicës në Ministrinë e Brendshme të Republikës Federative të Jugosllavisë (MUP).

E. Nuk ka mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Në atë rast, i pandehuri **D. D.** ka vepruar në bashkëkryerje me **O. I.**, sipas planit të përbashkët të dakorduar më parë dhe as për qëllimin për të detyruar Shqiptarët etnik të i braktisin shtëpitë e tyre dhe të largohen nga territori i Mitrovicës veriore as që ka shtyrë/urdhëruar grupin e Policëve apo “Rojat e Urës” që të i bastisin disa ndërtesa që ndodheshin në rrugët e lartcekura dhe që më forcë të i pastrojnë prej Shqiptarëve etnik.
2. Në atë rast grupe të zyrtarëve të MUP-it ose “Rojat e Urës” ishin pjesë e grupit spontan të Serbëve të cilët hynë në ndërtesat e lartcekura.

F. Prandaj

D. D. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET NGA AKUZA** sipas nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të KPK-së, nga vepra penale e Shtytjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye*

kombëtare në bashkëkryerje, duke rezultuar me lëndime të rënda trupore në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179, paragrafi 1.10 dhe neni 189 paragrafi 2.1 dhe 5 në lidhje me nenet 28, 31 të KPK-së, dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafi 2 dhe nenit 38 paragrafi 2 të KPKSAK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KPRSFJ-së;

Lidhur me nën-akuzën Ad. 3.

G. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Me 03 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” që ka lënduar disa Serb.
2. Dikur më vonë, në mbrëmje, grupe spontane të Serbëve kanë hyrë në ndërtesat që ndodheshin në rrugën “Knjaz Millosh”, rrugën “Lola Ribara”, rrugën “Tanaska Rajica, rrugën “Sutjeska dhe në rrugën “Kralja Petra”, të banuara me familje të kombësisë Shqiptare, me qëllim që të i dëbojnë dhe të i vrasin dhe i kanë sulmuar personat në vijim:
 - a. S. A. 2
 - b. U. A.
 - c. Sh. A.
 - d. V. A.
 - e. G. XH.
 - f. G. R.
 - g. M. H. 1
 - h. H. R.
 - i. H. S. 1
3. I pandehuri **D. D.** ka pasur cilësinë e komandantit të Stacionit Policorë të Mitrovicës në Ministrinë e Brendshme të Republikës Federative të Jugosllavisë (MUP).

H. Nuk ka mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Në atë rast, i pandehuri **D. D.** ka vepruar në bashkëkryerje me **O. I.**, sipas planit të përbashkët të dakorduar më parë dhe as për qëllimin për të detyruar Shqiptarët etnik të i braktisin shtëpitë e tyre dhe të largohen nga territori i Mitrovicës veriore as që ka shtyrë/urdhëruar grupin e Policëve apo “Rojat e Urës” që të i bastisin disa ndërtesa që ndodheshin në rrugët e lartcekura dhe që më forcë të i pastrojnë prej Shqiptarëve etnik.
2. Në atë raste grupe të zyrtarëve të MUP-it ose “Rojat e Urës” ishin pjesë e grupit spontan të Serbëve të cilët hynë në ndërtesat e lartcekura.

I. Prandaj

D. D. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET NGA AKUZA** sipas nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të KPK-së, nga vepra penale e Shtytjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare* në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179, paragrafi 1.10 në lidhje me nenet 28, 31 dhe 32 të KPK-së, dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafi 2 të KPKSAK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KPRSFJ-së;

IV. Lidhur me të akuzuarin N. V. 1, me të dhëna personale si më lartë

Lidhur me nën-akuzën Ad. 1.

A. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Me 03 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” që ka lënduar disa Serb.
2. Dikur më vonë, në mbrëmje, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm me përdorimin e pajisjeve shpërthyes në banesën që ndodhet në rrugën “Lola Ribara” nr. 3, e banuar nga familjet A. a dhe XH. dhe i kanë vrarë personat në vijim:
 - a. N. A. 1
 - b. N. XH.

B. Nuk ka mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **N. V. 1** ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit paramilitar të Serbëve të njohur si “Rojat e Urës”.
2. Në atë rast, **N. V. 1** ka vepruar me **I. V.** dhe **A. (S.) L.**, në bazë të planit të përbashkët të dakorduar më parë dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyes në banesën e lartcekur.

C. Prandaj

N. V. 1 SHPALLET I PAFAJSHËM dhe **LIROHET NGA AKUZA** sipas nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të KPK-së, nga vepra penale e vrasjes së rëndë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare* në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179, paragrafi 1.10 në lidhje me nenin 31 të KPK-së, dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafi 2 të KPKSAK-së në lidhje me nenin 22 të KPRSFJ-së;

Lidhur me nën-akuzën Ad. 2.

D. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Me 03 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” që ka lënduar disa Serb.
2. Dikur më vonë, në mbrëmje, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm me përdorimin e pajisjeve shpërthyesë në banesën që ndodhet në rrugën “Lola Ribara” nr. 3, e banuar nga familjet A.1 dhe XH. duke i lënduar personat në vijim:
 - a. R.A.
 - b. N. A. 2
 - c. A. A.2
 - d. E. XH..

E. Nuk ka mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **N. V. 1** e ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit të paramilitareve serb të njohur si ‘Rojet e Urës’.
2. Në atë rast, **N. V.1** ka vepruar në bashkëkryerje me **I. V.** dhe **A. (S.) L.ç** sipas planit të përbashkët të akorduar me pare dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyesë në banesën e lartcekur.

F. Prandaj

N. V.1 SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET**, sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së, për veprën penale tentim vrasje e rëndë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare*, në bashkëkryerje, duke rezultuar me lëndime të rënda trupore në bazë të nenit 179 § 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nën nenin 30 § 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LP RSFJ-së.

Lidhur me nën-akuzën Ad. 3.

G. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Me 3 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” ku u lënduan disa Serb.
2. Më vonë, gjatë natës, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm duke përdorur mjete shpërthyesë në banesat e banuara nga familjet A. 1 dhe XH. që ndodheshin në rrugën Lola Ribara numër 3 dhe kanë kryer sulm kundër këtyre personave:
 - a. S. A. 2

- b. U. A.
- c. Sh. A.
- d. V. A.
- e. G. XH.

H. Nuk ka mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **N. V. 1** e ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit të paramilitareve serb të njohur si 'Rojet e Urës'.
2. Në atë rast, **N. V.1** kishte vepruar në bashkëkryerje me **I. V.** dhe **A. (S.) L.** sipas planit të përbashkët të akorduar me pare dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyes në banesën e lartcekur.

I. Prandaj

N. V.1 SHPALLET I PAFAJSHËM dhe **LIROHET**, sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së, për veprën penale tentim vrasje e rëndë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare*, në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179 § 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nën nenin 30 § 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LP RSFJ-së.

V. Lidhur me të akuzuarin I. V., me të dhënat personale si më lartë

Lidhur me nën-akuzën Ad. 1.

A. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Me 3 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë "Bel Ami" ku u lënduan disa Serb.
2. Më vonë, gjatë natës, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm duke përdorur mjete shpërthyes në banesat e banuara nga familjet A.1 dhe XH. që ndodheshin në rrugën Lola Ribara numër 3 dhe kanë kryer sulm kundër këtyre personave:

- a. N. A.1
- b. N. XH.

B. Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **I. V.** ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit të paramilitareve serb të njohur si ‘Rojet e Urës’.

2. Në atë rast, **I. V.** kishte vepruar në bashkëkryerje me **N. V.1** dhe **A. (S.) L.** sipas planit të përbashkët të akorduar me pare dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyes në banesën e lartcekur.

C. Prandaj

I. V. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET**, sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së, për veprën penale tentim vrasje e rëndë në mënyrë të privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare, në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179 § 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nën nenin 30 § 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LP RSFJ-së.

Lidhur me nën-akuzën **Ad. 2.**

D. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Me 3 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” ku u lënduan disa Serb.

2. Më vonë, gjatë natës, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm duke përdorur mjete shpërthyes në banesat e banuara nga familjet A.1 dhe XH. që ndodheshin në rrugën Lola Ribara numër 3 dhe kanë kryer sulm kundër këtyre personave:

- a. R. A.
- b. N. A.2
- c. A. A 2
- d. E. XH.

E. Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **I. V.** ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit të paramilitareve serb të njohur si ‘Rojet e Urës’.

2. Në atë rast, **I. V.** kishte vepruar në bashkëkryerje me **N. V.1** dhe **A. (S.) L.** sipas planit të përbashkët të akorduar me pare dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyes në banesën e lartcekur.

F. Prandaj

I. V. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET**, sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së, për veprën penale tentim vrasje e rëndë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare*, në bashkëkryerje, duke rezultuar me lëndime të rënda trupore në bazë të nenit 179 § 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nën nenin 30 § 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LP RSFJ-së.

Lidhur me nën-akuzën Ad. 3.

G. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Me 3 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” ku u lënduan disa Serb.
2. Më vonë, gjatë natës, me qëllim për të vrarë, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm duke përdorur mjete shpërthyese në banesat e banuara nga familjet A.1 dhe XH. që ndodheshin në rrugën Lola Ribara numër 3 dhe kanë kryer sulm kundër këtyre personave:
 - a. S. A. 2
 - b. U. A.
 - c. Sh. A.
 - d. V. A.
 - e. G. XH.

H. Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **I. V.** ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit të paramilitareve serb të njohur si ‘Rojet e Urës’.
2. Në atë rast, **I. V.** kishte vepruar në bashkëkryerje me **N. V.1** dhe **A. (S.) L.** sipas planit të përbashkët të akorduar me pare dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyese në banesën e lartcekur.

I. Prandaj

I. V. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET**, sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së, për veprën penale tentim vrasje e rëndë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare*, në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179 § 1.10 në

lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nën nenin 30 § 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LP RSFJ-së.

VI. Lidhur me të akuzuarin Aleksandar (Sasha) Lazović, me të dhënat personale si më lartë

Lidhur me nën-akuzën Ad. 1.

A. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Me 3 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” ku u lënduan disa Serb.

2. Më vonë, gjatë natës, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm duke përdorur mjete shpërthyes në banesat e banuara nga familjet A.1 dhe XH. që ndodheshin në rrugën Lola Ribara numër 3 dhe kanë kryer sulm kundër këtyre personave:

- a. N.A. 1
- b. N. XH.

B. Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **A. (S.) L.** ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit të paramilitareve serb të njohur si ‘Rojet e Urës’.

2. Në atë rast, **A. (S.) L.** kishte vepruar në bashkëkryerje me **I. V.** dhe **N. V. 1** sipas planit të përbashkët të akorduar me pare dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyes në banesën e lartcekur.

C. Prandaj

A. (S.) L. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET**, sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së, për veprën penale tentim vrasje e rëndë në mënyrë të privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare, në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179 § 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nën nenin 30 § 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LP RSFJ-së.

Lidhur me nën-akuzën Ad. 2.

D. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Me 3 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” ku u lënduan disa Serb.

2. Më vonë, gjatë natës, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm duke përdorur mjete shpërthyes në banesat e banuara nga familjet A.1 dhe XH. që ndodheshin në rrugën Lola Ribara numër 3 dhe kanë kryer sulm kundër këtyre personave:

- a. R. A.
- b. N. A. 2
- c. A. A. 2
- d. E. XH.

E. Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **A. (S.) L.** ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit të paramilitareve serb të njohur si ‘Rojet e Urës’.

2. Në atë rast, **A. (S.) L.** kishte vepruar në bashkëkryerje me **I. V.** dhe **N. V.1** sipas planit të përbashkët të akorduar me pare dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyes në banesën e lartcekur.

F. Prandaj

A. (S.) L. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET**, sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së, për veprën penale tentim vrasje e rëndë në mënyrë të *privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare*, në bashkëkryerje, duke rezultuar me lëndime të rënda trupore në bazë të nenit 179 § 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nën nenin 30 § 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LP RSFJ-së.

Lidhur me nën-akuzën Ad. 3.

G. Faktet në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Me 3 shkurt 2000 në Mitrovicën veriore, në orët e mbrëmjes ka ndodhur një shpërthim në kafenenë “Bel Ami” ku u lënduan disa Serb.

2. Më vonë, gjatë natës, me qëllim për të vrarë, grupe spontane të Serbëve kanë lansuar një sulm duke përdorur mjete shpërthyes në banesat e banuara nga familjet A.1 dhe XH. që ndodheshin në rrugën Lola Ribara numër 3 dhe kanë kryer sulm kundër këtyre personave:

- a. S. A.2
- b. U. A.
- c. Sh. A.
- d. V. A.
- e. G. XH.

H. Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. **A. (S.) L.** ka pasur cilësinë e pjesëtarit të grupit të paramilitareve serb të njohur si 'Rojet e Urës'.

2. Në atë rast, **A. (S.) L.** kishte vepruar në bashkëkryerje me **I. V.** dhe **N. V.** sipas planit të përbashkët të akorduar me pare dhe kanë lansuar sulmin me përdorimin e pajisjeve shpërthyes në banesën e lartcekur.

I. Prandaj

A. (S.) L. SHPALLËT I PAFAJSHËM dhe **LIROHET**, sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPP-së, për veprën penale tentim vrasje e rëndë në mënyrë të privimit nga jeta të një personi tjetër për arsye kombëtare, në bashkëkryerje, në bazë të nenit 179 § 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe e ndëshkueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nën nenin 30 § 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LP RSFJ-së.

VII. Llogaritja e Paraburgimit

Për të pandehurin **O. I.**, duke pasur parasysh dënimin për piken 1 të akuzës, koha e kaluar në burg që nga 27 janar 2014 dhe 18 shtator 2015 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 18 shtator 2015 deri më sot do të llogariten në dënimin e shqiptuar, sipas nenit 83 paragrafi (1) dhe (4) i KPK-së lidhur me nenin 365 paragrafi (1. 5) KPP-së.

VIII. Shpenzimet procedurale

Në bazë të nenit 450-457 të KPPK-së dhe nenit 365 paragrafi 1.6 i KPP-së i akuzuari **O. I.** do të paguaj 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale përderisa çdo shpenzim i mbetur i procedurës penale do të paguhet nga burimet e buxhetit.

IX. Kërkesat pasurore juridike

Sipas nenit 365 paragrafi 1.6 i KPP-së, palët e dëmtuara: Xh. S., Sh. K.1, K. A., si dhe R. A., S. A.2, E. Xh. , G. Xh., Gj. S., Sh. C. 2, L. A. 2, H. S.1 , H. R., M. H. 1 dhe U. A. udhëzohen se mund të parashtrojnë kërkesat pasurore juridike në procedurë civile sipas nenit 463 Paragrafi (1) KPP.

Trupi gjykues nuk do i adresohet kërkesës pasurore juridike të dorëzuar nga M. Ll. pasi që në këtë rast ai nuk është në cilësinë e palës së dëmtuar.

PJESA E DYTË: ARËSYETIMI

I. RRJEDHA PROCEDURALE

I. A. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Hetimi penal për këtë lëndë ka filluar më 21 shkurt 2013 përmes Aktvendimit të Prokurorit. Më 1 tetor 2013, hetimi u zgjerua kundër të Pandehurit **O.I.** për ta përfshirë veprën penale të “Krimeve të luftës kundër popullatës civile.” Hetimi më pas u zgjerua më datat 10 mars dhe 14 prill 2014, për t’i përfshirë të dyshuarit tjerë. Më 2 prill 2014 janë dorëzuar prova shtesë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës së bashku me Vendimin e 10 marsit për Zgjerimin e Hetimeve.
2. Të pandehurit **O. I.** dhe **D. D.** ishin nën masën e paraburgimit që nga arrestimi i tyre më 27 janar 2014 dhe 4 shkurt 2014 përkatësisht, deri më 18 shtator 2015 kur paraburgimi u zëvendësua me masën e arrestit shtëpiak. Arresti shtëpiak kundër të dy të pandehurve më pas u vazhdua dhe zgjati deri në shpalljen e aktgjykimit. I pandehuri **N. V. 1** që vendosur nën masën e paraburgimit pas arrestimit të tij më 15 prill 2014 deri më 25 qershor 2014 kur masa e paraburgimit u zëvendësua me arrest shtëpiak. Më 19 gusht 2014, pas ngritjes së Aktakuzës në këtë lëndë, Kryetarja e trupit gjykues mbajti një seancë dëgjimore për paraburgim dhe urdhëroi paraburgimin kundër të pandehurve **N. V. 1** dhe **A. L.**, ndërsa i pandehuri **I. V.** që vendosur nën masën e ndalesës së afrimit një

vendi apo personi të posaçëm dhe paraqitje në stacion policor. Më 5 gusht 2015, masa e paraburgimit kundër të pandehurve **N. V. 1** dhe **A. L.** u zëvendësua me masën e ndalesës së afrimit të një vendi apo personi të posaçëm dhe paraqitje në stacionin policor. Këta dy të pandehur si dhe i pandehuri **I. V.** mbetën në masat e ndalesës deri në shpalljen e aktgjykimit.

3. Më 11 gusht 2014, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (“Prokurori”) e ngriti Aktakuzën PPS 04/2013 kundër pesë të pandehurve në Shkrimoren e Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Prokurori më pas i bëri disa korrigjime jo-substanciale në Aktakuzë, duke përfshirë shënimin e saktë të lokacioneve që përmenden aty.¹
4. Më 30 maj 2014, hyri në fuqi Ligji nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve lidhur me Mandatin e Misioni të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës - GZRK nr. 32/2014 - 15 maj 2014 (“Ligji për Mandatin e EULEX-it”). Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Mandatin e EULEX-it, më 18 qershor 2014 u nënshkrua një Marrëveshje ndërmjet Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Aspektet Relevante të Veprimit dhe Bashkëpunimit të Gjyqtarëve të EULEX-it me Gjyqtarët e Kosovës që punojnë në Gjykatat Vendore (“Marrëveshja”).
5. Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve nga Ligji për Mandatin e EULEX-it dhe siç është specifikuar më tutje në Marrëveshje, me Aktvendimin GJA nr. 458/14, të datës 11.08.2014, Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës e caktoi Gjyqtaren e EULEX-it Roxana Comsa si Kryetare e trupit gjykues në këtë lëndë.
6. Më 26 gusht 2014, Kryetarja e trupit gjykues mbajti Dëgjimin Fillestar në përputhje me nenin 245 të KPP-së. Në këtë dëgjim fillestar, të gjithë të pandehurit u deklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat.
7. Në vend të mbajtjes së dëgjimit të dytë, Kryetarja e trupit gjykues kërkoi nga palët të dorëzojnë parashtrës me shkrim në përputhje me nenet 245 (5) dhe 256 të KPP-së brenda tridhjetë (30) ditësh – gjegjësisht deri më 26 shtator 2014.
8. Kërkesa e avokatit mbrojtës për të pandehurin **O. I.**, z. N. V. 3 dhe z. Lj. P., për ta vazhduar afatin e fundit për paraqitjen e propozimeve është refuzuar si e pabazuar më 10 shtator 2014.

¹ *Shih* Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, paragrafët. 20-27.

9. Më 30 shtator 2014, prova të reja u paraqitën nga Prokurori në përputhje me nenin 244 paragrafi (3) të KPP-së. Provat e përmendura i janë dorëzuar Mbrojtjes në mënyrë të rregullt.
10. Kryetarja e trupit gjykues lëshoi një Aktvendim, të datës 31 tetor 2014, duke i refuzuar si të pabazuara të gjitha propozimet e Mbrojtjes lidhur me kundërshtimet ndaj provave dhe kërkesave për hedhjen poshtë të aktakuzës. Aktvendimi iu dorëzua palëve më 11 nëntor 2014. Kundër këtij Aktvendimi nuk janë paraqitur ankesa.
11. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 18 dhjetor 2014. Seancat pasuese të shqyrtimit gjyqësore u mbajtën më 21, 22, 23 dhe 26 janar 2015, 18-26 shkurt 2015, 11, 24-30 mars 2015, 22-27 prill 2015, 5-8, 11-14, dhe 20 maj 2015, 15, 29 dhe 30 qershor 2015, 2, 6-9, 13-15, 21-23, 28-31 korrik 2015, 3 dhe 4 gusht 2015, 10, 11, 15, 16, 17, 21 shtator 2015, 6-8, 13, 14, 20, 21, 27, 28 tetor 2015, 10, 17, 19, 20, 23 dhe 24 nëntor 2015, 1, 2, 4, 8-10, 15 dhe 17 dhjetor 2015, dhe 18 janar 2016. Gjykata i dëgjoi në total 86 dëshmitarë, përfshirë të gjithë të Pandehurit.
12. Me 21 Janar 2016, Trupi Gjykues shpalli aktgjykimin në praninë e Palëve.

I. B. KODI I PROCEDURËS

13. Më 1 janar 2013 hyri në fuqi në Kosovë një Kod i ri i Procedurës Penale. Kodi i Procedurës Penale (04/L-123) (KPP) e zëvendësoi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (e ndryshuar) (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26) (KPPPK) (nenet 545(2) dhe 547 të KPP-së). KPP-ja e re është zbatuar në procedurën për këtë lëndë, në përputhje me dispozitat kalimtare të këtij kodi.²

I. C. KOMPETENCA

² *Shih* Nenin 539 KPP.

14. Sipas nenit 11, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat³, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.
15. Neni 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë. Bazuar në Aktakuzën e ngritur, veprat e pretenduara penale kanë ndodhur në pjesët jugore dhe veriore të Mitrovicës dhe, rrjedhimisht, bien brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29, paragrafi 1, i KPP-së.
16. Sipas nenit 15, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11 i Ligjit të lartcekur për Gjykatat, veprat penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Vrasjes së Rëndë bien në juridiksionin e Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore. Prandaj, e tërë lënda është gjykuar nga Departamenti i Krimeve të Rënda.
17. Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 15 të Ligjit për Gjykatat, dhe në përputhje me Ligjin për Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë⁴, lënda është dëgjuar nga një Trup Gjykues i përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa, në cilësinë e Kryetares së trupit gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Vitor Pardal dhe Gjyqtarit të EULEX-it Nuno de Madureira, si anëtarë të trupit gjykues. Nuk ka pasur kundërshtime sa i përket përbërjes së Trupit Gjykues.

I. D. PROVAT E PARAQITURA

A. Dëshmitë në Gjykatë

18. Trupi Gjykues i dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve të poshtëshënuar gjatë shqyrtimit gjyqësor:

Dëshmitarët e Prokurorisë:

³ Ligji nr. 03/L-199.

⁴ Ligji nr. 03/L-053.

1. I. M. 1 (Pika I), më 21 dhe 22 Janar 2015
2. Xh.S. (Pika I), më 22 dhe 23 Janar 2015
3. M. Ll. (Pika I), më 23 dhe 26 Janar 2015
4. Sh. K. 1 (Pika I), 18 Shkurt 2015
5. K. A. (Pika I), më 19 Shkurt 2015
6. B. F. (Pika I), më 20 Shkurt 2015
7. M. M. 1 (Pika I), më 23 Shkurt 2015
8. F. P. (Pika I), më 24 Shkurt 2015
9. Z. A. (Pika I), më 25 Shkurt 2015
10. N. A. 3 (Pika I), më 25 Shkurt 2015
11. F. H. (Pika I), më 26 Shkurt 2015
12. Ç. I. (Pika I), më 11 Mars 2015
13. B. S. 1 (Pika I), më 11 Mars 2015
14. B. M. (Pika I), më 24 Mars 2015
15. B. I. (Pika I), më 24 Mars 2015
16. B. R. 2 (Pikat I dhe II), më 25 Mars 2015
17. M. H. 2 (Pika I), më 26 Mars 2015
18. Sh. C. 1 (Pika I), më 27 Mars 2015
19. H. B. (Pika II), më 30 Mars 2015
20. Sh. C. 1 (Pika II), më 22 Prill 2015
21. G. Xh. (Pika II), më 23 Prill 2015
22. R. A. (Pika II), më 24 Prill 2015
23. S. A. 2 (Pika II), më 27 Prill 2015
24. P. A. (Pika II), më 5 Maj 2015
25. B. S. 2 (Pika II), më 7 Maj 2015
26. R. N. 1 (Pika II), 7 Maj 2015
27. E. S. (Pika II), 8 Maj 2015
28. Sh. A. (Pika II), 11 dhe 12 Maj 2015
29. V. A. (Pika II), 13 dhe 20 Maj 2015
30. Gj. S. (Pika II), 14 Maj 2015
31. A. A. 2 (Pika II), 15 Qershor 2015
32. I. M. 3 (Pika II), 29 Qershor 2015
33. Sh. H. (Pika II), 30 Qershor 2015
34. H. R. (Pika II), 2 Korrik 2015
35. Dëshmitari X (Pika II), 6, 7 dhe 8 Korrik 2015
36. I. R. 1 (Pika II), 9 Korrik 2015
37. A. V. (Pika II), 13 Korrik 2015
38. M. M. 2 (Pika II), 14 Korrik 2015
39. A. S. 1 (Pika II), 15 Korrik 2015
40. E. B. (Pika II), 21 Korrik 2015
41. E. D. (Pika II), 22 Korrik 2015
42. F. J.i (Pika II), 23 Korrik 2015
43. E. J. (Pika II), 23 Korrik 2015
44. Dëshmitari Y (Pika II), 28, 29 dhe 30 Korrik 2015
45. N.H. (Pika II), 3 Gusht 2015
46. G. R. (Pika II), 4 Gusht 2015

47. L. A. 2 (Pika II), 10 Shtator 2015
48. I. R. 2 (Pika II), 10 Shtator 2015
49. B. P. (Pika II), 11 Shtator 2015
50. M. Sh. (Pika II), 15 Shtator 2015
51. D. Sh. (Pika II), 15 Shtator 2015
52. H. S.1 (Pika II), 16 Shtator 2015
53. M. H.3 (Pika II), 16 Shtator 2015
54. G. M. (Pika II), 17 Shtator 2015
55. M. H.1 (Pika II), 1 Dhjetor 2015

Dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja e O. I.:

56. L. A.1 (Pika I), 26 Mars 2015
57. B. K. (Pika I), më 6 Tetor 2015
58. D. M. 1 (Pika I), më 7 Tetor 2015
59. A. D. (Pikat I dhe II), më 8 Tetor 2015
60. N. K. (Pikat I dhe II), më 8 dhe 13 Tetor 2015
61. R. J. (Pika II), më 13 Tetor 2015
62. N. S. 2 (Pika II), më 14 Tetor 2015
63. Z. Đ. (Pika II), më 14 Tetor 2015
64. G. P. (Pika II), 15 Tetor 2015
65. O. M. (Pikat I dhe II), më 15 Tetor 2015
66. D. M. 2 (Pika II), më 20 Tetor 2015

Dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja e D. D.:

67. Lj. M. (Pika II), më 20 dhe 21 Tetor 2015
68. R. Š. (Pika II), më 27 Tetor 2015
69. J. G. 1 (Pika II), më 27 Tetor 2015
70. S. K. 2 (Pika II), më 28 Tetor 2015
71. V. V. (Pika II), më 17 Nëntor 2015
72. N. S. 3 (Pika II), më 17 Nëntor 2015
73. S. R. (Pika II), 19 Nëntor 2015
74. D. M. 3 (Pika II), 24 Nëntor 2015

Dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja e N. dhe I. V.:

75. M. T. (Pika II), më 10 Nëntor 2015
76. I. D. (Pika II), më 10 Nëntor 2015
77. D. K. (Pika II), më 20 Nëntor 2015

78. M. S.2 (Pika II), më 20 Nëntor 2015
79. N. V. 4 (Pika II), më 23 Nëntor 2015
80. B. G. (Pika II), më 23 Nëntor 2015
81. R. V. (Pika II), më 24 Nëntor 2015

Të gjithë të Pandehurit dëshmuan si në vijim:

- **O. I.** më 4 dhe 8 Dhjetor 2015
- **D. D.** më 9 Dhjetor 2015
- **N. V. 1** më 9 Dhjetor 2015
- **I. V.** më 10 Dhjetor 2015
- **A. L.** më 10 Dhjetor 2015

Këta dëshmitarë u refuzuan nga Trupi Gjykses:

- Një shoqe e V. A. (emri nuk dihet) e përmendur nga kjo dëshmitarë në dëshminë e saj në gjykatë më 20 maj 2015.⁵

B. Provat materiale të pranuar në prova

19. Këto prova materiale janë pranuar në prova:

- I. Prova materiale 1 – një skicë e bërë nga dëshmitari I. M.1
- II. Prova materiale 2 - një skicë e bërë nga dëshmitari I. M. 1
- III. Prova materiale 3 - një skicë e bërë nga dëshmitari Xh. S.
- IV. Prova materiale 4 - një skicë e bërë nga dëshmitari M. Ll.
- V. Prova materiale 5 - një skicë e bërë nga dëshmitari M. Ll.
- VI. Prova materiale 6 - një skicë e bërë nga dëshmitari Sh. K.1
- VII. Prova materiale 7 - një skicë e bërë nga dëshmitari B. F.

⁵ Arsyetimi i trupit gjykses se pse ky dëshmitar i propozuar nga Mbrojtja e **O. I.** nuk është pranuar ndodhet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 17 nëntor 2015, paragrafët. 331-336.

- VIII. Prova materiale 8 - një skicë e bërë nga dëshmitari M. M.1
- IX. Prova materiale 9 - një skicë e bërë nga dëshmitarja F. P.
- X. Prova materiale 10 - një skicë e bërë nga dëshmitari G. Xh.
- XI. Prova materiale 11 – një plan i banesës së A.1, i dorëzuar nga mbrojtja e **D. D.**
- XII. Prova materiale 12 - një skicë e bërë nga dëshmitarja R. A.
- XIII. Prova materiale 13 - një plan i banesës së A.1 , i dorëzuar nga mbrojtja e **O.I.**
- XIV. Prova materiale 14 – një kopje e provës materiale 13 e shënjuar nga dëshmitarja R. A.
- XV. Prova materiale 15 – një plan i katit ku ndodhet banesa e A.1, i dorëzuar nga mbrojtja e **O. I.**
- XVI. Prova materiale 16 – një kopje e provës materiale 13 e shënjuar nga dëshmitarja S. A. 2
- XVII. Prova materiale 17 – një kopje e provës materiale 13 e shënjuar nga dëshmitari Sh. A.
- XVIII. Prova materiale 18 – një kopje e provës materiale 13 e shënjuar nga dëshmitarja V.A.
- XIX. Prova materiale 19 – a një kopje e provës materiale 13 e shënjuar nga dëshmitari A. A.
- XX. Prova materiale 20 – një skicë e bërë nga dëshmitari I. M.
- XXI. Prova materiale 21 – një fotografi e dorëzuar nga mbrojtja e **D. D.** dhe e shënjuar nga dëshmitari Sh. H.
- XXII. Prova materiale 22 - një fotografi e dorëzuar nga mbrojtja e **D. D.**, e komentuar dhe shënjuar nga dëshmitari Sh. H..⁶
- XXIII. Prova materiale 23 – një skicë e sheshit Šumadija e dorëzuar nga mbrojtja e **D. D.**, e komentuar dhe shënjuar nga dëshmitari Sh. H.

⁶ Shënim: Shënjimi me ngjyrë të verdhë është bërë nga mbrojtja për përdorimin e tyre të brendshëm dhe nuk është relevant për dëshminë e dëshmitarit. *Shih* Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 30 qershor 2015, paragrafët. 344-345.

- XXIV. Prova materiale 24 – një skicë e dorëzuar nga mbrojtja e **D. D.** dhe e komentuar nga dëshmitari X
- XXV. Prova materiale 25 – një skicë e bërë nga dëshmitari Y
- XXVI. Prova materiale 26 – një skicë e dorëzuar nga mbrojtja e I. V. dhe e komentuar nga dëshmitarja N. V.4.

C. Provat dokumentuese

20. Provat dokumentuese në vijim janë pranuar në prova:

Provat e paraqitura nga Prokuroria:

1. Policia e UNMIK-ut, Memorandum i brendshëm, i datës 22/09/2000 (ref. 1999/00286), 705-718 (Regjistratori III)
2. Policia e EULEX-it, Fotografitë e vendit të ngjarjes me pjesëmarrjen e B. F. të datës 22/08/2013, 719-738 (Regjistratori III)
3. Policia e UNMIK-ut, Fotografitë e vendit të ngjarjes, të datës 26/05/2000, 739-744 (Regjistratori III)
4. Shikimi i vendit të ngjarjes nga B. M., të datës 15/04/1999, 745-753 (Regjistratori III)
5. Policia e UNMIK-ut, Raporti para vdekjes i F. M. të datës 21/10/2004 dhe dokumentet tjera lidhur me vdekjen e F. M., 754-775 (Regjistratori III)
6. Çertifikatat e Vdekjes së A. A.1, S.P., M. S. dhe F. M. të lëshuara më 18/06/2013, 776-778 (Regjistratori III)
7. Lista e UNMIK-ut të personave të zhdukur që janë identifikuar në Vidimiric, krahasuar me listën e personave të zhdukur në rrugën Popović 14/04/1999, 779-783 (Regjistratori III)
8. KFOR, Artikull Biografik i **O. I.**, të datës 12/11/2001, 784-810 (Regjistratori III)
9. KFOR, Biografia e **O. I.**, të datës mars 2000, 811-827 (Regjistratori III)

10. Letër e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, Drejtoria e Policisë, Administrata e Policisë Kriminale, Departamenti për Zbulimin e krimeve të luftës, të datës 04/03/2014 (ref. 76-2/14-12), 828-844 (Regjistratori III)
11. Deklarata e Ç. I. e datës 02/03/1999 dhënë Halit BARANIT, 845-847 (Regjistratori III)
12. Dosjet e Arkivit të Zyrës së Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, 1999, Kabllogram i Koduar Regjistratori-2, Kabllogram i Koduar Shkues, PËR 'MIYET, UNATIONS, New York', NGA: 'Kouchner, UNMIK, Prishtinë', të datës 22/10/1999, 1907-1910 (Regjistratori VI)
13. Dosjet e Arkivit të Zyrës së Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, 1999, Kabllogram i Koduar Regjistratori-3, Kabllogram i Koduar Shkues, PËR 'MIYET, UNATIONS, New York', NGA: 'Kouchner, UNMIK, Prishtinë', të datës 30/11/1999, 1911-1914 (Regjistratori VI)
14. Dosjet e Arkivit të Zyrës së Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, 1999, Kabllogram i Koduar Regjistratori-3, Kabllogram i Koduar Shkues, PËR 'MIYET, UNATIONS, New York', NGA: 'Kouchner, UNMIK, Prishtinë', të datës 03/01/2000, 1915-1918 (Regjistratori VI)
15. Dosjet e Arkivit të Zyrës së Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, 1999, Kabllogram i Koduar Regjistratori-3, Kabllogram i Koduar Shkues, PËR 'MIYET, UNATIONS, New York', NGA: 'Kouchner, UNMIK, Prishtinë', të datës 04/01/2000, 1919-1929 (Regjistratori VI)
16. Dosjet e Arkivit të Zyrës së Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, 1999, Kabllogram i Koduar Regjistratori-3, Kabllogram i Koduar Shkues, PËR 'MIYET, UNATIONS, New York', NGA: 'Kouchner, UNMIK, Prishtinë', të datës 08/02/2000', 1930-1934 (Regjistratori VI)
17. UNMIK, Njoftim për Shtypin, PSSP Kouchner viziton Mitrovicën, të datës 06/02/2000 1935-1936 (Regjistratori VI)
18. Misioni Monitorues i Komisionit Evropian, Zyra Rajonale Prishtinë, Vlerësimi Javor # 28-00, 15-21 Korrik 2000, 1937-1941 (Regjistratori VI)
19. *Kosova shkon drejt ndarjes etnike*, The Independent, nga Raymond Whitaker në Mitrovicë, Kosovo, të datës 27/02/2000, 1942-1945 (Regjistratori VI)

20. *12 vite pas masakrës në Mitrovicë, kriminelët Serb kanë kaluar në politikanë*, ëëë.lajmeshqip.com, të datës 03/02/2012, 1946-1968 (Regjistratori VI)
21. *Ne duhet të luftojmë*, www.ex-yupress.com, nga Petar Arsic, të datës 17/02/2000, 1969-1974 (Regjistratori VI)
22. *Historia jonë po rritet, Gjeografia jonë po tkurret*, www.ex-yupress.com, nga Slavisa Lekic, të datës 08/03/2000, 1975-1986 (Regjistratori VI)
23. *O. I. e ndërroi emrin e listës*, www.rts.rs, të datës nëntor 2013, 1987-1988 (Regjistratori VI)
24. *I.: Një vendim i gabuar e unifikoi listën*, Beta, të datës 15/09/2013, 1989-1992 (Regjistratori VI)
25. *K-For 'qëndroi prapa' në Mitrovicë*, BBC NEWS, nga Nicholas Wood në Kosovë, të datës 09/02/2000, 1993-2002 (Regjistratori VI)
26. *Trupat Franceze në Kosovë Akuzohen për Tërheqje*, The Washington Post Online, nga R. Jeffrey Smith, të datës 09/02/2000, 2003-2008 (Regjistratori VI)
27. *Serbët të Tërbuar pas Sulmit në një Qytet të Kosovës*, The New York Times Online, nga Carlotta Gall, 09/02/2000, 2009-2013 (Regjistratori VI)
28. *Shqiptarët Etnik Ikin nga Luftimet në Mitrovicë*, The Irish Times, nga Christian Jennings, 14/02/2000, 2014-2017 (Regjistratori VI)
29. Vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë të datës 25/10/1999 (ref. 112-2/99) mbi emërimin e **D. D.** në pozitën e Komandantit të Stacionit Policor në Mitrovicë, 2018-2020 (Regjistratori VI)
30. *Depërtuar nga Raketa*, KFOR, nga Maj Morten Karlsen, të datës shkurt 2000, 2021-2026 (Regjistratori VI)
31. Dokumenti 'Pandora' rreth aktivitetit të Policisë Serbe në shkelje të Rezolutës 1244 që e tregon **D. D.** si Komandant të Policisë – Shef i SUP-it, 2027-2052 (Regjistratori VI)
32. KFOR, Artikull Biografik për **D. D.**, të datës 09/09/2001, 2053-2058 (Regjistratori VI)
33. *Eskaloni dhuna në Kosovë*, The Washington Post Online, nga R. Jeffrey Smith, të datës 14/02/2000, 2059-2065 (Regjistratori VI)

34. UNMIK: Situata në Mitrovicë, Raportim në Këshillin e Sigurimit, të datës 02/02/2000 dhe 03/02/2000, 2066-2071 (Regjistratori VI)
35. Program i televizionit Japonez (CD), 2072 (Regjistratori VI)
36. Policia e EULEX-it, Fotografitë nga Vendi i Ngjarjes, të datës 12/11/2013, 2073-2084 (Regjistratori VI)
37. *Nata e Vrasjeve në Mitrovicë*, KOHA Ditore, të datës 05/02/2000, 2085-2089 (Regjistratori VI)
38. *Francezët hedhin gaz lotsjellës mbi Shqiptarët*, Serbët duartrokasit, KOHA Ditore, të datës 06/02/2000, 2090-2093 (Regjistratori VI)

Dokumentet në vijim janë nga shkresat e lëndës PPN 30/00 nga Prokuroria e Mitrovicës – vrasja e VOCËS:

39. Policia e UNMIK-ut, Raporti Fillestar/ i Incidentit, të datës 04/02/2000, 2094-2101 (Regjistratori VI)
40. Policia e UNMIK-ut, Raporti Fillestar, të datës 04/02/2000, 2102-2104 (Regjistratori VI)
41. Policia e UNMIK-ut, Raporti Hetimor, të datës 04/02/2000, 2105-2115 (Regjistratori VI)
42. Policia e UNMIK-ut, Raporti i Identifikimit Mjekoligjor, të datës 04/02/2000 dhe 10/02/2000, 2116-2130 (Regjistratori VI)
43. Çertifikata e Vdekjes së Sh. V., të datës 14/11/2001, 2131 (Regjistratori VI)
44. Çertifikata e Vdekjes e N. V., të datës 14/11/2001, 2132 (Regjistratori VI)
45. Policia e UNMIK-ut, Raporti i Prezencës në Autopsi, të datës 07/02/2000, 2133-2135 (Regjistratori VI)
46. Instituti Mjekoligjor Prishtinë, Raporti i Autopsisë për Sh. V., të datës 07/02/2000, 2136-2147 (Regjistratori VI)
47. Instituti Mjekoligjor Prishtinë, Raporti i Autopsisë për N. V., të datës 07/02/2000, 2148-2159 (Regjistratori VI)
48. Policia e UNMIK-ut, Lista e Provave Materiale, të datës 04/02/2000, 2160-2161 (Regjistratori VI)

49. Ministria e Punëve të Brendshme, Instituti Hulumtues i Kriminalistikës dhe Kriminologjisë, të datës 11/09/2000, 2162-2177 (Regjistratori VI)

Dokumentet në vijim janë nga shkresat e lëndës PP 73/00 nga Prokuroria Mitrovicë – vrasja e C.1:

50. Policia e UNMIK-ut, Raporti Fillestar/ i Incidentit, të datës 04/02/2000, 2178-2179 (Regjistratori VI)
51. Policia e UNMIK-ut, Raporti Fillestar, të datës 04/02/2000 , 2180-2184 (Regjistratori VI)
52. Policia e UNMIK-ut, Raporti i Identifikimit Mjekoligjor, të datës 04/02/2000, 2185-2190 (Regjistratori VI)
53. Çertifikata e Vdekjes për **R. C.**, të datës 03/09/2001, 2191 (Regjistratori VI)
54. Policia e UNMIK-ut, Fotografitë e Vendit të Ngjarjes, 2192-2201 (Regjistratori VI)
55. Policia e UNMIK-ut, Fotografitë e Autopsisë, 2202-2215 (Regjistratori VI)
56. Instituti Mjekoligjor Prishtinë, Raporti i Autopsisë për R. C., të datës 07/02/2000, 2216-2227 (Regjistratori VI)
57. Policia e UNMIK-ut, Lista e Prova Materiale, të datës 17/02/2000, 2228-2229 (Regjistratori VI)
58. Policia e UNMIK-ut, Formulari Plotësues/Vazhdues, të datës 17/02/2000 dhe SHTOJCA, 2230-2232 (Regjistratori VI)
59. Policia e UNMIK-ut, Raporti Hetimor, të datës 04/02/2000, 2233-2244 (Regjistratori VI)

Dokumentet në vijim ndërlidhen me vrasjen e A.2:

60. Policia e UNMIK-ut, Raporti Fillestar/ i Incidentit, të datës 15/02/2000, 2245-2254 (Regjistratori VII)
61. Çertifikata e Vdekjes për **S. A. 1**, të datës 15/05/2002, 2255 (Regjistratori VII)

Dokumentet në vijim ndërlidhen me vrasjet e A.1 dhe XH.:

62. UNMIK Mitrovicë, Raport i Incidentit., të datës 03/02/2000, 04/02/2000 dhe 05/02/2000, 2256-2272 (Regjistratori VII)
63. Policia e UNMIK-ut, Raporti Fillestar/ i Incidentit të datës 11/02/2001, 2273-2286 (Regjistratori VII)
64. Policia e UNMIK-ut, Raport për Veprimet Hetimore, të datës 11/02/2001, 2287-2289 (Regjistratori VII)
65. Policia e UNMIK-ut, Memorandumi i brendshëm, të datës 04/09/2000, 2290-2291 (Regjistratori VII)
66. Çertifikata e Vdekjes për N. Xh., të datës 18/04/2002, 2292 (Regjistratori VII)
67. Instituti Mjekoligjor Prishtinë, Raporti i Autopsisë për N. A., të datës 08/02/2000, 2293-2307 (Regjistratori VII)
68. Fakulteti i Mjekësisë Prishtinë, historiku i sëmundjes së R. A., të datës 05/02/2000, 2308-2375 (Regjistratori VII)

Dokumentet në vijim janë nga shkresat e lëndës PP 60/02 nga Prokuroria Mitrovicë – vrasja e S.1:

69. Policia e UNMIK-ut, Raporti Fillestar, të datës 04/02/2000, 2376-2377 (Regjistratori VII)
70. Policia e UNMIK-ut, Formulari Plotësues, të datës 04/02/2000, 2378-2379 (Regjistratori VII)
71. Policia e UNMIK-ut, Formulari Plotësues, të datës 16/02/2000, 2380-2381 (Regjistratori VII)
72. Policia e UNMIK-ut, Formulari Plotësues, të datës 18/03/2000, 2382-2383 (Regjistratori VII)

73. Policia e UNMIK-ut, Raporti i Vendit të Ngjarjes, të datës 04/02/2000, 2384-2385 (Regjistratori VII)
74. Policia e UNMIK-ut, Raporti i Identifikimit Mjekoligjor, të datës 04/02/2000, 2386-2391 (Regjistratori VII)
75. Policia e UNMIK-ut, Fotografitë e vendit dhe autopsisë, 2392-2438 (Regjistratori VII)
76. Instituti Mjekoligjor Prishtinë, Raporti i Autopsisë për M. S.1, të datës 10/02/2000, 2439-2456 (Regjistratori VII)
77. Çertifikata e Vdekjes e M. S. 1, të datës 26/02/2002, 2457 (Regjistratori VII)
78. Policia e UNMIK-ut, Listaz e Provave Materiale, të datës 14/07/2001, 2458-2459 (Regjistratori VII)
79. Protokoll nr. 240, nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Bullgarisë, Instituti Hulumtues i Kriminalistikës dhe Kriminologjisë, të datës 30/08/2001, 2460-2463 (Regjistratori VII)

Dokumentet në vijim ndërlidhen me vrasjen e B.:

80. Policia e UNMIK-ut, Raporti Fillestar / i Incidentit, të datës 05/02/2002, 2464-2467 (Regjistratori VII)
81. Policia e UNMIK-ut, Formulari Plotësues/Vazhdues, të datës 10/09/2002, 2468-2473 (Regjistratori VII)
82. Gjykata Themelore e Mitrovicës, Raporti i Autopsisë për S. B., të datës 09/02/2000, 2474-2496 (Regjistratori VII)

Dokumentet në vijim ndërlidhen me tentim-vrasjen e G.1:

83. Çertifikata e UNMIK-ut për përjashtimin e D. G. të datës 08/02/2000, 2497-2502 (Regjistratori VII)
84. Raporti Mjekësor i J. G.2 dhe T. G. që vërteton se këto vajza të D. G. kanë vuajtur nga stresi post-traumatik, 2503-2504 (Regjistratori VII)

Provat shtesë dokumentuese:

85. *Pastrimi Etnik në Kosovë: Një përshkrim*, Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA-së, Dhjetor 1999
86. *Nën Urdhra – Krimet e Luftës në Kosovë*, Human Rights Watch, 2001

Deklarata shtesë e dëshmitarit:

87. Procesverbali i marrjes në pyetje të Dëshmitarit N. A. 2, Gjykata e Qarkut Mitrovicë, Hep: nr. 139/02, të datës 27.01.2003.⁷

Provat e paraqitura nga Mbrojtja e O. I.:

88. Lënda me numër P 44/2000, kundër të pandehurit D. J. etj., para Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, ku vetëm I. S. është gjykuar⁸
89. Dy ditarë të të pandehurit O. I. nga 1999 deri 2000⁹
90. Libreza e punës së të pandehurit O. I. (kopje)¹⁰
91. Rregullorja mbi organizmin dhe ekzekutimin e obligimeve të punës të publikuar në Gazetën zyrtare të të RFJ-së nr. 36/1998 të datës 24 korrik 1998 dhe ndryshimet e publikuara në Gazetën zyrtare të RFJ-së nr. 20/1999 të datës 2 Prill 1999¹¹
92. Deklaratat e dëshmitares Sh. C. 1 në lëndën para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë kundër I. S. (D. J. et al.):

⁷ *Shih* Dosjen e Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, tab 9; *Shih* gjithashtu edhe kopjen e lëndes HEP 139/2002.

⁸ Shënim mbi provat, të datës 24 shtator 2014, Regjistratori i Gjykatës II, Shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 3. Lista e provave, 24 nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10.

⁹ Regjistratori i Gjykatës XIII, Shqyrtimi gjyqësor. Kopjet e faqeve relevante nga këta ditarë paraprakisht janë dorëzuar me Shënimin mbi provat, të datës 24 shtator 2014, Regjistratori i Gjykatës II, Shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 3.

¹⁰ Shënimi mbi provat me kopjet e dokumenteve, të datës 24 shtator 2014, Regjistratori i Gjykatës II, Shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 3.

¹¹ Lista e provave me dokumente, 24 nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10.

- Më 03 nëntor 1999 gjyqtarit hetues të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë nën numrin HEP. Nr. 2/99 (apo Kio Nr. 2/99)¹²
 - Më 14 shkurt 2000 në shqyrtimin gjyqësor para Gjykatës së UNMIK-ut me trupin gjykues të kryesuar nga Gjyqtari Suedez Christofer Karphammar (dëshmitari është marrë në pyetje për disa ditë, gjegjësisht më 14, 20, 21, 28 shkurt dhe 1 mars 2000)¹³
93. Artikull nga Tribunali i Hagës dhe Chicago Tribune *Të mashtruar nga Mashtruesit*, 1 mars 2002¹⁴
94. Raport nga Human Rights Watch *Dështimi për të Mbrojtur: Dhuna kundër Minoriteteve në Kosovë, mars 2004*, korrik 2004¹⁵
95. Raport i OSBE-së *Roli i Mediave në Ngjarjet e marsit 2004 në Kosovë*, Vienna 2004¹⁶
96. Komisionari i Përkohshëm për Media *Konstatimet dhe Rekomandimet*, 23 prill 2004¹⁷
97. Një artikull nga gazeta Politika, *15 vite nga sulmi ajror në ndërtesën e SUP-it në Mitrovicë*, 14 maj 2015¹⁸
98. *Viktimat Civile të Bombardimeve të NATO-s gjatë Operacionit Forca Aleate*, Human Rights Watch 2000, shkarkuar nga¹⁹
- <https://www.hrw.org/reports/2000/nato/Natbm200-03.htm>
- <https://www.hrw.org/reports/2000/nato/Natbm200-02.htm>
99. Deklaratat e nëntë zyrtarëve të pranishëm në Mitrovicë apo Kosovë në vitet 1999 dhe 2000²⁰
- Deklarata e H. S.2 ²¹
 - Deklarata e B. L. B.²²

¹² Regjistratori i Prokurorisë I, "Deklaratat mbi të cilat nuk është bazuar".

¹³ Regjistratori i Gjykatës V, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 2.

¹⁴ Regjistratori i Gjykatës VI, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 5.

¹⁵ Regjistratori i Gjykatës VI, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 5.

¹⁶ Regjistratori i Gjykatës VI, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 5.

¹⁷ Regjistratori i Gjykatës VI, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 5.

¹⁸ Regjistratori i Gjykatës VII, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

¹⁹ Regjistratori i Gjykatës VII, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

²⁰ *Shih* Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 17 nëntor 2015, paragrafi 337.

²¹ Deklarata nga tetori 2014, Regjistratori i Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 12.

²² Deklarata e datës 4 Nëntor 2014, Regjistratori i Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 12.

- Deklarata e W. L. N.²³
- Deklarata e J. H. F.²⁴
- Deklarata e A. C. W.²⁵
- Deklarata e C. M.²⁶
- Deklarata e J. N.²⁷
- Deklarata e G. M. G., PhD²⁸
- Deklarata e M. K.²⁹

100. Lista e dokumenteve nga lëndën penale HEP 139/2002, K. 44/2000 kundër D. J. et al., dhe P. 45/2002 kundër S. Z., dorëzuar nga Mbrojtja më 1 Dhjetor 2015³⁰

Provat e paraqitura nga Mbrojtja e D. D.:

- 101. Skema organizative e SUP-it në Mitrovicë³¹
- 102. Memorandum (përgjigje) e pronarit të motelit “BB”³²
- 103. Memorandum (përgjigje) e pronarit të bastores “Gvozd”, të datës 18.09.2014³³
- 104. Memorandum (përgjigje) e Partisë Radikale në Mitrovicë, Nr. 19/2014, të datës 18.09.2014³⁴
- 105. Raport i IKM-së në Kraljevë, të datës 24.08.2015³⁵

²³ Deklarata e datës 11 Nëntor 2014, Regjistratori i Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 12.

²⁴ Deklarata e datës 13 Nëntor 2014, Regjistratori i Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 12.

²⁵ Deklarata e datës 24 Nëntor 2014, 2014, Regjistratori i Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 12.

²⁶ Deklarata e datës 6 Dhjetor 2014, Regjistratori i Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 12.

²⁷ Deklarata e datës 14 Shkurt 2015, Regjistratori i Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 12.

²⁸ Deklarata e datës 13 Shkurt 2015, Shqyrtimi Gjyqësor Regjistratori i Gjykatës III, fashikulli 12.

²⁹ Deklarata e datës 10 Dhjetor 2014, Regjistratori i Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 12.

³⁰ *Shih* Lista e dokumenteve të datës 1 Dhjetor 2015, e dorëzuar nga mbrojtja e Oliver Ivanovićit, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 7. Dokumentet janë pranuar në prova nga Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 2 dhjetor 2015, *shih* para. 9 i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

³¹ Lista e provave me dokumente, 24 Nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

³² Lista e provave me dokumente, 24 Nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

³³ Lista e provave me dokumente, 24 Nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

³⁴ Lista e provave me dokumente, 24 Nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

106. Aktgjykimet dhe Aktvendimet e procedurave disiplinore kundër dëshmitarit "Y"³⁶
107. Raprot i IKM-së lidhur me personin Š. D., të përmendur në Aktakuzë si pjesëtar i MUP-it - 03/18/3 nr. 1846/14, të datës 20.11.2014³⁷
108. Lista e dokumenteve nga lënda penale HEP 139/00 të dorëzuar nga Mbrojtja më 1 dhjetor 2015.³⁸

Provat e paraqitura nga Mbrojtja e N. V. 1 dhe I. V.:

109. Çertifikata e Postës lidhur me N. V. 1, Nr: 2014-171154/2, të datës 13.11.2014³⁹
110. Vlerësimi nga drejtori i postës R. N. 2 për N. V.1 , i datës 26.05.2014⁴⁰
111. Libreza e avokatit për I. V., nr. 123, e datës 16.04.1984⁴¹
112. Shkresa nr. 03/4-7-1 numri 76-2/14 e datës 30.07.2014, MPB të Serbisë⁴²
113. Foto e N. V. 1. – fundi i janarit dhe fillimi i shkurtit 2000⁴³
114. Përgjigja e kompanisë së shërbimeve publike Standard, nr. 873 e datës 23.10.2015 me shtojca⁴⁴

³⁵ Lista e provave me dokumente, 24 Nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

³⁶ Regjistratori i Gjykatës XIII, Shqyrtimi Gjyqësor.

³⁷ Lista e provave me dokumente, 24 Nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

³⁸ *Shih* Lista e dokumenteve nga lënda penale HEP 139/00 e dorëzuar nga Mbrojtja e D. D. më 1 dhjetor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 6. Dokumentet janë pranuar në prova nga Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 2 dhjetor 2015, *shih* para. 9 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

³⁹ Lista e provave me dokumente, 24 Nëntor 2015, Regjistratori i Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, fashikulli 10.

⁴⁰ Lista e provave me dokumente, 24 nëntor 2015, Regjistratori i gjykatës X, shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10

⁴¹ Lista e provave me dokumente, 24 nëntor 2015, Regjistratori i gjykatës X, shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10

⁴² Lista e provave me dokumente, 24 nëntor 2015, Regjistratori i gjykatës X, shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10

⁴³ Lista e provave me dokumente, 24 nëntor 2015, Regjistratori i gjykatës X, shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10

⁴⁴ Lista e provave me dokumente, 24 nëntor 2015, Regjistratori i gjykatës X, shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10

115. Foto e apartmentit të **I. V.** me të gjitha dëmet, posaçërisht në derën e hyrjes së apartmentit⁴⁵
116. Skica e apartmentit të **I. V.**, rruga Lole Ribara C-3/11, Mitrovicë⁴⁶
117. Interpretimi i Ministrisë së Drejtësisë të RS KTR-86/15 të datës 19.06.2015 në lidhje me rigjykimin⁴⁷
118. Procesverbali i inspektimit të vendit, konfirmimi i sendeve të konfiskuara dhe të gjetura në skenë në natën kritike si pasojë e sulmit në apartament, fotografitë me skicat e vendit të ngjarjes në apartmentin e N. A. 2 dhe **I. V.** dhe korridorit të përbashkët – Policia e UNMIK-ut me datë 03/04.02.2000.⁴⁸
119. Konstatimet, vlerësimet dhe mendimet lidhur me shëndetin e **I. V.**, nr. 16/1-23, e lëshuar nga Komisioni Ushtarak i APJ-së, me datë 23 janar 1976.⁴⁹

Provat e dorëzuara nga mbrojtësi i **A. (S.) L.**:

120. Kopja e kartelës për dhurimin e gjakut, që kishte datën 03.02.2000⁵⁰
121. Kopja e certifikatës nga libri i regjistrimeve të dhuruesve të gjakut⁵¹

Provat në vijim ishin pranuar pas propozimit nga më shumë se një palë apo të gjitha palët:

122. Lënda HEP 139/2002⁵²
123. Video incizimi i deklaratës së dhënë nga N. A. 2, H. B.-it, faqe 902 (transkriptet në gjuhën angleze faqe 906, serbe 931, shqipe 953). Shënim në datën e intervistës faqe 908.⁵³
124. Biografia e Ministrit të Drejtësisë së Punëve të Brendshme Dušan Mihajlović, e shkarkuar nga uebfaqja Wikipedia⁵⁴

⁴⁵ Lista e provave me dokumente, 24 nëntor 2015, Regjistratori i gjykatës X, shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10

⁴⁶ Lista e provave me dokumente, 24 nëntor 2015, Regjistratori i gjykatës X, shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 10

⁴⁷ *Shih* Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 2 dhjetor 2015, para. 9.

⁴⁸ *Shih* Shkresën e lëndës HEP 139/2002.

⁴⁹ *Shih* Regjistratori i gjykatës X, Shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 8.

⁵⁰ *Shih* Regjistratori i gjykatës X, Shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 5.

⁵¹ *Shih* Regjistratori i gjykatës X, Shqyrtimi gjyqësor, fashikulli 5.

⁵² Kopja e shkresave të lëndës është pjesë e kësaj lënde (një regjistrator).

⁵³ *Shih* referencën në fusnotat 56 dhe 57 më poshtë.

Video incizimet vijuese ishin paraqitur në gjykatë:

125. Incizimet nga një program televiziv japonez lidhur me të pandehurin **O. I.**, I shfaqur në gjykatë me 2 dhjetor 2015⁵⁵
126. Video incizimet e deklaratave të dhëna H. B ⁵⁶ (një CD) të cilat ishin konsideruar si të shikuara, dhe transkriptimi ishte konsideruar si i lexuar në procesverbal, në seancën e datës 2 dhjetor 2015.⁵⁷

Provat në vijim janë refuzuar nga Trupi Gjykses:

127. Kopja e paredaktuar e të dhënave personale të dëshmitarit X, në lidhje me pyetjen e parashtruar nga anëtari i trupit gjykses dëshmitarit gjatë seancës së mbajtur me 8 korrik 2015 (par. 355-356), dhe e kërkuar nga avokati i **O. I.** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me 1 dhjetor 2015 (par. 37-39)⁵⁸
128. Kartolina përshëndetëse dërguar të pandehurit **D. D.** gjersa ai ishte në burg⁵⁹
129. Deklarata e M. I. e datës 29 tetor 2013, në regjistratorin e Prokurorisë “Deklaratat në të cilat nuk jemi mbështetur – Regjistratori I”⁶⁰
130. Procesverbalet lidhur me numrin e personave të dënuar me shkelje të betimit, deklarata të rrejshme nën betim, raportim apo akuzim të rrejshëm, apo vepra penale të ngjashme kundër gjyqësorit në rastet me një element interetnik që përfshin krime të luftës dhe vrasje në territorin e Kosovës që nga 10 qershori 1999⁶¹

⁵⁴ Regjistratori i gjykatës VIII, Shqyrtimi gjyqësor, fash.8.

⁵⁵ *Shih* Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 2 dhjetor 2015, par. 9-17 dhe 38-42. Dokumenti është i radhitur nën provat e paraqitura nga Prokuroria , nr. 37 më lart.

⁵⁶ *Shih* Regjistratorin e prokurorisë me deklaratat e dëshmitareve nga viti 2000, CD-ja i është bashkëngjitur deklaratës së Halit Baranit të datës 25 shkurt 2013, f. 902, gjithashtu e përmendur nën numrin 123 më lart.

⁵⁷ *Shih* Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 2 dhjetor 2015, paras. 12-18 and 38-41.

⁵⁸ Kërkesa ishte refuzuar nga Trupi Gjykses gjatë seancës së datës 2 dhjetor 2015. *Shih* Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, par. 9.

⁵⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 2 dhjetor 2015, par. 9.

⁶⁰ *Shih* Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 2 dhjetor 2015, par. 9.

⁶¹ Kërkesa për të siguruar informata të tilla ishte paraqitur në Gjykatë nga mbrojtja e **O. I.** *Shih* Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 17 nëntor 2015, par. 347 *et seq.*

- ¹³¹. Ekspertiza shtesë për t'u kryer nga një ekspert gjyqësor me profesion ndërtimtar/ballistikë⁶² lidhur me dëmet në derën e hyrjes në apartamentin e **I. V.** dhe dëme të tjera, e kërkuar nga avokati i **N. V.1.**

D. Vizita në terren

21. Provat e administruara gjatë vizitës në terren të kryer me 21 shtator 2015:

- ¹³². Raporti policor i vizitës në terren të kryer me 21 shtator 2015 në Mitrovicën e Veriut⁶³
- ¹³³. Raporti policor i vizitës në terren të kryer me 21 shtator 2015 ⁶⁴

E. Paditë Pasurore:

22. Palët e dëmtuara vijuese parashtruan padi pasurore: : Xh.S., Sh.K.1, K.A., sikurse edhe R.A., S.A.2, E.Xh., G.Xh., Gj.S., Sh.C.2, L.A.2, H.S.1, H.R., M.H.1 dhe U.A.. Dëshmitari M. Ll. gjithashtu parashtroi një padi pasurore.⁶⁵

I.E. PRANUESHMËRIA E PROVAVE DHE PROPOZIMET E TJERA PROCEDURALE

23. Gjykata ka lëshuar një numër të aktvendimeve procedural gjatë tërë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor. Një përmbledhje e këtyre aktvendimeve më të rëndësishme është ofruar më poshtë, gjersa aktvendimet, duke përfshirë arsyetimin e plotë janë bashkëngjitur në shkresat e lëndës.

⁶² *Shih* Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 11 shtator 2015, para. 5.

⁶³ *Shih* Dosjen e shqyrtimit gjyqësor me dokumentet mbi shiqimin e vendngjarjes të bërë me 21 shtator 2015

⁶⁴ *Id.*

⁶⁵ *Shiko* Dosjen e Gjykatës X, Shqyrtimi Gjyqësor, tab 4.

I. E.1. Përfaqësuesi i palës së dëmtuar

24. Më 17 nëntor 2015⁶⁶, Trupi Gjykses lëshoi një aktvendim gojor lidhur me përfaqësimin e palëve të dëmtuara nga një përfaqësues i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave ("Mbrojtësi i Viktimave"), dhe në lidhje me një propozim nga ana e avokatit mbrojtës të **O. I.**, të datës 28 tetor 2015. Avokati mbrojtës ka kërkuar që të informohet se cilat palë të dëmtuara janë të përfaqësuara nga Mbrojtësi i Viktimave dhe për t'u pajisur me kopje të autorizimeve të nënshkruara nga palët e dëmtuara, në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.
25. Duke pasur parasysh argumentet e mbrojtjes, përgjigjen e Prokurorit, dispozitat përkatëse të KPP-së dhe Procedurat Standarde të Veprimit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Trupi gjykses vendosi që pëlqimi i palëve të dëmtuara të përfaqësohet nga Mbrojtësi i Viktimave dhe kërkesa e tyre për atë që të marrë pjesë në seancat gjyqësore nuk duhet të shprehet në mënyrë zyrtare. Këtu, Trupi gjykses iu është referuar praktikës së gjykatave që paraqitja e letërnjoftimit nga Mbrojtësi i Viktimave është i mjaftueshëm që të përfaqësojë palët e dëmtuara në gjykatë. Trupi gjykses theksoi se palët e dëmtuara kanë qenë të pranishme gjatë disa seancave dhe se shumë prej tyre dëshmuan si dëshmitarë në rast dhe janë marrë në pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave. Në këto raste, ata u informuan nga Gjykata për rolin e Mbrojtësit të Viktimave dhe asnjëri prej tyre nuk paraqiti ndonjë kundërshtim për t'u përfaqësuar prej tij. Për më tepër, një numër i palëve të dëmtuara kanë paraqitur kërkesat pronësore-juridike nëpërmjet Mbrojtësit të Viktimave.
26. Trupi gjykses më tej vuri në dukje se, duke pasur parasysh peshën e akuzave në rastin në fjalë, është në interes të drejtësisë për palët e dëmtuara që të kenë përfaqësim ligjor dhe se ka qenë vetë Gjykata që ka kërkuar nga Mbrojtësi i viktimave që të vë kontakt me palët e dëmtuara dhe t'i informoi ata për të drejtat e tyre në procedurë. Edhe sikur Gjykata të konstatonte se një autorizim zyrtar do të ishte i nevojshëm, mungesa e tij nuk do të paraqiste shkelje të tilla substanciale të procedurave të përfshira në nenin 386 të KPP-së dhe nuk duhet të ketë ndikim në zhvillimin e mëtejshëm të procedurës. Kjo nuk do të ishte në interes të asnjë pale, duke përfshirë të pandehurit që janë nën masat

⁶⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 17 nëntor 2015, par. 337-346

kufizuese. Megjithatë, Trupi gjykues përsëriti detyrën e Mbrojtësit të Viktimave për t'i ofruar Mbrojtjes të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e mbrojtjes së tyre, duke përfshirë informacionin në lidhje me kërkesat pronësore juridike të paraqitura nga palët e dëmtuara.

I.E.2. Rregullat lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve

27. Aktvendimi i Trupit Gjykues për marrjen në pyetje të dëshmitarëve, i datës 16 korrik 2015 ka përcaktuar rregullat e mëposhtme:
28. Me qëllim të lehtësimit të veprimeve të mëtejshme procedurale nga ana e palëve në mënyrë që të kuptohet dhe të respektohet nga të gjithë, Gjykata vendosi të caktoj interpretimet e veta ligjore, kriteret ligjore dhe bazat mbi çështjet specifike si vijon:

Marrja e drejtëpërdrejtë në pyetje:

29. Faktet janë paraqitur në prova me anë të marrjes së drejtëpërdrejtë në pyetje. Vetëm pala që e propozon dëshmitarin kryen marrjen e drejtëpërdrejtë në pyetje të atij dëshmitari.

Marrja e tërthortë në pyetje:

30. Palët e tjera marrin tërthorazi në pyetje (duke përfshirë përfaqësuesin e palës së dëmtuar). Korniza e marrjes së tërthortë në pyetje përcaktohet nga marrja e përgjithshme në pyetje, së bashku me deklaratën e procedurës paraprake të dëshmitarit.
31. Pala propozuese kryen një rimarrje në pyetje të dëshmitarit, vetëm pas marrjes së tërthortë në pyetje.

Rimarrja në pyetje:

32. Fushëveprimi i rimarrjes në pyetje në parim është i diktuar nga çështjet e ngritura gjatë marrjes së tërthortë në pyetje. Rimarrësi mund të merret me të gjitha çështjet relevante

me ato të ngritura në marrjen e tërthortë në pyetje, edhe në qoftë se nuk trajtohen qartazi nga marrësi i tërthortë në pyetje.

33. Në mënyrë të ngjashme me marrjen e tërthortë në pyetje, pala që e merr në pyetje mund të përball dëshmitarin me mospërputhjet në deklaratat e tij gjatë rimarrjes në pyetje.
34. Trupi gjykues në çdo kohë mund të merr hapa aktivë për të sqaruar aspekte të caktuara apo i urdhëron palët që t'a bëjnë këtë.

I.E.3. Zbatueshmëria e parimit *ne bis in idem*

35. Gjykatës i është bërë thirrje për të vendosur mbi çështjen e zbatueshmërisë së parimit *ne bis in idem*, në lidhje me pikën 2 të Aktakuzës, në disa raste. Domethënë, të gjithë të pandehurit kanë argumentuar se procedurat në lëndën HEP 139/2002 para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë⁶⁷ ndaloi ndjekjen penale në rastin në fjalë. Gjykata hodhi poshtë pretendimin e Mbrojtjes në një numër të aktvendimeve të cilat janë përmbledhur më poshtë.

Historia e rastit

36. Lënda penale HEP 139/2002 para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë t ishte lidhur me vetëm një numër të vogël të akuzave të mbuluara nga rasti në fjalë, në mënyrë specifike "vrasje e dyfishtë dhe tentim vrasjet e familjes Xh. në Mitrovicë dhe A.1 me 3 shkurt, 2000, e cila rezultoi në vdekjen e N. A. dhe N. Xh., me katër të tjerë të plagosur." Rasti ishte shqyrtuar nga prokurori ndërkombëtar, i cili më 12 mars të vitit 2002 lëshoi një Refuzim të akuzës kundër të pandehurve **D. D., O. I., N. V.1, I. V. dhe A. L.**, me të cilin ai "hedhi poshtë akuzën e mundshme dhe institucionin e hetimeve paraprake" kundër të pandehurve, me arsyetimin se nuk ka prova të mjaftueshme të besueshme. Palët e dëmtuara janë informuar lidhur me vendimin.

⁶⁷ Dokumentet nga lënda HEP 139/2002 janë pjesë e shkresave të lëndës në këtë rast.

37. Më 8 prill 2002, palët e dëmtuara N. A. 2 dhe G. Xh. kanë paraqitur një Kërkesë për të kryer Hetimet në pajtim me nenin 60 (2) të KPP-së të RSFJ-së kundër të dyshuarve të lartpërmendur. Më 2 gusht 2002, gjykatësi hetues ndërkombëtar Vagn Joensen ka shqyrtuar kërkesën dhe ka rekomanduar "për të mos pranuar kërkesën për një hetim" me bazën se "pas shqyrtimit të të dhënave të policisë dhe kërkesës nga palët e dëmtuara", ai arriti në përfundimin se nuk ka prova të mjaftueshme të besueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se personat e përmendur më lart kanë kryer aktet e lartpërmendura penale. Si pasojë, gjykatësi hetues ndërkombëtar Vagn Joensen ka referuar kërkesën për të kryer hetimin e paraqitur nga palët e dëmtuara, së bashku me propozimin e tij për trupin gjykues të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës në përputhje me nenin 159 (7) të KPP-së të RSFJ-së.
38. Më 3 gusht 2002, një trup gjykues i përbërë nga tre gjykatës ndërkombëtarë, mori një "vendim për të refuzuar pjesërisht dhe për të pranuar pjesërisht propozimin e gjykatësit hetues." Gjegjësisht, në lidhje me të pandehurin **D. D.**, ata hodhën poshtë propozimin e gjykatësit hetues dhe vendosën që duhet të ndërmerret një hetim. Ata vlerësuan se ka ekzistuar dyshim i bazuar se **D. D.** ka kryer veprimet për të cilat ai është i dyshuar. Trupi gjykues ka gjetur prova të pamjaftueshme në lidhje me të dyshuarit e tjerë dhe për këtë arsye ka pranuar propozimin e gjykatësit hetues që nuk duhet të kryhet një hetim.
39. Në bazë të këtij vendimi, gjykatësi hetues ka kryer një hetim në lidhje me të pandehurin **D. D.**, duke intervistuar të dyshuarin, dhe palët e dëmtuara N. A. 2, G. Xh., V. A. dhe Sh. A.. Pala e dëmtuar R. A. nuk është paraqitur në një intervistë të caktuar dhe i dyshuari gjithashtu nuk është paraqitur për të dëshmuar "në kundërshtim dhe / apo dëshmitarët e tij."
40. Më 21 shkurt 2003, gjykatësi hetues lëshoi një vendim ku thuhet se hetimi i kryer në lidhje me të pandehurit **D. D.** kishte përfunduar dhe se palët e dëmtuara kanë të drejtë të parashtrojnë padi në afat prej tetë ditësh, ose ata do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga ndjekja penale dhe procedura do të hedhet poshtë me një vendim. Gjykatësi hetues i dërgoi një letër të dy palëve të dëmtuara, N. A.2 dhe G. Xh., për këtë qëllim në të njëjtën ditë. Nuk ka të dhëna në shkresat e lëndës se çfarë kishte ndodhur më tej.

Vendimi i Gjykatës

41. Gjykata së pari trajtoi zbatueshmërinë e parimit *ne bis in idem* në Aktvendimin e saj për vazhdimin e paraburgimit kundër **D. D.**, të datës 3 mars 2015⁶⁸. Edhe pse aktvendimi ishte vetëm lidhur me të pandehurin **D.**, Gjykata e ka përfshirë mendimin e saj në lidhje me zbatueshmërinë e parimit *ne bis in idem* edhe për të pandehurit e tjerë. Këto gjetje ishin përsëritur në Aktvendimin mbi Masat e Sigurisë në lidhje me të pandehurit **N. V. 1, I. V.**, dhe **A. (S.) L.**, të datës 19 mars 2015, e cila u konfirmua nga Gjykata e Apelit⁶⁹ dhe Gjykata Supreme e Kosovës⁷⁰.
42. Në lidhje me të pandehurit **O. I., N. V. 1, I. V.**, dhe **A. (S.) L.**, Gjykata konstatoi se vendimi i trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ishte "thjesht se një hetim 'nuk duhet të urdhërohet' në fazën e procedurës paraprake. Kjo do të thotë se asnjë hetim nuk është hapur, iniciuar apo zhvilluar kundër të pandehurve. Asnjë vendim i formës së prerë lidhur me përfundimin e hetimeve nuk ishte marrë nga gjykata".⁷¹ Gjykata vërejti se neni 403 (1) i KPP-së të RSFJ-së, i cili ishte në fuqi në kohën e procedurës së mëparshme lejon mundësinë e rihapjes së procedurave" nëse prova të reja paraqiten të cilat bindin Gjykatën se janë shfaqur kushtet për rihapjen e hetimeve. "E njëjta mundësi ekziston në bazë të nenit 422 (2) të KPP-së aktual, edhe pasi që aktakuza të jetë hedhur poshtë.⁷²
43. Më tej, Gjykata gjeti që subjekti i procedurave aktuale të ishte shumë më i gjerë se atyre të mëparshmeve, pasi që kishte të bënte me viktime të shumta dhe palë të dëmtuara të cilët nuk ishin përfshirë më parë. Për më tepër, në lidhje me faktet të cilat ishin subjekt

⁶⁸ Kjo çështje ishte trajtuar edhe nga gjykatësi i procedurës paraprake në Aktvendimet e tija të datës 15 prill 2004 dhe 14 maj 2014 (lënda Ppr. 11/2013) dhe e konfirmuar nga Gjykata e Apelit në Aktvendimet e saj të datës 20 prill 2014 (lënda numër PN1. nr. 775/14) dhe 17 maj 2014 (lënda nr. PN1. nr. 952/14).

⁶⁹ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN 1. 496/2015, i datës 27 mars 2015 (në lidhje me një ankesë të paraqitur nga i pandehuri **N. V.1**), regjistratori i gjykatës III, Paraburgimi – **N. V.1, I. V., A. L.**, fash. 3.

⁷⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml.Kzz 91/2015, 14 maj 2015, para. 4.4-4.8 (në lidhje me kërksën për mbrojtje të lidhshmërisë të paraqitur nga i pandehuri **N.V.**), Regjistratori i Gjykatës IV, Paraburgimi – **N. V 1., I. V., A. L.**, fashikulli 10. *Shih* edhe Vendimin mbi Kundërshtimin e provave dhe Kërkesave për të hedhur poshtë aktakuzën, 31 tetor 2014, f. 32-33, Regjistratori i gjykatës II, shayrtimi gjyqësor, fash.1

⁷¹ Aktvendimi për Vazhdimin e paraburgimit kundër të **D. D.**, 3 mars 2015, par.12, Regjistratori i Gjykatës II, Paraburgimi – **O. I.** dhe **D. D.**, fash 2; Aktvendimi mbi Masat e Sigurisë, 19 mars 2015, par. 18, Regjistratori i Gjykatës III, Paraburgimi – **N. V.1, I. V., A. L.**, fash.6.

⁷² Aktvendimi mbi Masat e Sigurisë, 19 mars 2015, para. 22-24, Regjistratori i Gjykatës III, Paraburgimi – **N. V.1, I. V., A. L.**, fash 6.

i procedurave të mëparshme, Gjykata konstatoi se prova të reja kishin dalë në dritë të cilat do të justifikonin rishikimin e procedurës penale sipas dispozitave të përmendura më lart dhe do të pengojë zbatimin e parimit *ne bis in idem*.⁷³

44. Gjykata erdhi në të njëjtin përfundim në lidhje me të pandehurin **D. D.**. Procedura e mëparshme kundër këtij të pandehuri kishte arritur një fazë të mëvonshme dhe se gjykatësi hetues kishte përfunduar hetimin dhe i kishte udhëzuar dy palët e dëmtuara (prokurorët privat) që ata kishin tetë ditë për të ngritur një aktakuzë. Nuk ka asnjë tregues se është ngritur ndonjë aktakuzë ndonjëherë nga prokurorët privat dhe duket se gjykatësi hetues kurrë nuk ka lëshuar një vendim për pushimin e procedurës në bazë të tërheqjes nga prokurori privat⁷⁴. Megjithatë, Gjykata konstatoi se efekti i këtyre hapave procedural është vetëm mundësia që "procedurat mund të konsiderohen si të pushuara në lidhje me palët e dëmtuara dhe në këtë rast është e sigurt se ato palë nuk do të kishin pasur mundësinë për të kërkuar rishikim të procedurës sipas ligjit të RSFJ-së (neni. 403 (3))."⁷⁵
45. Nga ana tjetër, Gjykata konstatoi se edhe nëse procedurat janë konsideruar si të pushuara, "neni 403(1) në mënyrë eksplicite lejon prokurorin publik për të kërkuar rihapjen e procedurave kur procedurat penale janë pushuar gjatë hetimit ose para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, me vendim të formës së prerë ... në qoftë se "prova të reja janë paraqitur të cilat bindin gjykatën se janë plotësuar kushtet për rihapjen e procedurës penale."⁷⁶ Nga kjo gjykata arriti në përfundimin se vendimi për të mos ndjekur penalisht nuk ka pasur një efekt definitiv dhe se, për këtë arsye, procedurat mund të rihapen në bazë të nenit 403 (1) të KPP-së të RSFJ-së dhe nenit 422 (2) të KPP-së, në qoftë se prova të reja janë paraqitur.⁷⁷

⁷³ Aktvendimi mbi Masat e Sigurisë, 19 mars 2015, para. 25-27, Regjistratori i Gjykatës III, Paraburgimi – **N. V.1, I. V., A. L.**, fash 6

⁷⁴ Aktvendimi mbi Paraburgimin kundër **D. D.**, 3 mars 2015, par. 17-20, Regjistratori i Gjykatës II, Paraburgimi– **O. I.** dhe **D. D.**, fash 2

⁷⁵ *Id.* në par.21.

⁷⁶ *Id.* në par. 23

⁷⁷ *Id.* në par. 23-27

46. Gjykata më pas përsëriti të njëjtin konstatim lidhur me ekzistimin e provave të reja për katër të pandehurit e tjerë, dhe arriti në përfundimin se parimi *ne bis in idem* nuk ishte i zbatueshëm në lidhje me të pandehurin **D. D.**⁷⁸

I.E.4. Pranueshmëria e deklaratës së dëshmitarit të ndjerë N. A. 2 dhe propozimet e tjera të provave

47. Më 27 prill 2015, pas shqyrtimit të parashtresave të palëve, trupi gjykues ka lëshuar një Aktvendim për Pranimin e Deklaratave të N. A. 2 dhe Propozimet e tjera Paraprake.⁷⁹ Trupi gjykues së pari vuri në dukje se të gjitha provat relevante konsiderohen si të pranueshme nëse shprehimisht nuk parashikohet ndryshe nga dispozitat e KPP-së. Kjo është në përputhje me nenin 257 (2) dhe nenin 329 (1). Në anën tjetër, të gjitha provat që qartazi konsiderohen të parëndësishme, siç përcaktohet në nenin 259 (1) të KPP-së, janë të papranueshme në procedurat penale.
48. Përveç kësaj, Kodi parasheh tri situata të tjera në të cilat provat konsiderohen të papranueshme dhe duhet të përjashtohen nga shkresat e lëndës. Në fakt, ky është rasti kur prova është marrë në mënyrë të paligjshme nga policia, prokurori i shtetit, apo ndonjë subjekti tjetër qeveritar, ajo shkel rregullat në Kapitullin XVI të KPP-së, apo prova është thelbësisht e pabesueshme.
49. Megjithatë, edhe kur konsiderohet e pranueshme, përdorimi i një deklaratë mund të jetë i kufizuar në varësi të cilësimit të saj në bazë të dispozitave që rregullojnë përdorimin e deklaratave të mëparshme. Në mënyrë të veçantë, neni 123 i KPP-së dallon mes marrjes në pyetje në procedurë paraprake, deklaratave në procedurën paraprake dhe deklaratave të ofruara si pjesë e mundësisë hetuese të veçantë. Vetëm dy llojet e fundit të deklaratave mund të përdoren si prova të drejtpërdrejta në shqyrtimin gjyqësor, me kusht që dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, mbrojtjes së privilegjit apo mungesës së pranisë në Kosovë. Në të kundërtën, përdorimi i marrjes në pyetje në procedurë paraprake është i kufizuar në fajësimin e dëshmitarit gjatë

⁷⁸ *Id.* në para. 28-31.

⁷⁹ Ankesa e prokurorit në aktvendim ishte hedhur si e papranueshme nga Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj PN 253/15, të datës 4 qershor 2015, Regjistratori i Gjykatës VII, Shqyrtimi Gjyqësor, fash 5.

marrjes së tërthortë në pyetje dhe nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

50. Në lidhje me çështjen nëse dëshmitarit i është dhënë paralajmërim para dhënies së deklaratës, trupi gjykues mendon se neni 257 i KPP-së parasheh që provat e marra në shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur Kodi ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht përshkruajnë kështu, dhe se neni 128 i KPP-së parasheh kur një deklaratë e dëshmitarit është e papranueshme. Kodi nuk ofron shprehimisht se fakti që dëshmitari nuk është paralajmëruar do t'a bënte deklaratën e tij të papranueshme.

Deklaratat e dhëna në polici

51. Duke pasur parasysh këto rregulla, Trupi gjykues ka konstatuar se deklaratat e dhëna nga i ndjeri N. A. 2 në polici, përkatësisht te KFOR-i francez (10.02.2000), Policia e UNMIK-ut (pa datë), dhe deklarata e datës 3 shkurt 2000, të përfshira në Kërkesën për të kryer hetime të datës 8 prill 2000, nuk mund të përdoren si provë në gjykim. E njëjta gjë u vendos në lidhje me çdo dokument tjetër të policisë që përmbante dëshminë e N. A. 2. Trupi gjykues ka konstatuar se deklaratat janë mbledhur në përputhje me Kodin e atëhershëm në fuqi të Procedurës Penale të RSFJ-së, por theksoi se ligjshmëria e veprimit hetimor i cili çoi në provat në fjalë dallon nga çështja e përgjithshme e pranueshmërisë së provave të tilla, të cilat varen nga dispozitat në fuqi të KPP-së.⁸⁰
52. Prandaj, Trupi gjykues konkludoi se, edhe pse deklaratat janë mbledhur në mënyrë të ligjshme dhe janë relevante, përdorimi i tyre në shqyrtimin gjyqësor është i kufizuar në bazë të neneve 123 (2) dhe 337 të KPP-së. Domethënë, deklaratat më së shumti mund të karakterizohen si ekuivalent i intervistës së procedurës paraprake në bazë të KPP-së aktualisht në fuqi. Si të tilla, ato nuk mund të përdoren si prova të drejtpërdrejta në shqyrtimin gjyqësor. Më saktë, përmbajtja e tyre mund të përdoret vetëm gjatë marrjes së tërthortë në pyetje me qëllim të sfidimit të dëshmitarit. Më së paku, deklaratat mund të cilësohen si intervista nga policia sipas nenit 73 (e cila nuk kërkon as paralajmërim) dhe kjo mund të përdoret edhe në marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit, në

⁸⁰ Trupi gjykues iu referua Vendimit të Gjykatës së Apelit në lëndën me numër PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, para.29 dhe 30.

përputhje me nenin 337 (5) të KPP-së. Në të dy situatat –qoftë ajo intervistë policore apo intervistë në procedurën paraprake, për shkak të faktit se dëshmitari është i vdekur dhe kështu nuk është në dispozicion për të dëshmuar, marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarit nuk mund të bëhet. Prandaj, asnjë vlerë provuese nuk mund t'i bashkëngjitet këtyre deklaratave të policisë.

53. Neni 338 (1) (1.1), në të cilën Prokurori mbështetet nuk është i zbatueshëm këtu, pasi që ai i referohet vetëm leximit në procesverbal të "dëshmime" të mëparshme të dëshmitarit dhe jo intervistave. Kjo konstatohet në bazë të formulimit të tekstit: në paragrafin 1, fjala "dëshmi" është përdorur, ndërsa paragrafi 2 i referohet "marrjes në pyetje". Për më tepër, do të ishte e palogjikshme për të lexuar në procesverbal intervistën e procedurës paraprake, vlera e vetme provuese e së cilës- që është në marrjen e tërthortë në pyetje - do të konsiderohej e padobishme nga mungesa e dëshmitarit para Gjykatës (dhe neni 338 paragrafi 1 KPP merret pikërisht me situatat kur dëshmitari nuk është i pranishëm).

Deklarata para Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës

54. Nga ana tjetër, Trupi gjykues konstatoi se deklarata e N. A.2 para Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, me 27.01.2003, është e pranueshme dhe duhet të lexohet në procesverbal. Dëshmitari u intervistua, sipas ligjit procedural në fuqi në atë kohë, nga gjykatësi hetues brenda Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, dhe ai ishte paralajmëruar në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij. Për më tepër, avokati mbrojtës i të dyshuarit (i pandehuri **D. D.**) ishte ftuar në mënyrë të rregullt.
55. Prandaj, deklarata përmbush kushtet e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake sipas nenit 132 të KPP-së, dhe mund të përdoret gjatë shqyrtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 123 paragrafi 3 të KPP-së. Për më tepër, neni 338 i KPP-së këtu është i zbatueshëm, i cili në paragrafin 1 parasheh se procesverbalet që përmbajnë marrjen e deklaratës së dëshmitarit mund të lexohen si prova në rastet kur dëshmitari nuk është në dispozicion për të dëshmuar për një nga arsyet e përmendura në nënparagrafët 1.1-1.3. Nën-paragrafi 1.1. i nenit 338 (1) parasheh në mënyrë specifike rastet ku ka vdekur dëshmitari, siç është rasti këtu.
56. Trupi gjykues më tej vuri në dukje se kur është marrë deklarata, hetimi ishte në vazhdim e sipër vetëm në lidhje me **D. D.**, dhe jo për të pandehurit e tjerë. Prandaj, në lidhje me

këtë të fundit, kjo deklaratë nuk i plotëson kushtet e një marrje të deklaratës në procedurë paraprake, pasi që këta të pandehur nuk ishin pjesë e këtyre procedurave dhe për këtë arsye ata nuk janë ftuar. Rrjedhimisht, deklarata nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë në lidhje me këta të pandehur.

Deklaratat e dëshmitarëve të tjerë

57. Në përputhje me rregullat e shprehura më lart, Trupi gjykues ka vendosur se deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve A. A. 2, Sh. A., G. Xh. dhe A. V. janë marrë në mënyrë të ligjshme dhe janë të pranueshme. Edhe në qoftë se këtyre dëshmitarëve nuk iu është paraqitur paralajmërimi, marrje e tyre në pyetje e ka të paktën vlerën e një marrje në pyetje nga policia dhe ajo mund të përdoret gjatë marrjes së tërthortë në pyetje në bazë të nenit 337 (5) të KPP-së. Për më tepër, pasi që dëshmitarët duhet që të merreshin drejtpërdrejt në pyetje në gjykatë, deklaratat e tyre të mëparshme mund të përdoren vetëm gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ose për të rifreskuar kujtesën e tyre.
58. Për më tepër, Trupi gjykues konstatoi se pa marrë parasysh aktvendimin e mësipërm në lidhje me pranueshmërinë e deklaratave të N. A. 2 dhe përdorimin e tyre si dëshmi të drejtpërdrejta, dëshmitarë të tjerë nga familjet A.1 dhe Xh. mund të pyeten se çfarë ata dinë nga të vdekurit në lidhje me të gjithë të pandehurit. Kjo konsiderohet përkatëse dhe e rëndësishme për çështjen dhe mund të ketë vlerë vërtetuese. Për më tepër, nuk ka asnjë ndalim për provat thashetheme në KPP. Burimi i njohurisë së dëshmitarit do të jetë një element për të vlerësuar peshën që t'i bashkëngjitet deklaratës së tij / saj.

I.E.5. Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarëve

59. Në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata vendosi për një numër të kundërshtimeve dhe kërkesave lidhur me rëndësinë dhe pranueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit. Këto vendime janë përmbledhur më poshtë.

60. Më 3 mars 2015,⁸¹ kryetari i trupit gjykues lëshoi një Aktvendim që refuzonte si të pabazuar kërkesën për të mos dëgjuar dëshmitarët e prokurorisë Ç.I., B.S.1, B.I., B.R.2, M.H.2 dhe H.B., mbi bazën se dëshmia e tyre nuk është relevante për rastin. Kryetari i trupit gjykues ka vendosur se dëshmitarët e kontestuar ka të ngjarë që të dëshmojnë në lidhje me aspekte që konsiderohen të rëndësishme, të tilla si konteksti i përgjithshëm i ngjarjeve, aktivitetet e të pandehurit **O. I.** apo hetimit. Për këtë arsye, gjyqtari konstatoi se, për sa kohë që provat nuk janë haptazi të parëndësishme apo thelbësisht të pabesueshme (dhe në këtë mënyrë të papranueshme në bazë të nenit 259 të KPP-së), Mbrojtja nuk mund të kufizojë fushën e administrimit të provave vetëm në provat e drejtpërdrejta. Çështja e peshës për t'iu bashkëngjitur çdo pjese të provave dhe vlerësimit të provave në tërësi, do të trajtohet nga Trupi gjykues gjatë këshillimeve.
61. Më 17 nëntor 2015⁸², kryetari i trupit gjykues shpalli vendimin për refuzimin e kërkesës së avokatit mbrojtës të **O. I.** për të dëgjuar mikun e dëshmitares V. A., të përmendur në dëshminë e saj para Gjykatës. Vendimi ishte bazuar në faktin se qëllimi i vetëm i dëshmisë së mikut të V. A. do të jetë për të kundërshtuar shpjegimin e saj të fakteve të caktuara të cilat nuk janë objekt i akuzave dhe për këtë arsye nuk janë relevante për rastin. Për më tepër, kryetari i trupit gjykues theksoi se mbrojtja vetë i ka konsideruar këto akuza si të parëndësishme, dhe se ata nuk kanë përfituar nga mundësia për të marrë tërthorazi në pyetje dëshmitaren në lidhje me identitetin dhe detajet e kontaktit të mikut të saj, kur në mënyrë të veçantë është ofruar mundësia.

I.E.6. Deklaratat e dëshmitarëve nëpërmjet video-lidhjes

62. Më 26 shkurt 2015, Kryetari i trupit gjykues lëshoi një aktvendim për refuzimin e kërkesës së avokatit mbrojtës të të pandehurit **O. I.** që dëshmitarja e prokurorisë Sh. C. 1, me banim në _____, të dëgjohej në gjykatë të hapur në vend se përmes video-lidhjes. Vendimi është bazuar në faktin se dëshmitarja ishte në moshë të shtyer dhe me shëndet të dobët, si dhe se ka pasur garanci të mjaftueshme se marrja në pyetje e

⁸¹ *Shih* Aktvendimin e dates 3 mars 2015, Dosja e Gjykatës V, tab. 4.

⁸² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 17 nëntor 2015, par. 331-336

dëshmitares do të kryhej në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse ligjore. Domethënë, fakti se dëshmitarja do të dëgjohej në një organizim zyrtar, të rregulluar me anë të ndihmës së ndërsjellë juridike me _____, do të sigurojë që dëshmia e saj do të reflektojë vullnetin e saj të lirë dhe se ajo nuk do t'i nënshtrohet asnjë ndikimi të jashtëm. Gjyqtari më tej ka konstatuar se të gjitha kushtet në lidhje me dëshminë nëpërmjet video-lidhjes të theksuara në rastin Tadiq ishin plotësuar.⁸³

63. Gjykata gjithashtu ka vendosur lidhur me kërkesat për të dëgjuar dëshmitarët X dhe Y në gjykatë dhe jo përmes video-lidhjes. Kërkesat ishin refuzuar⁸⁴ duke pasur parasysh masat mbrojtëse që ishin lejuar për dëshmitarët dhe duke marrë parasysh të njëjtat kushte dhe kërkesat e përcaktuara në Aktvendimin e datës 26 shkurt 2015 në lidhje me dëshmitaren Sh. C.1 të përmendur më lart. Edhe dëshmitarët Sh. A., V. A., dhe A. A. 2 janë dëgjuar nëpërmjet video-lidhjes.

I.E.7. Dëshmitarët e mbrojtur

64. Dy dëshmitarëve të Prokurorisë iu është lejuar masa e anonimitetit nga të pandehurit dhe publiku nga gjyqtari i procedurës paraprake⁸⁵. Dëshmitarët ishin referuar me pseudonimet X dhe Y gjatë gjithë procedurës. Masat e njëjta të anonimitetit ishin mbajtur në lidhje me Dëshmitarin X gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe dëshmitari ka dëshmuar nëpërmjet video-lidhjes me fytyrë dhe zë të shtrembëruar, në një seancë të hapur për publikun.⁸⁶ Masa e anonimitetit nga të pandehurit ishte larguar në lidhje me Dëshmitarin Y, por dëshmitari ka mbetur anonim për publikun dhe ka dëshmuar me

⁸³ Prokurori v. Tadic (IT-94-1-T), Vendimi në Kërkesën për të Thirur dhe Mbrojtur Dëshmitarët e Mbrojtjes, dhe në Dhënjën e Dëshmise përmes Video Lidhjes, 25 qershor 1996 (RP D9148-D9162) ("Vendimi Tadic").

⁸⁴ Procesverbali i seancës së mbyllur të datës 6 korrik 2015, par. 95. *Shih poashtu* Aktvendimin e datës 6 korrik 2015, në lidhje me dëshmitarin X, dhe Aktvendimi i datës 21 korrik 2015, në lidhje me dëshmitarin Y.

⁸⁵ *Shih* Aktvendimin e datës 27 Janar 2014, Dosja e procedurës paraprake I, **O.I.**, tab 19, Aktvendimet e datës 6 Mars 2014 dhe 13 Qershor 2014.

⁸⁶ *Shih* Aktvendimin e datës 14 Janar 2015, Dosja e Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, tab 3; Aktvendimi i datës 6 korrik 2015, në lidhje me dëshmitarin X. I Dosja e Gjykatës XII, Shqyrtimi Gjyqësor, tab 7; *Shih edhe* procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 6, 7 dhe 8 korrik 2015.

dyer të mbyllura përmes video-lidhjes.⁸⁷

I.E.8. Karakteri publik i shqyrtimit gjyqësor

65. Shqyrtimi gjyqësor ishte i hapur për publikun në përputhje me nenin 293 të KPP-së, me përjashtim të seancave më 28, 29 dhe 30 korrik 2015 dhe pjesërisht më 10 shtator 2015, 27 tetor 2015 dhe 1 dhjetor 2015, të cilat ishin shpallur të mbyllura për publikun .

I.E.9. Gjuha e procedurës, përkthimit dhe procesmbajtjes

66. Në bazë të nenit 16 të Ligjit mbi kompetencat dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, gjuha e përdorur në procedurat gjyqësore ishte gjuha angleze.
67. Në përputhje me nenin 1 paragrafin 2 të KPP-së, përkthyesit kanë përkthyer procedurat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet gjyqësore relevante për gjykimin nga gjuha angleze në gjuhën serbe dhe shqipe, dhe anasjelltas. Në disa raste palët kanë ngritur kundërshtime ndaj cilësisë së përkthimit. Të gjitha vërejtjet janë shqyrtuar menjëherë nga trupi gjykues dhe sqarimi ishte vënë në procesverbal.
68. Saktësia e procesverbalit të shkruar ishte kontrolluar nga kryetari i trupit gjykues në kohë reale. Ekranin e kompjuterit që shfaqte procesverbalin ishte vendosur para tij. Kjo mënyrë e procesmbajtjes ka bërë të tepërt përdorimin e metodave të tjera të procesmbajtjes pasi që dukej se ishte e pamundur për të arritur ndonjë saktësi më të mirë të përmbajtjes semantike të procesverbalit.

II. ARSYETIMI LIGJOR

69. Rasti është i strukturuar në dy Akuzat të ndara.

⁸⁷ *Shih* Aktvendimin e datës 14 Janar 2015, Dosja e Gjykatës III, Shqyrtimi Gjyqësor, tab 3; Aktvendimi i datës 21 korrik 2015, në lidhje me dëshmitarin Y. Dosja e Gjykatës XII, Shqyrtimi Gjyqësor, tab 7; . *Shih edhe* procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 28, 29 dhe 30 korrik 2015

70. Akuza 1 është e drejtuar vetëm ndaj **O. I.** Kjo akuzë është krime lufte kundër popullatës civile dhe ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur më 14 prill 1999.
71. Akuza 2 është e drejtuar ndaj të gjithë pesë të Pandehurve dhe ka të bëjë me disa sulme të ekzekutuara më 3 shkurt 2000, ndaj popullatës Shqiptare që jetonin në veri të Mitrovicës, dhe që rezultuan me vdekjen e dhjetë personave dhe lëndimin e 13 të tjerëve. Këto akuza i mbështesin tri akuza të nxitjes për të kryer vrasje të rëndë – kur është fjala për **O. I.** dhe **D. D.**- dhe tri akuza për vrasje të rëndë dhe vrasje të rëndë në tentativë – kur është fjala për **N.V.1, I. V.** dhe **A. (S.) L.**
72. Dy akuzat do të vlerësohen ndarazi në kapitujt vijues.

II. A. PIKA 1: NGJARJET E 14 PRILLIT 1999 NË MITROVICËN JUGORE:

II. A. 1 Faktet

73. Faktet e mëposhtme janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

- I. Gjatë viteve 1998-1999 në Kosovë ka pasur konflikt ndërmjet forcave serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që u intensifikua me përfshirjen dhe bombardimet nga Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) që filluan më 24 mars 1999.
- II. Në këto rrethana, më 14 prill 1999 forcat serbe organizuan një operacion spastrimi në Mitrovicën jugore, me synim përzhënien dhe vrasjen e shqiptarëve etnikë.
- III. Atë ditë, rreth orës 12:00 një numër i madh familjesh shqiptare që jetonin në zonën e rrugës Miladin Popović (tani rruga Ahmet Selaci) dhe rruga Njegos (që tani përbëhet nga rruga “Mehmet Gradica” dhe rruga 11 Marsi) u larguan me forcë nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe dhe i grumbulluan jashtë në rrugë.
- IV. Gratë, fëmijët dhe pleqtë u ndanë më pas nga pjesa tjetër e meshkujve, u çuan në drejtim të stacionit të autobusëve në Mitrovicë dhe u urdhëruan të shkonin për në Shqipëri.
- V. Një numër prej 15 meshkujsh shqiptarë ishin grumbulluar në grup dhe u shoqëruan nga ushtarët deri te muri i një shtëpie që gjendej në rrugën Njegos. Ata ishin:

F.M., I. M.1, Xh. S., B. F., M. M.1, I. M.2, S. P., K. A., L. A.1, A. A.1, B.A., S. K.1, M. S. (F.), Sh. K.1 dhe Sh. K.2.

- VI. Atje, ata u mbështetën për muri dhe iu morën ushtrisë nga një grup i armatosur paramilitarësh/policësh serbë dhe u mbajtën aty për rreth një orë me duart e lidhura prapa qafës. Gjatë asaj kohe grupi i paramilitarëve/policëve i mori ata në pyetje në lidhje me UÇK-në. Disa nga meshkujt e arrestuar ishin kërcënuar dhe sulmuar.
- VII. Pastaj tërë grupi, nën shoqërimin e paramilitarëve/policëve, ecën rrugës deri sa arritën në rrugën kryesore – rruga Miladin Popović, ku edhe i ndalën.
- VIII. Para tyre, në kryqëzimin ndërmjet rrugës Miladin Popović dhe rrugës Rruga për Bajr ishte një pikë kontrolli e policisë/e paramilitarëve.
- IX. Gjashtë nga meshkujt ishin ndarë nga të tjerët, ishin lënë të largoheshin dhe u ishte thënë që të shkonin për Shqipëri. Ata ishin: L.A.1, K.A., B.A., S.K. 1, I. M. 2, Sh. K.2.
- X. Nëntë të tjerët të mbetur ishin shoqëruar nga paramilitarët/policia në rresht për në rrugën Miladin Popović, drejt pikës së kontrollit. Ata ishin: F. M., I. M.1, Xh. S., B. F., M. M.1, S. P., A. A.1, M. S. (F.) dhe Sh. K.1.
- XI. Me atë rast O. I. ishte pjesë e grupit të paramilitarëve/policëve të pranishëm në pikën e kontrollit.
- XII. Ai kishte të veshur një uniform me ngjyrë të kaltër dhe ishte i armatosur.
- XIII. Para se të nëntë meshkujt e përmendur më lart në pikën 10 ta kalonin pikën e kontrollit, një pjesëtar i njësisë së policisë serbe/paramilitarëve serbë që ishte duke i shoqëruar ata, e kishte pyetur **O. I.** diçka si "Çfarë të bëjmë me ta shef?", të cilës **O. I.** i ishte përgjigjur diçka në kuptimin e: "Pse po më pyet mua, zbatoji urdhrat"
- XIV. Më pastaj të nëntë shqiptarët u shoqëruan përmes pikës së kontrollit dhe u çuan pak metra më tej në Rrugën për Bajr, aty ku ata u ndaluan.
- XV. Paramilitarët/policia i mori me vete dy nga dy, duke filluar nga fundi i rreshtit, drejt shtëpive që gjendeshin në secilën anë të rrugës dhe qëlluan mbi ta. Katër meshkuj u qëlluan, si më poshtë: S.P., F. M., A. A 1.dhe M. S. (F.).
- XVI. Gjersa ishin duke ndodhur këto ngjarje, një veturë Pinzgauer kishte arritur me një person të uniformuar, i cili dha urdhër që i ndali të shtënat.

- XVII. Ky person pastaj i shoqëroi pesë meshkujt e mbetur prapa për në rrugën Miladin Popović në drejtim të stacionit të autobusëve. Ata ishin: I. M 1., Xh. S., B. F., M. M.1 dhe Sh. K.1.
- XVIII. Në stacionin e autobusëve, ata u ribashkuan me familjet e tyre dhe së bashku shkuan në Shqipëri.
- XIX. **O. I.** ishte në dijeni të operacionit të përzënies dhe vrasjes së civilëve etnikë shqiptarë; atë ditë, duke vepruar siç përshkruhet më lart, ai veproi vullnetarisht në pajtim me planin, duke e ditur që për pasojë do të kishte vrasje.
- XX. **O. I.** ishte plotësisht i aftë mendërisht.
- XXI. Në atë kohë, **O. I.** ishte një figurë e mirë-njohur në Mitrovicë, me të dhëna të suksesshme sportive në artet marciale, në ndërmarrjet e ndryshme tregtare dhe me pozitë të shquar në kompleksin industrial shtetëror 'FERRONIKEL'. Ai gjithashtu e fliste rrjedhshëm gjuhën shqipe.

74. **Nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:**

- XXII. Duke ndërmarrë si më sipër, **O. I.** kishte vepruar në cilësinë e udhëheqësit të njësisë së paramilitarëve/të policisë serbe.
- XXIII. **O. I.** "e kishte nxitur grupin e paramilitarëve/policëve duke i urdhëruar ata" që të kryenin vrasje.

Vërejtje hyrëse:

75. Në aktakuzë pretendohet si vijon:

"më 14/04/1999 rreth orës 12:00 në Mitrovicë⁸⁸ në rrugën Miladin Popović (tani rruga Ahmet Selaci) dhe rrugën Rruga për Bajr, duke vepruar në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollit Shtesë II, dhe në cilësinë e udhëheqësit të njësisë paramilitare/të policisë serbe, ka nxitur grupin e paramilitarëve/policëve vartës që të kryenin krime lufte në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të karakterit ndërkombëtar kundër personave që nuk po merrnin pjesë

⁸⁸ Sipas Aktakuzës së korrigjuar, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 20 e më tej.

aktivisht në armiqësi, duke i urdhëruar ata që t'i vrasin viktimat e etnisë shqiptare, si në vijim:

- a. F. M.
- b. S. P.
- c. A. A. 1
- d. M. S. (F.)
- e. I. M.1
- f. Xh. S.
- g. B. F.
- h. M. M.1
- i. Sh. K.1

dhe për pasojë F. M., S. P., A. A.1 dhe M. S. (F.) u qëlluan për vdekje nga paramilitarë/policë të pidentifikuar nën komandën dhe kontrollin efektiv të të pandehurit.”

76. Aktakuza, në dispozitivin e saj nuk ka elaboruar më shumë sa i përket gjendjes faktike. Faktet e pretenduara janë përshkruar në pjesën arsyetuese të Aktakuzës dhe janë shtuar me argumentimin e prokurorit, në mënyrë mjaft joprecize. Trupi gjykues e ka shikuar si dispozitivin ashtu edhe arsyetimin si tërësi dhe është përpjekur që të vlerësojë faktet relevante për veprën penale që është objekt i Aktakuzës siç është identifikuar në të dyja pjesët.
77. Prokuroria ka administruar 17 dëshmitarë sa i përket kësaj Pike. Prej tyre, pesë prej dëshmitarëve ishin pjesë e “rreshtit për ekzekutim”⁸⁹ dhe kishin mbijetuar: I. M.,1 Xh. S., Sh. K.,1 B. F. dhe M. M..1 (Katër personat e tjerë në rreshtin për ekzekutim ishin vrarë.)

⁸⁹ Për ta thjeshtuar shpjegimin, ne do ta përdornim termin "rresht i ekzekutimit" për t'iu referuar rreshtit prej nëntë shqiptarësh të Kosovës të shoqëruar nga pika e fundit e ndarjes nga rruga Miladin Popović deri në vendin ku ka ndodhur ekzekutimi. Ata janë: F. M., I. M.1, Xh. S., B. F., M. M.1, S. P., A. A.1, M. S. (F) dhe Sh. K.1.

78. Dëshmitarët K. A. dhe L. A.1 ishin pjesë e grupit më të madh prej 15 shqiptarëve të Kosovës të cilët fillimisht u kapën dhe u morën në pyetje, por më vonë u liruan; ky i fundit ishte marrë në pyetje me kërkesë të mbrojtjes.
79. Edhe dëshmitarët F. P., B. S. 1, Sh. C. 1 dhe M. Ll. u dëbuan nga lagja në po të njëjtën ditë. Disa nga anëtarët e familjeve të tyre u vranë atë ditë, por ata nuk janë të përfshirë në lëndën e Aktakuzës.
80. Dëshmitarët Ç. I., Z. A. dhe N. A.3 kanë deklaruar se e kanë parë **O. I.** duke mbajtur uniformë gjatë konfliktit.
81. Dëshmitari B. I. është një ish-punëtor i Ferronikelit dhe kryesisht dëshmoi lidhur me aktivitetet e kompanisë gjatë luftës.
82. Disa dëshmitarë, si B. R.2, H. B., dëshmitari Y dhe F. H. u thirrën për të dëshmuar në lidhje me Pikën 2, por prekën aspektet që kishin të bënin edhe me Pikën 1.
83. Mbrojtja i propozoi dëshmitarët B. K., D. M.1, A. D., N. K. dhe O. M., si dëshmitarë të alibisë dhe për të provuar aktivitetet e të akuzuarit në atë kohë ose mbështetjen e tij për shqiptarët etnikë.
84. Kur vlerësohen ato, dëshmitë do të grupohen në katër kategori kryesore:
- (a) Dëshmitë në lidhje me ngjarjet e 14 prillit 1999 në Mitrovicë
 - (b) Dëshmitë në lidhje me anëtarësimin e **O. I.** në forcat serbe në vitin 1999
 - (c) Dëshmitë në lidhje me praninë e **O. I.** në Ferronikel më 14 prill 1999 dhe me aktivitetet e tij si civil në vitin 1999
 - (d) Roli i **O. I.** në ngjarjet e 14 prillit 1999 në Mitrovicë
 - (e) Analiza e kushteve të konfliktit të armatosur, statusi civil i popullatës së vënë në shënjestër dhe lidhja me konfliktin e armatosur.

(a) Dëshmitë që vërtetojnë ngjarjet e 14 prillit 1999 në Mitrovicë:

Rruga e viktimave nga dëbimi e deri te ekzekutimi dhe rrugëdalja e të mbijetuarve:

85. Dëshmitarë të shumtë⁹⁰ rrëfejnë me hollësi se si më 14 prill 1999, ata u përzunë nga shtëpitë e tyre që gjendeshin në zonën e rrugës Miladin Popović (rrugës së Kovaçëve)⁹¹ nga forcat e armatosura serbe. Ata ishin grumbulluar jashtë shtëpive të tyre, nëpër rrugë. Gratë, fëmijët dhe pleqtë u ndanë më pas nga pjesa tjetër e meshkujve, u çuan në drejtim të stacionit të autobusëve në Mitrovicë dhe u urdhëruan që të shkonin për Shqipëri. Pjesa e mbetur e meshkujve u kapën nga forcat serbe dhe disa prej tyre u ekzekutuan.
86. Që në fillim, trupi gjykues e cek se prokuroria e kishte përmendur në aktakuzë "që rrëfimi të jetë i plotë",⁹² se gjithsej 27 persona të etnisë shqiptare ishin vrarë në atë ndërhyrje policore/paramilitare. Megjithatë, vetëm nëntë individët e përmendur më lart - nga të cilët katër ishin vrarë në atë rast - janë të përfshirë shprehimisht në aktakuzë. Prandaj, në këtë vendim, trupi gjykues do të shqyrtojë vetëm fatin e këtyre nëntë personave. Këta nëntë persona fillimisht ishin pjesë e një grupi më të madh prej 15 sish; të gjithë ata u dëbuan nga shtëpitë që gjendeshin në rrugën Njegoš dhe u kapën në rrethana të ngjashme siç është paraqitur më poshtë.
87. Dëshmitari I. M. 1 tregoi se si më 14 prill të vitit 1999, rreth orës 12:00, gjersa ishte në shtëpi së bashku me familjen e tij - në mesin e të cilëve ishte dëshmitari Sh. K.1,⁹³forcat ushtarake erdhën në shtëpinë e tyre dhe kërkuan nga ata që ta lironin shtëpinë. Ata hynë edhe në apartamentet e fqinjëve, e edhe ata i urdhëruan që të

⁹⁰ Siç është detajuar më poshtë.

⁹¹ Për një përfaqësim më të mirë të gjeografisë të zonës, shih skicën dhe raportin e vizitës në terren të kryer më 21 shtator 2015, të hartuar nga Njësia e Forenzikës, Drejtoria e Policisë Rajonale në Mitrovicë, e datës 21 shtator 2015 dhe e paraqitur në Gjykatë më 28 shtator 2015.

⁹² Aktakuza, faqe 10, versioni në anglisht.

⁹³ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 56; Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, paragrafët 34, 440-441.

largoheshin. Ata ishin të armatosur, të pajisur me pajimet e plota ushtarake - helmata dhe jelekë - dhe ata kishin të veshur uniforma kamuflazhi të gjelbra. Ata të gjithë ishin mes moshave 30-40 vjeç dhe flisnin serbisht. Në bazë të moshës së tyre, dëshmitari pretendon se ata të gjithë ishin rezervistë dhe se asnjëri prej tyre nuk ishte nga zona e Mitrovicës.⁹⁴ Dëshmitari, familja e tij, si dhe fqinjët e tyre, u nxorën jashtë në rrugë, ku forcat serbe i ndanë meshkujt mbi moshën 18-19 nga pjesa tjetër e burrave të moshuar, nga gratë dhe fëmijët.

88. Një person me uniformë ushtarake e kishte urdhëruar grupin e burrave të moshuar, grave dhe fëmijëve që të largoheshin nga vendi dhe "i lëvizën ata tutje" duke ndjekur rrugën Foqa, e cila çon në rrugën Miladin Popović dhe më tej për te stacioni i autobusëve⁹⁵. Pjesa tjetër e tyre, meshkujt mbi moshën 18-19 janë shoqëruar nga oficerët e ushtrisë më poshtë në rrugën Njegoš, ku ata u vendosën mbështetur për muri të një shtëpie.
89. Dëshmitari Xh. S. i përshkruan ngjarjet ngjashëm si I. M.1. Ai ka deklaruar në mënyrë të qartë se edhe ai jetonte në rrugën Njegoš dhe në ditën kritike, 14 prill 1999 ai ishte në shtëpi së bashku me familjen e tij - në mesin e të cilëve ishte dëshmitari B. F..⁹⁶ Ishte rreth mesditës, në mes të orës 11:00 dhe 12:00, kur anëtarët e ushtrisë së rregullt hynë në shtëpi dhe i dëbuan ata duke i nxjerrë në rrugë. Ata ishin të armatosur, të veshur me uniforma ushtarake "të gjelbër dhe ngjyrë hiri". Ata flisnin serbisht.
90. Sipas deklaratës së tij, atë ditë, dëshmitari K. A. dhe gjithë familja e tij (25 anëtarë gjithsej) po qëndronin në shtëpinë e L. A.1 që ndodhet në rrugën Njegoš.⁹⁷ Edhe bijtë e tij A. A.1 dhe B. A. ishin atje. Edhe fqiu i tyre i parë S. P. dhe M. S. ishin atje (A. A.1, S. P. dhe M. S. u vranë menjëherë pas kësaj). Rreth orës 10:00 ose 10:30,⁹⁸ tre oficerë të veshur me uniforma të gjelbra ushtarake, me maska dhe të armatosur me pushkë

⁹⁴ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 88.

⁹⁵ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 125 e më tej.

⁹⁶ Xh. S., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 515 e më tej.

⁹⁷ K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, para. 21 e më tej.

⁹⁸ K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, para. 203.

automatike, hynë brenda me forcë dhe bërtisnin në gjuhën serbe "të gjithë jashtë, e keni kërkuar NATO-n dhe tani të gjithë jashtë".⁹⁹

91. Dëshmitari L.A. 1 e konfirmon rrëfimin e K. A..¹⁰⁰ Ai tregon se si në ditën kritike, rreth orës 11:00, "forcat parashtarake apo forcat ushtarake" erdhën në shtëpinë e tij dhe i dëbuan të gjithë banorët. Të gjithë ata janë nxjerrë në rrugë, ku meshkujt e rinj ishin ndarë nga pjesa tjetër.
92. Dëshmitari B. F. ka deklaruar se në të njëjtën ditë ai ishte duke e vizituar A. S.2 i cili jetonte në zonën e rrugës së Kovaçëve,¹⁰¹ në të njëjtën shtëpi sikurse dëshmitari Xh. S. (Edhe nëse këtij dëshmitari të veçantë nuk i kujtohet vendndodhja e saktë, ne mund ta vërtetojmë atë në bazë të dëshmisë së Xh. S. se shtëpia gjendej në rrugën Njegos). Ishte rreth orës 10:00, kur rreth dhjetë policë të veshur me uniformë të kaltër dhe të armatosur me pushkë automatike, bomba dhe disa prej tyre edhe me sëpata, hynë me forcë në shtëpi dhe i urdhëruan ata të largoheshin. Ata u larguan nga shtëpia dhe u mbledhën përpara ndërtesës. Oficerët flisnin në gjuhën serbe dhe dëshmitari mendon se ata ishin të policisë serbe. Ai shkoi në katin e poshtëm duke e mbajtur fëmijën e Xh. S. në krahët e tij. Duke qenë në katin e poshtëm, një njeri i veshur me të njëjtën lloj uniforme dhe që dëshmitari beson se ka qenë komandant i kishte kërkuar atij që ta lëshonte poshtë fëmijën që qante. Fëmija ishte marrë prej tij. Forcat serbe filluan t'i ndanin burrat nga gratë dhe fëmijët, ndërkohë që "komandanti" i nxiste ata: "më shpejtë, më shpejtë". Pas ndarjes, dëshmitari u shoqërua për te muri pranë shtëpisë së B. V..
93. Më 14 prill të vitit 1999, dëshmitari M. M.1 ishte në shtëpinë e tij në rrugën Njegos,¹⁰² kur forcat e armatosura serbe erdhën dhe i dëbuan familjen e tij. Ata fillimisht nuk e gjetën atë pasi që ai ishte fshehur në bodrum; megjithatë, menjëherë pas kësaj, babai i tij erdhi përsëri i shoqëruar nga dy meshkuj serbë në uniformë dhe ata e morën atë. Ai u nxor jashtë shtëpisë dhe u bashkua me pjesën tjetër të grupit të dëbuar nga lagja. Kjo

⁹⁹ K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, para. 35.

¹⁰⁰ L. A.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 26 mars 2015, para. 90 e më tej.

¹⁰¹ B. F., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 20 shkurt 2015, para. 25 e më tej..

¹⁰² M. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 shkurt 2015, para. 27 *et seq.*

ndodhi diku mes orës 10:00 e 11:00 të paradites. Njerëzit e uniformuar të cilët i dëbuan ata ishin të veshur me uniforma të kaltra të policisë dhe kishin jelekë me ngjyrë të gjelbër dhe dy granata raketa hedhëse në shpinë. Gjersa e dëbonin dëshmitarin dhe familjen e tij, policët u thanë atyre "ne ju dhamë çdo gjë dhe ju nuk e donit, tani NATO po ju ndihmon ju, ndërsa ne kemi Rusinë." Dëshmitari nuk ka njohur asnjë fytyrë të njohur dhe për këtë arsye supozonte se ata kishin ardhur nga Serbia.

94. Të gjitha dëshmitë përputhen për sa i përket procedurës: familje të tëra ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre. Sapo gjendeshin jashtë, femrat, fëmijët dhe pleqtë ndaheshin dhe urdhëroheshin që të marshonin në drejtim të stacionit të autobusëve, ndërsa burrat i ndalnin prapa dhe ata kapeshin nga forcat e armatosura serbe.
95. Pas ndarjes nga familjet e tyre, burrat e mëposhtëm janë shoqëruar dhe rreshtuar duke u mbështetur për murin e një shtëpie që gjendej në rrugën Njegoš:¹⁰³ S. K.1, S. P., K. A., L. A.1, B. A., A. A.1, M. S., Sh. K.2, I. M.2, F. S. M., Sh. K.1, I. M. 1, Xh. I. dhe B. F.. M. M.1, i cili kishte arritur të shkonte pa u vënë re kur ushtarët fillimisht e kontrolluan shtëpinë e tij familjare (pasi që ai ishte fshehur në bodrum), u soll më vonë nga dy ushtarë dhe ata e detyruan që t'u bashkohej të tjerëve te muri.¹⁰⁴
96. Të 15 shqiptarët e Kosovës ishin mbështetur për muri me duar lart, gishtat i kishin të gërshetuar prapa kokës dhe ishin me ballë të mbështetur për muri. Ata u mbajtën me armët e drejtuara kundër tyre, u kontrolluan dhe u morën në pyetje¹⁰⁵ për rreth një orë.¹⁰⁶ Ata u pyetën nëse ishin pjesëtarë të UÇK-së, ata u shanë me fjalë dhe u kërcënuan se do të vriteshin.¹⁰⁷ Një nga burrat në uniformë mbante një sëpatë dhe e shtypte lehtë me të në shpinë I. M.1.¹⁰⁸

¹⁰³ Segment i rrugës Njegoš që tani quhet "11 Marsi".

¹⁰⁴ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para 113, dhe M. M.1, paragrafët 40-63; K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, para. 45.

¹⁰⁵ K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, para. 45.

¹⁰⁶ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 113; K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, para. 41.

¹⁰⁷ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 228 *et seq.*

¹⁰⁸ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 188 *et seq.*

97. Nga muri, më pas ata ishin renditur në një rresht dhe u shoqëruan përsëri për në rrugën Njogoš në drejtim të rrugës Miladin Popović. Pas ngjitjes së shkallëve që e lidhnin rrugën Njogoš me atë Miladin Popović, ata i detyruan që të ktheheshin në të majtë dhe të ecnin disa metra në këtë rrugë dhe pastaj ata u ndaluan.
98. Ata u ndanë në rresht njëri pas tjetrit, në një distancë të ngushtë, rreth një hap¹⁰⁹ ose “sa gjatësia e krahut” .¹¹⁰
99. Menjëherë kur ata u kthyen në të majtë në rrugën Miladin Popović, ata vunë re një pikë kontrolli me polici dhe paramilitarë, dhe ndoshta me ushtri. Pika e kontrollit ishte e vendosur në kryqëzimin para tyre, mes rrugës së Kovaçëve/Miladin Popović, rrugës së vogël që çon në drejtim të ish-shkollës "Meto Bajraktari" dhe Rrugës Për Bajr.
100. Ata marshuan disa metra në rrugën Miladin Popović dhe u ndalën afërsisht dhjetë metra para pikës së kontrollit.¹¹¹
101. Këtu njerëzit e uniformuar të cilët i shoqëruan ata atje i dorëzuan ata te disa të tjerë “të kaltrit”.¹¹²
102. Një person nga pika e kontrollit në uniform të kaltër të policisë¹¹³ dhe që mbante një maskë iu afrua atyre. Ai i zgjodhi disa nga grupi, i liroi ata dhe i shoqëroi ata prapë për në rrugën Miladin Popović, në drejtim të stacionit të autobusëve. Grupi i parë përbëhej prej gjashtë meshkujve: L. A.1, K. A.,¹¹⁴ B. A., S. K.1, I. M. 2 dhe Sh. K.2.¹¹⁵
103. Nëntë meshkujt e mbetur u shoqëruan nga paramilitarët/policia në drejtim të kundërt

¹⁰⁹ Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, para. 314.

¹¹⁰ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 156.

¹¹¹ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, paragrafët 175-176.

¹¹² I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, paragrafët 423-428. Për thjeshtim të shpjegimit, termat “të kaltrit” dhe “të gjelbërit” do të përdoren në këtë dokument për të treguar trupat e veshura me uniforma të kaltra ose uniforma të gjelbra; aspekti i uniformës do të vlerësohet më në detaje më tej në aktgjykim.

¹¹³ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 449.

¹¹⁴ Deklaratat e K. A. të datave 05/08/2013, 08/12/1999 dhe 24/01/2000.

¹¹⁵ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 273; Xh.S., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, paragrafët 635-646.

në rrugën Miladin Popović, në drejtim të udhëkryqit me pikën e kontrollit. Këta ishin: F.M., I.M.1, Xh.S., B.F.,¹¹⁶ M.M.1,¹¹⁷ S.P., A.A.1, M.S.(F.) dhe Sh. K.1.¹¹⁸

104. Sipas I. M.1, rendi në rresht, duke filluar nga përpara deri në prapa, ishte si vijon: M.M.1, Xh.S., B.F., I. M.1, Sh. K.1, që pasoheshin nga katër personat që u ekzekutuan, dhe të cilët ishin F. M., A. A.1, S. P. dhe M S.¹¹⁹
105. Sh. K.1 e konfirmon se I. M.1 ishte para tij dhe F. M. ishte prapa tij, por nuk i kujtohet rendi i të tjerëve.¹²⁰
106. M. M.1 tregon se ai ishte i pari në rresht, prapa tij ishte I. M. dhe më pas të tjerët, por ai nuk është i sigurt për rendin e saktë të tyre. ¹²¹
107. Sa i kujtohet Xh. S. i pari në rresht ishte M. M.1, që pasohet nga ai vetë ose kunati i tij;¹²² prapa tyre ishte I. M.1 ose Sh. K.1 ¹²³.
108. B. F.tregoi se pas ndarjes së tyre të fundit, ai ishte i vendosur ndërmjet Xh.S dhe I.M.1, të tjerët ishin M.M.1 dhe mysafiri i I.M.1¹²⁴-“gjithsej pesë njerëz”. ¹²⁵
109. Bazuar në atë që u tha më sipër, është vërtetuar se rreshti fillonte me pesë njerëzit që mbijetuan: i pari ishte M.M.1 dhe i pesti në rresht ishte Sh. K.1. Ata pasoheshin nga katër meshkujt që u ekzekutuan. Të gjithë dëshmitarët përputheshin në atë që u tha më sipër. Prandaj, është e qartë se grupi i pesë të mbijetuarve fillonte me M. M.1 dhe përfundonte me Sh.K.1; Xh.S., B.F. dhe I.M.1 ishin në mes. Kur është fjala për rendin e këtyre të treve, ka mospërputhje të caktuara në dëshmitë e dëshmitarëve, të cilat në mënyrë të arsyeshme mund t'i atribuohen kalimit të kohës, ose situatës stresuese. Prandaj, nuk mund ta vërtetojmë me siguri rendin e personave

¹¹⁶ Deklaratat e B. F. të datave 18/07/2013, 22/08/2013 dhe 28/01/2000.

¹¹⁷ Deklarata e M. M.1 e datës 13/08/2013.

¹¹⁸ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 275.

¹¹⁹ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 370.

¹²⁰ Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, para. 230.

¹²¹ M. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 shkurt 2015, para. 210.

¹²² Kunati i Xh. S. është B. F.. *Shih* dëshminë e Xh. S, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 648.

¹²³ Xh. S., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, paragrafët 16-18.

¹²⁴ Mysafiri i I.M1 është Sh. K.1. *Shih* dëshminë e I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, paragrafët 52-58.

¹²⁵B. F., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 20 shkurt 2015, paragrafët 150-151.

të dytë, tretë dhe të katërt në rresht. Megjithatë, identiteti i tyre është vërtetuar: Xh. S., B. F. dhe I. M.1.

Nga ndarja deri te ekzekutimi:

110. Pavarësisht disa mospërputhjeve lidhur me ngjyrat e uniformave të trupave të ndryshëm të përfshirë në veprime të ndryshme, dëshmitë janë konsistente, sa i përket faktit se ai ishte "grupi i të kaltërve", i cili mori përsipër grupin prej nëntë shqiptarësh të Kosovës pas ndarjes së tyre të fundit në rrugën Milladin Popović.
111. Ata u urdhëruan që ta vazhdonin marshimin në rrugën Miladin Popović, në drejtim të kryqëzimit me pikën e kontrollit.¹²⁶ Të gjithë (të nëntit) u urdhëruan që të marshonin, kaluan afër pikës së kontrollit dhe vazhduan më tej për në Rrugën për Bajr. Ata u shoqëruan nga "të kaltrit" dhe pa "të gjelbrit" që të shiheshin diku.¹²⁷ Kur iu afruan pikës së kontrollit, njerëzit me uniformë të pozicionuar atje, i tërhoqën poshtë maskat.

Njerëzit e vranë:

112. Katër shqiptarët e Kosovës që ishin të fundit në rresht u vranë. Rojet e armatosura i morën me vete nga pjesa tjetër e grupit në drejtim të shtëpive që ndodhen në secilën anë të rrugës¹²⁸ dhe i qëlluan ata. Të katër burrat si në vijim, u qëlluan: S. P., F. M., A. A.1 dhe M. S.. Dëshmitë e të pesë të mbijetuarve janë njëzëri lidhur me këtë. Edhe nëse asnjëri prej tyre nuk e ka parë vetë ekzekutimin, ata i kishin dëgjuar forcat serbe duke u bërë thirrje të katër viktimave që të lëviznin kah shtëpitë anësore dhe i dëgjuan të shtënat me armë menjëherë pas kësaj.¹²⁹

¹²⁶ Xh. S, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 592; I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 162 *et seq.*

¹²⁷ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, paragrafët 431-434.

¹²⁸ Shtëpitë i përkisnin H. K. dhe S. K.. *Shih* I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 386.

¹²⁹ M. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 shkurt 2015, paragrafët 210 – 214 dhe 271-274; Xh. S, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, paragrafët 16-18; I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 370; Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, para. 228.

113. Trupi gjykues ka marrë dëshmi në lidhje me grumbullimin e trupave të viktimave të vrarë atë ditë. Dëshmitari B. M. ishte gjyqtar hetues në atë kohë dhe ai ishte thirrur në atë cilësi për të marrë pjesë në këqyrjen e vendit të ngjarjes të nesërmen pas ekzekutimit. Disa trupa ishin gjetur në rrugën Mbreti Millutin¹³⁰ në Mitrovicë. Gjyqtari hetues i kishte përshkruar konstatimet e tij në raportin e tij Kri nr. 58/99 të datës 15 prill 1999. Vërtetësia e raportit është e vërtetuar më 23 maj 2014 në Dhomën e Posaçme për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd, siç dëshmohet nga shënimi i shkruar me dorë, nënshkrimi dhe vula në faqen e fundit të dokumentit.¹³¹ Në raport pasqyrohet se cilat nga viktimat ishin identifikuar, pas ekzaminimit me daktiloskopi papilare. Është vërtetuar se të katër viktimat që janë subjekt i Aktakuzës janë në mesin e trupave të gjetur më 15 prill 1999.¹³² Gjyqtari hetues kishte urdhëruar që trupat të varroseshin në një vend në fshatin Vidimiriq, pasi që kjo duket të ishte zgjidhja më efikase, duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e situatës së sigurisë në atë kohë.¹³³ Mbetjet e katër viktimave më vonë ishin zhvarrosur dhe identifikuar nga UNMIK-u në vendin e specifikuar.¹³⁴ Dëshmitari K. A. dëshmoi se ai e kishte marrë trupin e djalit të tij A.3, tre muaj më vonë nga Vidimiriqi. ¹³⁵Në mënyrë të ngjashme, mbetjet e F. M. i ishin dorëzuar familjes së tij.¹³⁶
114. Certifikatat e vdekjes ishin lëshuar për të gjitha (të katër) viktimat.¹³⁷ Ka gabime të caktuara që mund të vërehen në certifikata, kur bëhet fjalë për të dhëna të tilla si data e lindjes apo e vdekjes.¹³⁸ Megjithatë, këto janë konsideruar thjesht si gabime materiale *de minimus*. Duke pasur parasysh provat e përgjithshme të përmendura më lart, këto

¹³⁰ Emri tjetër i përdorur për rrugën Miladin Popović/rruga e Kovaçëve, *shih* F. P., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 shkurt 2015, para. 25; B. M., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 Mars 2015 para. 35-37; Procesverbali i shiqimit të vendngjarjes, 21 Shtator 2105, para. 16.

¹³¹ *Shih* Raportin mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes nga B. M., të datës 15/04/1999, - Dosja I e Prokurorisë, Provat Shkresore, f. 745-753.

¹³² B. M., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 mars 2015, paragrafët 35 *et seq.*, dhe para. 110; *shih* po ashtu Raportin mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes nga B. M., të datës 15/04/1999, f. 745-753.

¹³³ B. M., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 mars 2015, para. 74.

¹³⁴ Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga B. M., i datës 15/04/1999 f. 745-753.

¹³⁵ K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, para. 161.

¹³⁶ Raporti postmortum i Policisë së UNMIK-ut për F. M. i datës 21/10/2004 dhe dokumente të tjera që lidhen me vdekjen e F. M., f. 754-775.

¹³⁷ Certifikatat e vdekjes së A. A.1, S. P., M. S. dhe F. M. të lëshuara më 18/06/2013, f. 776-777.

¹³⁸ Shembull: për M. S., data e vdekjes i paraprin datës së lindjes dhe të dyja janë në vitin 1999; për S. P. të dyja data e lindjes dhe e vdekjes janë të shënuara si 14 prill 1999.

gabime të vogla materiale nuk ishin të mjaftueshme për të vënë ndonjë dyshim të arsyeshëm në bindjen e trupit gjykues se katër viktimat ishin vrarë atë ditë kritike.

Ekzekutimi ishte ndërprerë:

115. Pesë dëshmitarët që ishin në rreshtin e ekzekutimit – përkatësisht I. M.1, Xh. S., Sh. K.1, B. F. dhe M. M.1 treguan njëzëri se një person me uniformë kishte ardhur në vendin e ekzekutimit dhe i kishte urdhëruar policinë/paramilitarët që të ndaleshin. Për shkak të ndërhyrjes së tij, ekzekutimi ishte ndërprerë dhe të pestët ishin liruar. Ata ishin shoqëruar në drejtim të stacionit të autobusëve nga ky "shpëtimtar", i cili afër tyre ngiste një automjet Pinzgauer me të cilën ai kishte arritur. Shumica e dëshmimeve janë të qëndrueshme se ai kishte të veshur një uniformë të gjelbër dhe mbante maskë.¹³⁹

Prania e O. I. në pikën e kontrollit:

116. Meqë çështja kryesore e kontestueshme është prania e O. I. në vendin e ngjarjeve, ky aspekt do të vlerësohet më në thellësi.

117. Ne do të kthehemi në momentin kur 15 shqiptarë të Kosovës u shoqëruan në rresht nga rruga Njegoš për në rrugën Miladin Popović. Pasi ata u ngjitën shkallëve që i lidhin dy rrugët dhe u kthyen në të majtë, ata vunë re një pikë kontrolli disa metra më përpara. Pika e kontrollit gjendej para disa dyqaneve të vjetra, në kryqëzimin mes ish-rrugës së Kovaçëve,¹⁴⁰ rrugës që ka qasje në ish-shkollën "Meto Bajraktari", Rrugës për Bajr¹⁴¹ dhe rrugës Miladin Popović. Distanca në mes këndit më të largët të këtij kryqëzimi dhe

¹³⁹ Përveç se për Sh. K.1 i cili tregoi se ai mbante uniformë të kaltër dhe nuk ishte i maskuar; Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, paragrafët 255 dhe 306.

¹⁴⁰ Ose Lagja e Kovaçëve.

¹⁴¹ Rruga Azem Galica, ish-rruga Dane Brklač; shih procesverbali, skica dhe raporti i vizitës së lokacionit i kryer më 21.09.2015.

shkallëve që e lidhnin ish-rrugën Njegoš me rrugën Miladin Popović¹⁴² është 49 metra. Në pikën e kontrollit kishte "persona të uniformuar, policë dhe ushtarë"¹⁴³; numri i tyre ishte rreth 30-40 sish;¹⁴⁴ ata ishin të armatosur dhe të sistemuar në dy linja paralele të vendosura në anët e kundërta të rrugës¹⁴⁵ në zonën e kryqëzimit. I. M.1 vlerësoi se ata ishin të vendosur rreth 25-30 metra nga shkallët mes ish-rrugës Njegoš dhe rrugës Miladin Popović. Kjo konsiderohet e besueshme, pasi që distanca e shënuar në raportin e vizitës së këqyrjes së vendit të ngjarjes është matur, siç është specifikuar më parë, në këndin më të largët të kryqëzimit me pikën e kontrollit. Duke pasur parasysh numrin e tyre të konsiderueshëm, jo të gjithë ushtarët mund të ishin të përqendruar në një pikë, prandaj është e arsyeshme të konkludohet se ata ishin të shpërndarë edhe në vetë kryqëzimin, pra më afër shkallëve. Prandaj, kur rreshti i 15 shqiptarëve të Kosovës u kthye në rrugën Miladin Popović, ata i vunë re ushtarët në pikën e kontrollit nga një distancë prej më pak se 50 metra. Disa nga forcat e armatosura kishin të veshur kapuç-maskë në kokë, e disa jo.¹⁴⁶

118. Kjo është kur dëshmitari Isa Mustafa vuri re **O. I.** në radhët e grupit. Ai së pari e vuri re atë nga një distancë prej dhjetë metrash.¹⁴⁷ **O. I.** ishte i veshur me uniformë complete të policisë, me një kapuç të zi që mund të shndërrohet në një kapuç-maskë, i armatosur me një pistoletë, një pushkë dhe një thikë.¹⁴⁸ I. M.1 mund të vërente fytyrën e **O. I.** për rreth dy minuta para se ai ta vendoste kapuçin e tij.¹⁴⁹ Ai gjithashtu i kishte njohur disa civilë të tjerë, secili prej tyre i armatosur me një pushkë automatike.¹⁵⁰

¹⁴² Shih skica dhe raporti i vizitës së lokacionit i kryer më 21 shtator 2015 të hartuara nga Njësia e Forenzikës, Drejtoria e Policisë Rajonale Mitrovicë, të datës 21 shtator 2015 dhe të paraqitura në Gjykatë më 28 shtator 2015.

¹⁴³ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 164.

¹⁴⁴ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, paragrafët 182 dhe 340.

¹⁴⁵ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 172.

¹⁴⁶ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 183.

¹⁴⁷ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, paragrafët 429 – 430, dhe procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 209.

¹⁴⁸ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, paragrafët 287-297.

¹⁴⁹ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para. 349.

¹⁵⁰ I. M.1a, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, paragrafët 349-355. Civilët janë I. S., V. dhe S. A; në lidhje me ta, trupi gjykues vendosi që të mos jetë specifik, pasi që ata nuk janë subjekt i Aktakuzës; për më tepër, kur bie fjala për I. S., trupi gjykues u përpoq që të mos paragjykojë parimet "*res judicata*" dhe "*ne bis in idem*" të nxitura nga Vendimi i datës 09.04.01 në çështjen P 44/2000.

119. Mbrojtja vuri në dukje atë që ata konsiderojnë të jetë kontradiktë me deklaratën e mëparshme të dhënë nga dëshmitari më 4 mars 2000¹⁵¹, ku ai tha se "**O. I.**, kur na pa, ai vuri maskën e tij". Trupi gjykues nuk e vlerëson këtë si një kontradiktë. Së pari, mund të jetë e mundur që ishte dëshmitari ai i cili ishte i pari që e kishte vërejtur **O. I.** dhe vetëm pas kësaj, kur i pandehuri i kishte parë shqiptarët e Kosovës që po afroreshin, ai e kishte vendosur maskën e tij. Së dyti, nuk është gjë e pazakontë që pas 16 vjetësh, dëshmitari të japë rrëfime paksa të modifikuara në lidhje me kohëzgjatjen e saktë të takimit të papritur. Në çdo rast, kjo deklaratë vërteton me siguri se ai ia kishte hedhur sytë **O. I.**-it për një periudhë të shkurtër kohe. Sipas dëshmitarit, kjo ishte e mjaftueshme që ai të mund ta identifikonte **O. I.**, dhe që "*absolutisht të mos kishte dyshime*".¹⁵² I. M.1 e dinte shumë mirë se kush ishte **O. I.** - drejtor i sallës së sporteve dhe lojtar i karatesë. Vetë I. M. 1 ishte arbitër dhe atij i interesonte sporti. Ai e kishte parë **O. I.** duke luajtur disa herë dhe ai e dinte se të tjerët në sallën e sporteve e thirrnin atë "**O.**".¹⁵³
120. Mbrojtja sjell një tjetër mospërputhje mes deklaratave të njëjta: në deklaratën nga viti 2000, dëshmitari kishte deklaruar se **O. I.** ishte i ulur në shkallët e dyqanit dhe nuk ishte në këmbë. Dëshmitari nuk ka ndonjë shpjegim të veçantë për këtë dhe ai qëndron prapa kësaj deklarate të dhënë në gjykatë. Trupi gjykues nuk konsideron që kjo kontradiktë të jetë e një karakteri të madh, sa për të ngritur dyshime në lidhje me ndershmërinë dhe objektivitetin e dëshmitarit ose ta sjellë në pikëpyetje identifikimin e të pandehurit.
121. Në përgjithësi, I. M.1 është i pandryshueshëm në deklaratat e tij, kur është fjala për aspektet kryesore të dëshmisë së tij. Trupi gjykues e konsideron dëshminë e tij si të besueshme, duke marrë parasysh edhe konsideratat e elaboruara më tej.
122. Dëshmitari Sh. K.1 ishte gjithashtu në rreshtin e njëjtë të të burgosurve kur e kishte parë **O. I.**¹⁵⁴ nga një distancë prej 20-30 metrash, ¹⁵⁵të veshur me rroba të kaltra kamuflazhi dhe të armatosur. ¹⁵⁶Dëshmitari dëshmon: "*kur kemi shkuar në rrugë, kur kemi shkuar në afërsi të blloqeve të banimit, unë mund ta vëreja O. cili nuk kishte veshur maskë për*

¹⁵¹ Faqet 327-329 të shkresave të lëndës.

¹⁵² I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 22 janar 2015, para 353.

¹⁵³ I. M.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 21 janar 2015, para. 303 *et seq.*, dhe para. 340 *et seq.*

¹⁵⁴ Sh. K.1 procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, paragrafët 148-150.

¹⁵⁵ Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, para. 174.

¹⁵⁶ Sh. K.1 procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, paragrafët 159-172.

*momentin, por sapo na vërejtë neve, ai e vuri maskën e tij ."*¹⁵⁷ Duke u marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë, Sh. K.1 u përball me deklaratat e tij të mëparshme, kur bëhet fjalë për identifikimin e të akuzuarit. Dëshmia pasuese e dëshmitarit është riprodhuar më poshtë:¹⁵⁸

*"Lj. P.: Si mund ta interpretojme atë pjesë të deklaratës suaj, nuk e kam të qartë bile unë, të cilën e dhatë para gjyqtarit hetues më 23 nëntor 1999, faqe 413, versioni anglisht, ku për këtë person i cili rrinte ulur në shkallë, për të cilin pohoni të ishte **O. I.**, do ta citoj këtë pjesë të deklaratës: "Them që ky person ma kujton një person i cili ishte menaxher i qendrës sportive dhe merrej me karate...etj." Pra atëherë thatë që ky person i përngjante **O. I.** dhe jo që ai ishte **O. I.** Shpjegojani këtë gjykatës, ju lutem.*

*Sh. K.1: Në atë moment, në pamje të parë, mund ta shihja që ai ishte **O. I.** por kisha dyshime, dhe në bisedën time me I.M.1 e pyeta nëse ai personi ishte **O.**, ai u përgjigj, "po ai vet ishte."*

*Lj. P.: Para disa minutash, thatë që ishit absolutisht i sigurt që ishte **O. I.** dhe tash thoni që kishit një dozë dyshimi dhe që I. M.1 jua qartësoi këtë.*

*Sh.K.1 : Isha 100% i sigurt se ai ishte **O. I.** por desha të dija nëse personi tjetër pajtohej me mua në mënyrë që të isha i sigurt se nuk gaboja.*

*Lj. P: A ishit i sigurt asokohe që personin të cilin e patë ishte **O. I.**?*

Sh. K.1: Nuk ka kundërthënie mes dy deklaratave të mia. Nëse ka një gjë të cilën e sheh dhe njëkohësisht e pyet personin tjetër sepse ishte kohë lufte dhe nuk e dinim se ç'do të ndodhte me fatin tonë. E kam parë dhe doja të isha i sigurt që të mos gaboja dhe jo të ishte një person në vend të tij, në mënyrë që mos ta etiketoja një person i cili nuk ka qenë atje; nuk pohoj që e kam parë duke e kryer ndonjë ekzekutimin ose diçka të atillë.

¹⁵⁷ Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, para. 148

¹⁵⁸ Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, para. 364 et seq.

Lj. P.c: Z. Sh. K.1, a është e drejtë të thoni se ishit 100 i bindur se ai ishte O. I. vetëm pasi që biseduat me I. M.1?

Sh. K.1: Asokohe, isha 100% i sigurt që nuk e kisha gabim.

Lj. P.: Në cilën kohë ishit 100% i bindur?

Sh. K.1: Pas Mokra Gorës, kur u ndamë nga kolona, pasi që i gjetëm gratë dhe fëmijët tanë dhe kishim më shumë kohë për të diskutuar për këtë.

Lj. P.: Pra është e vërtetë të thuhet se kur të gjithë ju u bashkuat, ishte koha kur je ri-siguruar 100% se ishte O. I.?

Sh. K.1: Në atë kohë, kishim kohë, derisa gjatë udhëtimit tonë i cili zgjati 3 orë, pasi që i gjetëm gratë tona dhe fëmijët, nuk kishim kohë as të merrnim frymë e lere më të bisedojmë për O. ose për atë se kush ka marrë pjesë e kush nuk ka marrë pjesë.”

123. Në parashtrimin e mbrojtjes fakti se dëshmitari nuk ishte absolutisht i sigurt për identitetin e O. I., kur ai për herë të parë e kishte vënë re atë, ngre një element të caktuar të dyshimit në lidhje me identifikimin e të akuzuarit. Me të vërtetë duket se Sh. K.1 e kishte ndjerë nevojën që ta verifikonte vëzhgimin e tij sa i përket të pandehurit, para se të fillonte të tregonte me gishta drejt tij me akuza të tilla të rënda. Ky ishte një tregues i qartë për trupin gjykues se dëshmitari ka vepruar në vullnetin e mirë dhe nuk donte të bënte pretendime të caktuara lehtë. Megjithatë, trupi gjykues e pranon se ky aspekt pakëz e zvogëlon peshën e dëshmisë së këtij dëshmitari. Prapëseprapë, dyshimi i ngritur është i vogël dhe deklarata e Sh. K.1 tregon me një shkallë të lartë të probabilitetit se O. I. ishte i pranishëm në pikën e kontrollit.
124. Mbrojtja po ashtu vuri në dukje se dëshmitari ishte jo konsistent me deklaratat e tij në lidhje me atë nëse ai e njohte të akuzuarin me emrin e plotë në atë kohë. Dëshmitari jep dëshminë e mëposhtme:

“Lj. P.: Pse pra në deklaratën tuaj para gjyqtarit hetues në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës keni thënë “personi të cilin e kam parë ma kujton një person i cili ka qenë menaxher i qendrës sportive, ai merrej me karate dhe e di që quhej O. por nuk e di emrin e tij të plotë

dhe mbiemrin.” Tash, sapo deklaruar se asokohe e keni njohur këtë person me emër dhe mbiemër.

Sh. K.1: Në atë moment, nuk më kujtohet ta kem deklaruar këtë. Vetëm më kujtohet të kem thënë se **O. I.** e quanin **O.**, ai punonte në qendrën sportive.

Lj. P.: Sidoqoftë, në deklaratën tuaj, fjalë për fjalë shkruan, “Nuk e di emrin dhe mbiemrin e tij, vetëm e di që e thërrasin **O.**.”

Sh. K. 1: Ka mundësi që në atë moment nuk mund të më kujtohej. Edhe për njerëzit të cilët ishin atje për t’u ekzekutuar, i di emrat e tyre por mund të ndodh që për një moment të mos më kujtohen emrat e tyre.

Lj. P.c: Më herët thatë se para kësaj ngjarjeje fatkeqe, kurrë s’keni pasur rast të flisnit me **O. I.** Jam kureshtar të di sepse sot e thatë këtë, si e dini që e flet rrjedhshëm gjuhën shqipe.

Sh. K.1: E kam parë duke folur me shqiptarët. Gjatë gjithë kohës ai fliste shqip” .¹⁵⁹

125. Në vlerësimin e trupit gjykues, ky ngurrim i mundshëm nuk ngre ndonjë dyshim lidhur me identifikimin e të akuzuarit. Dëshmia është njëzëri se në një qytet të vogël si Mitrovica, i akuzuari ishte një personazh i spikatur dhe i mirënjohur në mesin e njerëzve të zakonshëm kryesisht për tre gjëra: ai ka luajtur karate dhe e ka drejtuar sallën e sporteve, ishte biznesmen dhe e fliste rrjedhshëm gjuhën shqipe. Asokohe, është e pakontestueshme se ishte një gjë e zakonshme që shqiptarët etnikë të dinin serbisht – gjuhën e qeverisë – dhe jo anasjelltas. I akuzuari po ashtu ishte i mirënjohur për nga pamja dhe ai thirrej me pseudonimin “**O.**”. Këto elemente janë të mjaftueshme për ta vërtetuar me vendosmëri identitetin e të akuzuarit, madje edhe nëse dëshmitarit nuk do t’i kujtohej mbiemri i plotë zyrtar i këtij të fundit.
126. I. M. 1 dhe Sh. K. 1 janë dy dëshmitarët e vetëm nga rreshti i të burgosurve të cilët e kishin vërejtur **O. I.** Deklaratat e tyre më tej vërtetohen nga ato të dëshmitarëve të tjerë të cilët ishin të pranishëm në atë zonë gjatë ngjarjeve të njëjta.
127. Sh.C. 1 deklaroi se ajo ishte dëbuar nga banesa e saj në të njëjtin rast. Pak para mesditës (mes orës 10:00-11:30), forcat e policisë të cilat Sh. C.1 i përshkruan si paramilitarë, të armatosur me pushkë dhe pa maska¹⁶⁰ hynë me forcë në apartamentin e saj. Të dy, ajo dhe djali i saj E. u nxorën në rrugë. Posa doli jashtë ndërtesës ajo e pa **O. I.** dhe ajo iu

¹⁵⁹ Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, paragrafët 356-361.

¹⁶⁰ Sh. C.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 27 mars 2015, para. 27 et seq.

përgjëruea "O., shpëtoma djalin tim".¹⁶¹ Sh. C. 1 e vuri re vetëm pak O. I.,¹⁶² pasi ajo u nxitua tutje nga paramilitarët. Por ajo tha se ajo qartë e kishte parë O. I.¹⁶³ Ajo nuk e kishte vënë re se ai ishte i armatosur. Ai ishte i veshur "si në rroba ushtarake", por që ajo i kategorizon si "civile". Ai kishte rroba me ngjyrë të gjelbër të errët, por ndryshe nga ato të paramilitarëve, të cilët ishin të veshur me rroba me ngjyrë të kaltër. Megjithatë, dëshmitarja specifikon se ajo nuk mund ta theksojë qartë dallimin pasi që ajo nuk kishte qenë në ushtri. Trupi gjykues konsideron se ky shpjegim është i arsyeshëm dhe nuk e prish në asnjë mënyrë pjesën tjetër të rrëfimit së saj. Pastaj, ajo ishte shoqëruar tutje. Djali i saj ishte mbajtur peng dhe më pastaj ishte vrarë.

128. Sh. C.1 dëshmoi para Gjykatës përmes video lidhjes dhe gjatë marrjes së saj në pyetje ajo fillimisht iu referua të akuzuarit si "O. M." dhe më pas ajo e korrigjoi veten. Kjo mund t'i atribuohet kalimit të kohës dhe për faktin se për një kohë të gjatë, dëshmitarja kishte jetuar jashtë vendit dhe si rrjedhojë ajo ka qenë e shkëputur nga realiteti lokal. Më e rëndësishmja, trupi gjykues sërish thekson se një identifikim i fortë pozitiv nuk varet domosdoshmërisht nga ajo që dëshmitarja ta njohë të akuzuarin me emrin e tij të plotë. Ajo ofron detaje që nuk lënë asnjë dyshim se ajo i referohej O. I.: ai luan karate, dhe ai flet shqip. Pjesa tjetër e rrethanave të paraqitura në lidhje me dëshmitarin Sh. K.1 janë përsëritur në këtë mënyrë.¹⁶⁴
129. Sh. C.1 e ka identifikuar të pandehurin edhe në Gjykatë, prej katër personave. Megjithatë, trupi gjykues nuk i dha shumë vlerë kësaj; sepse identifikimeve brenda në gjykatë duhet t'u qasemi me kujdes të konsiderueshëm marrë parasysh se mjedisi ku kryhet identifikimi është sugjestiv. Trupi gjykues është i vetëdijshëm se identifikimi i një të akuzuari në sallën e gjykimit mund të ketë qenë i ndikuar padrejtësisht dhe në mënyrë të pandërgjegjshme nga vendosja fizike e të akuzuarit, si dhe faktorë të tjerë të cilët e bëjnë të akuzuarin qendër të vëmendjes në sallën e gjykimit.
130. Megjithatë, trupi gjykues është i bindur, në bazë të rrethanave të paraqitura më lart se në të vërtetë ishte O. I. ai, të cilin e kishte vërejtur Sh. C.1 ate ditë.

¹⁶¹ Sh. C.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 27 mars 2015, para. 42 *et seq.*

¹⁶² Sh. C.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 27 mars 2015, paragrafët 87-90, 115.

¹⁶³ Sh. C.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 27 mars 2015, paragrafët 93-94.

¹⁶⁴ *Shih* paragrafin 124 më lartë

131. Sipas Sh.C.1, ai ishte afër një grupi paramilitarësh, duke qëndruar në anën e kundërt të rrugës prej tyre.¹⁶⁵ Kur ajo doli nga ndërtesa e saj, dëshmitarja e vërejtji **O. I.**-in menjëherë përpara. Është relevante të dihet se ku gjendej ndërtesa ku e kishte banesën Sh. C.1: ish-Lagjja e Kovaçëve ose rruga Mbreti Millutin.¹⁶⁶ Kjo e vendos të akuzuarin në zonën e pikës së kontrollit.
132. Mbrojta e ngriti çështjen se deklarata e tanishme e Sh. C.1 dallon nga ajo që ajo kishte dhënë më parë.¹⁶⁷ Atje, dëshmitarja kishte deklaruar se djali i saj E. ishte ai i cili kishte shkëmbyer fjalë me **O. I.** dhe jo ajo vetë.
133. Se a ishte ajo Sh.C.1 apo djali i saj që kishin shkëmbyer fjalë me **O. I.**, kjo nuk e ndryshon faktin se Sh.C.1 e kishte vënë re dhe e kishte identifikuar të pandehurin. Megjithatë, trupi gjykues ka vendosur që t'i japë më shumë besim deklaratës së dhënë nga dëshmitarja në rastin e tanishëm dhe e ka vërtetuar se ishte Sh. C.1 ajo e cila i ishte drejtuar të akuzuarit. Dhe kjo, pasi që deklarata e saj është vërtetuar nga dëshmia e F. P., si më poshtë:
134. Dëshmitarja F. P. ishte fqinje e Sh. C.1 dhe ishte dëbuar në rrugë në po të njëjtin rast. Ajo e konfirmon se Sh. C.1 i ishte drejtuar me këto fjalë dikujt “O, **O.** shpëtoma djalin tim”, por që nuk e kishte vërejtur si duhet atë të cilit i ishin drejtuar fjalët. Ajo e kishte parë **O.** “si në mjegull”, por nuk ia kishte parë fytyrën e tij.¹⁶⁸ Sipas dëshmisë së saj, ai episod ka mbetur i vulosur në kujtesën e F.P. për një arsye: ajo ishte revoltuar të dëgjonte që Sh.C.1 po lutej për ndihmë vetëm për djalin e saj duke shpërfillur pjesën tjetër të njerëzve. Të dyja gratë ishin shoqëruar tutje nga zona nga ushtarët dhe gjersa ato ishin duke ikur, F. P. kishte pyetur më shumë për **O.**: *“E pyeta atë ‘Si e njeht ti atë. Ajo më tha ‘E njoh si qytetar të vjetër të Mitrovicës, si karateist dhe ai e njeht djalin tim’”*.¹⁶⁹ Kjo e shton më shumë kredibilitetin e rrëfimit të Sh. C.1 në gjykatë.
135. F. P. e konfirmon edhe një herë praninë e paramilitarëve përreth pikës së kontrollit. Sipas saj, episodi kur Sh. C.1 iu drejtua **O.** ndodhi afër ndërtesës me apartamente – pika C në skicën e vizatuar nga F. P..¹⁷⁰ Kjo është në anën e kundërt të dyqanit në rrugën Miladin

¹⁶⁵ Sh. C.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 27 mars 2015, paragrafët 110-113.

¹⁶⁶ F. P., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 shkurt 2015, para. 34; F. P. dhe Sh. C.1 jetonin në të njëjtën ndërtesë të apartamenteve.

¹⁶⁷ Deklarata e Sh. C.1 e datës 21 shtator 1999. Dosja II e Prokurorisë, f. 498-544.

¹⁶⁸ F. P., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 shkurt 2015, para. 34.

¹⁶⁹ F. P., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 shkurt 2015, para. 34.

¹⁷⁰ F. P., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 shkurt 2015, paragrafët 38 *et seq.*, dhe 86-88; shih edhe Provën 9.

Popović, pra ku dëshmitarët e tjerë e treguan pozicionin e pikës së kontrollit. F. P. po ashtu dëshmon për praninë e paramilitarëve në atë zonë, disa prej tyre mbanin maska; disa prej tyre i vinin maskat më vonë dhe i *“vinin ato dhe i hiqnin”*; ajo ishte në gjendje t'i njohë në mesin e tyre disa fqinjë¹⁷¹, të cilët në të vërtetë janë të njëjtit si ata që i tregoi I. M.1.

136. Mbrojtja na tërheq vëmendjen për faktin se në deklaratën e saj të dhënë gjatë procedurës paraprake nga viti 1999, F. P. i përshkruan personat e tjerë që ajo kishte parë, por ka lënë pa përmendur qoftë Sh.C.1 ose O. I-in. Trupi gjykues konsideron se kjo nuk e ul deklaratën e saj si të pandershme, pasi që ky mund të jetë një detaj i pa shqyrtuar në fazën e hetimit. Është e arsyeshme të besojmë se në mungesë të ndonjë pyetje të tillë specifike, dëshmitarja nuk e ka konsideruar të rëndësishme që t'ia jep policisë vullnetarisht një informacion të tillë të detajuar. Në fund të fundit, kjo kishte të bënte me diçka që ajo e kishte dëgjuar pa dashur nga fqinji i saj. F. P. ka shpjeguar se ajo e kishte lënë që vetë Sh. C. 1¹⁷² ta jepte këtë informacion. Trupi gjykues konsideron se shpjegimi që ajo ka ofruar është i arsyeshëm.
137. Një dëshmitar tjetër që e kishte vënë re O. I-in në atë zonë në kohën e ngjarjeve është M. Ll.. Ai jetonte në rrugë Miladin Popović, nja rreth 20 metra largësi ajrore nga shtëpia e I. M.1.¹⁷³ Ai ishte dëbuar nga ndërtesa e tij së bashku me familjen e tij rreth orës 10:30 të mëngjesit, pak para familjes së I. M.1. ¹⁷⁴Sapo ishte jashtë, ai filloi të ecte tutje në të majtë në drejtim të daljes së ndërtesës së tij. Pas 150 metrash, ai pastaj u kthye shpejt nga rruga kryesore në një rrugicë pa dalje, i kapërceu dy gardhe dhe ia doli ti shpëtojë vigjilencës së rojeve. Para se të largohej nga rruga Miladin Popović e të kthehej në rrugicën anësore, ai ishte thirrur nga një zë, i cili në gjuhën serbe i kishte thënë "Ku po shkon?" Ai kishte kthyer kokën dhe e kishte vënë se ishte O. I., ai i cili iu drejtua atij. Ai ishte duke ecur një - dy hapa para

¹⁷¹ F. P., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 shkurt 2015, paragrafët 34, 109-111. Këta janë I. S., V. dhe S. A.. Në lidhje me ta, trupi gjykues vendosi që të mos jetë specifik, pasi që ata nuk janë subjekt i Aktakuzës; për më tepër, kur bie fjala për I. S., trupi gjykues u përpoq që të mos paragjykojë parimet *“res judicata”* dhe *“ne bis in idem”* të nxitura nga Vendimi i datës 09.04.01 në çështjen P 44/2000.

¹⁷² F. P., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 shkurt 2015, paragrafët 191-194.

¹⁷³ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, para. 395 *et seq.*

¹⁷⁴ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, para. 480.

një grupi prej rreth 30 policëve, të gjithë të veshur me uniformë të njëjtë.¹⁷⁵ Edhe **O. I.** ishte i veshur me uniformë të policisë, "me ngjyrën e kaltër që mbizotëronte" dhe i veshur me një jelek anti-plumb dhe një kapele të zezë në kokë. Ai ishte i armatosur me një pushkë dhe dy shpata. Kjo ndodhi para ndërtesës dhjetë-katëshe në rrugë Miladin Popović, ¹⁷⁶rreth 50-60 metra nga pika e kontrollit, grupi i policëve ishte duke ecur për në rrugën Miladin Popović, në drejtim të pikës së kontrollit¹⁷⁷. M. Ll. e kishte vërejtur **O. I.**-in vetëm "për një moment të shkurtër",¹⁷⁸ kur e ktheu kokën mënjanë,¹⁷⁹ "në një moment blic".¹⁸⁰ Megjithatë, trupi gjykues gjeti arsye të mjaftueshme për të ardhur në përfundim se ai njihej mirë me **O. I.**: ai ishte llamarinë-punues dhe disa herë ishte angazhuar nga **O. I.** për t'ia rregulluar çatinë e dyqanit tij; dëshmitari kishte pasur edhe marrëdhënie miqësore me **O. I.**, kur ai jepte me qira sallën e sporteve për disa ndeshje të futbollit.¹⁸¹ Atë ditë, M. Ll. e kishte vënë re **O. I.**-in nga një distancë të shkurtër, rreth 15 metra,¹⁸² duke e bërë kështu identifikimi i tij të sigurt edhe nëse koha e ekspozimit ishte e shkurtër.

138. Mbrojtja vë në pah disa mospërputhje me deklaratat e mëparshme:
139. Para Gjykatës, dëshmitari ka thënë se **O. I.** i ishte drejtuar atij në gjuhën serbe,¹⁸³ ndërsa në deklaratën e tij gjatë procedurës paraprake ai ka përmendur se fjalët janë thënë në gjuhën shqipe. Kjo huti është normale pasi që dëshmitari i flet të dyja gjuhët¹⁸⁴ dhe kjo nuk ngre dyshime sa i përket ndershmërisë së dëshmitarit.
140. Po ashtu, para Gjykatës, dëshmitari thotë se ai nuk iu është përgjigjur në ndonjë mënyrë thirrjeve të **O. I.** Megjithatë, sipas një deklarate gjatë procedurës paraprake të dhënë më

¹⁷⁵ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, paragrafët 427-437.

¹⁷⁶ Pika 4, skica e zonës e bashkëngjitur në foto albumin në lidhje me vizitën e lokacionit të kryer më 21 shtator 2015, e hartuar nga Njësia e Forenzikës, Drejtoria e Policisë Rajonale Mitrovicë e datës 21 shtator 2015 dhe e paraqitur në Gjykatë me 28 shtator 2015.

¹⁷⁷ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, para. 478.

¹⁷⁸ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, para. 425.

¹⁷⁹ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, para. 401.

¹⁸⁰ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, para. 454.

¹⁸¹ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2015, paragrafët 419 dhe 490.

¹⁸² M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 26 janar 2015, paragrafët 196 -197

¹⁸³ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 26 janar 2015, paragrafët 92-101.

¹⁸⁴ M. Ll., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 26 janar 2015, para. 113.

17.08.1999, dëshmitari i ishte përgjigjur **O. I.**-it dhe i kishte thënë atij se ai ishte lejuar nga S.2-i që t'i bashkohej grupit të grave.¹⁸⁵

141. Trupi gjykues nuk e sheh të pazakontë që, pas 15 vjetësh nga ngjarjet kritike dhe nga deklarata e parë, gjërat të jenë harruar apo lënë pas dore dhe se rrëfimi është thjeshtuar. Do të ishte brengosëse nëse do të kishte ndodhur e kundërta dhe dëshmitari do të kishte ofruar shumë më tepër hollësi më vonë, të cilat, edhe nëse janë shumë të rëndësishme, janë lënë pas dore nga deklarata e mëparshme.
142. Dëshmitari ka qenë konsekuent gjatë gjithë deklaratës së tij se e kishte parë **O. I.**-in, si dhe për pamjen e këtij të fundit. Deklaratat e tij u konsideruan të besueshme.
143. Për ta përmbyllur, janë katër dëshmitarë të cilët e kanë identifikuar të pandehurin: dy prej tyre, I. M.1 dhe Sh. K.1 ishin pjesë e rreshtit të ekzekutimit, dy të tjerët janë Sh. C1 dhe M. Ll. Edhe F. P. përforcon rrëfimin e Sh. C.1. Tre dëshmitarët e fundit u dëbuan në të njëjtin rast së bashku me pjesën tjetër të shqiptarëve të Kosovës. Të gjithë ata e kishin vërejtur **O. I.**-in në vendin dhe kohën e ngjarjeve kritike dhe nga pozita të ndryshme të favorshme.¹⁸⁶ Trupi gjykues i vlerëson të gjitha këto dëshmi si të ndershme dhe të besueshme. Siç është përmendur më parë, ekzistojnë disa devijime të caktuara nga deklaratat e tyre të mëparshme ose mospërputhje mes rrëfimeve të tyre të ndryshme të mëparshme, kur bëhet fjalë për aspekte të tilla si përshkrimi i uniformave të ndryshme. Për arsyet e detajuara më lartë, këto mospërputhje konsiderohen normale dhe nuk e prishin identifikimin e të pandehurit.
144. Dëshmitarët shqiptarë të Kosovës të cilët dëshmuuan në lidhje me dëbimin e tyre dhe atë të shumë të tjerëve, vinin nga shtresa të gjera e të ndryshme nga ai komunitet, në përgjithësi me asnjë lidhje me njëri-tjetrin përtej viktimizimit të tyre, dhe është e pakonceptueshme që ata të gjithë kanë mundur ose do të mund të sajnin rrëfime të tilla të detajuara dhe konsekuente të ngjarjeve që ata i kanë përjetuar dhe dëshmitarë të të cilave ata ishin.

¹⁸⁵ M. Ll., deklarata e datës 17.08.1999, f. 384.

¹⁸⁶ Nga drejtimi i rrugës Miladin Popović, përkatësisht nga drejtimi i rrugës së Kovaçëve.

145. Më e rëndësishmja, trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë arsye të dukshme se pse këta dëshmitarë do të bashkoheshin kundër të pandehurit. Nuk ka histori të ndonjë konflikti apo armiqësie mes ndonjërit prej tyre dhe të akuzuarit. Kjo është në përputhje me atë që e ka pranuar vetë i pandehuri¹⁸⁷. Me disa prej tyre, i pandehuri madje ka bashkëvepruar në mënyrë të përzemërt¹⁸⁸. Mund të spekulohet se, duke pasur parasysh faktin se ata të gjithë janë shqiptarë etnikë, ata do të ktheheshin kundër një serbi. Megjithatë, nuk ka dëshmi të paraqitur apo të sugjeruar për atë se pse ndonjëri prej këtyre dëshmitarëve do të kthehej kundër këtij serbi të veçantë.
146. Përveç ngjarjeve traumatike që ata vetë i kishin përjetuar, disa nga dëshmitarët pësuan humbje të konsiderueshme në familjet e tyre: I. M.1 e humbi kushëririn e tij F.M., Sh. C.1 e humbi djalin e saj E., M. Ll. e humbi vëllain e tij z., F. P. e humbi vëllain e saj A.4 dhe xhaxhain e saj E. P.. Nëse ata në dëshmitë e tyre do të i shinin shtyrë nga hakmarrja dhe urrejtja, ata më shumë gjasa do të kishin hyrë në detaje më të mëdha për t'i fabrikuar rrëfimet e tyre. Përkundrazi, dëshmitarët nuk ofrojnë shumë detaje në lidhje me veprimet e të akuzuarit për shkak se, sipas tyre, ata nuk kanë pasur kohë që t'i vërenin. Kjo shumë qartazi çon në përfundimin se dëshmitarët dëshmuar në lidhje me diçka që ata në fakt më shumë e kishin parë dhe përjetuar se sa për një ngjarje që e kishin mësuar më pastaj ose si një përpjekje që ta inkriminonin të akuzuarin për ndonjë arsye tjetër, por vetëm që ta bënë dikë përgjegjës.
147. Deklarata e I. M.1 ishte veçanërisht bindëse. Ai ishte konsistent në deklaratat e tij kur vie fjala te aspektet kryesore të dëshmisë së tij. Disa dëshmitarë e konfirmuan se I. M.1 e kishte përmendur pjesëmarrjen e **O. I.** dhe këtë ai e kishte bërë menjëherë pasi i kishte shpëtuar ekzekutimit dhe i ishte bashkuar konvojit të njerëzve që ishin drejtuar për në Shqipëri. Këto deklarata, edhe nëse nuk e vërtetojnë identifikimin e **O.I.**, ato i shtojnë edhe më shumë besim rrëfimit të I. M.1.
148. Fakti që ai e tregoi **O. I.**-in menjëherë pas incidentit, *in loco*¹⁸⁹ i shton shumë peshë rrëfimit të tij: në një moment kur ai i kishte ikur gati vdekjes dhe ai ishte shumë i shqetësuar për fatin e tij dhe të familjes së tij, nuk është logjike që ai do të fokusohet në

¹⁸⁷ O. I, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 8 dhjetor 2015, paragrafët 230-237.

¹⁸⁸ I. M. 1 dhe M. Ll., shih detajet më lart.

¹⁸⁹ Sh. K.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 18 shkurt 2015, para. 275.

atë që t'ia kurdiste dikujt. Përveç kësaj, trupi gjykues përsërit se nuk ka asnjë interes të provuar që kjo të kurdisej kundër **O. I.** Nuk është pranuar se ky mund të jetë një veprim i drejtuar kundër karrierës politike të të akuzuarit siç sugjerohet nga mbrojtja,¹⁹⁰ pasi që në atë kohë I. M.1 nuk ka mundur ta ketë parashikuar përfshirjen e mëtejme të **O. I.** si politikan.

149. Trupi gjykues është i vetëdijshëm për faktin se secili nga dëshmitarët e përmendur më lart e kishte vënë re **O. I.**-in për një kohë të shkurtër. Megjithatë, secili prej tyre e dinte saktësisht se kush ishte ai nga koha e mëparshme. Kjo është arsyeja pse trupi gjykues konsideron se madje edhe një ekspozim i shkurtër ka bërë të mundur identifikimin pozitiv të të akuzuarit. Edhe në qoftë se ndonjëri prej tyre mund të jetë gabuar pak, dëshmitë e kombinuara të të gjithë atyre nuk lënë asnjë dyshim të arsyeshëm se i pandehuri ishte i pranishëm në atë vend.
150. K. A. është një dëshmitar tjetër që e kishte vënë re **O. I.**-in në atë zonë, edhe pse jo saktësisht në kohën e kryerjes së veprës penale, por rreth 2 orë para incidentit. Atë mëngjes, rreth orës 8:00-8:30, ai kishte shkuar për të blerë bukë në zonën e Kovaçëve. ¹⁹¹Me atë rast, ai e kishte vënë re **O. I.** nga një distancë prej 15-20 metrash. Ai ishte i veshur me rroba civile dhe ai ishte në shoqërinë e disa ushtarakëve, me uniforma të gjelbra dhe të armatosur.¹⁹² Dëshmitari e njihte **O. I.** shumë mirë nga pamja që më përpara, nga fëmijëria, pasi që ishin rritur në rajonin e njëjtë.¹⁹³Për këtë periudhë kohore, i pandehuri fuqishëm mohonte të ketë qenë në atë rajon.¹⁹⁴ Sipas vlerësimit të trupit gjykues, kjo dëshmi ishte në kundërtënie me teorinë e mbrojtjes dhe i shtonte akoma më shumë kredibilitet katër dëshmitarëve të vlerësuar më lartë.
151. Në fund, trupi gjykues do ta adresojë dëshminë e L. A.1. Ai deklaroi së me atë rast, disa kuponë pensional ishin marrë nga shtëpia e tij dhe më vonë janë këmbyer në Serbi.¹⁹⁵ Nga pikëpamja e mbrojtjes, kjo do ta mbështeste konkludimin se trupat që u futën në

¹⁹⁰ Procesverbali i seancës mbi paraburgimin të mbajtur më 28 janar 2014. Dosja I e Procedures paraprake, **O. I.**, tab 15.

¹⁹¹ K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, paragrafët 319-326.

¹⁹² K. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 19 shkurt 2015, paragrafët 134-149 dhe 246-251.

¹⁹³ K. A., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 19 shkurt 2015, para. 133.

¹⁹⁴ O. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 4 dhjetor 2015, para. 80-86

¹⁹⁵ Ç. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 mars 2015, para. 141 *et seq.*

shtëpi ishin po ashtu nga Serbia. Trupi gjykues nuk pajtohet; nuk ka të dhëna se si ato qeqe të pensioneve përfunduan atje. Përveç kësaj, fakti se disa trupa ishin nga Serbia nuk e përjashton pjesëmarrjen e luftëtarëve vendor gjithashtu.

(b) Dëshmitë që kanë të bëjnë me lidhjen e O. I. me forcat Serbe në vitin 1999:

152. Përveç dëshmitarëve që e panë O. I. atë ditë, ka prova për përfshirjen e O. I. me forcat e armatosura Serbe në vitin 1999.
153. Në shkurt të vitit 1999, në Mitrovicë, gjatë orëve të mbrëmjes, rrugës për t'i vizituar disa të afërm, dëshmitari Ç. I. e pa O. I., të veshur me uniformë policore dhe i armatosur me pushkë¹⁹⁶. Ai ishte në një grup me policë tjerë në afërsi të lagjes Bajr në Mitrovicë. Ata shkurtimisht i shkëmbyen disa fjalë: O. I. e thirri dëshmitarin me nofkën e tij "Ç.". Dëshmitari ishte i befasuar që e pa O. I. së bashku me policët dhe i tha atij "O., edhe ti je këtu". Ai u përgjigj: "Po, valla" .¹⁹⁷
154. Ngjarja ishte e shkurtë. Dëshmitari vetëm e ngriti kokën shkurtimisht për të biseduar me O. I., pasi që ishte i frikësuar për veten dhe familjen e tij duke pasur parasysh se rruga ishte plot policë Serb. Megjithatë, kjo ngjarje u regjistrua thellë në kujtesën e tij. Sipas shpjegimit të tij, dëshmitari "ishte i befasuar kur pa si një humanist, një sportist, mund të vesh uniformë policore dhe t'i bashkohet forcave tjera për të kryer dhunë" .¹⁹⁸ Prandaj, dëshmitari është i bindur se bashkëfolësi i tij ishte O. I.
155. Ç. I. është gazetar. Ai shpesh shkonte në ngjarje sportive ku O. I. performonte karate dhe ai ndonjëherë i mbulonte ato ngjarje.¹⁹⁹

¹⁹⁶ Ç. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 mars 2015, para. 52.

¹⁹⁷ Shprehja e përdorur si nga Shqiptarët ashtu edhe nga Serbët që do të thotë "Po, në të vërtetë"; Ç. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 mars 2015, para. 52-54.

¹⁹⁸ Ç. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 mars 2015, para. 156.

¹⁹⁹ Ç. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 mars 2015, paras. 98, 226 dhe 246.

156. Dëshmia e tij konsiderohet e besueshme dhe ka shërbyer për vërtetimin e lidhjes së të Akuzuarit me forcat e armatosura Serbe në periudhën për të cilën ai ka mohuar ndonjë përfshirje të tillë.
157. Dy dëshmitarë tjerë deklaruan se e kanë parë **O. I.** me uniformë në vitin 1999. Këta dy janë çifti bashkëshortor Z.A. dhe N. A.3. Ata jetonin në Gjakovë dhe gjatë bombardimeve të NATO-s shtëpia e tyre u dogj. Kjo i detyroi ata të kërkojnë strehim jashtë vendit. Ata po udhëtonin me autobus nga Gjakova për në Mal të Zi dhe gjatë rrugës ata u ndaluan nga **O. I.** afër Gjurakocit. **O. I.** ishte i shoqëruar nga një ushtar tjetër, i cili ishte i armatosur. Të dy kishin të veshura uniforma dimërore SMT, ngjyrë hiri. **O. I.** e urdhëroi të tjetrin që “*vendose plakun në tokë*” (duke iu referuar Z.A.). Nga ata u kërkuar të zbresin nga autobusi dhe **O. I.** i kontrolloi letërnjoftimet e tyre. Pas rreth gjysmë ore, ata u lejuan të vazhdojnë rrugën. **O. I.** i kishte thënë vozitësit të mos shkonte përmes Pejës/Rozhajës, pasi që UÇK-ja ishte aty. Në vend të kësaj, ata kaluan nëpërmjet Rashkës. Z.A. thotë se ai nuk e njohte **O. I.** në atë kohë. Ai e kuptoi identitetin e tij vetëm më vonë, kur e pa atë në TV, duke dhënë intervista dhe në Parlament²⁰⁰. Kur ai e njohu **O.I.** në TV, ai e informoi bashkëshorten e tij gjithashtu se ky ishte personi nga autobusi²⁰¹. Bashkëshortja e tij N.A.3 e vërteton pothuajse në tërësi përshkrimin e dhënë nga burri i saj, përveç një aspekti: ajo thotë se bashkëshorti i saj i kishte treguar menjëherë, rrugës për në Mal të Zi, se ai ishte **O. I.** i cili i kishte ndaluar. Ata po ashtu e panë atë më vonë në TV dhe i kujtuan ngjarjet²⁰².
158. Pasi që Z.A. – i cili sipas bashkëshortes së tij ishte burimi i informatës së identitetit të **O. I.** – nuk e vërteton përshkrimin e N.A.3, trupi gjykues mund vetëm të konkludojë se këta dy dëshmitarë nuk e njohnin **O. I.** në vitin 1999. Kjo është e arsyeshme për ta besuar pasi që, për dallim nga dëshmitarët tjerë, këta dy dëshmitarë nuk janë nga rajoni i Mitrovicës.
159. Ndonëse trupi gjykues e pranon në tërësi sinqeritetin e të dy dëshmimeve të tyre, është thelbësore që ta kemi parasysh faktin se dy bashkëshortët, për dallim nga dëshmitarët tjerë të përmendur më lartë, nuk e njohnin **O. I.** më përpara. Ata vetëm e panë atë nën

²⁰⁰ Z. A., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, paras. 427-437.

²⁰¹ Z. A., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, paras. 284, 374-379, dhe 391.

²⁰² N. A.3, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, paras. 470, 512-522, dhe 475.

rrethana traumatike, kur kishin frikë për jetën e tyre. Nuk ka prova të prodhuara rreth programeve televizive që kanë nxitur këtë identifikim dhe shkallës së sugjestionit të tyre. Ka mundësi që në mënyrë të nënvetëdijshe, Z.A. mund të ketë deklaruar se e kishte njohur **O. I.** për shkak të ekspozimit të tij të gjerë në publik dhe në media. Gjithashtu, identifikimi i **O. I.** dhe, në fakt, dëshmia e përgjithshme e N.A 3, nga mënyra si i tregonte ngjarjet dhe e formonte rrëfimin e saj, u shfaq mjaft e ndikuar nga përshkrimi i burrit të saj. Konkludimi i identifikimit pozitiv nuk mund të arrihet me siguri.

160. N.A.3 po ashtu e identifikoi të Pandehurin në Gjykatë. Sikurse është paraqitur në një pjesë tjetër të aktgjykimit, mjedisi i gjykatës është sugjektiv. Prandaj, identifikimi përbrenda gjykatës nuk është në tërësi i besueshëm, posaçërisht 15 vite pas ngjarjes. Rrjedhimisht, trupi gjykues nuk i jep peshë të madhe identifikimit të të Akuzuarit nga këta dy dëshmitarë.
161. Në fund, trupi gjykues shkurtimisht do ta adresojë një aspekt të përmendur nga dëshmitari H. B.. Në një moment të dëshmisë së tij në gjykatë, ai deklaroi se më 16 prill 1999 ai e pa **O. I.** te udhëkryqi 'Te Shelgjet' në Mitrovicë. I akuzuari ishte i armatosur, i veshur me uniformë me ngjyrë të kaltër dhe po diskutonte me disa policë apo paramilitarë. Disa prej tyre kishin vënë maska në kokë. Në atë kohë, një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës ishin dëbuar dhe po ecnin nga Mitrovica në kolonë. **O. I.** dhe grupi i tij i nxorën nëntë shqiptarë nga kolona dhe i tërhoqën zvarrë në një oborr. Dëshmitari dëgjoji të shtëna pak kohë pas kësaj²⁰³.
162. Trupi gjykues vëren se dëshmitari e përmendi këtë aspekt për herë të parë para Gjykatës dhe për afërsisht 16 vite pas ngjarjes. Për dallim nga shumica e dëshmitarëve tjerë, H. B. nuk mund të cilësohet si laik kur bëhet fjalë për ligjin dhe shkeljet e ligjit. Ai është aktivist për të drejtat e njeriut dhe është e logjikshme të konkludohet se ai i ka ditur shumë mirë pasojat e vrojtimit të veta. Në fakt, ky është një konkluzion i arsyeshëm për çdo person të zakonshëm. Gjatë konfliktit në Kosovë, H. B. i ka mbledhur përshkrime të shumta nga viktimat e abuzimeve. Megjithatë, kur ballafaqohet me prova inkriminuese si më lartë, ai qëndron i heshtur për më shumë se 16 vite dhe e jep

²⁰³ H. B., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 30 mars 2015, para. 218 *et seq.*

vullnetarisht këtë informatë vetëm para Gjykatës dhe vetëm drejt fundit të marrjes në pyetje të tij nga ana e prokurorit.

163. Qëndron në natyrën e procedurës penale që mund të ketë mospërputhje apo lënie jashtë në përshkrimet e dhëna herëve të mëparshme. Dëshmitarit ndoshta i janë bërë pyetje të ndryshme në kohë të ndryshme apo ai mund t'i ketë harruar apo kujtuar disa hollësi. Ndonëse besueshmëria e një dëshmitari nuk preket drejtpërsëdrejti me praninë e disa mospërputhjeve në përshkrimet e ndryshme, ato megjithatë duhet të shqyrtohen me kujdes gjatë përcaktimit të peshës që duhet t'i jepet dëshmisë së dëshmitarit. Duke i pasur parasysh argumentet e paraqitura në paragrafin më lartë, nuk mund t'i jepet rëndësi të madhe dëshmisë së H. B..

(c) Dëshmia lidhur me praninë e O. I. në Ferronikel më 14 prill 1999 dhe lidhur me aktivitetin e tij si civil në vitin 1999:

164. Mbrojtja vazhdimisht ka argumentuar se në ditën e përmendur i Akuzuari nuk ka qenë në zonën e ngjarjeve dhe se në këtë kohë specifike ai ka qenë në vendin e punës në Ferronikel. Gjatë tërë rrjedhës së procedurës, mbrojtja ka bërë përpjekje që të dëshmojë se i Akuzuari as nuk ka ditur as nuk ka marrë pjesë në çfarëdo fazë të realizimit të operacionit.
165. B. K., D. M.1 dhe N. K. janë dëshmitarë të alibisë. Të tretë kanë punuar në kompaninë Ferronikeli gjatë viteve 1998-1999. Ferronikeli ishte një konglomerat industrial dhe ndërmarrja e tretë më e madhe në Kosovë. Përbrenda Ferronikelit kishte impiante prodhimi që ndodheshin në Glllogoc kur xehet thaheshin dhe përpunoheshin. Ata po ashtu kishin një impiant pompe në Bivolak dhe një fabrikë të ujit në kodrën mbi Glllogovcin²⁰⁴. Administrata dhe ndërtesat komerciale ishin në Prishtinë²⁰⁵. Gjatë luftës në vitin 1999, ndërmarrja kishte rreth 300 punëtorë, nga të cilët rreth 70% ishin Shqiptarë²⁰⁶.

²⁰⁴ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 173.

²⁰⁵ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 23.

²⁰⁶ B.K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, paras. 29-35 dhe 228.

166. B. K. ishte Drejtor i Përgjithshëm, D. M.1 ishte Shef i Njesisë për Çështje Komerciale dhe N. K. ishte Shef i Departamentit Juridik. Ndërkaq, **O. I.** ishte zëvendës drejtor i ndërmarrjes, duke filluar nga tetori i vitit 1998. Detyrat e tij ishin kryesisht lidhur me aspektet komerciale dhe financiare të ndërmarrjes²⁰⁷. Ai ishte në krye të veprimeve bankare, pagesës së rrogave dhe lëshimit të mallrave²⁰⁸. Në fakt, **O. I.** dhe Drejtori i Përgjithshëm ishin dy personat e vetëm në ndërmarrje të cilët kishin nënshkrime të autorizuar në bankë²⁰⁹. Prandaj, ai duhej të shkonte disa herë në ditë për pagesa në disa banka si Jugobanka, Vojvodjanska Banka, Beogradska Banka, Kosovo Metohija Banka ose Komercijalna Banka²¹⁰. Ai gjithashtu ishte përgjegjës për bashkërendimin e disa grupeve punuese të përfshirë në një program të mirëmbajtjes dhe revitalizimit të impiantit të prodhimit²¹¹. Zyra e **O. I.** ishte në ndërtesën e administratës në Prishtinë. Megjithatë, ai shpesh shkonte në Golesh dhe Glogovc për aktivitete të ndryshme të ndërmarrjes²¹².
167. Gjatë luftës në vitin 1999, fabrika në Glogovc funksiononte nën rrethana speciale. Në fakt, prodhimi ishte ndalur në tërësi për shkak të konfliktit. Megjithatë, fabrika nuk mund të mbyllej në tërësi dhe duhej të mbahej në “gjendje të ngrohtë” (apo në gjendje të mirëmbajtjes). Vetëm duke bërë kështu ata mund ta shpëtonin metalin që e kishin në depo, në vlerë prej rreth 10 milion dollarësh. Po ashtu, në vitet 1996/1997 fabrika kishte përfituar nga një renovim gjeneral në vlerë prej rreth 12,5 milion dollarësh nga investimet e jashtme²¹³. Prandaj, investitorët e huaj ishin të interesuar në ruajtjen e potencialit prodhues të ndërmarrjes dhe ata kërkonin raportime të rregullta për këtë. Ishte po ashtu **O. I.** që komunikonte me ta. Në fund të vitit 1998, Ferronikeli u zgjerua dhe një ndërmarrje e re u krijua- FNG. I pandehuri u bë drejtori i saj²¹⁴.
168. Për ta përmbledhur, viti 1999 ishte vit plot angazhime për Ferronikelin dhe gjendja e mirëmbajtjes së fabrikës në Glogovc përfshinte më shumë aktivitete se zakonisht.

²⁰⁷ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 55.

²⁰⁸ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 87.

²⁰⁹ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 340.

²¹⁰ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 91.

²¹¹ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 59.

²¹² B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 69.

²¹³ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, paras. 35-41.

²¹⁴ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, paras. 65 dhe 199.

169. Dëshmitari B. K. deklaroi se në atë kohë ai dhe **O. I.** jetonin në Mitrovicë dhe udhëtonin së bashku për në Prishtinë. Ata voziteshin në të njëjtën veturë, zakonisht duke filluar në orën 7:00 nga Mitrovica dhe ktheheshin në orët e mbrëmjes²¹⁵. Kjo zgjati nga tetori 1998 deri në qershor 1999. Gjatë orëve të punës, **O. I.** ndonjëherë qëndronte me B. K.. Nëse ai shkonte në Gllogovc apo Golesh, ai zakonisht shkonte me B.K. apo me dikë tjetër. Vetëm kur shkonte në bankë ai shkonte vetëm²¹⁶.
170. Rrobat e tij ishin civile, zakonisht kostum.
171. Gjatë kohës së luftës kishte hyrë në fuqi ligji për obligimet e punës. Sipas këtij ligji, i tërë personeli udhëheqës në Kosovë ishte i caktuar në vendet e tyre të punës. Në rast të mungesës ata raportoheshin²¹⁷. Kjo vlente edhe për të Akuzuarin.
172. Lidhur me ditën kritike të 14 prillit 1999, dëshmitarit nuk i kujtohet se çfarë aktivitete konkrete ka kryer **O. I.** Por, meqë ishte ditë e mërkurë, dëshmitari konkludoi se i Pandehuri me siguri ka qenë i angazhuar me aktivitete të rregullta të përshkruara më lartë²¹⁸. Do të kishte qenë tepër vështirë për të Akuzuarin që të mungojë në punë pa një *“arsye jashtëzakonisht të mirë”*. Në rast të mungesës, ai është dashur t’i raportonte Drejtorit të Pergjithshëm dhe kjo nuk ka ndodhur²¹⁹.
173. Këto aspekte janë konfirmuar edhe nga dy dëshmitarët tjerë të cilët kanë punuar bashkë me të Pandehurin, D. M.1 dhe N. K..
174. Për t’i plotësuar provat lidhur me aktivitetet ditore të të Akuzuarit, Mbrojtja po ashtu dorëzoi në prova dy nga ditarët e tij, që mbulonin periudha të caktuara në vitet 1999 dhe 2000, përfshirë ditën kritike.²²⁰ Nën datën 14 prill 1999, ditari përmban 7 faqe shënime. Ato përgjithësisht përbëhen nga emra dhe numra telefonash.
175. Me këto dy ditarë si dhe me dëshmitarët e lartcekur, mbrojtja synonte që të Akuzuarin ta vendoste në vendin e tij të punës ditën kritike dhe ta përjashtojë praninë e tij në rajonin e Mitrovicës. Megjithatë, trupi gjykues konstaton se alibia e paraqitur është tejet e përgjithshme dhe rrjedhimisht jo bindëse. Asnjëri nga dëshmitarët nuk ka paraqitur

²¹⁵ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 79.

²¹⁶ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 333.

²¹⁷ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, paras. 65 dhe 199.

²¹⁸ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, paras. 248-264.

²¹⁹ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, paras. 357-360.

²²⁰ *Shih* Dosjen e Gjykatës XIII

ndonjë provë konkrete rreth vendndodhjes së të Pandehurit atë ditë. Edhe nëse ai është paraqitur në punë atë ditë, është dëshmuar se ai kishte aktivitetet fleksibile dhe prandaj ka mundur lehtë ta fshehtë mungesën e tij nga puna.

176. Mbrojtja e paraqiti Rregulloren mbi organizimin dhe ekzekutimin e detyrave të punës²²¹ ku përcaktohej se gjatë gjendjes së luftës, autoritetet shtetërore mund t'u imponojnë qytetarëve detyra të punës. Dëshmitarët B.K., D.M.1 dhe N.K. deklaruan se ky ka qenë rasti me të Pandehurin: ai ishte i caktuar në vendin e tij të punës. Trupi gjykues vlerëson se ekzistenca e kësaj Rregulloreje për obligimet e punës nuk e ka përjashtuar në tërësi mungesën e një të punësuarit nga vendi i tij i punës. Sipas deklaratës së vet Dëshmitarit, nëse ka ndodhur që për shkaqe sigurie punëtorët nga ndonjë fshat nuk kanë mundur të vijnë në punë, ata ishin të detyruar të kontaktonin me punëtorë tjerë të cilët do të mund të shkonin me qëllim që ta informojnë udhëheqësinë²²². Edhe nëse ne pranojmë se një mungesë potenciale do të duhej t'i raportojë udhëheqësisë, udhëheqësia përbëhej nga i Pandehuri, si Zëvendës Drejtor dhe B. K., Drejtori i Përgjithshëm. Sipas B.K., **O.I.** ishte "njeri i tij i besueshëm"²²³. Ata bashkëpunonin ngushtë dhe ishin shokë. Në fakt, **O. I.** e mori përsipër pozitën e Zëvendës Drejtorit pas kërkesës personale të B. K.. Edhe një fakt tregues është se përveç vetes, B.K. e autorizoi vetëm të Pandehurin që të nënshkruaj për veprimet bankare. As madje D. M.1, i cili ishte Shef i Njesisë për Çështje Komerciale dhe Financiare, nuk mund t'i nënshkruante urdhërpagesat dhe dokumentet e ngjashme. E drejta e tij paraprake për të nënshkruar u revokua kur B. K. u bë Drejtor i Përgjithshëm²²⁴. I pandehuri gëzonte një nivel të lartë besimi. Është e arsyeshme të besohet se ai nuk ka qenë nën kontroll të rreptë, por kishte një lloj pavarësie në aktivitetet e tij ditore. Përveç kësaj, nuk

²²¹ Rregullorja e publikuar në "Gazetën Zyrtare" të RFJ-së, Nr. 36, 24 korrik 1998; 20/99. *Shih* Dosjen e Gykates X, Shqyrtimi Kryesor, tab 10.

²²² **O.I.**, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 8 dhjetor 2015, paras. 17-19.

²²³ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 276.

²²⁴ D. M. deklaroi: "Z. B. K. e mori këtë të drejtë nga unë dhe ishin vetëm z. B. K. dhe z. **O. I.** që e kishin këtë të drejtë. Gjatë periudhës së R. V., unë gjithashtu isha përgjegjës për atë; unë e kisha atë të drejtë. Gjyqtari Nuno Madureira: Ju po thoni se për një fabrikë që punësonte 1200 persona dhe kishte shumë objekte të shpërndara në tërë territorin, vetëm dy persona ishin të autorizuar që t'i nënshkruajnë shpenzimet?; D. M.: Po, pikërisht këtë po e them. Është e qartë se z. B. K. nuk ka pasur shumë besim te unë." *Shih* D. M., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 7 Tetor 2015, paras. 224-227.

është e paarsyeshme të pranohet se përfshirja në aktivitete të paramilitarëve apo policëve rezervë nuk ka kërkuar ndonjë orar të caktuar apo prani të vazhdueshme por, në disa emergjenca operationale, mund të kërkohet sipas rastit.

177. Për ta përmbledhur, trupi gjykues nuk mund të mbështetet në këto dëshmi të dëshmitarëve për të zbuluar aktivitetet e të Pandehurit më 14 prill 1999.
178. Në anën tjetër, në rast se mungesa e tij do të ishte vërejtur, Drejtori i Përgjithshëm do të duhej ta raportonte të Akuzuarin të autoritetet²²⁵. Mirëpo, ishin pikërisht “autoritetet” që e organizuan operacionin e pastrimit në Mitrovicë, prandaj në sytë e tyre mungesa do të ishte e arsyetueshme.
179. Ditarët e paraqitur nga i Pandehuri nuk mbartin ndonjë vlerë provuese. Ato nuk paraqesin të dhëna zyrtare apo të paanshme. Ato janë hartuar nga i Pandehuri dhe nuk ka prova tjera, përveç shpjegimeve të dhëna nga i Pandehuri se si dhe kur janë shënuar. Edhe datat janë shënuar me dorë. Të Pandehurit nuk i kujtoheshin aktivitetet e sakta më 14 prill 1999, por ai supozonte se ishte në punë si çdo ditë tjetër pune. Duke pasur parasysh se nën atë datë specifike janë shtatë faqe shënimesh, i Pandehuri konkludon se me siguri ka qenë ditë shumë e ngarkuar²²⁶. Megjithatë, shënimet menjëherë para datës 14 prill 1999 janë të regjistruara me datën 6 prill 1999. Dhe data e radhës e regjistruar është 23 prilli 1999. Prandaj, shënimet në ditarë janë nën data të ndara me 8-9 ditë. Sipas të Pandehurit, ai shkonte në punë çdo ditë dhe ishte shumë i zënë me punë. Nuk është e qartë se pse shënimet në ditarë janë në aq distancë kohore. Ne vetëm mund të konkludojmë se ditarët nuk i pasqyrojnë saktë aktivitetet ditore të të akuzuarit. Përveç kësaj, shënimet nën datën 14 prill nuk paraqesin një listë detyrash apo takimesh, dhe as nuk përmbajnë ndonjë sugjerim rreth periudhës kohore të ndonjë aktiviteti apo nëse ato janë realizuar ose jo. Ditari përmban një listë emrash dhe numrash telefoni dhe trupi gjykues nuk mund ta përdor këtë për ta bazuar ndonjë konkludim. Ditari nuk mund të ngrit ndonjë dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të Akuzuarit në vendin kritik më datën 14 prill 1999.
180. Në konkludim, alibia ofron vetëm informata të përgjithshme rreth aktivitetit të të Pandehurit në atë kohë dhe kundërshtohet me prova konkrete të specifikuar më lartë.

²²⁵ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 tetor 2015, paras. 361-362.

²²⁶ O. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 4 dhjetor 2015, paras. 85-90.

181. Ne gjithashtu do të përmendim se dëshmitari B. I., i propozuar nga prokuroria, po ashtu dëshmoi rreth aktiviteteve të Ferronikelit. Gjatë dëshmisë së tij, ai e përmendi prezencën e forcave të armatosura Serbe në fabrikë gjatë kohës që ai ishte i punësuar aty. Megjithatë, dëshmitari ndërpreu punën në verën e vitit 1998²²⁷ dhe kjo ka qenë para se i Pandehuri madje të fillonte aktivitetet e tij aty. Prandaj, u konstatua se dëshmia e tij nuk ishte relevante.
182. Në dëshminë e tij, dëshmitari B. R. gjithashtu foli rreth aktiviteteve në Ferronikel, mirëpo pa ofruar ndonjë informatë të brendshme që mund të konsiderohej relevante.
183. Trupi gjykues vëren se disa dëshmitarë të afërm me të Pandehurin, përfshirë fqinjin e tij të parë G. P., deklaruan se kurrë nuk e kishin parë atë me uniformë²²⁸. Kjo është një deklaratë e përgjithshme negative dhe nuk e përjashton këtë mundësi, posaçërisht duke pasur parasysh natyrën potenciale të fshehtë të aktiviteteve paramilitare. Më me rëndësi, kjo deklaratë e përgjithshme hidhet poshtë nga vet dëshmia e të Akuzuarit. Sipas pranimit të tij, më parë ai kishte qenë në forcat rezerviste policore dhe kishte një uniformë të kaltër²²⁹. Dëshmitari Y po ashtu dëshmoi për faktin e njëjtë²³⁰.
184. Në fund, trupi gjykues është i vetëdijshëm për një numër të madh të dëshmimeve rreth karakterit të mirë të O. I. dhe qëndrimit të mirë të tij ndaj Shqiptarëve. Klubi i tij sportiv promovonte përfshirjen etnike. Sipas B. K.²³¹, D. M.²³², A. D.²³³ dhe O. M., ndërsa punonte në Ferronikel, ai ka qenë i angazhuar në organizimin e një karvani për t'i transportuar Shqiptarët e Kosovës jashtë kufirit të Kosovës, kryesisht në IRJM. Karvani ishte i përbërë nga një autobus dhe rreth 30 veturash dhe transportonte 200-300 persona, ish-punëtor të Ferronikelit dhe familjet e tyre dhe familjet tjera Shqiptare, disa prej tyre nga Mitrovica²³⁴. O. I. gjithashtu kishte bërë përpjeke paraprakisht që ta nxjerr

²²⁷ B. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 24 mars 2015, para. 144 *et seq.*

²²⁸ G. P., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 15 Tetor 2015, para. 122.

²²⁹ O. I., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 4 dhjetor 2015, para. 264-267.

²³⁰ Dëshmitari Y, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 28 korrik 2015, para. 46-47.

²³¹ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 120 *et seq.*

²³² D. M., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 7 Tetor 2015, para. 96 *et seq.*

²³³ A. D., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 8 Tetor 2015, para. 111 *et seq.*

²³⁴ B. K., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 6 Tetor 2015, para. 145 *et seq.*

A. D. jashtë vendit me veturë private, por operacioni kishte qenë i pasuksesshëm. Të gjitha këto përpjekje të lartcekura janë ndërmarrë pas shumë lutjeve nga Shqiptarët e Kosovës, të cilët pastaj ishin shumë mirënjohës ndaj organizatorëve. Kjo provë në të vërtetë mbështet konkludimin se i Pandehuri ka treguar një qëndrim njerëzor dhe miqësor ndaj Shqiptarëve.

185. I tërë ky operacion mund të sugjerojë po ashtu një mjet për ta arritur një qëllim të përbashkët: largimin e Shqiptarëve nga Kosova. Megjithatë, pa prova konkrete për ta mbështetur këtë supozim, trupi gjykues e merr parasysh karakterin e mirë të të Pandehurit.
186. Ka shumë letra rreth karakterit të tij që janë paraqitura në prova. Ato burojnë nga disa zyrtarë ndërkombëtar që kanë bashkëpunuar me të Pandehurin në periudha të ndryshme pas qershorit të vitit 1999²³⁵ dhe ato janë dëshmi rreth qëndrimit të tij përkrahës ndaj përfshirjes së Shqiptarëve të Kosovës dhe pajtimit ndërmjet dy komuniteteve.
187. Mbrojtja e **O. I.** në thelb ka sugjeruar, si në parashtrësit e veta dhe në dëshmitë, se karakteri i tij ka qenë në shpërputhje të plotë me pretendimet e paraqitura në Aktakuzë. Në një mënyrë shumë grafike, Mbrojtja e paraqet këtë në deklaratat fillestare të 18 dhjetorit 2014: **O. I.** *“po vepronte si zëvendës drejtor i një kompanie të rëndësishme, dhe ai i ka kryer detyrat e veta gjatë gjithë kohës së luftës. Ai mbathte një kostum dhe kravatë, jo uniformë, dhe çdo kush e di këtë. Ai nuk ishte një “luftëtar i fundjavës”, i cili vepronte si drejtor i një kompanie gjatë javës dhe i cili urdhëronte vrasje gjatë fundjavës, duke u shndërrua nga Dr. Jekyll paqësor në Z. Hyde gjakatar”*
188. Nga pikëpamja e trupit gjykues, karakteri i të Akuzuarit nuk do të ishte një konsideratë domethënëse, nëse ka prova bindëse për të kundërtën, posaçërisht duke pasur parasysh përkushtimin e qartë për arritjen e qëllimeve ushtarake dhe politike të forcave Serbe. Alibia dhe karakteri nuk e përjashtojnë përfshirjen e **O. I.** nëse ka pasur arsye të forta pse ai është dashur të merr pjesë në ngjarje. Karakteri i tij i mirë nuk ka mundur të ketë rëndësi kur ai ka vepruar vetëm si pjesëmarrës i thjeshtë në një veprim më të gjerë

²³⁵ *Shih* Dosjen e Gjykats III, Shqyrtimi Kryesor, tab 12.

kolektiv. Deklaratat rreth karakterit të tij mund të konsiderohen vetëm si faktorë lehtësues.

189. Bazuar në të gjitha dëshmitë e vlerësuara deri më tani, trupi gjykues konstaton përtej dyshimit të arsyeshëm se me atë rast **O. I.** ishte pjesë e grupit të paramilitarëve/policëve të pranishëm në pikën e kontrollit dhe se ai kishte të veshur një uniformë të kaltër dhe ishte i armatosur.

(d) Roli i **O. I.** në ngjarjet e 14 prillit 1999 në Mitrovicë

Sjellja e **O. I.** në pikën e kontrollit:

190. Në rrugën Miladin Popović, një person i veçoi dhe liroi gjashtë Shqiptarë të Kosovës nga nëntë të tjerët të cilët pastaj u dërguan në vendin e ekzekutimit. Dëshmitarët janë unanimit në këtë aspekt.
191. Për më tepër, sipas dëshmitarit I. M.1, “personi i cili i veçoi këtë gjashtë veta”²³⁶, e pyeti **O. I.**: “çfarë do të bëjmë me këta?”. **O. I.** u përgjigj në gjuhën serbe “pse po më pyetni mua, veproni sipas urdhrit.”²³⁷ Ai po ashtu e quajti **O. I.** “shef”²³⁸. I. M.1 pretendon se i kujtohen këto shprehje shumë mirë²³⁹.
192. Duket se shkëmbimi i fjalëve ka ndodhur menjëherë pas veçimit²⁴⁰. Kjo është në përputhje me faktin se I. M.1 deklaroi se “i kaltri” i veçoi ata pa qenë i urdhëruar nga dikush²⁴¹. Këtu është një kundërthënie e vogël në deklaratat e tij: në deklaratën e tij dhënë në procedurën paraprake ai e dha këtë përshkrim “ishte një person, **O. I.** i cili urdhëroi që të na ndajnë neve”²⁴². Do të ishte e logjikshme që “urdhri” të jetë dhënë para ndarjes dhe jo pas, sikurse deklaroi ai para Gjykatës. Kjo kundërthënie nuk e bën deklaratën e I. M.1 jo-kredibile. Ngatërresa mund të jetë shkaktuar nga fakti se

²³⁶ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 281.

²³⁷ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 277-279, 314, dhe 318-321.

²³⁸ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 322-330 dhe 333-334.

²³⁹ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 322.

²⁴⁰ “Ata u larguan dhe ne qëndruam aty, njëri prej tyre i foli **O. I.**”; I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 277.

²⁴¹ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 22 janar 2015, para. 450-451.

²⁴² I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, para. 452.

ndarja dhe pastaj dërgimi i nëntë Shqiptarëve te Rruga për Bajr kanë ndodhur shumë shpejt, kjo ka zgjatur vetëm për disa minuta²⁴³. Megjithatë, pozita e dëshmitarit duket se shkon më shumë drejt faktit se shkëmbimi i fjalëve ndodhi pas ndarjes. I. M.1 e përforcoi këtë qëndrim para Gjykatës kur, pas një rrëfimi të ndryshëm, ai përsëri e dha përshkrimin e njëjtë: *“Ai [O. I.] u përgjigj në gjuhën Serbe ‘pse po më pyetni mua, veproni sipas urdhrorit.’ Pastaj ata të gjithë i vendosën maskat e tyre në kokë dhe menjëherë na çuan në këtë rrugë në të djathtë.”*²⁴⁴

193. Sh. K.1 vetëm dëgjoi një zë duke thënë: “Zbatoni rregullat”,²⁴⁵ pa e parë folësin. Duket se në deklaratën e tij në procedurën paraprake të datës 24 janar 2000, dëshmitari deklaroi se ishte **O. I.** ai i cili i shqiptoi këto fjalë. Megjithatë, para Gjykatës, dëshmitari me vendosmëri deklaroi se ai nuk e kishte vërejtur të Akuzuarin pasi që duart i kishte të kryqëzuara prapa qafës së tij dhe koka e tij ishte e ulur.²⁴⁶ Trupi gjykues konstaton se deklarata e tij është e besueshme, edhe pse erdhi pasi ju rifreskua kujtesa e tij. Fakti se dëshmitari e censuroi deklaratën e tij dhënë në procedurën paraprake siç u paraqit më lartë dhe ofroi një shpjegim logjik për këtë ndryshim të qëndrimit demonstroi se ai me vëmendje po shqyrton se çfarë ka përjetuar në të vërtetë dhe çfarë jo.
194. Xh. S. e dëgjoi zërin gjithashtu²⁴⁷, por ai e paraqiti këtë informatë vetëm pasi u pyet disa herë edhe pasi iu rifreskua kujtesa. Prandaj, trupi gjykues i jep më pak vlerë dëshmisë së tij. Sidoqoftë, përshkrimi i tij ka peshën e dëshmisë vërtetuese.
195. L. A.1, ndonëse paraprakisht ka përmendur një shkëmbim të ngjashëm fjalësh, ai nuk e konfirmoi këta para Gjykatës²⁴⁸. Kur dëshmitari dëshmon në Gjykatë, Kodi i Procedurës Penale e kufizon rreptësisht përdorimin e deklaratave të tij të mëparshme. Gjegjësisht, deklaratat paraprake mund të përdoren vetëm për ta rifreskuar kujtesën e dëshmitarit gjatë marrjes direkte në pyetje dhe për ta sfiduar kredibilitetin e dëshmitarit në marrjen e tërthortë në pyetje (Neni 123 KPP). Në të dy rastet, përmbajtja e deklaratës paraprake përdoret vetëm për t’i ndihmuar palës në arritjen e këtyre qëllimeve dhe nuk mund të

²⁴³ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, para. 447.

²⁴⁴ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 279.

²⁴⁵ Sh. K.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 shkurt 2015, para. 325-332.

²⁴⁶ Sh. K.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 shkurt 2015, para. 325.

²⁴⁷ Xh. S., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, paras. 667-684.

²⁴⁸ L. A.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 mars 2015, para. 203-217.

pranohet si dëshmi direkte e fakteve. Prandaj, nuk mund t'i jepet asnjë vlerë provuese deklaratës së L. A.1 dhënë në procedurën paraprake.

196. Prandaj, duke u bazuar në dëshmitë e bashkuara më lartë, trupi gjykues konstaton përtej dyshimit të arsyeshëm se para se nëntë burrat Shqiptarë të Kosovës të kalonin nëpërmjet pikës së kontrollit drejt pikës së ekzekutimit, një pjesëtar i njesisë policore/paramilitare Serbe i cili po i dërgonte ata e pyeti **O. I.** diçka si “Çfarë do të bëjmë me këta shef?”, ku **O. I.** u përgjigj disi në këtë mënyrë: “Pse më pyetni mua, zbaroni urdhrat!”.
197. I. M. 1 po ashtu përmendi se pasi që “shpëtimtari” e ndali ekzekutimin, kur pesë të mbijetuarit ecën prapa drejt pikës së kontrollit, ai dëgjoi një zë duke thënë diçka si “*Tani shkoni në Shqipëri*”. Ai e njohu zërin si i përkiste **O. I.**²⁴⁹. Megjithatë, trupi gjykues nuk mund të mbështetet mjaftueshëm në këtë informatë për të konstatuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ka qenë në të vërtetë i Akuzuari i cili i shqiptoi këto fjalë të fundit. Të gjithë pjesëtarët policisë/paramilitarët përreth pikës së kontrollit ishin të maskuar në atë pikë dhe dëshmitari nuk ka mundur ta shohë fytyrën e **O. I.** Njohja përmes zërit është vlerësuar si jo mjaft e besueshme për ta identifikuar pozitivisht të Pandehurin.

Roli komandues i **O. I.**:

198. Sipas I. M.1, gjatë shkëmbimit të fjalëve ndërmjet njerëzve të “kaltër” në uniforma dhe **O. I.**²⁵⁰, ky i fundit u quajt “shef”²⁵¹.
199. Trupi gjykues konstatoi se përdorimi i termit “shef” mund të jetë i dykuptimtë. Edhe vet I. M.1 pranoi se **O. I.** mundur t'i ketë marrë urdhrat nga dikush tjetër.
200. Nocioni i “Shefit” nuk i jep ndonjë mbështetje të madhe një konkludimi të prerë lidhur me pozitën e të Akuzuarit midis trupave. Nocioni i “shefit”, në vetvete, mund të jetë kuptuar më gjerë nga disa paramilitarë në atë kohë, pasi që disa prej tyre mund ta kenë

²⁴⁹ I. M., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 456, dhe Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, para. 316.

²⁵⁰ Siç u përshkrua më lartë.

²⁵¹ I. M., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, paras. 322-330, 333-334.

përdorur termin vetëm si shenjë respekti apo për pranuar ndikimin. Ka mundur të jetë pozita shoqërore e të Akuzuarit që e ka nxitur respektin dhe jo autoriteti i tij zyrtar apo *de fakto* përbrenda forcave të armatosura Serbe.

201. Për më tepër, përgjigja e **O. I.** – “Pse më pyetni mu, zbatoni urdhrat!” – e sugjeron më shumë faktin se nuk ka qenë ai që e ka dhënë urdhrin, por se dhënësi i urdhrit ka qenë dikush tjetër.
202. Kur dëshmitari M. Ll. e vërejti **O. I.**, ky i fundit ka qenë i pozicionuar para një grupi të personave tjerë të armatosur. Sipas dëshmitarit, “udhëheqësi i grupit qëndron gjithnjë para grupit”²⁵². Trupi gjykues nuk e mbështet këtë konkludim dhe e konsideron thjeshtë vetëm si mendim personal i dëshmitarit, që nuk ka ndonjë vlerë provuese.
203. Në fund të deklaratës së saj, Sh. C.1 përmendi “ai vërtet ishte udhëheqësi i tyre; ai ishte një kriminel; ai e dha urdhrin për ekzekutim”²⁵³. Megjithatë, ajo nuk dëgjoi ndonjë urdher apo fjalë komandimi dhe vlerësimi i saj është tërësisht i pambështetur me fakte.
204. Z. A. po ashtu sugjeroi se “**O. I.** ishte udhëheqësi”, bazuar në faktin se ai po ecte para tjetrit dhe se ai fliste.²⁵⁴ Fillimisht, siç u paraqit më lartë, vlera që i jepet deklaratës së tij kur bëhet fjale për identifikimin e të Akuzuarit është shumë e vogël. Së dyti, argumenti i njëjtë që është dhënë për përkrahimin e M. Ll. përsëritet edhe këtu: kjo paraqet vetëm mendimin e dëshmitarit. Shpërndarja fizike e ushtarëve përbrenda një grupi nuk mund të jetë bazë për një konkludim vendimtar se kush është duke komanduar.
205. Informata e vetme e dhënë nga dikush i cili ka qenë i lidhur nga brenda me aktivitet policore ka ardhur nga Dëshmitari Y, i cili ka qenë zyrtar policor më përpara. Dëshmitari deklaroi se ai njëherë ruante një pikë kontrolli në Vushtrri së bashku me **O. I.** dhe ky i fundit ishte vartësi i tij. Edhe pse kjo gjë ka ndodhur një vit para ngjarjeve në gjykim, dhe rrjedhimisht në asnjë mënyrë nuk është vendimtare për ne, ajo

²⁵² M. Ll., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 23 janar 2015, para. 435, 448-454.

²⁵³ Sh. C.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 mars 2015, para. 137

²⁵⁴ Z. A., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, para. 51 - 71 dhe 96.

megjithatë ngrit edhe më shumë dyshime lidhur me pozitën komanduese të të Pandehurit.

206. Dëshmitari F. H. deklaroi se *“O. I. ishte personi kyç për krimet që kanë ndodhur në Mitrovicë, në veçanti në rrugën e njohur si “rruga e Kovaçëve”, në vitin 1999”*²⁵⁵. Megjithatë, siç dëshmitari e elaboroi më tutje, ky konkluzion ishte i bazuar në jo më shumë se thashethemet²⁵⁶. Ai nuk kishte njohuri personale për ngjarjet në gjykim. Për këtë, trupi gjykues i kushton rëndësi të vogël raportimeve të tilla të thashetheme të pabazuara.
207. Si prova dokumentuese janë dorëzuar dosja raporte të KFOR-it dhe UNMIK-ut si dhe memorandumi që e përshkruan **O. I.** si udhëheqës apo komandues i formacioneve paramilitare/policore. Nuk ka ndonjë të dhënë lidhur me burimin e tyre, dhe këto nuk janë vërtetuar në gjykatë në ndonjë mënyrë. Prandaj, këtyre dokumenteve nuk i jepet peshë provuese.
208. Ky aspekt nuk ka mundur të vërtetohet.

Plani i përbashkët dhe bashkërendimi ndërmjet trupave të RFJ-së dhe Serbisë- të rregullta (polica/ushtria) dhe të parregullta:

209. Provat vërtetojnë se forcat e armatosura Serbe dhe të RFJ-së kanë vepruar të bashkërenduara në realizimin e qëllimit të përbashkët.
210. Trupi gjykues vërën se madje nuk ka domosdoshmëri që qëllimi i përbashkët të jetë dakorduar apo formuluar paraprakisht; ai mund të materializohet spontanisht dhe të nxirret konkludimi nga faktet konkrete²⁵⁷. Ekzistimi i një plani të përbashkët mund të konkludohet, ndër të tjera, nga mënyra se si është kryer vepra në fjalë²⁵⁸.

²⁵⁵ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 125 dhe 93.

²⁵⁶ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 127-128 dhe 136.

²⁵⁷ Aktgjykim i Apelit Tadić, para 227; Aktgjykim i Apelit Krnojelac, para 97, Aktgjykim i Apelit Vasiljević, paras. 100, 109; Aktgjykim i Apelit Brđanin, para. 415, 418.

²⁵⁸ Aktgjykim i Apelit Vasiljević, para. 100, 109; Aktgjykim i Apelit Furundžija, para. 119; Aktgjykim i Apelit Tadić, para. 227; Aktgjykim i Apelit Ntakirutimana, para. 466; Aktgjykim i Gjykimit Blagojević, para. 699; Aktgjykim i Gjykimit Brđanin, para. 262; Aktgjykim i Gjykimit Simić, para. 158; Aktgjykim i Gjykimit Krnojelac, para. 80; Aktgjykim i Gjykimit Krstić, para. 611; Aktgjykim i Gjykimit Milutinović, Vëllimi I, para. 102.

211. Dëshmitarët unanimitisht dëshmuan për një prani të përbashkët në rajon të ushtrisë, policisë dhe atyre që ata i identifikojnë si “paramilitarë” (apo ushtria e parregullt). Ata i përmendën dy lloje kryesore uniformash: të gjelbër dhe të kaltër. Për ta thjeshtësuar, ne këtu u jemi referuar forcave që i kanë veshur ato si “të gjelbrit” apo “të kaltrit”.
212. Aktakuza përdor formulimin “paramilitarë/policia”. “Paramilitarë” është një term që përdoret në mjetet ligjore humanitare, sikurse Protokollin Shtesë I i Konventave të Gjenevës, ndonëse aty nuk është i përkufizuar. Një grup paramilitar në përgjithësi përshkruan një forcë apo njësi funksionet dhe organizimi i së cilës janë analoge apo ndihmëse për forcat profesionale ushtarake, por që nuk konsiderohet se ka status profesional apo legjitim²⁵⁹. Në jurisprudencën e saj, TPNJ-ia ka vënë termin “paramilitarë” grupeve që luftojnë pranë forcave ushtarake apo policore në konfliktet në territorin e ish RSFJ-së, që identifikoheshin me uniformat, trajnimet dhe lidërsipin e tyre, dhe të cilat shpesh përfshiheshin në forcat rezerviste²⁶⁰.
213. Megjithatë, dallimi ndërmjet policisë (aktive apo rezerviste) dhe paramilitarëve nuk është shumë i qartë në materialet tona të provave. Sipas dëshmive të dëshmitarëve, të dy grupet kishin uniforma që kryesisht ishin të kaltra; megjithatë, disa prej tyre kishin maska apo mbathje të ngjashme me ngjyrë të zezë për kokë. Disa nga dëshmitarët iu referoheshin këtyre të fundit si “paramilitarët” apo “pjesëtarët e ushtrisë së parregullt”²⁶¹. Duhet të kihet parasysh se dëshmitarët ishin civil dhe se asnjëri prej tyre nuk kishte trajnim të avancuar ushtarak së fundmi që të jenë në gjendje ta bëjnë dallimin e qartë ndërmjet llojeve të uniformave.

²⁵⁹ Fjalori i Oxfordit i gjuhës Angleze.

²⁶⁰ Shih Aktgjykimin e Apelit Martić, paras. 195, 205; Aktgjykimin e Apelit Krajišnik, para. 246; Aktgjykimin e Apelit Brđanin, paras. 146, 236; Aktgjykimin e Gjykimit Đorđević, para. 191.

²⁶¹ Si shembull, I. M. 1.a e ka këtë perceptim: “N. V.3: Çfarë është dallimi ndërmjet ushtrisë së rregullt dhe rezervistëve?; I. M.1: Sikurse thashë dje, unë bazohem në moshën dhe uniformën e tyre; N. V.3: Pra, ushtria e rregullt dhe rezervistët nuk janë të njëjtë, e saktë?; I. M. 1.: Jo; N. V.3: Kur e përdorni fjalën paramilitar për çfarë mendoni?; I. M.1: Nuk e di nëse e kam përmendur atë fjalë, por nëse e kam përdorur ajo nënkupton se personat mund të jenë civil paramilitarë dhe me uniforma; N. V. 3: Çfarë janë këto uniforma paramilitare?; I. M. 1: Dje unë i përmenda dy lloje uniformash të cilat ishin uniforma të kaltra policore të kamufluara dhe uniformat e kamufluara të gjelbërta ushtarake; N. V. 3: Nëse është kështu, dy lloje të uniformave, atëherë si mund ta dalloni uniformën paramilitare? I. M. 3: Me aq sa di, unë asnjëherë nuk e kam përmendur fjalën paramilitarë, unë vetëm e kam përmendur policinë dhe ushtrinë; N. V. 3: Kjo do të thotë se ju thatë se atë ditë vetëm policia dhe ushtria ishin në shtëpinë tuaj?; I. M. 1: Po. Policia me uniforma dhe policia me shalla. Ata kishin uniforma policore dhe kishin shalla të zi.”; shih I. M. 1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, paras. 22-33.

214. Dëshmitë vazhdimisht tregonin se ishin “të gjelbrit” që i dëbuan ata nga shtëpitë e tyre, i mblodhën në rrugë dhe pasi i veçuan nga familjet e tyre, i dërguan 15 Shqiptarët e Kosovës në murin e një shtëpie në rrugën Njogoš. Këtu, ata u morën nga të kaltrit dhe u morën në pyetje. Më pas, ata përsëri u dërguan diku tjetër nën përcjellje. Përshkrimet e dëshmitarëve dallojnë kur bëhet fjalë se kush i çoi ata nga muri në rrugën Miladin Popović. Megjithatë, përshkrimet janë unanime rreth faktit se ishin “të kaltrit” që i morën ata pas veçimit të fundit në rrugën Miladin Popović dhe i dërguan në vendin e ekzekutimit.
215. Sa i përket atyre që i kishin marrë në pyetje burrat te muri, shumica e dëshmimeve janë të ngjashme për faktin se ata ishin të “kaltrit”. Ushtarët i dorëzuan 15 burrat te të “kaltrit”, të cilët i mbanin ata kundrejt murit. I. M.1 i përshkruan ata të veshur me uniforma të kaltra policore me kamuflazh me disa “*kapela të zeza të ngjashme me shall*”²⁶². Ndërsa nga ana tjetër, Sh. K.1 i përshkroi ata si ushtarë²⁶³.
216. Pas përfundimit të marrjes në pyetje te muri, këta 15 persona u dërguan prapa në rrugën Njogoš (tani rruga Mehmet Gradica), përpjetë shkallëve dhe pastaj në rrugën Miladin Popović nga të “gjelbrit”²⁶⁴. I. M.1 nuk vërejtë se ku ishin të “kaltrit”²⁶⁵. Ngjashëm, Sh. K.1 po ashtu pohoi se ata që i dërguan burrat te vendi i ndarjes së fundit, në rrugën Miladin Popović, ishin ushtarë²⁶⁶. Xh. S. deklaroi se pjesëtarët e ushtrisë së parregullt i dërguan në rrugën Miladin Popović²⁶⁷.
217. Fakti se mund të ketë mospërputhje në dëshmitë lidhur me ngjyrën e uniformave të atyre që kanë kryer veprime të caktuara nuk konsiderohet se e zhvlerëson peshën e deklaratave të tyre. Këto mospërputhje nuk konsiderohen substanciale pasi që ato nuk kanë të bëjnë me elemente të rëndësishme të faktit. Dëshmitë e paraqitura para trupit gjykues qartazi tregojnë se dëshmitarët kishin përjetuar ngjarje jashtëzakonisht traumatike: ata ishin dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre, ishin ndarë nga të dashurit e tyre dhe ishin mbajtur peng pa e ditur se çfarë i priste. Gjatë kësaj periudhe prej rreth një ore ata i kishin parë forcat e uniformuara, kryesisht duke veshur dy lloje të ndryshme

²⁶² I. M., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 113.

²⁶³ Sh. K.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 shkurt 2015, paras. 99-104.

²⁶⁴ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, para. 420.

²⁶⁵ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, paras. 421-422.

²⁶⁶ Sh. K.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 shkurt 2015, paras. 102, 128-132.

²⁶⁷ Xh. S., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, paras. 594-596.

të uniformave. Nuk është e pazakonshme të ngatërrohet se kush nga ata i ka kryer cilat veprime saktësisht. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, dallimi ndërmjet një personi civil dhe personi me uniformë ngulitet më lehtë në kujtesë sesa lloji specifik i uniformave që mbathen nga një person. Në fakt, kur merren parasysh koha që ka kaluar ndërmjet ngjarjeve të përshkruara dhe dëshmimeve të dëshmitarëve para gjykatës, mospërputhjet e tilla – qoftë të brendshme²⁶⁸ qoftë të jashtme ²⁶⁹ - nuk janë befasuese apo të pazakonshme dhe nuk e zvogëlojnë vlerën e dëshmisë së tyre.

218. Për më tepër, përshkrimet e ndryshme mund të mos jenë sugjeruese të mospërputhjeve. Fakti se “të kaltrit” erdhën aty kur grupi prej 15 burrash u dërguan në mur në rrugën Njegoš, nuk do të thotë domosdoshmërisht se “të gjelbrit” u larguan nga ai rajon. Në fakt, ka prova solide që e sugjerojnë të kundërtën. Sipas dëshmitarit I. M.1, pas i dorëzuan burrat të të “kaltrit”, të “gjelbërit” nuk u largon nga ajo zonë, por qëndruan në afërsi²⁷⁰. Dëshmitari po ashtu specifikisht iu referua të gjithë “*personave të uniformuar, policisë dhe ushtarëve*”²⁷¹ të pika e kontrollit.
219. Është e arsyeshme të konkludohet se edhe “të gjelbrit” dhe “të kaltrit” ishin përreth dhe, në mes të tërë tollovisë dhe trazirës, dëshmitarë të ndryshëm kanë mundur të vërejnë burra të ndryshëm të uniformuar, posaçërisht pasi që këta të fundit ishin më shumë në numër. Si ilustrim i kësaj është fakti se dëshmitari Xh. S. deklaroi se nuk ishte i sigurt nëse ishin dërguar në rrugën Miladin Popović nga personat e njëjtë që i kishin marrë në pyetje ata të muri, “*sepse ajo rrugë ishte përplot pjesëtarë të ushtrisë së parregullt*”²⁷².
220. Dëshmitarja F. P. përshkroi se si, përderisa njerëzit po dëboheshin, policia si dhe paramilitarët e maskuar ishin jashtë, duke i përbuzur ata. Dëshmia e saj në këtë drejtim është shumë ilustruese: “*Ne aty filluam të qajmë pasi që e dinim se ishte luftë dhe lufta nuk kthen por vetëm merr. Policia e morri foshnjën dymuajshe nga vëllai im gjersa ai e mbante në dorë dhe vëllai im iu bashkua grupit të njerëzve të shtrirë. Natyrisht, në atë moment ne*

²⁶⁸ Disa dëshmitarë kujtojnë një uniformë tjetër në dëshmitë e tyre para Gjykatës, për dallim nga deklaratat e tyre të mëparshme.

²⁶⁹ Dallimet ndërmjet deklaratave të dëshmitarëve të ndryshëm.

²⁷⁰ I. M. 1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, paras. 414-415.

²⁷¹ I. M. 1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, para. 164.

²⁷² Xh. S., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, paras. 594-596.

filluam të qajmë me zë, të bërtasim, dhe paramilitarët që kishin vënë maska dhe ishin afër një supermarketi filluan t'i imitojnë vajtimet tona. Ata kishin maska.”²⁷³

221. Është vërtetuar se trupat e “gjelbra” dhe “të kaltra” dhe paramilitarët kishin prani të përbashkët në atë zonë.
222. Për më tepër, ata që ishin dëbuar merrnin udhëzime të ngjashme nga të gjitha grupet e forcave të armatosura. Dëshmitarët dëshmuuan se si iu ishte thënë “shkoni në Shqipëri” si nga ushtarët dhe policët ashtu edhe nga paramilitarët. Në përgjithësi, veprimet e forcave Serbe tregonin se ata kishin detyra specifike, ku disa trupa e siguronin zonën, disa i bastisnin shtëpitë dhe disa trupa merreshin me njerëzit.
223. Kur bëhet fjalë për veprimet e ndërmarra kundër grupit prej nëntë viktimave Shqiptarë të Kosovës të shënuar në Aktakuzë, u dëshmuua se grupet e ndryshme Serbe ishin qartazi të bashkërenduara. Secili grup ia dorëzonte këta njerëz grupit tjetër disa herë, ata vepronin pa hezitim, me dashje dhe duke e ditur se çfarë të bëjnë. Dëshmitari I. M.1 deklaroi se ai nuk ka mundur ta dëgjojë ndonjë shkëmbim fjalësh ndërmjet të “kaltërve” dhe të “gjelbërve” gjatë ndërveprimit të tyre²⁷⁴.
224. Po ashtu, gjatë ecjes drejt rrugës Miladin Popović, I. M.1 filloi të bisedojë me një ushtar i cili po i shoqëronte ata, në përpjekje për ta shpëtuar veten. I. M.1 dëshmon: *“ai (ushtari²⁷⁵) tha se kur ne të arrijmë në fund të rrugës ne do të kemi njerëz që do ta na identifikojnë. Kështu të gjithë ne 15 veta vazhduam rrugën tonë së bashku me ushtrinë dhe kur arritëm në fund të rrugës, aty ishin rreth katër apo pesë shkallë. Pastaj ata na kthyen majtas në rrugën Miladin Popović dhe aty ishin disa shitore të vjetra. Kur ne arritëm në fund dhe u kthym majtas aty ishte një pikë kontrolli kur kishte polic dhe paramilitarë”²⁷⁶.* Kjo na tregon se ushtari ishte i vetëdijshëm për praninë e policisë dhe paramilitarëve pas qoshes te pika e kontrollit.
225. Duke kaluar në fazën e radhës – ekzekutimin – policia/paramilitarët që qëndruan prapa në pikën e kontrollit mund ta vëzhgonin skenën e ekzekutimit nga një distancë e shkurtë

²⁷³ F. P., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 24 shkurt 2015, para. 34.

²⁷⁴ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22 janar 2015, paras. 417-418.

²⁷⁵ Theksimi i shtuar.

²⁷⁶ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, para. 248.

prej vetëm disa metrash²⁷⁷. Ata nuk shfaqën asnjë shenjë të habitës, dhe as nuk kanë shprehur ndonjë shenjë të jashtme që do të ishte e natyrshme për të shprehur tronditje apo befasi.

226. Fakti se ekzekutimi është ndaluar nga një i “gjelbër” nuk është në kundërtënie me bashkërendimin e tyre. Kjo vetëm tregon faktin se trupat në terren (apo së paku të “kaltrit”) mund ta kenë tejkaluar urdhrin fillestar të përbashkët apo se metodat e zbatuara për dëbimin e Shqiptarëve të Kosovës nuk ishin aprovuar nga disa eprorë. Në fakt, kjo ndërhyrje nuk erdhi si befasi për policët/paramilitarët. Ata nuk u përpoqën që ta vënë në mëdyshje urdhrin për ndërprerje, apo për ta qartësuar, por për të negociuar. Sikurse u tregua me përshkrimin e Sh. K.1: *“një person bërtiti me zë të lartë, ai urdhëroi ndërprerjen e vrasjeve, polici që ishte pranë meje tha ‘vetëm edhe këtë’ dhe personi tjetër tha ‘as një më shumë’.*²⁷⁸” Duke parë se ushtari iu ndaloi atyre të vazhdojnë me ekzekutimin, policët/paramilitarët vazhduan me ngacmimet e tyre të mëparshme ndaj Shqiptarëve të Kosovës duke iu thënë që të “shkojnë në Shqipëri”. Fakti se “shpëtimtari” i shoqëroi ata me Pinzgauer drejt stacionit të autobusëve demonstroi se ai ende ishte i brengosur se forcat tjera të armatosura mund ta tejkalonin urdhrin fillestar.
227. Megjithatë, për të konkluduar, trupi gjykues e konsideron sjelljen e përgjithshme të trupave siç u përshkrua më lartë si dëshmi e qartë se, pavarësisht faktit se hollësitë e planit nuk ishin specifikuar apo respektuar, ushtria, policia dhe forcat e parregullta Serbe vepruan në bazë të planit të përbashkët dhe me qëllimin e përbashkët të zhvendosjes së Shqiptarëve të Kosovës nga ai rajon. Veprimi i tyre i bashkërenduar shihet qartë nga këto dëshmi.

(e) Analiza e kushteve të konfliktit të armatosur, statusi civil i popullatës së vënë në shënjestër dhe lidhja me konfliktin e armatosur.

Konflikti i brendshëm:

²⁷⁷ Shih raportin dhe skicën e vizitës në terren të kryer më 21 shtator 2015, të hartuar nga Njësia Forenzikës, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë të datës 21 shtator 2015 dhe e paraqitur në Gjykatë më 28 shtator 2015.

²⁷⁸ Sh. K.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 shkurt 2015, para. 228.

228. Faktet në Aktakuzë ndodhën pak kohë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s.
229. Për ta vlerësuar ekzistimin e një konflikti të armatosur të një natyre jo-ndërkombëtare, trupi gjykues iu ka përmbajtur përkufizimit funksional të dhënë nga jurisprudenca e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë (TPNJ) në rastin *Tadić*²⁷⁹:
230. “Një konflikt i armatosur ekziston kurdo që ka rrekte forcave të armatosura ndërmjet Shteteve apo ka dhunë të zgjatur të armatosur ndërmjet autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura, apo ndërmjet grupeve të tilla përbrenda një Shteti”.
231. Ky test është zbatuar në mënyrë sistematike në jurisprudencën pasuese²⁸⁰.
232. Jurisprudenca e TPNJ-së i referohet dy kritereve thelbësore të konfliktit të armatosur të zgjatur: organizimit të palëve dhe intenzitetit të dhunës.
233. Konsiderohet se forcat e rregullta apo të kontrolluara nga shteti – në këtë rast forcat e armatosura të RFJ-së dhe Serbisë- i plotësojnë këto kritere. Sa i përket grupeve të forcave të armatosura jo-shtetërore sikurse UÇK-ja, ato nuk duhet domosdoshmërisht të jenë të organizuara sikurse forcat e armatosura të një Shteti, por është e mjaftueshme që ato të kenë “një nivel të organizimit”²⁸¹. Lidershipi i grupit duhet që, minimalisht, të ketë mundësinë të ushtrojë njëllë kontrolli mbi pjesëtarët e saj me qëllim që obligimet

²⁷⁹ Vendimi i Juridiksionit Tadić, para. 70,

²⁸⁰ Prokurori kundër Delalić, Mucić, Delić dhe Landžo, Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, 16 nëntor 1998, Lënda TPNJ nr. IT-96-21-T, para. 183; Prokurori kundër Furundžija, Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, 10 dhjetor 1998, Lënda TPNJ nr. IT-95-17/1, para. 59; Prokurori kundër Kordić dhe Čerkez, Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, 26 shkurt 2001, Lënda TPNJ nr. IT-95-14/2-T, para. 24; Prokurori kundër Kordić dhe Čerkez, Aktgjykim i Dhomës së Apelit, 17 dhjetor 2004, Lënda TPNJ nr. IT-95-14/2-T, para. 336; Prokurori v. Kunarac, Kovač dhe Vuković, Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, 22 shkurt 2001, Lënda TPNJ nr. IT-96-23, para. 402; Prokurori kundër Kunarac, Kovač dhe Vuković, Aktgjykim i Dhomës së Apelit, 12 qershor 2002, Lënda TPNJ nr. IT-96-23, para. 56; Prokurori kundër Naletilić dhe Martinović, Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, 31 mars 2003, Lënda TPNJ nr. IT-98-34-T, para. 177; Prokurori kundër Stakić, Lënda nr. IT-97-24-T, Aktgjykimi, Dhoma Gjyqësore II, 31 korrik 2003, para. 568; Prokurori kundër Slobodan Milošević, Vendimi i tretë i Dhomës Gjyqësore mbi Propozimin për Aktgjykimin Lirues (Vendimi Milošević Rregulli 98bis), Lënda TPNJ nr. IT-02-54-T, 16 qershor 2004, para. 16; Prokurori kundër Blagojević dhe Jokić, Lënda nr. IT-02-60-T, Aktgjykimi, Dhoma Gjyqësore, 17 janar 2005, para. 536; Prokurori kundër Strugar, Lënda nr. IT-01-42-T, Aktgjykimi, Dhoma Gjyqësore II, 31 janar 2005, para. 215; Prokurori kundër Limaj, Bala, dhe Musliu, Lënda nr. IT-03-66-T, Aktgjykimi, 30 nëntor 2005, para. 84; Prokurori kundër Orić, Aktgjykimi, Aktgjykimi i Lëndës nr. IT-03-68-T, Dhoma Gjyqësore II, 30 qershor 2006, para. 254; Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj, Aktgjykimi, Lënda nr. IT-04-8bis-T, Dhoma Gjyqësore II, 29 nëntor 2012, para. 393.

²⁸¹ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore Boškoski, paras 196-198; Aktgjykimi i Gjykimit Limaj, para. 89; Aktgjykimi i Gjykimit Orić, para. 254; Aktgjykimi i Gjykimit Đorđević, para. 1525; Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj, Aktgjykimi, Lënda nr. IT-04-8bis-T, Dhoma Gjyqësore II, 29 nëntor 2012, para. 393.

themelore të Nenit 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës të mund të zbatohet²⁸². Këto janë elemente faktike që duhet të përcaktohen në baza rast pas rasti²⁸³. Elementet në vijim duket të jenë vendimtare: ekzistenca e një strukture komanduese, autoriteti për të nisur operacione që sjellin bashkë njësi të ndryshme, aftësia për të rekrutuar dhe trajnuar luftëtarë të rinj ose ekzistimi i rregullave të brendshme.

234. Trupi gjykues merr parasysh gjetjet e TPNJ-së në lëndën e prokurorit kundër Limajt: “Dhoma konsideron se para fundit të majti 1998, ka ekzistuar një konflikt i armatosur në Kosovë në mes të forcave Serbe dhe UÇK-së. Në atë kohë UÇK-ja kishte një Shtab të Përgjithshëm, i cili emëroi komandantët e zonave, dha urdhra për njësitë e ndryshme të formuara ose në proces të formimit, dhe lëshoi deklarata publike në emër të organizatës. Komandantët e njësive dhanë urdhra luftarak dhe njësitë vartëse dhe ushtarët në përgjithësi vepruan në pajtim me këta urdhra²⁸⁴”.
235. Jurisprudenca në Kosovë ka treguar një qasje të ngjashme. Vendimi i Gjykatës Supreme i datës 21 korrik 2005 në lëndën *L. G. et al.*, gjithashtu konstatoi se në mes të gushtit 1998 dhe mesit të qershorit 1999, struktura organizative e UÇK-së përmbushi kërkesat sipas nenit të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës dhe Protokolli Shtesë II²⁸⁵.
236. Ky aspekt është konfirmuar edhe gjatë procedurës aktuale. Dëshmitari B. R.2 po jetonte në Mitrovicë në atë kohë, por ka deklaruar se nuk ishte andej pari gjatë ngjarjeve, si në vitin 1999 dhe deri në fund të konfliktit, ai ndodhej në male. Ai ishte kirurg në UÇK dhe ishte i vendosur në male. Ai foli për zonat operative dhe brigadat e UÇK-së. Ai ishte “përgjegjës për çështje të shëndetit” mbi zonën operative të Shalës e cila kishte dy

²⁸² Aktgjykimi i gjykimit Gjorgjeviq, paragrafi 1525; Aktgjykimi i gjykimit Boshkoski, paragrafi 196, që citon Komentarin e KNKK-së për Konventën e Gjenevës II, f. 34 (duke vëzhguar nëse një grup jo shtetëror nuk zbaton nenin e përbashkët 3, “do të dëshmojë se ato grupe që i konsiderojnë veprimet e veta si akte të thjeshta të anarkisë apo banditësh kanë të drejtë”). Shih gjithashtu KNKK, “E drejta Ndërkombëtare Humanitare dhe Sfidat e Konflikteve Bashkëkohore të Armatosura”, Raporti i përgatitur nga Komisioni Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Konferenca e 28 Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Gjenevë, 2 deri 6 dhjetor 2003, në f. 19 (lidhur me “forcat e armatosura apo grupe të armatosura me një nivel të caktuar të organizimit, strukturën e komandës, dhe, prandaj, aftësia për të zbatuar të drejtën humanitare ndërkombëtare”); Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj, Aktgjykimi, Lënda nr. IT-04-8bis-T, Dhoma gjyqësore II, 29 nëntor 2012, paragrafi 393

²⁸³ Aktgjykimi i gjykimit Gjoregjeviq, paragrafi 1522; Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj, Aktgjykimi, Lënda nr. IT-04-8bis-T, Dhoma gjyqësore II, 29 nëntor 2012, paragrafi 393.

²⁸⁴ Prokurori kundër Limaj, Bala dhe Musliu, Lënda nr. IT-03-66-T, Aktgjykimi, 30 nëntor 2005, paragrafi 171.

²⁸⁵ Vendimi i Gjykatës Supreme në lëndën *Latif Gashi et al.* 21 korrik 2005, faqe 10, versioni në gjuhën angleze.

brigada, brigadën 141, e cila kryesisht ishte e vendosur në Shalë të Bajgores dhe brigadën 142, e cila mbulonte Vaganicën, Oshlanin dhe vende të tjera. Ai po ashtu përmend ekzistimin e brigadave tjera, si Drenica, ku ai kreu disa intervenime kirurgjike²⁸⁶. Kjo konfirmon edhe njëherë nivelin e lartë të organizimit të UÇK-së.

237. Kur është fjala për intensitetin e përlshjeve të armatosura në atë kohë kritike, rreth së cilës është bërë vlerësim nga trupi gjykues me vëmendje të shtuar rreth: angazhimit të trupave qeveritare, shkatërrimit të pronës, zhvendosjes së popullatës lokale, të cilat janë dëshmuar në shqyrtim gjyqësor, gjithashtu edhe ekzistencës së viktimave, gjë që është një fakt i njohur. Trupi gjykues ka ndjekur një koncept të zbatuar nga TPNJ në lëndën *Prokurori kundër Milosheviqit*²⁸⁷. Në lëndën në fjalë, dëshmitarët e dëgjuar për Pikën 1 të aktakuzës unanimisht treguan se si e gjithë lagjja në Mitrovicë ishte dëbuar. Të gjitha familjet ishin urdhëruar të ecnin drejt Shqipërisë në kolona, pavarësisht moshës së tyre. Duke filluar nga foshnjat dhe duke përfunduar me të vjetrit dhe të sëmurët, të gjitha zonat e Mitrovicës janë dëbuar. Anëtarët e familjes që ishin shumë të sëmurë për të ecur apo ishin të hendikepuar, thjesht janë bartur me karrocë dore²⁸⁸. Vetë dëshmitarët ishin pjesë e kësaj kolone.
238. Dëshmitari B. F. gjithashtu e përmend se në ditën kritike, derisa ai po ecte drejt stacionit të autobusëve, shtëpitë gjatë rrugës po digjeshin²⁸⁹.
239. Gjatë periudhës së njëjtë, shqiptarët ishin dëbuar gjithashtu edhe nga zonat e tjera të Kosovës. Dëshmitarët Z. A. dhe N. A.3 e kishin shtëpinë e tyre të djegur në Gjakovë dhe duhej të largoheshin nga shtëpia dhe të shkonin në Mal të Zi²⁹⁰. Ata janë larguar me autobus përmes Rashkës dhe gjatë rrugës ata kaluan kah Mitrovica dhe aty vërejtën një kolonë të gjatë të njerëzve që largoheshin nga qyteti në këmbë dhe po drejtoheshin drejt Pejës²⁹¹. E rëndësishme rreth nivelit të shkatërrimit të territorit të Mitrovicës,

²⁸⁶ B. R.2, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 mars 2015, paragrafët 9-13.

²⁸⁷ Prokurori kundër Slobodan Milosheviqit, Lënda nr. IT-02-54-T, Rregulli 98 i vendimit, 16 qershor 2004, paragrafët 26-32.

²⁸⁸ Z. A., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, paragrafi 325.

²⁸⁹ B. F., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20 shkurt 2015, paragrafi 137.

²⁹⁰ Z. A., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, paragrafi 21-27.

²⁹¹ Z. A., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, paragrafi 325.

dëshmitari Z. A. iu referua si “dita kur është djegur Mitrovica”²⁹². Kjo ndodhi disa ditë pasi filloi sulmi ajror i NATO-s, që do të thotë, disa ditë pas Bajramit²⁹³.

240. Në fund, duhet të theksohet se dispozitat e nenit të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës, zbatohen edhe jashtë vendit ekzistues të operacioneve luftarake, që nënkupton në tërë territorin nën kontrollin e një pale luftuese pavarësisht nëse ndodh apo jo luftimi atje.
241. Kjo është në përputhje me jurisprudencën e tanishme në Kosovë. Gjykata Supreme ka vërtetur ekzistencën e konfliktit të armatosur mes Jugosllavisë dhe forcave serbe dhe UÇK-së gjatë luftës së Kosovës, në lëndën *K*, Vendimi i datës 5 gusht 2004,²⁹⁴ dhe i vërtetuar me vendimin e Gjykatës Supreme të datës 21 korrik 2005 në lëndën *L. G. et al*²⁹⁵.
242. Më 24 mars 1999, NATO nisi operacionet ushtarake kundër forcave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë. Ky operacion nuk rezultoi menjëherë me ndërprerje të konfliktit të brendshëm në Kosovë, por çoi në përkeqësimin e tij në periudhën në fjalë në aktakuzë.
243. Konflikti i armatosur jo-ndërkombëtarë përfundon atëherë kur të arrihet një zgjidhje paqësore²⁹⁶. Më 09 qershor 1999, Marrëveshja e Kumanovës (Marrëveshje Teknike Ushtarake në mes të Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë ["KFOR"] dhe Qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë) është nënshkruar dhe kjo ka shënuar një moment kur forcat e ushtrisë jugosllave dhe serbe filluan tërheqjen e tyre nga Kosova. Kjo marrëveshje parashikonte tërheqjen në faza, të forcave të armatosura nga Kosova brenda 11 ditëve pas nënshkrimit të marrëveshjes. Tërheqja ka përfunduar më 21 qershor 1999, kur trupat e fundit të Jugosllavisë dhe Serbisë u larguan nga territori i Kosovës.

²⁹² Z. A., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, paragrafët 127-139; dëshmitari nuk është i sigurt kur është në pyetje data e saktë.

²⁹³ Bajrami në atë vit ishte më 28 mars 1999; shih procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 25 shkurt 2015, paragrafi 536.

²⁹⁴ Vendimi i Gjykatës Supreme në lëndën *K*. AP-KZ 230/2003, 21 korrik 2005.

²⁹⁵ Vendimi i Gjykatës Supreme në lëndën *L. G. al*, 21 korrik 2005, f. 10 - 11, versioni në gjuhën angleze.

²⁹⁶ Vendimi Tadiq për Juridiksion, paragrafi 70; Kunarac Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 57; Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj, Aktgjykimi, Lënda nr. IT-04-8bis-T, Dhoma Gjyqësore II, 29 nëntor 2012, paragrafi 396.

244. Prandaj, trupi gjykues arriti në përfundim se në rajonin e Mitrovicës kishte një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtarë brenda kuptimit të nenit të përbashkët 3, në kohën e veprimeve me të cilat ngarkohet i akuzuari.
245. Ekzistimi i konfliktit të tillë nuk është kundërshtuar nga avokati mbrojtës.

Lidhja me konfliktin e armatosur

246. Trupi gjykues ka ndjekur konceptin e vëzhguar nga TPNJ lidhur me nevojën e një lidhjeje në mes të veprimit të të akuzuarit dhe konfliktit me qëllim të klasifikimit të veprimit si krim lufte.
247. Në lëndën Tadiq, TPNJ ka shprehur mendimin se:

*“Duhet të ketë një lidhje të dukshme në mes të veprës penale dhe konfliktit të armatosur [. . .] është e mjaftueshme se krimet e pretenduara ishin të lidhura ngushtë me armiqësitë që ndodhnin në pjesë tjera të territorit të kontrolluar nga palët në konflikt.”*²⁹⁷

248. Në të njëjtën lëndë, TPNJ theksoi faktin se një krim lufte mund të kryhet edhe nëse përleshjet thelbësore nuk ishin duke ndodhur në rajon në kohën dhe vendin kur gjoja janë kryer krimet.”²⁹⁸
249. Një shpjegim më i detajuar në këtë çështje është paraqitur nga Dhoma e Apelit të TPNJ-së në lëndën Kunarac:

“Ajo që në fund të fundit e dallon një krim lufte nga një vepër e thjesht dhune është që një krim lufte është i formuar nga ose varet nga mjedisi – konflikti i armatosur – në të cilin është kryer. Ai nuk duhet të jetë planifikuar apo mbështetur nga ndonjë formë e planit ose politikës. Konflikti i armatosur nuk duhet të jetë shkaktar për kryerjen e krimin, por ekzistimi i një konflikti të armatosur duhet, të paktën, të ketë luajtur një rol të rëndësishëm në aftësinë e kryerësit për ta kryer, në vendimin e tij për ta kryer atë, në mënyrën në të cilën

²⁹⁷Prokurori kundër Tadiq, Lënda nr. IT-94-1, Vendimi për Propozimin e Mbrojtjes për Ankesën interlokutore për Juridiksion, 2 tetor 1995, paragrafi 70.

²⁹⁸Ibidem.

është kryer, apo qëllimin për të cilin është kryer. Prandaj, në qoftë se mund të vërtetohet, si në lëndën aktuale, që kryerësi ka vepruar në mbështetje të ose nën maskën e konfliktit të armatosur, do të ishte e mjaftueshme për të vërtetuar se veprimet e tij ishin të lidhura ngushtë me konfliktin e armatosur”²⁹⁹.

250. Trupi gjykues vlerësoi se veprimet objekt i aktakuzës janë të ndërlidhura në mënyrë eksplicite me konfliktin e armatosur në proces:
251. Të gjithë kryerësit ishin anëtarë të grupeve të armatosura serbe, të rregullta dhe jo të rregullta, përfshirë ato shtetërore të zbatimit të ligjit, që morën pozicionin e një armiku dhe përndjekës i popullsisë shqiptare. Prandaj, civilët shqiptarë ishin të privuar nga çdo formë e mbrojtjes ligjore kundër forcave qeveritare që u kthyen kundër tyre. Keqbërësit konsideroheshin përkohësisht të pafajshëm.
252. Disa nga shqiptarët e dëbuar rrëfyan se si forcat serbe i kanë sharë ata lidhur me intervenimin e NATO-s. Dëshmitari M. M.1 rrëfeu se si ndërsa po e dëbonin, ata i thanë fjalët në vijim: *“ne ju dhamë gjithçka dhe ju nuk e deshët, tash NATO po ju ndihmon juve e ne e kemi Rusinë”³⁰⁰*. Dëshmitari B. F. dëshmoi të njëjtat fjalë. Ndërsa po i mbanin 15 burra mbështetur për muri, policia serbe ju tha: *“Pse po e kërkon NATO-në?! Tash kërkon ndihmë prej NATO-s”* dhe *“Ne do të kujdesemi për juve”³⁰¹*.
253. Për më tepër, 15 burrat janë mbajtur të mbështetur për muri dhe janë marrë në pyetje rreth lidhjes së tyre me UÇK-në³⁰².
254. Trupi gjykues konsideron se ekziston lidhja e nevojshme.

²⁹⁹ Prokurori kundër Kunarac, Kovac dhe Vukovic, Aktgjykimi i Apelit, 12 qershor 2002, paragrafët 58 dhe 59.

³⁰⁰ M. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 23 shkurt 2015, paragrafi 52.

³⁰¹ B. F., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20 shkurt 2015, paragrafi 123.

³⁰² I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, paragrafi 213; Sh. K.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 shkurt 2015, paragrafi 86; L. A.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 mars 2015, paragrafi 94 dhe 190.

Statusi civil i viktimave:

255. Pasi që neni i përbashkët 3 i Konventës së Gjenevës mbron personat që nuk marrin pjesë aktive në vepra armiqësore, duhet të vërtetohet se viktimat e shkeljes së pretenduar nuk kanë marr pjesë aktive në vepra armiqësore në kohën kur është kryer krimi³⁰³.
256. Edhe nëse janë bërë dallime se si gratë, fëmijët dhe të vjetërit janë trajtuar në raport me të tjerët, ende, veprimet e forcave serbe janë ndërmarr kundër të gjitha grupeve.
257. Të gjithë shqiptarët etnik të cilët janë dëbuar atë ditë, janë nxjerr nga shtëpitë e tyre. Familje të tëra, përfshirë fëmijët, të vjetrit dhe të sëmurët janë dëbuar. Ata nuk bënë asnjë rezistencë dhe menjëherë dolën në rrugë siç janë urdhëruar, disa nga ta kishin veshur vetëm shoshone. Nuk ka asnjë provë se ndokush prej tyre ishte me uniformë apo të armatosur në ndonjë mënyrë.
258. Në fakt, duket se vetë ushtarët pritën të gjenin civilë dhe jo luftëtarë. Ata vepruan në përbërje, me vetëbesim dhe nuk përdorën mjete të rënda sulmuese. Dëshmitari I. M.1 tregoi se si ushtarët që e dëbuan nga shtëpia “u sollën mirë”³⁰⁴. Dëshmitari B. S.1 gjithashtu e përmendi sjelljen e mirë të trupave³⁰⁵. Dëshmia e F. P., në veçanti e thotë atë. Ajo kujtoi se si “*dy nga njësia speciale shkuan tutje tek ca shkallë dhe filluan të qanin. Ata thanë ‘nuk është e lehtë për ne’*”³⁰⁶. Fakti që trupat që cilët dëbuan shqiptarët etnik nuk kanë shfaqur asnjë sjellje agresive ndaj tyre, tregon se ata nuk pritën ndonjë rezistencë të veçantë apo konfrontim. Përveç kësaj, fakti se disa prej trupave ka vepruar duke u shfajësuar, tregon se ata e dinin që po i drejtonin veprimet e tyre kundër civilëve.
259. Disa prej tyre janë marrë në pyetje rreth lidhjes së tyre me UÇK-në. I. M.1 pohon se asnjë nga burrat nuk ishin në UÇK³⁰⁷. Nuk ka asnjë sugjerim në prova për të kundërtën. Asnjë prej tyre nuk kishte veshur ndonjë uniformë dhe as nuk ishin të armatosur. Rrobat e viktimave janë përshkruar nga gjyqtari hetues i cili i ka mbledhur trupat si civil³⁰⁸.

³⁰³ Aktgjykimi i gjykimit *Kvoqka*, paragrafi 124; Aktgjykimi i gjykimit *Blagojeviq*, paragrafi 540.

³⁰⁴ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, paragrafi 186.

³⁰⁵ B. S.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 11 mars 2015, paragrafi 386.

³⁰⁶ F. P., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 24 shkurt 2015, paragrafi 34.

³⁰⁷ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, paragrafët 232-235.

³⁰⁸ Inspektimi i vendit të krimit nga B. M., i datës 15/04/1999. f. 745-753.

260. Për më tepër, edhe nëse ka pasur luftëtarë të UÇK-së apo përkrahës në mesin e popullatës civile- gjë që nuk është provuar fare – kjo nuk do ta kishte ndryshuar faktin se sulmi ishte ndaj një popullate civile.
261. Për më tepër, nuk ka asnjë provë që sugjeron se forcat serbe bënë përpjekje reale dhe efektive për të bërë dallimin në mes të anëtarëve të UÇK-së dhe pjesës tjetër të shqiptarëve të Kosovës. Pyetjet e tyre fillestare rreth ndonjë lidhjeje me UÇK-në dëshmuar që janë të pambështetura me veprime reale që do të çonin në identifikimin e pjesëtarëve të dyshuar të UÇK-së. Trupi gjykues rikujton njërin që tregonte shembullin e dëshmitarit I. M.1, i cili në përpjekje për ta shpëtuar jetën e tij, është munduar t'ia shpjegoi forcave të policisë që e përcollën, se ai nuk duhet të keqtrajtohet, pasi ai kishte jetuar në atë zonë dhe se ai kishte marrëdhënie të mira fqinjësore me serbët³⁰⁹. Argumenti i tij nuk e nxiti policin për të shqyrtuar më shumë për atë. E as nuk pat ndonjë efekt në frenimin e policisë në dërgimin e tyre tek vendi i ekzekutimit, aty ku forcat e armatosura vazhduan me vrasjen e katër shqiptarëve të Kosovës.
262. Këto veprime specifike nga forcat serbe tregojnë se qëllimi i tyre nuk ishte arrestimi, marrja në pyetje apo vrasja e vetëm pjesëtarëve dhe mbështetësve të UÇK-së.
263. Në kryerjen e krimeve të përmendura më lartë, forcat serbe vepruan pa dallime. Ata i drejtuan sulmet e tyre kundër tërë popullatës shqiptare të Kosovës, të bazuar në mënyrë specifike në përkatësinë e tyre etnike. Asnjë dallim dhe as tentim për dallim nuk është bërë, në mes të civilëve dhe luftëtarëve. Popullata civile nuk ka qenë e rastësishme por objektivi kryesor.
264. Në fund të fundit, i gjithë operacioni ishte motivuar nga fakti i thjeshtë se viktimat ishin shqiptarë etnik. Të gjitha familjeve që u dëbuan iu kërkua të shkonin në Shqipëri. Ato u trajtuan me fyerje lidhur me përkatësinë e tyre etnike, si: *“të qimët e nanës, këta Shiptart³¹⁰, krejt nanat e tyre duhet të qihen dhe krejt janë pjesëtarë të UÇK-së”³¹¹*. B. F. gjithashtu rrëfen se si *“ata u fyen në aspekt kombëtarë”³¹²*.

³⁰⁹ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, paragrafi 248.

³¹⁰ Një fjalë ofenduese për shqiptarët etnik.

³¹¹ I. M.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21 janar 2015, paragrafi 223; B. F., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20 shkurt 2015, paragrafi 123.

³¹² B. F., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20 shkurt 2015, paragrafi 123.

265. Dëshmitari I. M.1 është pyetur në mënyrë të përsëritur, për shkak të lëkurës së tij të errtë, në qoftë se ai i përkiste minoritetit rom³¹³. Kur I. M.1 mohoi dhe u përgjigj se ai ishte Shqiptar, burri serb me uniformë, sipas Sh. K.1, u përgjigj *“mund ta fajësosh vetën për këtë –që nënkupton- pse nuk po thua që je rom dhe do të jesh i lirë”*³¹⁴.
266. Trupi gjykues konstaton se viktimat nuk po merrnin pjesë aktive në veprime armiqësore në kohën kur është kryer krimi.

II. A. 2. LIGJI

267. Neni 3.1 i KPK-së, i cili është aktualisht në fuqi, përcakton se ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të zbatohet për veprën penale. Më 14 prill 1999, ligji në fuqi ishte Kodi Penal i Republikës Federale të Jugosllavisë (KP i RFJ-së).
268. Sipas nenit 142 të KP RFJ-së:

“Kushdo që në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur apo pushtimit, urdhëron...që të vrahët popullata civile [...], ose i cili kryen një nga veprat e mësipërme, do të dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet dhe deri në 40 vjet”.

269. Në mënyrë që të ekzistojë përgjegjësia penale sipas nenit 142 të KP të RFJ-së, duhet të dëshmohen këto³¹⁵:

1. Sjellja përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e kryerjes;
2. Vepra duhet të kryhet gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo pushtimit;
3. Duhet të ketë një lidhje në mes të veprës së kryerësit dhe luftës, konfliktit të armatosur apo pushtimit;
4. Kryerësi duhet të urdhërojë ose të kryejë veprën në fjalë.

³¹³ B. F., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20 shkurt 2015, paragrafi 117.

³¹⁴ Sh. K.1, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 18 shkurt 2015, paragrafi 98.

³¹⁵ Vendimi i Gjykatës Supreme në lëndën *L. G. et al.*, 21 korrik 2005.; edhe nëse Vendimi i referohet KP të SRFJ-së, dispozitat e KP të RSFJ-së, janë të njëjta kur janë në pyetje elementet e krimit

270. Tri kërkesat e para njihen si elemente *chapeau*, ndërsa e katërta ka të bëjë me kryerjen e veprës penale të ndërlidhur. Çdo element do të analizohet me rend më poshtë.

1. Neni 142 i KP të RFJ-së kërkon që vepra e kryer nga kryerësi përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e kryerjes.

271. Komenti i këtij neni përkufizon të drejtën ndërkombëtare si “[P]arimet dhe dispozitat e të drejtës ndërkombëtare që ndalojnë sjellje të caktuara dhe që i përcakton ato si vepra penale, kryerësit e të cilave duhet të mbajnë përgjegjësinë penale dhe të dënohen në përputhje me to.”³¹⁶

272. E drejta ndërkombëtare penale është e përcaktuar si një “[G]rup i rregullave ligjore të përcaktuara nga traktatet ndërkombëtare dhe marrëveshjet tjera, si dhe nga zakonet ndërkombëtare, shkelja e të cilave paraqet një vepër penale dhe rezulton në përgjegjësi individuale penale dhe zbatim të sanksioneve penale.”³¹⁷

273. Konventat e Gjenevës të vitit 1949 janë ratifikuar nga Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë në vitin 1950 dhe Konventa e katërt e Gjenevës e vitit 1949 lidhur me Mbrojtjen e Popullatës Civile në Kohën e Luftës hyri në fuqi më 21 tetor 1950. Protokollat e Konventave të Gjenevës janë ratifikuar në vitin 1979 dhe Protokollin Shtesë II i Konventave të Gjenevës hyri në fuqi 7 dhjetor 1978. Për më tepër, Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës është pranuar gjerë si pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe prandaj është detyrues edhe për shtetet jo-nënshkruese.³¹⁸

274. Pasi që lufta në Kosovë është karakterizuar si një konflikt i brendshëm i armatosur³¹⁹, Neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollin Shtesë II janë normat e së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në lëndën në fjalë. Neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës dhe Protokollin Shtesë II (PSH II) paraqet ligjin përkatës ndërkombëtarë të cilit i referohet neni 142 i KP të RFJ-së³²⁰.

275. Neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës përcakton si në vijim:

³¹⁶ Ljubiša Lazarević, Komentari i Kodit Penal të RFJ-së v.1995, edicioni i 5-të; Savremena Administracija; Beograd.

³¹⁷ Ibidem.

³¹⁸ Shih Aktgjykimin *Kunarac*, para. 406

³¹⁹ Shih arsyetimin në paragrafet 228-245 më lartë.

³²⁰ Vendimi i Gjykatës Supreme në lëndën *Latif Gashi et al.*, 21 korrik 2005 .

“Ne rastet e një konflikti të armatosur me karakter ndërkombëtar në një territor në të cilin një nga palët në konflikt ka përqendrimin me të madh, të gjitha palët në konflikt janë të detyruara të aplikojnë, si minimum, pikat e mëposhtme:

Personat të cilët nuk marrin pjesë aktive në këto ndodhi, duke përfshirë edhe anëtarë të forcave të armatosura të cilët kanë ulur armët dhe ata të cilët janë në gjendje të papërshtatshme luftimi për shkak sëmundjesh, plagësh, burgimi, dhe ndonjë shkak tjetër, do të trajtohen në të gjitha rrethanat në mënyrë humane, pa ndonjë dallim për shkak të racës, ngjyrës, fesë ose besimit, seksit ose pasurisë ose ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm.

Për këtë qëllim, veprimet e mëposhtme janë dhe do të mbeten, në çdo kohë, vend dhe rrethanë lidhur me personat e mësipërm, të ndaluara:

Dhunim të jetës dhe personit, në veçanti vrasje, prerje, keqtrajtim, dhe tortura;

[...].”

276. Neni 4 § 2(a) i Protokollit Shtesë II në lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jo-ndërkombëtare, i datës 8 qershor 1977 e zgjeron mbrojtjen e të gjithë personave të prekur nga konflikti i armatosur:

“ (1) Të gjithë personat të cilët nuk marrin pjesë drejtpërdrejt ose që kanë ndërprerë pjesëmarrjen në konflikte ushtarake, pavarësisht nëse liria e tyre është kufizuar apo jo, kanë të drejtën e respektimit të personit, nderit dhe bindjeve dhe praktikave të tyre fetare. Në çdo rrethanë ata do të trajtohen sipas kushteve njerëzore, pa dallime diskriminuese. Ndalohet të urdhërohet që nuk do të ketë të mbijetuar.

(2) Pa cenuar përgjithësimin e sa më lart, veprat e mëposhtme kundër personave të përmendur në paragrafin I janë dhe do të mbeten të ndaluara në çdo lloj kohe dhe vendi:

(a) dhuna ndaj jetës, shëndetit, dhe mirëqenies fizike ose mendore të personave, veçanërisht vrasjet si dhe trajtimi çnjerëzor, si për shembull tortura, gjymtimi ose çdo formë e dënimit fizik;

[...].”

277. Kërkesat e përgjithshme për të dyja, zbatimin e nenit të përbashkët 3 dhe veprave specifike që parashihen sipas nenit të përbashkët 3 janë theksuar, *inter alia*, nga dhoma gjyqësore e TPNJ-së në aktgjykimin Kunarac, si më poshtë:³²¹

(i) Shkelja duhet të përbëjë një shkelje të një rregulli të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

(ii) Rregulli duhet të jetë zakonor për nga natyra apo, nëse i takon ligjit të traktatit, kushtet e kërkuara duhet të plotësohen.

(iii) Shkelja duhet të jetë "serioze", që do të thotë, duhet të përbëjë shkelje të një rregulli që mbron vlera të rëndësishme, dhe shkelja duhet të përfshijë pasoja të rëndë për viktimën.

(iv) Shkelja e rregullit duhet të sjellë, sipas të drejtës zakonore ose konvencionale, përgjegjësi individuale penale personit që e shkel rregullin.

(v) Duhet të ketë një lidhje të ngushtë midis shkeljeve dhe konfliktit të armatosur.

(vi) Shkeljet duhet të jenë kryer kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në vepra armiqësore.

278. Nuk mund të ketë asnjë dyshim se vrasja, si vepër e akuzuar në lëndën në fjalë, paraqet një vepër të rëndë.

279. Parakushtet tjera janë plotësuar gjithashtu siç është detajuar më parë në këtë aktgjykim.

280. Prandaj, kushti i parë – që sjellja përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e kryerjes – është përmbushur.

281. Kushti i dytë dhe i tretë– ekzistimi i një konflikti të armatosur dhe *lidhja* – gjithashtu ekzistojnë, siç është shtjelluar në pjesën e arsytimit lidhur me gjendjen faktike.

4. Kryerësi duhet të urdhërojë apo të kryejë veprën në fjalë.

282. Përveç elementeve *chapeau* të përshkruara më sipër, duhet të vërtetohet se i pandehuri ka urdhëruar apo ka kryer veprën penale në fjalë, pra vrasjen në lëndën në fjalë. Elementet objektive të nenit 142 të KP të RFJ-së në lidhje me dispozitat përkatëse të Konventës së Gjenevës konsiderohen të përmbushura.

³²¹ *Kunarac et al.*, Lënda nr. T-96-23-T & IT-96-23/1-T, Aktgjyrimi i gjykimit, 22 shkurt 2001.

283. Në lëndën në fjalë, është dëshmuar se katër viktima kanë vdekur. Vdekja e tyre është shkaktuar nga të shtënat, si pjesë e operacionit të spastrimit në të cilin ka marrë pjesë i pandehuri. Lidhur me pesë të tjerët e mbijetuar, vepra penale e vrasjes kualifikohet si tentativë. Kryerja e saj është ndërprerë nga intervenimi i elementit të tretë të jashtëm, i ashtuquajtur “shpëtimtar”.
284. Kryerja përfshinë bashkëkryerjen dhe ndihmën, të cilat janë të shtjelluara në hollësi më poshtë.
285. Neni 22 i KP të RFJ-së e përcakton bashkëkryerjen si vijon³²²: *“Në qoftë se disa persona kryejnë bashkë një veprë penale duke marrë pjesë aktive në kryerje apo në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre do të dënohet siç përshkruhet për veprën.”*
286. Komentari i Kodit Penal të RFJ-së përmban një pasqyrë të detajuar të teorive të ndryshme të bashkëkryerjes, si dhe një shtjellim në të ashtuquajturën teorinë e “zotërimit të veprës” që është e shoqëruar me formën e bashkëkryerjes siç përcaktohet në nenin 22. Pjesa më përkatëse e komentarit parashikon si më poshtë³²³:

“Sipas ligjit, bashkëkryerja është një krim i kryer bashkë, d.m.th një i kryer nga disa njerëz përmes roleve të ndryshme apo me mjete tjera. Theksi është në kryerjen e përbashkët të veprës. Kryerja e tillë e përbashkët e veprës realizohet me pjesëmarrje të përbashkët të asaj vepre ose në ndonjë mënyrë tjetër. “Mënyrë tjetër” nënkupton që një bashkëpunëtor mund të jetë po ashtu personi i cili nuk merr pjesë (drejtpërdrejt) në kryerjen e veprës. Pikërisht mbi bazën e idesë së zotërimit të veprës, këto kryerje në rrethana të ndryshme mund të jenë kryerje e veprave.

Është një supozim i përgjithshëm që bashkëveprimi është një kryerje e përbashkët e veprës me një vendim të përbashkët: të gjithë janë bartës të vendimit rreth kryerjes së veprës; të gjithë, në bashkëpunim me të tjerët, e kryejnë veprën e tij; kontributi është i tillë që në kuadër të një vendimi dhe shpërndarjes së roleve, përbën një element të rëndësishëm (pjesë) në procesin e planifikimit për të kryer një veprë të

³²² Në përkthimin në anglisht përdoret fjala “bashkëveprim,” që është çorientuese. Titulli origjinal i nenit është “saizvršilaštvo,” që shprehimisht nënkupton bashkë-kryerje.

³²³ Ljubiša Lazarević, Komentari i Kodit Penal të RFJ-së v.1995, Botimi i 5-të; Savremena Administracija; Beograd.

caktuar. Kështu, nocioni i bashkëveprimit ka komponentin e vet subjektiv dhe objektiv.”

287. Më 14 prill 1999, **O. I.** ka qenë i pranishëm te vendi kritik në një grup së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe. Shfaqja dhe sjellja e tij përjashtojnë mundësinë e të qenit një kalimtar.
288. Ai ishte i armatosur, që ruante dhe siguronte një pikë kontrolli kah e cila kaluan viktimat. Edhe në qoftë se ai nuk ishte ai që lëshonte urdhra për ekzekutimin e viktimave, ai ia kujtoi ushtarit tjetër urdhrin para se të fillonte ekzekutimi.
289. Siç është detajuar më lartë, i gjithë operacioni ishte i përbashkët dhe i koordinuar mes forcave serbe, me caktimin e detyrave të caktuara për secilin individ. Çdo detyrë ishte thelbësore për zbatimin e planit. Sjellja e të akuzuarit ka kontribuar kryesisht në rezultatin inkriminues. Performanca e **O. I.** ishte sipas funksionit e lidhur me aktivitetet e të tjerëve dhe i plotësonte ato në mënyrë të vendosur. Veprimet e tij përbënin një segment esencial në procesin e kryerjes së veprës penale. Prandaj, ai mori pjesë si bashkëkryerës në kryerjen e veprës penale.
290. Trupi gjykues thekson se nuk është e nevojshme që të gjithë bashkëkryerësit të jenë në gjykim dhe madje të jenë të njohur. Ky përfundim është në përputhje me jurisprudencën. Gjykata Supreme e Kosovës thotë në vijim në lëndën *L. G. et al. : “Është e vetëkuptueshme se mungesa e informacionit për bashkëkryerësit tjerë nuk mund të çojë në rezultatin se një person ...nuk do të ndiqet penalisht dhe/ose dënohet sipas ligjit³²⁴”*. Një qasje e ngjashme ka pasuar nga Gjykata Supreme e Kosovës në lëndën *B. K.*³²⁵.
291. Duhet të theksohet se krimet e luftës kundër popullatës civile konsiderohen si një vepër e vetme penale sipas nenit 142 të KP të RSFJ-së.
292. Lidhur me këtë, Gjykata e Apelit të Kosovës konstatoi në lëndën kundër *Z. K.*³²⁶:

“Trupi gjykues konstaton se edhe pse veprat penale të drejtuara kundër integritetit personal, si rregull përbëjnë vepra individuale

³²⁴ Vendimi i Gjykatës Supreme në lëndën *L. G. et al.*, Lënda Ap. – Kz. Nr. 89/2010, 26 janar 2011, f. 24, versioni në gjuhën angleze.

³²⁵ Vendimi i Gjykatës Supreme në lëndën *B. K.*, Lënda Ap.- Kz. Nr. 153/2008, 12 janar 2010, f. 21 - 22, versioni në gjuhën angleze.

³²⁶ Aktgjykimi i apelit i datës 25 shtator 2013, paragrafi 87.

penale, vepra penale e Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile dhe vepra tjera kundër njerëzimit dhe e së drejtës ndërkombëtare janë të dallueshme në këtë drejtim. Për shkak të natyrës së këtyre veprave penale, ato në përgjithësi do të drejtohen kundër viktimave të shumta. Kjo është, ndër të tjera, e qartë nga formulimi i vetë normës penale (Neni 142 i KP të RSFJ-së, neni 153 KPRK-së). Vepra penale është titulluar Krime Luftë kundër Popullatës Civile, dhe në normë përdoret shumësi, p.sh. “popullata civile subjekt i vrasjeve, torturës, trajtimit çnjerëzor...peng- marrjes, arrestimeve të paligjshme...”.

293. Në mënyrë të ngjashme, Komentari i nenit 142 të KP- të RFJ-së parashikon³²⁷:

“Aktivitetet inkriminuese janë futur në ligj në mënyrë alternative, ashtu që akti mund të kryhet nga secili veprim. Megjithatë, nëse një person kryen disa aktivitete identike apo disa aktivitete të ndryshme të inkriminuara në këtë nen, kjo do të jetë vetëm një vepër penale e krimit të luftës kundër popullatës civile, pasi në këtë rast, kjo rezulton nga përshkrimi ligjor i veprës penale se kjo është një vepër e vetme penale, pavarësisht nga numri i aktiviteteve të kryera individuale. Sipas vendimit të Gjykatës Supreme të Serbisë Kz-2539/56, është një vepër penale e krimit të luftës kundër popullatës civile, pavarësisht kryerjes së veprave të veçanta nga kryerësi në vende të ndryshme, kundër personave të ndryshëm, në periudha më të gjata kohore dhe në një mënyrë të tjetër.”

294. Tani trupi gjykues vlerëson nëse janë vërtetuar elementet subjektive (të ashtuquajtura *mens rea*) e të akuzuarit.

295. Në bazë të nenit 11 KP i RFJ-së, një person është penalisht përgjegjës nëse ai ose ajo është mendërisht i aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale. Në pajtim

³²⁷ Ljubiša Lazarević, Komentari I Kodit Penal të RFJ-së v. 1995, Botimi i 5^{ttë}, Savremena Administracija; Beograd.

me dispozitën e njëjtë, një person është fajtor për kryerjen e veprës penale kur ai ose ajo e kryen një vepër penale me dashje ose nga pakujdesia.

296. Së pari, nuk ka asnjë dyshim për faktin se i akuzuari ka qenë plotësisht i aftë mendërisht kur e ka kryer veprën. Asgjë në shkresat e lëndës nuk sugjeron ndryshe dhe asnjë kundërshtim i tillë nuk është ngritur nga Mbrojtja.
297. ë dyti, i akuzuari kur e ka kryer veprën ka vepruar me dashje.
298. Një vepër penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale. Personi vepron me dashje direkte kur ai ose ajo është në dijeni për veprën e tij ose të saj dhe e dëshiron kryerjen e saj. Personi vepron me dashje eventuale kur ai ose ajo është në dijeni se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit të saj ose mosveprimit dhe ai ose ajo pranon që ajo të ndodh.
299. Trupi gjykues konstatoi se i pandehuri ka vepruar *animus necandi*. Qëllimi për të vrarë, duke qenë një element i vullnetshëm i ngulitur në ndërgjegjen e personit, mund të nxirret vetëm nga provat në lidhje me sjelljen e vëzhguar të të pandehurit. Elemente provuese të mundshme për ta zbuluar qëllimin e personit ndër tjera janë: sjellja e tij para, gjatë dhe pas agresivitetit, që përfshinë ato që janë thënë, shprehjet kërcënuese, ndihma e dhënë ndaj viktimave dhe në përgjithësi çdo informacion tjetër që mund të rezultojë nga specifikat e lëndës.
300. Siç është e detajuar në vlerësimin e gjendjes faktike, provat vërtetuan se forcat e armatosura të RFJ-së dhe të Serbisë kanë vepruar në bashkëpunim dhe në realizimin e një qëllimi të përbashkët: largimin e popullatës shqiptare nga Kosova. Nuk ka asnjë dyshim se ata ishin plotësisht në dijeni për ekzistimin e konfliktit si dhe të faktit që popullata në shënjestër ishte ajo civile. Argumentet gjithëpërfshirëse janë paraqitur më lartë në këtë aktgjykim. Është e pranueshme se disa nga pjesëtarët e forcave serbe nuk dëshiruan që të vriten shqiptarët e Kosovës. Kjo është konstatuar nga fakti se “shpëtimtari” e ndërpreu ekzekutimin.
301. Megjithatë, si grupi “ i të kaltërve” të cilët i përcollën nëntë shqiptarë të Kosovës nga vija e ekzekutimit dhe ata burrat në uniformë të pranishëm te pika e kontrollit, i donin ata të vrarë. Ata ndaluan duke ja drejtuar armët dhe i qëlluan katër prej tyre me paramendim. I vetmi përfundim i arsyeshëm i hapur për faktet është se kryerësit kishin synimin e nevojshëm për t'i vrarë ata. Prandaj, ata vepruan me dashje direkte. Dashja e tyre

direkte është vërtetuar në lidhje me të gjithë nëntë shqiptarët. Ishte vetëm e rastësishme që vetëm katër prej tyre u qëlluan. “Shpëtimtari” u shfaq dhe e ndali ekzekutimin. Në qoftë nuk do të ishte ai, “të kaltrit” do të kishin vazhduar me veprimet e tyre. Në fakt, edhe pas intervenimit të “shpëtimtarit”, ata kanë provuar të negociojnë me të për mundësinë që të qëllonjë më shumë. Ata të gjithë vepruan pa hezitim ndërsa i përcillnin dhe ekzekutonin viktimat. Asnjë shenjë habie nuk është shfaqur gjatë ose pas ekzekutimit nga “të kaltrit” te pika e kontrollit, të cilët ishin disa metra larg ekzekutimit. Ky është tregues i faktit se ata nuk ishin duke vepruar në mënyrë joracionale kur po i qëllonin viktimat dhe se ishin plotësisht të vetëdijshëm dhe i dëshironin pasojat e veprimeve të tyre.

302. Kur është fjala për të akuzuarin, ai ishte në mesin e forcave të pranishme te pika e kontrollit. Edhe në qoftë se nuk është vërtetuar se ai dha urdhrin për ekzekutimin e viktimave, fakti që ai ia kujtoi ushtarit tjetër urdhrin tregon përtej dyshimit të bazuar se ai ishte në dijeni rreth planit. Të gjitha ato që u konsideruan më lartë i referohen edhe të pandehurit dhe janë tregues për qëllimin e tij për të privuar viktimat nga jetët e tyre. Ai ishte plotësisht në dijeni për pasojat e veprimeve të tij dhe e dëshironte rezultatin inkriminues.
303. Përfundimisht, trupi gjykues arriti në konstatimin në vijim, lidhur me përgjegjësinë e të akuzuarit në forma tjera të përgjegjësisë së pretenduar në aktgjykim. Aktakuza pretendon se i akuzuari, “në cilësinë e një lideri”, “nxiti grupin e vartësve”. Para së gjithash, trupi gjykues vëren se të dy supozimet – se ai ishte udhëheqësi dhe se ai nxiti vartësit e tij – janë reciprokisht përjashtues sipas elementeve konkrete faktike. Nëse do të ishte vërtetuar fakti se **O. I.** ishte udhëheqësi, pastaj dhënia e udhëzimeve do të arrinte në “urdhërimin” dhe jo “nxitjen”. **O. I.** do të kishte qenë një kryerës.
304. Sa i përket nxitjes, asnjë provë e drejtpërdrejt nuk është ofruar për të dëshmuar pretendimin se i akuzuari i ka nxitur bashkëkryerësit për të kryer veprën penale në fjalë. Për të nxitur, duhet të vërtetohet një *lidhje* në mes të veprës së nxitjes dhe kryerjes së krimit. Trupi gjykues ka konsideruar se njerëzit në uniformë të cilët i përcollën dhe ekzekutuan viktimat kanë qenë veçse të vendosur që t’i kryejnë veprat para se të shkëmbejnë fjalë me të akuzuarin. Ata vepruan me vetëbesim dhe në mënyrë të

vendosur dhe se e dinin se çfarë ishin duke bërë. Me shprehjet e tij, i pandehuri praktikisht nuk ka përcjellë ndonjë informacion apo udhëzime për ta. Edhe pse, ata nuk kërkuan ndonjë siguri plotësuese apo sqarim, por vazhduan me zbatimin e planit. Ndërsa, për të ekzistuar nxitja, “nxitësi” nuk do duhej që veçse ta kishte ndarë mendjen për ta kryer veprën. Duhet të jetë vepra e “nxitësit” ajo që do të vinte në pah vendosmërinë penale të ekzekutuesit. Kjo nuk është çështja në fjalë. Gjithashtu, është tipar i brendshëm i nxitjes që vetë “nxitësi” nuk merr pjesë në kryerjen e veprës penale të cilën ai e nxit. I pandehuri është një bashkëkryerës, prandaj ai nuk mund të nxis të tjerët.

305. Në bazë të nenit 360 paragrafi 2 i KPP-së, *“Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”*.

306. Më herët në këtë aktgjykim, trupi gjykues ka dhënë konkluzionet faktike lidhur me ngjarjen dhe me sjelljen përkatëse të të akuzuarit, dhe ne e kualifikuam atë si bashkëkryerje. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues ka shpallur të akuzuarin penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale “Krime lufte kundër popullatës civile” e ndëshkueshme sipas nenit 142 të KP të RFJ-së. I akuzuari kreu veprën me dashje direkte. Kodet penale të mëvonshme gjithashtu e dënojnë veprën penale “Krime lufte kundër popullatës civile”. Në thelb, elementet përkatëse të veprës mbasin të njëjta sipas të gjitha kodeve penale³²⁸. Për më tepër, çfarëdo kontributi në kryerjen e veprës penale, sikurse e të pandehurit, kualifikohet si bashkëkryerje sipas çdo kodi.

Dënimi:

307. Trupi gjykues është i bindur përtej dyshimit të arsyeshëm, për arsyet e dhëna, për përgjegjësinë penale individuale të **O. I.** për pjesëmarrjen e tij si bashkëkryerës i veprës penale të ngarkuar dhe do të marrë dënimin mbi këtë bazë.

308. Gjatë shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit të dënuar për një krim të caktuar, gjykata duhet ta ketë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit – d.m.th. për të shtypur aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke frenuar të tjerët nga kryerja e veprave të njëjta,

³²⁸ Shih detajet në pjesën e dënimit.

dhe qëllimin specifik – d.m.th. për të parandaluar kryerësin nga përsëritja e veprës. Sipas nenit 34 të KPK-së³²⁹: “Qëllimet e dënimit janë: 1) të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; dhe 2) të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale”. Dy objektivat tjera të dënimeve zakonisht të referuara nga ekspertët e kriminologjisë dhe ata penal, janë ndëshkimi dhe rehabilitimi.

309. Prandaj, trupi gjykues, duhet të marrë parasysh të gjitha këto objektiva gjatë caktimit të dënimit.
310. Që nga data e kryerjes së veprës penale deri në ditët e sotme, disa kode penale kanë pasuar. Prandaj, trupi gjykues duhet të marrë parasysh parimin e zbatimit të prerë të ligjit më të favorshëm ose *lex mitior*³³⁰. Trupi gjykues duhet që *in concreto* ta kishte parasysh se cili ligj do të jetë më i favorshëm për të pandehurit kur të bëhej llogaritja e dënimit. Siç është thënë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), *lex mitior* është ai i cili është më i favorshmi për të pandehurin, duke pasur parasysh karakteristikat e tij ose të saj, natyrën e veprës dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra³³¹. Prandaj, *lex mitior* duhet të zbatohet *in concreto*³³².

Llogaritja e dënimit sipas Kodit Penal të RFJ-së:

311. KP i RFJ-së hyri në fuqi në vitin 1993 dhe për këtë arsye ishte i zbatueshëm në datën e kryerjes së veprës penale.
312. Vepra penale “Krime lufte kundër popullatës civile” është e dënueshme sipas nenit 142 dhe mbart një dënim minimal prej pesë vjet burgim dhe maksimal deri 40 vjet. Një kategori e veçantë e dënimit – prej 20 vjet burgim – është dhënë në alternativ.
313. Lidhur me rregullin e përgjithshëm të dënimit me burgim, neni 38 paragrafi (1) i KP të RFJ-së thekson se “Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë ose më i gjatë se 15 vjet”.

³²⁹ Të njëjtat dispozita janë edhe në nenin 33 të KP të RFJ-së.

³³⁰ Mbështetur me nenin 3 të KPRK-së.

³³¹ *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2), nr. 10249/03, paragrafi 109, 17 shtator 2009; *Maktouf dhe Damjanovic kundër Bosnjës dhe Hercegovinës, mendimet e veçuara*, f. 43

³³² Shih më lartë, *Maktouf dhe Damjanovic kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, f. 44.

314. Neni 38 paragrafi (2) i KP të RFJ-së parasheh se “për veprat më të rënda penale, mund të shqiptohet burgimi në 20 vjet”.
315. Në rastin në fjalë dhe duke pasur parasysh kontributin e kufizuar e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale, trupi gjykues do të marrë parasysh vetëm kategorinë e dënimit me burgim në mes 5 dhe 15 vjet.
316. Prandaj, lartësia e zbatueshme i dënimit është, nga 5 deri në 15 vjet burgim.
317. Gjykata do të përcaktojë dënimin për veprën penale brenda kufijve të parashikuar me ligj për një vepër të tillë penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe në veçanti shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, intensitetin e rrezikut ose të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, sjelljen e mëparshme dhe rrethanat personale të kryerësit, sjellja e tij apo e saj pas kryerjes së veprës penale dhe të gjitha rrethanat konkrete në të cilat është kryer vepra. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe me rrethanat e kryerësit.
318. Si rrethanë rënduese, trupi gjykues konsideroi si në vijim: mënyra e kryerjes së krimit ishte veçanërisht shqetësuese - viktimat ishin nxjerrë nga shtëpitë e tyre dhe para syve të familjeve të tyre. Në vazhdim, ata janë marrë në pyetje, janë mbajtur peng dhe në fund janë vrarë në mes të lagjes ku ata jetonin, në afërsi të shtëpive të tyre. Një tjetër faktor rëndues është fakti se numri i personave që ishte qëllimi të vriteshin ishte aq i lartë sa nëntë (edhe pse në fund vetëm katër u vranë).
319. Si rrethanë lehtësuese, trupi gjykues konsideroi se niveli i pjesëmarrjes së të akuzuarit në veprën penale ishte zvogëluar. Trupi gjykues është gjithashtu në dijeni për karakterin e mirë e të pandehurit, e dëshmuar nga dëshmitarët dhe provat dokumentuese.
320. Duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përmendura më lartë, trupi gjykues do të dënojë të akuzuarin në nëntë vjet burgim për veprën penale “krime lufte kundër popullatës civile” e ndëshkueshme sipas nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë (KPRFJ).

Llogaritja e dënimit sipas Kodit Penal të RSFJ-së:

321. Neni 1 paragrafi 1.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 për Ligjin e Zbatueshëm në Kosovë, që ka hyrë në fuqi më 12 dhjetor 1999 parasheh se:

“Ligji i zbatueshëm në Kosovë do të jetë:

(a) Rregullorja e shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet shtesë të lëshuara në përputhje me të; dhe

(b) Ligji në fuqi në Kosovë, më 22 mars 1989.”

322. Prandaj, nga dhjetori 1999 e tutje, me Rregulloren e UNMIK-ut të mësipërme në fuqi, dispozitat e Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (KPRSFJ)³³³ janë “riaktivizuar”.

323. Lidhur me veprën penale “krime lufte kundër popullatës civile”, neni 142 i KP të RSFJ-së parasheh një dënim jo më pak se pesë vjet ose dënim me vdekje. Neni 38 i KP të RSFJ-së thekson si më poshtë:

“(1) Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë ose më i gjatë se 15 vjet”.

(2) Gjykata mund të shqiptojë një dënim me burgim për periudhën prej 20 vjet për veprat penale e dënueshme me dënim me vdekje.”

324. Në lëndën në fjalë dhe duke pasur parasysh kontributin e kufizuar e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale, trupi gjykues do të marrë parasysh vetëm kategorinë e dënimit me burgim në mes 5 dhe 15 vjet.

325. Në bazë të të njëjtave rrethana lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues do të ketë, shqiptuar ndaj të të pandehurit një dënim prej 9 vjet burgim për veprën e njëjtë penale.

³³³ E miratuar nga Kuvendi i RSFJ-së në shtator 28 1976 dhe e cila ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977.

Llogaritja e dënimit sipas Kodit të vjetër të Përkohshëm Penal të Kosovës:

326. KPK ka hyrë në fuqi në vitin 2004. Lidhur me veprën e njëjtë penale, neni 120 i KPK-së gjithashtu parasheh një dënim më së paku pesë vjet ose me burgim afatgjatë.
327. Neni 45 paragrafi (1) i KPK-së thotë se ‘Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se 15 ditë e as më tepër se 20 vjet’.
328. Trupi gjykues, siç theksoi më sipër, do të konsideronte vetëm dënimin me burgim. Atëherë, lartësia e zbatueshme e dënimit do të jetë prej pesë deri në 20 vjet burgim.
329. Në bazë të të njëjtave rrethana lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues do të kishte shqiptuar kundër të pandehurit një dënim prej 11 vjet burgim.

Llogaritja e dënimit në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës:

330. KPRK ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013. Në lidhje me veprën e njëjtë penale, neni 152 i KPRK-së gjithashtu parasheh një dënim jo më pak se pesë vjet ose me burgim afatgjatë.
331. Neni 45 paragrafi (1) i KPRK-së thotë se ‘Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se 30 ditë e as më tepër se 25 vjet’.
332. Trupi gjykues, siç theksoi më lartë, do të konsideronte vetëm dënimin me burgim. Atëherë, lartësia e zbatueshme e dënimit do të jetë prej pesë deri në 25 vjet burgim.
333. Në bazë të të njëjtave rrethana lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues do të kishte shqiptuar kundër të pandehurit një dënim prej 13 vjet burgim.

Lex mitior dhe llogaritja përfundimtare

334. Trupi gjykues konsideroi se rezultati më i favorshëm për të pandehurin do të jetë arrirë *in concreto* duke zbatuar ose KP të RFJ-së ose KP të RSFJ-së. Pasi që të dy kodet janë po aq të favorshëm, trupi gjykues do të zbatojë atë që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht KP të RFJ-së.
335. Koha e kaluar në paraburgim në mes të 27 janarit 2014 dhe 18 shtatorit 2015 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 18 shtator 2015 deri më sot duhet të llogaritet në

kohëzgjatjen e dënimit, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) dhe (4) i KPK-së në lidhje me nenin 365 paragrafi (1. 5) të KPP-së.

II. B. PIKA 2: NGJARJET E 3 SHKURTIT 2000 NË VERI TË MITROVICËS

336. Trupi gjykues mbron qëndrimin se parimi “*ne bis in idem*” nuk është i zbatueshëm në rastin aktual³³⁴.

Vërejtjet paraprake:

337. Pikat e aktakuzës kanë të bëjnë me disa sulme të kryera ndaj popullatës shqiptare më 3 shkurt 2000 në veri të Mitrovicës.

338. Në mënyrë të ngjashme për pikën 1 të akuzës, aktakuza, në dispozitivin e saj nuk ka shtjelluar më shumë për gjendjen faktike. Faktet e pretenduara janë përshkruar në pjesën e arsyetimit të aktakuzës dhe nganjëherë vendosen në mes të argumentimit të prokurorit. Për më tepër, për të shtuar hutimin, përveç përshkrimit të ngjarjeve në gjykim, aktakuza përshkruan me të njëjtin nivel të hollësive dhe duke iu referuar provave, ngjarje të cilat nuk janë objekt i aktakuzës:

“Dy persona kanë hyrë me forcë në banesën numër 12 të D. G dhe e dëbuan së bashku me nënën e saj dhe 5 fëmijët. Ata ishin të armatosur me pistoleta dhe granata dore. Ata thërrisnin “do të ju vrasim, ju duhet të largoheni”. Duke dalë jashtë, anëtarët e familjes së saj ishin keqtrajtuar fizikisht nga autorët serbë. Njëri nga serbët ia ka vënë armën në fytyrën vajzës së saj 21 vjeçare dhe i tha: “kujt po i thoni të qetësohet’.”³³⁵

339. Megjithatë, asnjë nga të pandehurit nuk është ngarkuar për sulm kundër D. G. dhe familjes së saj dhe këta të fundit nuk janë në mesin e palëve të dëmtuara të përmendura në aktakuzë.

³³⁴ Shih hollësitë në aktvendimet mbi “*ne bis in idem*” të paraqitura në historikun procedural tek paragrafet 35-46 më sipër.

³³⁵ Aktakuza, f.33, version në gjuhën angleze.

340. Trupi gjykues duhej të shqyrtonte edhe dispozitivin dhe arsyetimin në tërësi në mënyrë që të identifikonte dhe të vlerësonte faktet e pretenduara relevante për veprat penale të pretenduara nën piken e akuzës 2.

341. Viktimat e plagosura nga sulmet që janë objekt i aktakuzës u sulmuan në lokacionet e mëposhtme:

- Banesa e N. A.2, e cila ndodhet në rrugën Lola Ribara, ndërtesa S/3; viktimat si më poshtë gjendeshin brenda: N. A.2, N. A.1, R. A., S. A.2, U. A., Sh. A., V. A., A. A.2, G. Xh., N. (N.) Xh., E. Xh.
- Banesa e familjes V.1, e cila ndodhët në rrugën Tanaska Rajiča Nr 4; viktimat më poshtë gjendeshin brenda: N. V.2 dhe Sh. V.
- Banesa e familjes C.1, e cila ndodhët në rrugën Lola Ribara Nr 5; viktima R. C. gjendej brenda
- Banesa e familjes S.2 (S.2), e cila ndodhët në rrugën Lola Ribara 17/6; viktimat më poshtë gjendeshin brenda: N.S.1 dhe H. S.1 (S.)
- Banesa e familjes A.2, e cila ndodhët në rrugën Lola Ribara Nr 5; viktima S. A.1 gjendej brenda
- Banesa e familjes S.1, e cila ndodhët në rrugën Knjaza Miloša 2; viktima M. S.1 gjendej brenda
- Banesat e familjeve B., R.1 dhe H., të ndodhura në rrugën Sutjeska 8; viktimat më poshtë gjendeshin brenda: S.B., H.R. dhe M. H.1 respektivisht
- Banesat e familjeve R.2 dhe R.3, të cilat ndodhen në rrugën Kralja Petra I, ndërtesa S/42; viktimat më poshtë gjendeshin brenda: G. R. dhe B. R.1 respektivisht

342. Banesat të cilat u sulmuan gjendeshin në rrugët fqinje në pjesën veriore të Mitrovicës³³⁶.

³³⁶ Për pasqyrim më të mirë të gjeografisë së zonës, shih skicën dhe raportin e shikimit të vendit të ngjarjes të kryer më 21.09.2015 hartuar nga Njësia e Forenzikës, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë datë 25.09.2015.

343. Akuzat kundër të pandehurve **O. I.** dhe **D. D.** kanë të bëjnë me sulmet kundër banesave të sipërpërmendura, ndërsa të pandehurit **N. V.1, I. V.** dhe **A. (S.) L.** ngarkohen vetëm në lidhje me sulmin në banesën e familjes A.1.

Nënkapitulli B1: Analiza në lidhje me të pandehurit O. I. dhe D. D.:

II. B1. 1. Faktet

344. Këta dy të pandehur ngarkohen për vepra të ngjashme penale që dyshohet të jenë kryer në bashkëkryerje. Një pjesë e madhe e provave të administruara nga prokuroria kundër tyre janë të përbashkëta. Prandaj, rrethanat e tyre do të trajtohen së bashku më poshtë.

345. Në aktakuzë pretendohet si në vijim:

“Më 03/02/2000 gjatë natës në Mitrovicën veriore, të dy të pandehurit duke vepruar në bashkëkryerje, sipas një plani të përbashkët të rënë dakord më parë dhe në cilësinë – **D. D.** të komandantit të Policisë në Mitrovicë të Ministrisë së Brendshme të Republikës Federale të Jugosllavisë (MUP) dhe **O. I.** të një lideri të grupit paramilitar serb të njohur si “Rojet e Urës” - me dashje direkte për të detyruar shqiptarët etnikë me forcë të braktisin shtëpitë e tyre dhe të largohen nga territori i Mitrovicës veriore dhe me dashje eventuale për t’i vrarë ose shkaktuar lëndime trupore atyre, ata nxitën/urdhëruan grupin e zyrtarëve policor vartës dhe anëtarëve të grupit paramilitar serb të njohur si “Rojet e Urës” të sulmojnë disa ndërtesa që gjendeshin në rrugën Kneza Milosa³³⁷, rrugën Lole Ribara, rrugën Tanaska Rajica, rrugën Sutjeska dhe rrugën Karl Petri dhe me forcë t’i spastrojnë shqiptarët etnikë, si rezultat i të cilave disa prej tyre u vranë ose u lënduan në mënyre të rëndë nga mjetet shpërthyesë, pistoletat apo thikat, dhe në veçanti:

³³⁷ Sipas aktakuzës së përmirësuar

1. më 03/02/2000 gjatë natës grupet e zyrtarëve të policisë së MUP-it dhe të “Rojave të Urës” të shoqëruar nga grupe spontane të serbëve të Mitrovicës veriore, kanë hyrë në ndërtesat e banuara nga familjet e përkatësisë etnike shqiptare me qëllim për t’i dëbuar ata dhe duke vepruar me dashje eventuale për të vrarë, kanë vrarë personat në vijim:

N. A.1

N. XH.

S. A.1

R. C.

M. S.1

S. B.

N. V.2

Sh. V.

B. R.1

N. S.1 (S.)

2. më 03/02/2000 gjatë natës grupet e zyrtarëve të policisë së MUP-it dhe të “Rojave të Urës” të shoqëruar nga grupe spontane të serbëve të Mitrovicës veriore, kanë hyrë në ndërtesat e banuara nga familjet e përkatësisë etnike shqiptare me qëllim për t’i dëbuar ata dhe duke vepruar me dashje eventuale për të vrarë, ndërmorën veprimin në drejtim të kryerjes së veprës penale të vrasjes por veprimi nuk është përfunduar dhe ka rezultuar në shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore ndaj personave në vijim:

R. A.

N. A.2

A. A.2

E. XH.

3. më 03 shkurt 2000 gjatë natës grupet e zyrtarëve të policisë së MUP-it dhe të “Rojave të Urës” të shoqëruar nga grupe spontane të serbëve të Mitrovicës veriore, kanë hyrë në ndërtesat e banuara nga familjet e përkatësisë etnike shqiptare me qëllim për t’i dëbuar ata dhe duke vepruar me dashje eventuale për të vrarë, ndërmorën veprimin në drejtim të kryerjes së veprës penale të vrasjes por veprimi nuk është përfunduar:

S. A.2
U. A.
Sh. A.
V. A.1
G. XH.
G. R.
M. H.1
H. R.
H. S.1”

346. Prokuroria ka administruar 38 dëshmitarë rreth kësaj pike të akuzës.
347. Dëshmitarët në vijim kanë qenë të pranishëm në banesën e familjes A.1 gjatë ngjarjeve kritike: G. Xh., R. A., S. A.2, Sh. A., V. A., A. A.2.
348. Dëshmitari M. M.2 ishte fqinj i familjes A.1. Ai i kishte vizituar ata pak para ngjarjeve tragjike dhe banesa e tij u sulmua në të njëjtin rast.
349. P. A. ishte po ashtu një fqinje e familjes A.1 dhe e kishte vëzhguar sulmin në banesën e tyre.
350. Dëshmitarët Sh. C.2, A. V., E. D., P. A., L. A.2, B. S.2 (kunata e M.S.1), E. S., Gj. S., G. R., M. Sh. dhe D. Sh., kanë dhënë dëshmi në lidhje me sulmet në banesat e familjeve C.1, S.1, R.2, V.1 dhe A2, si dhe në lidhje me situatën e sigurisë së përgjithshme më 3 shkurt 2000.
351. Dëshmitarët H. S.1 dhe I. R.2 kanë dhënë dëshmi në lidhje me sulmet në banesat e familjeve S.2 dhe R.3, respektivisht.
352. Dëshmitarët H. R., Sh.H., I. R.1, N. H., A. S.1 dhe M. H.1 kanë dhënë dëshmi në lidhje me sulmet në banesat e familjeve B., R.1 dhe H..
353. Dëshmitarët X dhe Y si dhe I. M.3 kanë qenë jashtë në rrugë në kohën e ngjarjeve.
354. H. B. është një aktivist i të drejtave të njeriut dhe në këtë funksion ai ka mbledhur deklaratat nga viktimat.

355. B. R.2 ishte kryetar i Mitrovicës. Ai nuk ishte në veri të Mitrovicës, në mbrëmjen kritike dhe dëshmia e tij ka të bëjë kryesisht me sigurinë e përgjithshme dhe situatën politike në atë kohë.
356. Pjesa tjetër e dëshmimeve të dëshmitarëve nuk kanë të bëjnë saktësisht me ngjarjet e ndodhura më 3 shkurt 2000, por më shumë me kontekstin e përgjithshëm të ngjarjeve ose qëllimi i tyre ishte për të siguruar prova për veprimtarinë e “Rojave të Urës”.
357. Gjatë mbrëmjes kritike, dëshmitarët e mbrojtur X dhe Y ishin të pranishëm jashtë në afërsi të ndërtesave të sulmuara.
358. Secili prej dy të pandehurve kanë administruar tetë dëshmitarë në lidhje me këtë akuzë, të cilët kryesisht kanë ofruar hollësi në lidhje me secilën vendndodhje të pandehurve dhe të aktiviteteve konkrete në atë mbrëmje. Aktivitetet e përgjithshme të të pandehurve në atë kohë po ashtu janë shqyrtuar me kujdes.
359. Gjatë vlerësimit të tyre, dëshmitë do të grupohen në katër kategori kryesore:

(a) Dëshmitë në lidhje me ngjarjet e 03 shkurtit 2000 në veri të Mitrovicës

(b) Dëshmitë në lidhje me pozitën e O. I. në kuadër të Rojave të Urës

(c) Dëshmitë në lidhje me pozitën e D. D. në kuadër të MUP-it

(d) Dëshmitë në lidhje me planifikimin dhe koordinimin e përbashkët ndërmjet O. I. dhe D. D.

(a) Dëshmitë në lidhje me ngjarjet e 03 shkurtit 2000 në veri të Mitrovicës:

Konteksti i përgjithshëm i tensioneve

360. Ka dëshmi të mjaftueshme rreth asaj se më 03 shkurt 2000 në veri të Mitrovicës, në orët e mbrëmjes, ka ndodhur një shpërthim tek kafiteria “Bel Ami”, duke plagosur një numër të serbëve³³⁸. Përveç kësaj, ky aspekt nuk është kontestuar.

³³⁸ O.I., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 8 dhjetor 2015, para. 180; D. D., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 8 dhjetor 2015, para. 406; N. V.1, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 9 dhjetor 2015, para. 424; I. V., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 10 dhjetor 2015, para.9; A. (S.) L., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 10 dhjetor 2015, para. 254

Ngjarjet në banesën e familjes A.1:

361. Banesa e familjes A.1 ishte njëra nga banesat që ishin sulmuar gjatë asaj mbrëmjeje. Banesa gjendet në rrugën Lola Ribara, numër 12, kati i tretë, ndërtesa S/3. Brenda gjendeshin pjesëtarët e familjes A.1: N. A.2, gruaja e tij S. A.2, vajza e tyre R. A., djemtë e tyre N. A.1 dhe U. A. Sh. A. (vëllai i N.A.2) po ashtu ishte së bashku me familjen e tij: gruaja e tij V. A. dhe djali i tyre A. A.2. Fqinjët e tyre, familja Xh. po ashtu gjendeshin aty: G. Xh., gruaja e tij N. Xh. dhe vajza e tyre E. Xh.
362. Nga këta 11 banorë, personat në vijim janë dëgjuar si dëshmitarë para trupit gjykues: G. Xh., R. A., S. A.2, Sh. A., V. A. dhe A. A.2.
363. U. A. nuk ishte propozuar nga prokurori dhe E. Xh., edhe pse fillimisht kishte qenë në listën e dëshmitarëve të prokurorit, më vonë ishte tërhequr³³⁹.
364. N. A.2 ka vdekur në ndërkohë dhe për këtë arsye marrja e dëshmisë së tij në gjykatë ishte e pamundur. Deklaratat e tij në procedurën paraprake janë shpallur të papranueshme, me një përjashtim: deklarata e tij e dhënë më 27 janar 2003 para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë është e pranueshme, por vetëm kur behët fjalë për të pandehurin **D. D.**.
365. N. A.2 dhe N. Xh. kanë vdekur pas lëndimeve të pësuar gjatë sulmit.
366. Dëshmitë e administruara para trupit gjykues janë konsistente në vijim: gjatë mbrëmjes kritike, një turmë e zemëruar ishin mbledhur në rrugë Lola Ribara. Një grup personash kanë hyrë në korridorin e objektit të banimit. Ata së pari shkuan në katin e sipërm dhe u përpoqën të hynin në banesën e M. M.2. Ata nuk patën sukses pasi dera ishte metalike. Ata u kthyen në derën e banesës së familjes A.1. Pasi N.A.2 refuzoi të pajtohej me thirrjet e tyre për të hapur derën, ata filluan që t'i sulmonin ata. Banesa e tyre u sulmua me granata dhe të shtëna me armë për disa orë. Në një moment, një grup i disa serbëve kanë hyrë në banesë, duke ua ndërprerë telefonat dhe kanë ikur. Ata u shpëtuan nga forcat

³³⁹ Duke pasur parasysh moshën e tyre të re dhe përmbajtjen e deklaratave të tyre në procedurën paraprake, trupi gjykues nuk e ka parë të arsyeshme për t'i thirrur ata *ex-officio*.

ndërkombëtare dhe u barten në jug të Mitrovicës. Të plagosurit u dërguan në spitalin maroken. Si pasojë e lëndimeve, N. A.1 dhe N. Xh. vdiqën menjëherë pasi u dërguan në spital. R. A., N. A.2, A. A.2 dhe E. Xh. gjithashtu pësuan dëmtime të rënda.

367. Prandaj, aspektet e sipërpërmendura konsiderohen të vërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm.
- 368.** Në vazhdim, trupi gjykues do të vlerësojë më thellë provat që u nxorën në lidhje me autorët e sulmit dhe për përfshirjen e dyshuar në sulm të **O. I.** dhe **D. D.**
369. Vëmendje e veçantë i është dhënë dëshmime të bashkëshortëve Sh.A. dhe V. A., pasi ata ofrojnë rrëfimet më të gjera dhe në të njëjtën kohë më inkriminuese në këtë aspekt. Kjo analizë mund të prek edhe mbi aspektet të deklaruara nga dy dëshmitarë në lidhje me të pandehurit **N. V.1, I. V., dhe A. (S.) L.**, pasi dëshmitë e tyre janë vlerësuar si produkt i përbashkët.

Sh. A.:

370. Kur bëhët fjalë për rrëfimin e Sh. A., trupi gjykues merr parasysh si më poshtë:
371. Ai dëshmoi gjatë dy ditëve dhe, madje edhe nga leximi i parë, deklarata e tij mund të shihet vetëm me mosbesim dhe rezerva.
372. Që nga fillimi, procesi i shqyrtimit të tij është provuar të jetë shumë i vështirë.
373. Shqetësimi kryesor i trupit gjykues lidhur me besueshmërinë e tij është se rrëfimi i tij është i mbushur me polemika. Ka mospërputhje të shumta, si të brendshme – ndërmjet rrëfimeve të tij të ndryshme – dhe të jashtme – ndërmjet deklaratave të tij dhe pjesës së tjera të provave.

Mospërputhjet e brendshme (ndërmjet rrëfimeve të ndryshme të tij):

374. Kuptimi i përgjithshëm i njërës nga pjesët më të rëndësishme të intervistave të mëparshme është në kontrast tepër të dukshëm dhe rrënjësor me pohimin pozitiv që ai

bëri në dëshminë e tij me gojë: përpara gjykatës, ai pohoi se kishte parë secilin nga pesë të pandehurit duke hedhur një granatë nga korridori në banesën e tyre, duke përfshirë edhe **O. I.** Në lidhje me **O. I.**, jo vetëm që dëshmitari nuk kishte përmendur praninë e tij në korridorin e ndërtesës më parë, por ai në fakt e kishte përjashtuar atë. Kur ai ishte pyetur më parë në lidhje me **O. I.**, dëshmitari përmendi vetëm se ai e vërejtë atë jashtë ndërtesës. I vetmi aspekt tjetër lidhur me **O. I.** i përmendur nga dëshmitari në lidhje me atë ditë është se **D. D.** i tha atij dhe vëllait të tij N.A.2 se ai ishte duke vepruar sipas urdhrave të **O. I.** Fakti që në fund të deklaratës të tij në-gjykatë, dëshmitari papritmas pa u pyetur jep informacione të tilla të rëndësishme sikur e kishte parë **O. I.** duke hedhur një granatë, konsiderohet nga trupi gjykues si jo e besueshme. Më e rëndësishmja, qëndrimi i tij në thelb bie ndesh me deklaratat e tij të mëparshme, ku ai tha se nuk e kishte vërejtur apo nuk mund ta kishte vërejtur askënd. Në pyetjen e intervistuesit “A e keni parë **O. I.** dhe **D. D.** duke hedhur granata dore?”, Dëshmitari u përgjigj: “Nuk e kam parë, por një fqinj përballë banesës së vëllait tim N.A. 2 ishte dëshmitar dhe u transmetua në televizionin e Kosovës disa ditë pas 3 shkurtit 2000”³⁴⁰. Ai më pas, në përgjigje të një pyetje tjetër, përsëriti të njëjtën gjë: “Unë nuk e kam parë se kush ka hedhur granata dore”³⁴¹. Në një tjetër pyetje në procedurën paraprake, ai kishte deklaruar si vijon: “Unë i pashë ata persona duke hedhur granata në drejtim të banesës së N. A. 2, por ishte e pamundur për të parë se kush i hodhën ato, për shkak të gjithë tymit në banesë.”³⁴² Pas ballafaqimit me deklaratat e tij të mëparshme, ai ofron një shpjegim që sipas mendimit të trupit gjykues nënvizon edhe një herë mungesën e sinqeritetit:

“D. L.: Unë do të ju kujtoj deklaratën tuaj, faqe 1218, ‘dikush e hodhi një granatë dore në banesën e N. A.2, por ishte e pamundur për të parë se kush ishte për shkak të tymit’.

³⁴⁰ Intervista e dëshmitarit Sh. A. datë 20 shkurt 2014, f. 1231, versioni në gjuhën angleze.

³⁴¹ Intervista e dëshmitarit Sh. A. datë 20 shkurt 2014, f. 1232, versioni në gjuhën angleze.

³⁴² Intervista e dëshmitarit Sh. A. datë 19 shkurt 2014, f. 1214, versioni në gjuhën angleze.

Sh. A.: Unë e kisha fjalën vetëm për granatën e parë.³⁴³

375. Dëshmitari u përpoq të na bëjë të besojmë se përgjigja e tij - se nuk e kishte parë - iu kishte referuar vetëm granatës së parë. Megjithatë, ai kishte treguar në mënyrë të qartë në deklaratën e tij të mëparshme edhe arsyen se pse ai nuk kishte mundur ta shihte, konkretisht për shkak të tymit. Megjithatë, kjo ishte saktësisht e para prej dy granatave që nxorën tymin. Nuk mund të ketë pasur ndonjë tym para shpërthimit të parë. Në fakt, provat janë unanime se granata e parë u hodh në derën e banesës. Pra, kjo ishte dera që do të kishte penguar atë për ta parë se kush e hodhi, jo tymi. Prandaj, shpjegimi i tij - se ai nuk mund të shihte për shkak të tymit - mundet ndoshta mos t'iu ketë referuar granatës së parë dhe i mungon plotësisht besueshmëria.

376. Dëshmitari deklaroi:

"Sh. A.: Nuk me kujtohet nëse kam harruar ta them këtë por e di se nuk e kam parë bombën e parë, por bomba e dytë ishte hedhur nga fqinji i tij I.V. dhe djali i tij N.V. dhe A.S.L. .

N.V.3: Nuk ju pyeta këtë, po ju pyes, në deklaratën tuaj në _____ keni thënë se nuk keni mundur të njihni askënd për shkak të tymit.

Sh. A.: Kam thënë në lidhje me bombën e parë.

N. V.3: Keni përdorur shumësin kur keni folur për bombat, jo njëjësin, por ta lëmë këtë anash."³⁴⁴

377. Dëshmitari jep dëshmi kontradiktore që kanë të bëjnë me aspekte të cilat konsiderohen nga trupi gjykes të jetë thelbësore, të tilla si ku, kur dhe si ai e kishte vërejtur të pandehurin gjatë ngjarjes kritike.

378. Fillimisht, ai tha se e kishte parë **D. D.** në rrugë, para ndërtesës, para fillimit të sulmeve. Ai madje ofroi shumë hollësi në lidhje me veshjen e të pandehurit dhe sjelljet e përgjithshme:

³⁴³ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, paragrafët 569-570.

³⁴⁴ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 148-151.

*“Prokurori i EULEX-it: Në turmën e njerëzve para ndërtesës ku ishte edhe **O. I.**, a e keni parë edhe personin që ju e përmendët më parë, që quhej **D. D.**?”*

*Sh. A.: Po, e kam parë edhe **D. D.**.*

*Prokurori i EULEX-it: Kur e keni parë **D. D.** në këtë turmë të njerëzve para ndërtesës së N. A.2, çfarë kishte të veshur ai dhe a ishte ai i armatosur apo jo?*

Sh. A.: Ai ishte i armatosur deri në dhëmbë.

*Prokurori i EULEX-it: Atë natë, kur ju patë Zt. **D. D.**, a ishte i armatosur ai, a keni parë që ai ishte i armatosur, nga ballkoni?*

Sh. A.: Sigurisht që e kam parë, sepse unë e njoh atë shumë mirë.

Prokurori i EULEX-it: Kur e patë atë, nga ballkoni, çfarë lloji të armës kishte ai me vete dhe ku e mbante ai armën e tij?

Sh. A.: Si të them, ai kishte një armë të shkurtër automatike.

Prokurori i EULEX-it: Kur ju e patë atë nga ballkoni, a kishte ai me vete armën e shkurtër automatike, a e keni parë këtë?

Sh. A.: Për momentin, nuk më kujtohet emri i armës automatike, por ai kishte edhe një thikë me vete.

*Prokurori i EULEX-it: Zt. Sh. A., mos i përdorni fjalët: “Gjithmonë e kam parë”, përqendrohuni që atë që thoni në momentin e caktuar. Pra, kur ju patë nga ballkoni Zt. **D. D.**, a ishte ai i armatosur me armë automatike me tytë të shkurtër?*

Sh. A.: Po, sigurisht.

Prokurori i EULEX-it: A e keni parë D. D., duke dhënë ndonjë lloj urdhri me duart e tij ose duke biseduar me persona të caktuar?

Sh. A.: O. I. i thirri ata të gjithë dhe së bashku me persona të tjerë, gjithashtu në praninë e D. D., ai iu dha urdhra gjithë atyre njerëzve.

Prokurori i EULEX-it: Pra, ju nuk e keni parë D. D. duke i dhënë urdhra dikujt në këtë grup?

Sh. A.: O. I. thirri së pari D. D. dhe pastaj D. D. thirri persona të tjerë dhe pas kësaj ata hynë brenda në ndërtesë.

Prokurori i EULEX-it: A e keni parë O. I. duke i dhënë urdhra D. D. në ndonjë moment, i cili pastaj urdhëroi të tjerët për të hyrë në ndërtesë, a e keni parë këtë?

Sh. A.: Unë e kam parë këtë personalisht dhe çdo gjë është e vërtetë.”³⁴⁵

379. Megjithatë, në fund të shqyrtimit të tij, kur u kërkua nga trupi gjykues për të sqaruar se sa herë ai e kishte parë D. D. atë ditë, dëshmitari ka konfirmuar vetëm dy raste të tjera nga tre që kishte përmendur përpara - brenda ndërtesës dhe jashtë ndërtesës kur KFOR-i i kishte evakuuar viktimat – duke lënë krejt jashtë kësaj episodin kur D. D. gjoja ishte para ndërtesës dhe që e kishte përshkruar në hollësi të tilla një ditë më parë:

“Kryetarja e trupit gjykues: (...)Kur dhe sa herë e keni parë D. D. atë mbrëmje?

Sh. A.: E kemi parë atë natë kur erdhi dhe foli me vëllain tim dhe tha se kishte ardhur aty me urdhër të O. I.

Presiding Judge: A ishte ky i vetmi rast?

³⁴⁵ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 202-219.

Sh. A.: Po. Ky ishte i vetmi rast e pastaj prapë kur kemi dalë jashtë e kemi parë kur forcat Amerikane dhe Daneze ishin aty.”³⁴⁶

380. Në fund, në përgjigje të pyetjes së radhës, ai haptazi pranoi se ai në fakt nuk e kishte parë **D. D.** fare para sulmeve atë ditë:

“Kryetarja e trupit gjykues: A keni parë edhe para ndërtesës para se të filloj ngjarja apo jo?

Sh. A.: Jo, nuk e kam parë atë ditë, por kur policia e SHBA-vë dhe KFOR-i danez erdhën, e pashë atë.”³⁴⁷

381. Trupi gjykues thekson se ky pranim vjen pasi dëshmitari, gjatë të njëjtit shqyrtim në gjykatë, kishte dhënë hollësi shumë specifike në lidhje me një situatë që ai pastaj e ka mohuar.

382. Dëshmitari gjithashtu ka dhënë dëshmi kontradiktore rreth asaj nëse i pandehuri **D. D.** kishte hyrë ose jo në banesën e N. A.2. Gjatë dëgjimit të tij më 11 maj 2015, dëshmitari pohoi se **D. D.** kishte hyrë në banesë:

*“Prokurori i EULEX-it: Z. Sh.A., rreshtat e fundit që ju i cekët kanë të bëjnë me momentin kur **D. D.** me disa njerëz kishin hyrë në banesën e z N.A.2.. A e keni parë atë personalisht, kur kishte hyrë në banesën e N. A.2?*

*Sh. A.: Ne e kemi parë atë, dhe vëllai im e ka parë po ashtu, kur ai erdhi aty dhe tha: “Unë kam ardhur tek ju me urdhër të **O. I.**”³⁴⁸*

383. Dëshmitari madje ka përshkruar veprimet e **D. D.** përderisa ishte në banesë:

*“Prokurori i EULEX-it: **D. D.** ishte në banesë dhe e ka bërë një bisedë të shkurtër me N., çfarë ndodhi pastaj?*

³⁴⁶ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 382-383.

³⁴⁷ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 394-395.

³⁴⁸ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 302-303.

Sh. A.: Në atë moment ata i morën të gjithë telefonat dhe çdo gjë që mundën.

EULEX Prosecutor: Dhe u larguan nga banesa?

*Sh. A.: Po.*³⁴⁹

384. Megjithatë, në seancën e marrjes në pyetje të tërthortë, dëshmitari deklaroi pikërisht të kundërtën, d.m.th., se **D. D.** nuk ka hyrë në banesë, por ka mbetur para derës:

*“Kryetarja e trupit gjykues: Kur ju tha për **O. I.**, a ishte brenda banesës tuaj? Po flas për **D. D.**”*

Sh. A.: Jo, ishte pranë derës së hyrjes dhe po fliste me vëllai tim.

Kryetarja e trupit gjykues: A ishte në korridor të ndërtesës?

*Sh. A.: Po. Ishte në korridor por vëllai im e njihte shumë mirë. Unë e njoh shumë mirë por vëllai im e njeh më mirë.”*³⁵⁰

Kundërthëniet e jashtme (ndërmjet deklaratave të tij dhe pjesës tjetër të dëshmive):

385. Disa fakte të cilat ai i paraqet si të caktuara janë në kundërshtim të qartë me pjesën tjetër të dëshmive. Në lidhje me të pandehurit, ai vazhdimisht ka deklaruar se në ditën kritike, ata ishin të veshur me uniforma dhe ishin të armatosur rëndë:

*“Prokurori i EULEX-it: Kur e keni parë **D. D.** në këtë turmë të njerëzve para ndërtesës së N. A.2, çfarë kishte të veshur ai dhe a ishte ai i armatosur apo jo?*

*Sh. A.: Ai ishte i armatosur deri në dhëmbë.”*³⁵¹

³⁴⁹ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 330-333.

³⁵⁰ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 386-389.

“Prokurori i EULEX-it: Kur e keni parë D. D. gjatë asaj dite, a ishte ai i armatosur në ndonjë mënyrë?”

Sh. A.: Ata ishin të armatosur deri në dhëmbë, njëjtë si O. I.”³⁵²

386. Duke pasur parasysh mënyrën se si sulmi është kryer, është e qartë se autorët duhet të ketë qenë të armatosur. Ajo që është e pazakontë, megjithatë, është se dëshmitari ka deklaruar se të gjithëve u shiheshin armët:

“D. L.: A i mbanin këto armë fshehurazi apo ishin këto armë të dukshme?”

Sh. A.: Ishin aq të guximshëm sa që armët i mbanin në mënyrë aq të dukshme sikur të ishin në shtëpinë e tyre.”³⁵³

387. Çfarë është edhe më e vështirë për të besuar është ajo që dëshmitari deklaroi me siguri, se të gjithë të pandehurit, së bashku me të tjerë në turmë, ishin të veshur me uniforma të plota³⁵⁴.

388. Për shembull, kur ishte pyetur për I. V. dhe N. V.1, dëshmitari ka ofruar rrëfimin në vijim:

“Prokurori i EULEX-it: Pra, ju i patë ata të dy në turmë, nga ballkoni?”

Sh. A.: E saktë.

Prokurori i EULEX-it: A keni parë nëse ata kishin armë me vete, nga ballkoni?”

Sh. A.: Ata kishin të veshura uniforma ushtarake me shumë armë.

³⁵¹ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 204-205.

³⁵² Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 98-99.

³⁵³ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 594-595.

³⁵⁴ Ne do të prekim aspektet e dëshmisë së këtij dëshmitari e cila ka të bëjë po ashtu me tre të pandehurit e tjerë; Është logjike se besueshmëria e tij vlerësohet në lidhje me deklaratën e tij të konsideruar si tërësi.

Prokurori i EULEX-it: Atë natë, kur i keni parë ata nga ballkoni, a keni parë nëse ata kishin të veshura uniforma ushtarake?

*Sh. A.: Po, absolutisht.*³⁵⁵

389. Në lidhje me **O. I.** ai deklaroi si në vijim:

"Sh. A.: Dje, nuk kam mundur ta kujtoj saktësisht, por uniformë që e kishte aso kohe ishte uniformë e re serbe.

N. V.3: A mund të shpjegosh çka ishte kjo uniformë franceze?

Sh. A.: Dje kam thënë se ngjante me uniformën franceze dhe këtu kam një fotografi, por pa kapelë, dhe mund t'ju tregoj dhe për këtë jam i sigurt 100%.

N. V.3: Dje ishte 100% i sigurt se ishte uniformë franceze.

Sh. A.: Është e ngjashme me uniformën franceze.

N. V.3: Si duket ajo përveç që është e gjelbër?

Sh. A.: Ka ngjyrë të gjelbër, e gjelbër e mbylltë dhe po ashtu mund të them diçka si të kafet dhe ishte e madhe.

N. V.3: Atë natë, me 3 shkurt 2000, a e kishte veshur atë uniformë apo pallto?

*Sh. A.: Atë natë ai ishte me uniformë dhe çdo gjë tjetër.*³⁵⁶

390. Sipas dëshmitarit, serbët e tjerë ishin me uniforma dhe të armatosur po ashtu.³⁵⁷

391. Në të kundërtën, pjesa tjetër e dëshmitarëve janë të njëzëshëm për faktin që asnjë nga të pandehurit nuk kishin qenë me uniformë, ose të armatosur.

³⁵⁵ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 234-239.

³⁵⁶ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 17-25.

³⁵⁷ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 275-276.

392. Më e rëndësishmja, ngjarjet në fjalë kanë ndodhur pas qershorit të vitit 1999, kur marrëveshja e Kumanovës kishte hyrë në fuqi. Sipas marrëveshjes, siguria e rajonit i ishte besuar forcave ndërkombëtare. Askush tjetër, përveç forcave ndërkombëtare, nuk lejoheshin të vishnin uniformë. Dëshmitari Y, i cili ishte një _____, e konfirmoi këtë.³⁵⁸ Uniformat e forcave zyrtare të RFJ-së ishin dorëzuar. Armët mund të mbaheshin vetëm nga personat e autorizuar.
393. KFOR-i e mbante këtë nën kontroll nga afër. Një shembull i thënë i vërtetuar me prova është se, në një rast, **D. D.** u ndalua dhe u morr në pyetje nga KFOR-i për të parë nëse ai ishte i autorizuar për mbajtjen e pistoletës së tij.³⁵⁹
394. Është vështirë për t'u besuar se, ndërsa ishin nën një kontroll të tillë nga afër, qytetarët serbë, në vend që të përpiqeshin të mos binin në sy kur po e orkestronin sulmin, do të visheshin me të veshje të plotë ushtarake dhe haptazi të tërhiqnin vëmendjen e forcave ndërkombëtare për veten e tyre.

Kundërthëniet e jashtme dhe të brendshme:

395. Trupi gjykues gjithashtu thekson se në deklaratën e tij para gjykatës, dëshmitari në mënyrë të përsëritur dhe kategorikisht ka mohuar se ai, vëllai i tij N. A. 2 dhe G. Xh. kanë përdorur armë për të mbrojtur veten nga sulmi. Kjo vjen në kundërshtim me të dy deklaratat e G. Xh.³⁶⁰ dhe V. A..³⁶¹ Kjo përforcon edhe më shumë bindjen e trupit gjykues se dëshmitari nuk është i sinqertë.
396. Për më tepër, disa nga rrëfimet e tij sfidojnë logjikën, ose janë dukshëm mashtruese. Për shembull, ai thotë se ai shpesh i kishte parë të pandehurit në urë - si pjesë e "Rojave të Urës" - gjatë kohës kur behet fjalë në aktakuzë. Për të shtuar peshë në rrëfimin e tij, ai shpjegon se ai kalonte urën çdo ditë për të shkuar në punë - nga veriu i Mitrovicës, ku ai jetonte, për në jug, ku ai punonte. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, dëshmitari pranoi

³⁵⁸ Dëshmitari Y, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 28 maj 2015, para. 206.

³⁵⁹ R. Š., procesverbal i shqyrtimit kryesor, 27 tetor 2015, para. 604-624; **D. D.**, procesverbali i shqyrtimit kryesor, 9 dhjetor 2015, para. 189

³⁶⁰ G. Xh., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 prill 2015, para. 89-90;

³⁶¹ V. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 20 maj 2015, para. 407-411.

faktin se zyrat e tij në fakt duhej të zhvendoseshin nga jugu i Mitrovicës në veri menjëherë pas qershorit të vitit 1999, që do të thotë më shumë se gjashtë muaj para ngjarjeve dhe në një kohë kur “Rojet e urës” nuk ekzistonin.

397. Dëshmitari po ashtu mbron qëndrimin se, ndërsa ata u sulmuan, ai pati mundësi ta vërente njërin nga të pandehurit dike hedhur një granatë nga dy kate më lart. Kjo deklaratë e bën edhe më të vështirë besueshmërinë.

398. Faktikisht nuk është e arsyeshme të pranojmë se një granatë do të hedhet dhe do të arrin në banesën që ndodhet dy kate më poshtë. Ajo që sfidon logjikën edhe më shumë është se dëshmitari, i cili ishte brenda banesës së sulmuar, mund të ketë vërejtur se çfarë po ndodhte dy kate mbi të:

“Sh. A.: Unë tani do të ju tregojë për këtë. Më vonë, nga kati i dytë sipër vëllait tim, dy granata dore janë hedhur dhe pastaj divani ka filluar të digjet dhe N.A. 1 u plagos.

Prokurori i EULEX-it: A mos rastësisht e ke parë ti se kush ishte duke i hedhur këto dy granata dore?

Sh. A.: Me sa më kujtohet, mendoj ishte N. V. 1 dhe ai ishte tullac, dhe pas kësaj N.A. 1 dhe R.A. ishin plagosur.

Prokurori i EULEX-it: Çka ju bën të mendoni se ishte N. V.1 ai i cili i kishte hedhur këto granata dore?

Sh. A.: Sepse unë e njoh atë mjaft mirë dhe ata gjuajtën me snajper nga ana tjetër e banesave dhe e qëlluan djalin e vëllait tim, N. A.1.

Prokurori i EULEX-it: A e keni parë ju në fakt N. V. 1 duke i hedhur këto granata dore ose ju thjesht mendoni se ishte ai?

Sh. A.: Askush tjetër veç tij nuk mund t'i ketë hedhur ato, sepse ai jetonte atje.

Prokurori i EULEX-it: A e keni parë ju, me sytë tuaj N. V. 1 duke i hedhur këto granata?

Sh. A.: Me sytë e mi, unë mund të ju garantoj se ai i hodhi ato, sepse askush tjetër veç tij nuk mund t'i ketë hedhur ato."³⁶²

399. Kur u kërkua nga ai që ta sqaroj, ai nuk ishte në gjendje t'ia shtoj besimin rrëfimit të tij:

"N. V. 3: Kjo për mua është paksa e çuditshme. Si ka mundësi që bomba nga kati i 2-të bjerë në mes të dhomës?

Sh. A.: As unë se di sepse aso kohe po luftonim për jetë.

N. V. 3: Dje keni thënë se keni parë bombën duke rënë.

Sh. A.: Thashë se e kam parë kur është hedhur, por pyetje juaj ishte pse në mes.

N. V. 3: Po ju pyes, si është e mundur që bomba e hedhur nga kati i dytë bie në mes të dhomës në katin e 3-të?

Sh. A.: Ka shumë mundësi që ai ka qenë specialist që e ka hedhur bombën."³⁶³

400. Dëshmitari ka penguar marrjen e tij në pyetje duke u lëshuar në një tregim që nuk kishte të bënte me pyetjet. Një tjetër fakt alarmues është se shpesh, kur u pyet në lidhje me një aspekt të caktuar specifik, ai ofronte një përgjigje që ishte e përgjithshme ose edhe më keq, kishte të bënte me një rast krejtësisht të ndryshëm. Mënyra se si ai ndërtoi tregimin e bënte të dukej sikur përgjigja e ofruar prej tij të ishte përgjigja e pyetjes së shtruar. Më poshtë është vetëm një shembull, por është ilustrues i këtij modeli të ndërtimit të përgjigjeve. Ai e bëri këtë në një masë të tillë, sa që edhe prokurori u alarmua rreth kësaj:

"Prokurori i EULEX-it: Zt. Sh. A., mos i përdorni fjalët: "Gjithmonë e kam parë", përqendrohuni në atë që keni pa në momentin e caktuar. Pra, kur ju patë nga ballkoni Zt. D. D. (...)"³⁶⁴

³⁶² Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 370-378 (Theksimi i shtuar).

³⁶³ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 139-144.

401. Ai nuk e ndërpriste këtë praktikë edhe pas paralajmërimeve në mënyrë të përsëritur nga ana e trupit gjykues. Duke përdorur këtë teknikë të paqartë, përgjigjet e tij mund të kenë qenë lehtë mashtruese dhe sollën konkluzione të gabuara, duke supozuar se përgjigja e dhënë i referohej pyetjes. Në fakt, po të mos ishin testuar aspekte të caktuara gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, trupi gjykues do të kishte mbetur me një përshtypje të pasaktë në lidhje me disa aspekte absolutisht të rëndësishme.³⁶⁵

402. Një shqetësim tjetër, sipas mendimit të trupit gjykues, janë përpjekjet të Sh. A. në rrjedhën e dëshmisë së tij për të zbehë dallimin mes asaj që e kishte parë dhe asaj që ai e mendonte. Duket se për këtë dëshmitar nuk ka asnjë vijë ndarëse në mes të asaj që ai kishte qenë dëshmitar, për çfarë vëllai i tij N. A. 2 ose bashkëshortja e tij V. A. kishin qenë dëshmitarë apo çfarë, sipas vlerësimit të tij, përbënte një përfundim logjik.

403. Në fillim të marrjes së tij në pyetje, dëshmitari deklaroi se ishte vëllai i tij N. A. 2 i cili i kishte thënë atij se ai e kishte vërejtur **A. (S.) L.** dhe **I. V.** duke hedhur granata:

*“Prokurori i EULEX-it: Z. Sh. A., a mund t’i tregoni gjykatës kur N. A. 2 ju tha se ata që e hodhën granatën e dorës ishin **S. L.** dhe **I. V.**. A ju ka thënë ai këtë gjatë asaj nate apo dikur më vonë? (...) Si e dini që vëllai juaj e ka parë **S. L.** dhe **I. V.** duke i hedhur ato granata?”*

*Sh. A.: Ai mund t’i ketë parë ata pasi që ai i kishte ata fqinjë të parë. Vëllai im banonte në anën e djathtë kurse familja **V. 2** banonte në anën e majtë.*

*Kryetarja e trupit gjykues: A ju ka thënë vëllai juaj se ai e kishte parë **I. V.** dhe **S. L.** duke hedhur granata?*

³⁶⁴ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 May 2015, para. 212.

³⁶⁵ Shih shembullin e mëparshëm kur ai e mohon deklaratën e tij se e kishte parë **D. D.** para ndërtesës ditën para ngjarjeve.

Sh. A.: 100% dhe madje ai edhe kishte bër titur me zë të lartë dhe i kishte thënë: “Edhe ju S. L. jeni duke hedhur granata”.

Prokurori i EULEX-it: Kur ju ka thënë ai që këta dy persona kanë hedhur granata, a ndodhi kjo atë natë ose më vonë?

Sh. A.: Atë natë.”³⁶⁶

404. Gradualisht, gjatë rrjedhës së marrjes së tij në pyetje, dëshmitari del me qëndrim të kundërt, duke mbrojtur qëndrimin se ishte vetë ai i cili e kishte parë **A. S. L.**:

“Kryetarja e trupit gjykues: A e keni parë A. S. L. duke hedhur ndonjë granatë në banesë?

Sh. A.: Vëllai im e kishte parë sepse ai tha ‘edhe ju S. L. po gjuani’.

Kryetarja e trupit gjykues: A nënkupton kjo se ju personalisht nuk e keni parë atë?

Sh. A.: Edhe unë po ashtu e kam parë sepse e njoh atë shumë mirë .”³⁶⁷

405. Ka raste të shumta të përgjigjeve të ngjashme në dëshminë e tij. Shpesh, kur i kërkohej që të sqaronte përgjigjet e tij fillestare të paqarta, dëshmitari, vetëm pas disa paragrafëve, e rregullon rrëfimin e tij fillestar dhe e ngrit nga një fakt më pak të sigurt tek një fakt 100% të sigurt. Ai gjithashtu ofron si shpjegim vetëm interpretimi e tij të pambështetur në fakte. Këtu kemi një shembull:

“Kryetarja e Trupit Gjykues: Të kalojmë te Z. D. D.. A e keni parë D. D. duke hedhur ndonjë granatë në banesë?

Sh. A.: D. D. ardhur deri te dera jonë kur i ka treguar vëllait tim se O. I. po kërkon ta shoh atë dhe mund të them se sapo e kemi parë dhe atë që ka thënë e kemi

³⁶⁶ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 359-366 (Theksimi i shtuar).

³⁶⁷ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 796-799.

ditur se ishin ata që na e kishin bërë këtë neve. Dhe po të mos ishin ata, kush tjetër do të ketë mundur të na e bëj këtë neve, duke tentuar të na vrasin të gjithëve?

Kryetarja e Trupit Gjykses: Z. Sh. A., përveç kësaj bisede, a e keni parë atë duke hedhur ndonjë granatë apo jo? Është pyetje e lehtë. Ju lutem përqendrohuni dhe qetësohuni. Dua përgjigje me po ose jo.

Sh. A.: Po, ishte ai që kishte hedhur bashkë me të gjithë paramilitarët tjerë.

*Kryetarja e Trupit Gjykses: A e keni parë **D. D.** duke hedhur ndonjë granatë në banesë? Po ose jo?*

*Sh. A.: Po 100% ishin ata të cilët kishin hedhur granatën në bashkëpunim me **O. I.** dhe gjithë të tjerët.³⁶⁸*

406. Ose:

“Prokurori i EULEX-it: A mos rastësisht e ke parë ti se kush ishte duke i hedhur këto dy granata dore?

*Sh. A.: Me sa më kujtohet, mendoj ishte **N.V. 1** dhe ai ishte tullac, dhe pas kësaj N.A 1 dhe R. A. ishin plagosur.*

*Prokurori i EULEX-it: Çka ju bën të mendoni se ishte **N. V. 1** ai i cili i kishte hedhur këto granata dore?*

Sh. A.: Sepse unë e njoh atë mjaft mirë dhe ata gjuajtën me snajper nga ana tjetër e banesave dhe e qëlluan djalin e vëllait tim, N.A. 1.

*Prokurori i EULEX-it: A e keni parë ju në fakt **N. V. 1** duke i hedhur këto granata dore ose ju thjesht mendoni se ishte ai?*

³⁶⁸ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 818-822 (Theksimi i shtuar).

Sh. A.: Askush tjetër veç tij nuk mund t'i ketë hedhur ato, sepse ai jetonte atje.

Prokurori i EULEX-it: A e keni parë ju, me sytë tuaj N. V. 1 duke i hedhur këto granata?

Sh. A.: Me sytë e mi, unë mund të ju garantoj se ai i hodhi ato, sepse askush tjetër veç tij nuk mund t'i ketë hedhur ato.

*Prokurori i EULEX-it: Unë mendoj që ky është një supozim i juaj por ju duhet t'i tregoni gjykatës, nëse ju e keni parë **N.V. 1** kur ai i hodhi granatat e dorës.*

Sh. A.: Unë e kam parë atë me sytë e mi derisa po digjeshin sofat unë i jam afruar xhamit të dritares.

Prokurori i EULEX-it: Nga kjo çfarë ju jeni duke thënë, duket se ju i keni parë granatën tek fluturonte drejt banesës, por a e keni parë personin që e ka hedhur atë?

*Sh. A.: Është 100% ai, ai është tullac, trupmadh dhe gjatë gjithë kohës ai qëndronte tek ura.*³⁶⁹

407. Ky shqetësim përkeqësohet nga fakti se dëshmitari paraqet spekulimet e tij si një fakt 100% të sigurt. Në fakt, ai përdori këtë shprehje disa herë. Kjo rezulton, që përgjigjet të cilat dëshmitari i ka vërtetuar 100% janë kundërshtuar dukshëm nga dëshmi të besueshme. Për shembull, dëshmitari tregon që në mbrëmjen kritike, ai e kishte vërejtur një zyrtar të policisë së MUP-it, si pjesë e turmës trazirave. Në marrje në pyetje të tërthortë, mbrojtësi theksoi se zyrtari i policisë në fakt kishte vdekur më parë dhe ata kishin dorëzuar prova me shkrim në mbështetje të kësaj³⁷⁰. Megjithatë, në pyetje të drejtpërdrejtë, dëshmitari deklaroi se ishte i sigurt se e kishte parë atë. Dhe ai madje

³⁶⁹ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 371-384 (Theksimi i shtuar).

³⁷⁰ Shih Shtojcën për raportin Human Rights Watch Raport mbi viktimat civile të bombardimeve të NATO-s gjatë Operacionit të Forcave Aleate, dosja e gjykatës, bajnderi VI, shqyrtimit kryesor, tab 5.

dukej i sigurt në fillim të marrjes në pyetje të tërthortë, derisa mbrojtësi i tregon atij që polici kishte vdekur.

408. Në një ekstrakt nga marrja e tij në pyetje thuhet:

"N. V. 3: (...)Më trego diçka. Keni thënë se nga banesa e N.A. 2 keni mundur t'i njihni disa polic dhe ju keni vënë në lista nja 15-20 sish.

Sh. A.: Mund t'ju them se i kam njohur të gjithë sepse kam punuar aty, ashtu edhe vëllai im. Nëse më pyesni mund t'ju tregoj edhe për 50 veta, jo vetëm për 15-20.

Presiding Judge: Cila është pyetja?

N. V. 3: Unë po e provoj deklaratën e tij dhe dua të dijë se a i ka parë persona të caktuar (...)

N. V. 3: M. A.?

Sh. A.: Edhe atë e njoh.

N. V.3: A e ke parë atë?

Sh. A.: E kam parë edhe atë.

N. V. 3: M. M. A., çfarë bënte ai?

Sh. A.: Ishte aty me të gjithë Serbët para banesës.

N. V.3: Ku qëndronte saktësisht M.A. ?

Sh. A.: Para ndërtesës.

*N. V. 3: A ishte afër **O. I.**?*

*Sh. A.: Nuk ishte afër **O. I.***

N. V. 3: z. Sh. A., M. A., të cilin e keni parë para ndërtesës, është vrarë me 2 maj 1999 kur ishte bombarduar ndërtesa e sekretariatit të punëve të brendshme në Mitrovicë. A nuk është pak çudi që e keni parë 10 muaj pas vrasjes së tij?

Sh. A.: E kam ngatërruar. Unë po flas për J., jo A..

N. V. 3: Unë po ashtu ia përmenda emrin, M..”³⁷¹

409. Gjatë deklaratës së tij ai shpesh herë pa u pyetur ka ofruar - ndonjëherë edhe në mënyrë shumë të thjeshtë, detaje fajësues të cilat nuk i kishte ofruar fare ose sugjeruar në deklaratat e tij të mëparshme. Ai nuk ishte në gjendje për të shtjelluar ose ofruar fakte konkrete në mbështetje të pretendimeve të tij. Por pretendimet e tij janë aq të plota sa ato paraqitën si të pabesueshme:

410. Për shembull, ai ka treguar se si **D. D.** kishte hyrë në banesën e tyre dhe kishte thënë: *“Kam ardhur tek ju me urdhër të O. I.”³⁷²*

411. Pastaj ai e kishte dëgjuar **O. I.** duke dhënë urdhrat në vijim, autorëve të krimit:

“Prokurori i EULEX-it: (...) A dëgjuat se çfarë u tha saktësisht O. I. këtyre personave ndërsa iu bënte thirrje për të hyrë në ndërtesë?”

Sh. A.: Në atë moment, kam dëgjuar duke iu thënë atyre që familja A.1, të gjitha ata, nuk do të mbesin gjallë, sepse ata kanë dijeni për gjithçka që ka ndodhur më parë, gjatë dhe pas luftës.”³⁷³

412. Kjo e sfidon logjikën se autorët, gjatë zbatimit të sulmit të tyre, do të shpalosnin hollësitë me zë të lartë ose t’ua shpjegonin viktimave.

413. Përveç kësaj, ai pohoi se edhe pse ai ishte në ballkon në katin e tretë, ai mund të dëgjonte urdhrin e dhënë nga **O. I.** shumë qartë:

“Prokurori i EULEX-it: Pra, ju e dëgjuat Zt. O. I. nga ballkoni që u thoshte këtyre njerëzve që të hyjnë në ndërtesë?”

Shemsedin Ajeti: 100%”³⁷⁴

³⁷¹ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 57-90 (Theksimi i shtuar).

³⁷² Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 371-384.

³⁷³ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 198-199.

³⁷⁴ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 180-181.

414. Edhe pse dëshmitari e bëri këtë pohim, sipas tij, ka pasur rreth 100 persona të mbledhur³⁷⁵ jashtë dhe ka prova të gjera për faktin se turma ishte e zhurmshme dhe po thërrisnin parulla anti-shqiptare.³⁷⁶
415. Në përgjithësi, dëshmitari dukej mjaft i gatshëm për të rënë dakord me ndonjë pohim të shtruar nga prokurori.
416. Në disa raste, ai madje ka treguar një qëndrim mospërfillës dhe mjaft konfrontues ndaj të pandehurit:

"Sh. A.: Kur kanë ardhur ata, të gjithë kishin veshur uniforma të zeza.

D. L.: Pyetja ime ishte se si dukeshin këto uniforma të zeza?

Sh. A.: D. D. më së miri din për to.

D. L.: Unë ju pyeta juve."³⁷⁷

417. Ose:

"D. L.: A jeni në dijeni se në të njëjtën kohë gjersa është shtënë në derën e N.A. 2, ishte shtënë edhe në derën e I. V.?"

Sh. A.: Jo, nuk e di këtë, më mirë ta pyesni z. O. I. sepse ai ishte udhëheqësi."³⁷⁸

418. Ose:

"Gjyqtari Vitor Pardal: Po ju nuk ia keni drejtuar këto fjalë KFOR-it, apo?"

Sh. A.: KFOR-it, kujt tjetër. Askush tjetër nuk ishte aty.

Gjyqtari Vitor Pardal: Në rregull. Faleminderit shumë.

³⁷⁵ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 11 maj 2015, para. 155.

³⁷⁶ V. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 13 maj 2015, para. 127-128; R. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 prill 2015, para. 31.

³⁷⁷ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 586-589.

³⁷⁸ Sh. A., procesverbali i shqyrtimit kryesor, 12 maj 2015, para. 689-690.

Sh. A.: Ndoshta ne duhet t'ia kishim drejtuar këto fjalë O. I. apo D. D..

Gjyqtari Vitor Pardal: Kjo është e mjaftueshme. E kam të qartë. Të faleminderit!”³⁷⁹

419. Pikëpamjet e vëna në dukje më sipër bënë që trupi gjykues ta konsideroj dëshminë e tij me shumë kujdes. Dëshira dëshmitarit për të mbajtur dikë përgjegjës për sulmin mund të ketë rezultuar në vendosjen e rreme të fajit për të gjithë të akuzuarit, me mënyrën e formësimit të pikëpamjes së tij për të u përshtatur me rastin e prokurorisë. Gatishmërinë e tij për ta bërë këtë gjë rrënjos tek trupi gjykues një mosbesim të përgjithshëm të besueshmërisë së këtij dëshmitari. Pas deklaratës së tij, trupi gjykues ngel me një ndjenjë të konfuzionit dhe mosbesimit. Trupi gjykues ngel me përshtypjen e padyshimtë se ai në të vërtetë ka dhënë një dëshmi të pavërtetë. Shpjegimi dhe sjellja i tij në përgjithësi treguan mungesë të së sinqeritetit dhe për këtë arsye dëshmia e tij konsiderohet si jo e besueshme. Megjithatë mund të jetë që dëshmia e tij gjithashtu të përmbaj fakte të caktuara të cilat janë të sakta. Trupi gjykues nuk qe në gjendje që të bëjë përcaktime të tilla dhe nuk ka zgjedhje tjetër përpos që të lë këtë dëshmi tërësisht anash.

V. A.:

420. Përgjithësisht shpjegimi i V. A. duket i prerë sipas bashkëshortit të saj Sh. A. , si në kuptim të përmbajtjes ashtu edhe sa i përket rrjedhës së përgjithshme të dëshmisë së saj.

421. Ngjashëm me burrin e saj, V. A. dha shpjegime të caktuara me çka ngriti shqetësimin e trupit gjykues sa i përket besueshmërisë s tyre, sepse dëshmia e saj është në kundërshtim me dëshmi të tjera të besueshme. Ai vuri në dukje se mu para sulmit, rreth orës 20:00 – 20:10³⁸⁰, ajo vuri re të pandehurin **D. D.** nga ballkoni. Sipas saj, **D. D.** ishte para ndërtesës së banesës së tyre së bashku me një grup njerëzish. Ajo deklaroi pa nda se **D. D.** dhe grupi ishin me uniforma dhe të armatosur: *“unë e pashë zotëri **D.D.***

³⁷⁹ Sh. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 12 maj 2015, para. 789-783.

³⁸⁰ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 55.

që kishte të veshur uniform si dhe shumë të tjerë që kishin të veshur uniforma dhe ishin të armatosur".³⁸¹

*"D. D. e kishte grupin i cili ishte i hapur. Ata nuk ishin të mbuluar në asnjë mënyrë. Ata vepronin në mënyrë të hapur, në uniforma dhe ata nuk frikësoheshin."*³⁸²

422. Ajo më pas deklaroi si në vijim sa i përket **D. D.**:

*"Ai nuk rrinte në një vend. Ai ishte në lëvizje; ai lëvizte përreth. Nuk ishte e vështir t'i veje ata në dukje sepse ata ishin të armatosur dhe të gjithë ishin të veshur me uniforma të të ashtuquajturve 'Frenki', me ngjyrë të zezë."*³⁸³

423. Ajo po ashtu foli për disa njerëz në turmë të veshur me "uniforma të rojave të urrës":

"Prokurori i EULEX-it: Si ishin të veshur këta njerëz përreth O. I. ?

*V. A.: Ata kishin uniforma, ndoshta të rojave të urrës(...)"*³⁸⁴

*"V. A.: Grupi i D.D. së bashku me D. ata ishin plotë me armë. D. D. e kam fjalën."*³⁸⁵

424. Të dy kryesit e veprës të cilët hynë në banesat e tyre gjatë ngjarjeve ishin, sipas V.A. , po ashtu të veshur me uniforma të policisë.³⁸⁶

425. Kjo deklaratë bie në kundërshtim jo vetëm me dëshmitë tjera që janë vlerësuar si të besueshme³⁸⁷, por duket si jo e besueshme nëse kemi parasysh realitetet shoqërore të asaj kohe dhe faktin që pas Marrëveshjes së Kumanovës së qershorit të vitit 1999, vetëm forcat ndërkombëtare janë lejuar të veshin uniforma në këtë regjion. Të njëjtat

³⁸¹ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 316.

³⁸² V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 371.

³⁸³ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 379.

³⁸⁴ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 368-369.

³⁸⁵ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 363.

³⁸⁶ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 391 *et seq.*

³⁸⁷ R. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 24 prill 2015, para. 189; S.A., 2 Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, para. 127-128; G. Xh., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 prill 2015, para. 154-157.

konsiderata të hollësishme të bëra mbi këtë pikë kur u vlerësua deklarata e Sh. A. më sipër u përsërit serish me këtë rast.

426. Dëshmitarja gjithashtu paraqet një tendencë të caktuar që të nxitoj në përfundime. Gjatë dëgjimit të saj, ajo vazhdimisht ka thënë se një prej kryesve të veprës i cili ka hyrë në banesën e N.A.2 po komunikonte përmes radio lidhjes me të pandehurin **D. D.** Vetëm atëherë kur iu kërkua me ngulm nga ana e trupit gjykues që të sqaroj, ajo shpjegoi se si ajo erdh në këtë përfundim në bazë të faktit se asaj ia kapi veshi atë duke thënë "D.1"³⁸⁸. Megjithëqë, D.1 është një emër serb që përdoret shpesh dhe kjo nuk është e arsyeshme që kjo të merret kështu menjëherë, në bazë të kësaj, që bashkëbiseduesi ishte gjithsesi **D. D.** Megjithatë, ajo e dha këtë detaj në fund të dëgjimit të saj dhe vetëm pas kërkesës së trupit gjykues që të sqaruar. Para se ta bënte këtë gjë ajo vazhdimisht paraqiste si të sigurt faktin se ishte **D. D.** ai i cili ishte në radio me ndërhyrësin:

*"Prokurori i EULEX-it: A mos pe **D. D.** duke bë far gjesti kur ti e pe atë nga ballkoni?"*

V. A.: Unë nuk pata rastin që të shoh.

Prokurori i EULEX-it: A mos e pe atë të kishte ndonjë aparat pajisje për komunikim?"

V. A.: Unë nuk kam parë ndonjë aparat për komunikim në dorën e tij por kur erdhën dy oficerë të policisë në banesën tonë ata e pyeten atë përmes radio lidhjes se a të na vrisnin neve apo jo."³⁸⁹

*"Prokurori i EULEX-it: Çka i thanë ata, nëse e mbani mend, **D. D.** përmes radio lidhjes apo përmes telefonit mobil?"*

V. A.: Kur ata komunikuan, ai i pyeti ata se si është situata dhe ata than "gati të gjithë janë të vvarë por çka të bëjmë me këta tjerët, a t'i vrasim a jo?"³⁹⁰

³⁸⁸ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 20 maj 2015, para. 643 et seq.

³⁸⁹ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, paras. 388-391.

³⁹⁰ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, paras. 430-431.

427. Ka gjëra të tjera për të cilat dëshmitarja fillimisht tregoj një shkallë të lartë sigurie, e që në fund u dëshmuar të ishin të dyshimta, siç ishte uniforma që **D. D.** kishte të veshur atë ditë:

*“Prokurori i EULEX-it: A kishte të veshur uniform edhe **D. D.**?”*

V. A.: Po, jam e sigurt 100% për këtë gjë.

Prokurori i EULEX-it: po ashtu me ngjyrë të zezë siç e përshkrove ti?

V. A.: Po.”³⁹¹

428. Në marrjen në pyetje nga ana e kundërt kur u ballafaqua me deklaratën e saj të më hershme, ajo më nuk ishte e sigurt nëse rrobat që kishte të veshura **D. D.** ishin rroba civile apo uniform:

*“M. B.: Kjo është fjalia juaj: ‘unë mendoj që kësaj here **D. D.** ishte i veshur me rroba civile me xhaketë policore anti-plumbi me syza dielli sipër dhe me mustaqe’³⁹².*

V. A.: A tregova se çfarë ngjyre i kishte rrobat?

Kryetarja e trupi gjykues: Zonja V. A., të lutem prisni pyetjen.

M. B.: Si është e mundur që në një prej deklaratave tuaja ti thuash se ai ishte i veshur me rroba civile dhe me xhaketë anti-plumb dhe në deklaratën tjetër ai kishte të veshur uniform të policisë?

Kryetarja e trupi gjykues: Zonja V. A. a mund të na sqarosh këtë të lutem?

V. A.: Unë thash rroba civile por se nuk përmenda ngjyrën e këtyre rrobave. Pra uniforma e policisë është uniform e zezë kështu që pra ai ndoshta kishte uniform të

³⁹¹ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, paras. 382-385 (të shtuara shprehjet).

³⁹² Deklarata e V. A. e datës 31 janar 2003, f. 1132, versioni në gjuhën angleze.

zezë. Fakti që ai kishte xhakete anti-plumb është e mjaftueshme, nuk është me rëndësi nëse ai kishte të veshur rroba civile apo uniform ushtarake."³⁹³

429. Në ekzaminimin e saj, ajo dukej se ishte e shtyrë nga e njëjta dëshirë për të fajësuar dhe për ta mbajtur dikë përgjegjës për sulmin e që kjo është vënë re nga trupi gjykues në lidhje me burrin e saj. Për shembull, ajo ka deklaruar se të dy personat që hynë në banesën e tyre iu than atyre që **D. D.** i kishte dërguar ata, pasi që ai ishte komandanti i tyre.³⁹⁴ Kur, sipas dëshmitares, **D. D.** u paraqit në derën e tyre, ai gjithashtu dha detaje rreth asaj se kush e organizoi sulmin, duke përmendur **O. I.**, si person përgjegjës³⁹⁵. Prap se prap, për arsyet e detajuara gjatë vlerësimit të deklaratës së Sh. A. trupi gjykues nuk e gjen besueshme që, pasi që kanë ardhur që të orkestrojnë sulmin kundër tyre, secili nga kryesit e veprës së pari kishte kohë që të hynte në bisedë me viktimat, duke iu shpjeguar atyre se kush qëndronte prapa gjithë kësaj.
430. Për më tepër, ajo ndonjëherë paraqiste akuza në bazë të bindjeve të saja të pambështetura në fakte:

*"Prokurori i EULEX-it: Pyetja ime lidhet me dy grupet e ndryshme sepse ti the se **O. I.** ishte në një grup dhe **D. D.** ishte në një grup. A e kemi fjalën për dy grupe të ndryshme të ndara?"*

V. A.: Nuk është bash ashtu siç ju e keni kuptuar. Ishin dy grupe, grupi që vepronte dhe grupi që jepte urdhra.

Prokurori i EULEX-it: Cili grup po jepte urdhra dhe cili grup po vepronte dhe çka iu bëri juve të mendonit kështu?"

V. A.: Unë kam përshtypjen që O. I., si udhëheqës serb, gjatë luftës dhe pas luftës jepte urdhra deri në vitin e kaluar."³⁹⁶

431. Ose:

³⁹³ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 20 maj 2015, paras. 245-250 (të shtuara shprehjet).

³⁹⁴ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 421.

³⁹⁵ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, para. 476.

³⁹⁶ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 maj 2015, paras. 372-375 (të shtuara shprehjet).

“E. P.: Por a ishin këta persona të cilët iu sulmuan juve të lidhur me këta të pandehur, a mos i pe ti ata së bashku?”

V. A.: Rojat e Urës ishin në lidhje me udhëheqësit e tyre.

Kryetarja e trupi gjykues: A ishin këta persona që iu cenuan juve fizikisht së bashku me të pandehurit në ato raste?

V. A.: Unë nuk i kam parë ata të kem qenë atje personalisht, por ata ishin kolegë”.³⁹⁷

432. Po ashtu trupi gjykues vuri re një tjetër aspekt që ngriti mosbesim. Sipas pikëpamjes së saj, V. A. konsideron se **O. I.** është përgjegjës për sulmet. Megjithatë, në vitin 2007-2008, V. A. iu drejtua **O. I.** kur asaj iu dashtë ndihmë për të u kthyer në regjion³⁹⁸. Është vështir të kuptohet se si dikush mund të mbështetet dhe të i besoj një personi që ajo e fajësoi për vdekjen dhe lëndimin e anëtarëve të familjes së saj.
433. Duke marrë parasysh faktet e diskutuara më lart, për të përcaktuar se ku qëndron e vërteta në dëshminë e saj kundërthënëse është padyshim sfiduese. Trupi gjykues nuk u bind se mund të mbështetet në deklaratat e kësaj dëshmitareje në mënyrë të sigurt si bazë për dëshmimin e fakteve të rëndësishme. Pjesë të caktuara të dëshmisë së saj janë shqyrtuar në mënyrë rigoroze dhe trupi gjykues ka ngel shumë i rezervuar në lidhje me disa aspekte të dëshmisë së saj. Trupi gjykues nuk është i gatshëm që të pranoj dhe të veproj vetëm mbi dëshmitë e saj në lidhje me çfarëdo çështje materiale kështu i ka dhënë rëndësi vetëm atyre pjesëve të dëshmisë së saj në aspekte të rëndësishme të cilat janë konfirmuar nga prova të tjera të besueshme - si në përshkrimin e përgjithshëm të sulmit. Pjesa tjetër e dëshmisë së saj nuk do të merret parasysh.
434. Trupi gjykues tani kthehet që të vlerësoj dëshmitarët e tjerë. Dëshmitari A. A.2 nuk dha hollësi të rëndësishme në dëshminë e tij, pasi që ai nuk kishte vu re asnjërin nga kryesit e veprës³⁹⁹. Dëshmitari deklaroi se xhaxhai i tij N. A. 2 i përmendi atij

³⁹⁷ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 20 maj 2015, paras. 38-42.

³⁹⁸ V. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 20 maj 2015, paras. 38-42.

³⁹⁹ A. A.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 qershor 2015, para. 143-145.

diçka lidhur me përfshirjen e **O. I.** dhe **D. D.** në atë ngjarje⁴⁰⁰. Në mungesë të dëshmisë së N.A. 2, trupi gjykues nuk i jap rëndësi kësaj informate të dorës së dytë. Dëshmia e A. A.2 nuk mund të përbëjë mjet për të zëvendësuar deponimin e N. A.2.

435. G. Xh., R. A., dhe S. A.2 dhanë shpjegime të hollësishme për sulmin. Deponimet e tyre paraqiten mospërputhje të vogla të caktuara-ose të brendshme ose të jashtme- kur bëhej fjalë për aspekte siç është ekzekutimi konkret apo korniza kohore e sulmit apo pozita e personave në banesë në kohë të ndryshme. Këto mospërputhje nuk kanë të bëjnë me elemente të rëndësishme faktike dhe nuk janë të pazakonta kur dihet fakti që këto ngjarje për të cilat ata dëshmuuan në gjykatë ishin jashtëzakonisht traumatike, ku bëhej fjalë për jetë a vdekje. Në vlerësimin e dëshmive të dhëna nga këta dëshmitarë, trupi gjykues duhej të kishte parasysh se çfarëdo vërejtje që ata bënë mund të ketë qenë si pasojë e stresit dhe frikës. Kalimi i kohës po ashtu e bënë të veten kur është fjala te aftësia e dëshmitarit për të rikujtuar gjërat.
436. Megjithatë, deklaratat e tyre me gojë ishin në përputhshmëri, në pjesët e tyre më të rëndësishme me deklaratat e tyre të mëparshme, si dhe me njëra-tjetrën. Shpjegimet e tyre kanë qenë në thelb të ngjashme kur bëhet fjalë për dinamikën e sulmit, plagosjen e viktimave dhe rrethanat e lirimimit të tyre. Edhe pse anëtarët e tyre të familjes së ngushtë pësuan më së shumti nga sulmi, ata nuk duket që ia veshin lehtë fajin ose që të bien në përfundime të pa mbështetura. Deklaratat e tyre janë të harmonizuara dhe të mbështetura me fakte dhe shpjegime logjike dhe mbeten konstante gjatë gjithë dëgjimit të tyre.
437. Sipas pikëpamjes së trupit gjykues është i një rëndësie fakti që dëshmitari G. Xh. pranoi faktin se ata që të tre – ai, N.A. 2 dhe Sh. A. – iu kundërvunë atyre për të u mbrojtur nga sulmi. ⁴⁰¹ Ky pranim vetëm sa e bënë më të besueshëm dëshminë e tyre.
438. Për të përfunduar, duke e konsideruar sjelljen dhe mënyrën e tyre në të cilën ata dhanë dëshmi si dhe rrjedhën e përgjithshme të dëshmive të tyre, trupi gjykues vlerësoi se G. Xh., R. A., dhe S. A.2 janë dëshmitarë të ndershëm. Trupi gjykues nuk ka asnjë dyshim që ata të dëshmuuan të vërtetën dhe i konsideron dëshmitë e tyre si të besueshme.

⁴⁰⁰ A. A.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 qershor 2015, para. 150.

⁴⁰¹ G. Xh., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 prill 2015, para. 90;

439. Që të tre treguan në hollësi se si, kur N. A.2 u thirr për të hapur derën, personat që qëndronin pas derës të i kenë thënë atij se ata ishin duke përcjellë "urdhrat e **D.D.**" dhe se ky i fundit i tha N.A. 2 që të shkonte në katin e poshtëm. N.A.2 u përgjigj se **D. D.** duhej të ngjitej lart. Menjëherë pas pak, bomba e parë u hodh në derë⁴⁰². Biseda u zhvillua me dyer të mbyllura dhe asnjë prej tyre nuk ishte në gjendje të njihte zërat. Trupi gjykues konsideron se kjo nuk mund të përcaktohet përtej dyshimit të arsyeshëm, vetëm në bazë të shkëmbimit të këtyre fjalëve me persona të panjohur, se ishte në të vërtetë **D. D.** ai që i dërgoi ata në banesën N.A. 2. **D. D.** dhe N. A. 2 ishin kolegë, brenda strukturave të MUP-it. Nuk mund të përjashtohet mundësia që personat në derë po përdornin emrin e **D. D.** në mënyrë që të ia mbushin mendjen N. A.2 për të hapur derën, ose të dilte jashtë nga banesa.
440. Pasiguritë e tilla dëshmojnë më tej faktin se gjykata nuk mund të vërtetoj se i akuzuari ishte me të vërtetë ai që i dërgoi ata persona në derën e N.A.2 . Ky dyshim duhet të interpretohet në favor të të akuzuarit, bazuar në parimin e *in dubio pro reo*.
441. Në bazë të këtij parimi, pesha e të dëshmuarit që i vihet si obligim prokurorit për të provuar fajësinë e të pandehurit përtej dyshimit të arsyeshëm do të thotë se duhet të vërtetohet dhe të argumentohet se nuk ka alternativa të tjera të arsyeshme për atë që prokurori e demonstroi. Siç sqaron Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në rastin e *Barberà, Messegué dhe Jabardo v Spain*, sa i përket të drejtës për një gjykim të drejtë, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj): "paragrafi 2 [i nenit 6] mishëron parimin e supozimit të pafajësisë. Kërkohet, mes tjerash, që me zbatimin e detyrave të tyre, anëtarët e gjykatës nuk duhet të fillojnë me ide të paramenduara se i akuzuari ka kryer veprën që akuzohet: barra e provës i bie prokurorisë, dhe për çfarëdo mëdyshje duhet të përfitoj i akuzuari"⁴⁰³. Prandaj, ky parim është brenda së drejtës për të u supozuar i pafajshëm deri kur të dëshmohet fajësia në bazë të ligjit. Më pas, në bazë të parimit të *in dubio pro reo*, gjykata, me rastin e vlerësimit të fakteve dhe provave, duhet t'i gjej në favor të të akuzuarit në rast të mëdyshjes.

⁴⁰² R. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 24 prill 2015, para. 81-83; S. A.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, para. 46-54; G. Xh., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 prill 2015, para. 50.

⁴⁰³ A 146 (1989); 11 EHRR 360 para 77 PC.

442. Asnjëri nga ta nuk e vuri re as **O. I.** apo **D. D.** në vazhden e mbrëmjes, gjatë sulmeve. G. Xh. deklaroi qartazi se ai e dinte mirë se kush ishin të pandehurit dhe se ai nuk e pa **D. D.**⁴⁰⁴ apo **O. I.**⁴⁰⁵ gjatë ngjarjeve. Po ashtu, ai vazhdoi se askush nuk përmendi emrin e **O. I.**⁴⁰⁶. R. A. nuk e njihte **O. I.**⁴⁰⁷ apo **D. D.**⁴⁰⁸ atë kohë. Ngjashëm, S. A.2 nuk e pa **O. I.**⁴⁰⁹ Apo **D. D.**⁴¹⁰ gjatë sulmeve.
443. Trupi gjykues vë në dijeni se me Aktvendimin e trupit gjykues të datës 27 prill 2015⁴¹¹, deklarata e N. A.2 para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë e datës 27.01.2003 ishte shpallur e pranueshme lidhur me të pandehurin **D. D.** Megjithatë, vendimi për të pranuar këtë intervistë të më hershme nuk është, sigurisht, në asnjë mënyrë faktor vendimtar që trupi gjykues ia jap asaj. Fakti që kjo deklaratë është shpall e pranueshme nuk e ndryshon faktin që i pandehuri nuk pati mundësin që t'i parashtroj pyetje dëshmitarit në mënyrë të tërthortë pasi që avokati i tij nuk paraqitet në seancë. Në bazë të nenit 262 paragraf 1 të KPP-së, gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në bazë të, apo deri në një masë, dëshmisë apo provave tjera të cilat nuk mund të kundërshtohen nga ana e të pandehurit apo avokatit mbrojtës përmes marrjes në pyetje në dikur në një fazë të procedurës gjyqësore penale. Më tej, në deklaratën e tij, N. A.2 pohoi se ishte **D. D.** ai cili erdhi tek dera para sulmeve dhe e thirri atë që ta hapte derën. Dëshmitari deklaroi se ai e njohu zërin e **D. D.** dhe më pas e shikoj përmes vrimës së përgjimit. Kjo u kundërshtua nga dëshmitarët e tjerë të besueshëm të cilët në hollësi deklaruan se në fakt personat tek dera shtreshin se i kishte dërguar **D. D.** dhe se sipas tyre, **D. D.** ishte poshtë. Po ashtu, dëshmitarja S. A.2 deklaroi se N. A.2 nuk pati shans të shikonte përmes vrimës së përgjimit. Eksplozimi ndodhi menjëherë pasi që N. A.2 pati bisedën me derë të mbyllur⁴¹². Prandaj, trupi gjykues nuk i jap ndonjë vlerë provuese të rëndësishme kësaj deklaratë.

⁴⁰⁴ G. Xh., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 prill 2015, para. 253.

⁴⁰⁵ G. Xh., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 prill 2015, para. 206-209.

⁴⁰⁶ G. Xh., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 prill 2015, para. 210-211.

⁴⁰⁷ R. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 24 prill 2015, para. 178-181.

⁴⁰⁸ R. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 24 prill 2015, para. 86.

⁴⁰⁹ S. A.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, para. 200-201.

⁴¹⁰ S. A.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, para. 186-187.

⁴¹¹ Shih hollësitë në Historikun Procedural tek paragrafet 54-56 më sipër.

⁴¹² S. A.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2015, para. 69-70.

444. Dëshmitari M. M.2 ishte fqinj me familjen A.1 dhe banesa e tij gjendej dy kate më sipër, në katin e pestë. Ai vizitoi A.1 shumë pak përpara ngjarjeve tragjike. Banesa e tij iu nënshtrua të shtënave me armë me rastin e njëjtë, mu para sulmit në banesën e familjes A.1. Pasi që ai kishte derë të blinduar, kryesit e veprës nuk mundën ta shkatërronin derën apo të hynin në banesën e tij. Ai nuk ka mundur të shihte se kush shtiu në banesën e tij, ai vetëm tregoi se ata folën në gjuhën serbe⁴¹³. Ai nuk e ka parë **O. I.**⁴¹⁴ apo **D. D.**⁴¹⁵ atë natë. Dëshmitari po ashtu deklaroi se atij i tha N. A.2 të nesërmen se njëri nga kryesit e veprës ishte **D. D.** Megjithatë, trupi gjykues nuk i jap ndonjë rëndësi kësaj dëshmie të tërthortë për të vërtetuar praninë e të pandehurit.
445. P. A. atë kohë jetonte andej rrugës nga familja A.1 dhe vështroi sulmin mbi banesën e tyre nga banesa e saj. Dëshmitarja deklaroi se ajo vuri re disa silueta në ballkonin e familjes A.1 të cilët dukeshin se hodhën një granat brenda. Megjithatë, ajo nuk mund të i njoh ata e as të jep ndonjë hollësi tjetër sa iu përket atyre⁴¹⁶.
446. Duke marr parasysh të gjitha këto rrethana, trupi gjykues nuk mundi të nxjerr ndonjë përfundim pozitiv lidhur me kryesit e veprës apo lidhur me përfshirjen e të pandehurve në këtë sulm mbi banesën e familjes A.1.

Ndodhitë në banesën e familjes V.1:

447. Dëshmitari G. R. ishte gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë në atë kohë dhe ishte kujdestar në natën kritike. Në këtë cilësi, atë e thirri policia e UNMIK-ut në shtëpinë e familjes V.1, ku ai vërtetoi vdekjen e dhunshme të bashkëshortëve Sh.V. dhe N. V.2⁴¹⁷. Nuk ka dëshmitar të drejt për drejt për sulmin, prandaj nuk mund të vërtetohet lidhja me të pandehurit.

Ndodhitë në banesat e familjes C.1 dhe familjes A.1:

448. Të dy këto familje jetonin në ndërtesat e banesave përball njëra tjetrës.

⁴¹³ M. M.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 14 korrik 2015, para. 61-67.

⁴¹⁴ M. M.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 14 korrik 2015, para. 188-189.

⁴¹⁵ M. M.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 14 korrik 2015, para. 174.

⁴¹⁶ P. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 5 maj 2015, para. 213-214.

⁴¹⁷ G. R., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 4 gusht 2015, para. 22 *et seq.*

449. Në natën kritike, dëshmitari Sh. C.2 deklaroi se ai ishte në shtëpi së bashku me bashkëshorten e tij R.C. dhe me një oficer policor Jordanez i cili ishte qiraxhinj i tyre. Banesën e tyre e kapluan të shtënat dhe dy nga të shtënat e qëlluan R.C. e cila si pasoj e kësaj vdiq. Një grup nga 6-8 serb u vërsulen brenda në banesë dhe dëshmitari njohu njërin nga të ata të ishte D.2 nga S.⁴¹⁸
450. Dëshmitari A. V. jetonte në të njëjtën ndërtesë. Ai deklaroi se si pas sulmeve në banesën e tij ai dhe familja e tij u fshehën në shtëpinë e fqinjit të tij I. B.. Ai nuk vuri re ndonjërin nga të pandehurit⁴¹⁹ gjatë ngjarjeve kritike. Dhe as dëshmitari E. D., i cili po ashtu ishte fqinj⁴²⁰.
451. Në ndërtesën përball, dëshmitari L. A.2 ishte në shtëpi së bashku me të atin e tij R. si dhe me të ëmën e vetë S. A.1. Sipas shpjegimit të tij, banesa e tyre iu nënshtrua të shtënave nga arma e zjarrit dhe se njëra nga të shtënat e qëllloi të ëmën e tij. Ajo vdiq ditën e nesërme si pasoj e plagëve. Ai nuk vuri re ndonjërin nga të pandehurit⁴²¹.
452. Andaj, në bazë të dëshmive të marra veç e veç si dhe / ose si tërësi, nuk mund t vërtetohet asnjë lidhje mes kryesve të veprës së këtyre sulmeve në këto ndërtesa dhe të pandehurve.

Ndodhitë në banesën e familjes S.2 (S.2):

453. Dëshmitarja H. S.1 kujton në hollësi se si në mbrëmjen kritike ajo ishte në shtëpi së bashku me bashkëshortin e saj N.S.1 dhe fëmijët e tyre. Ata dëgjuan një shpërthim dhe më pastaj një turmë e nevrkosur filloi që të mblidhej në rrugë. Së shpejti ata hynë në ndërtesën e tyre dhe u vërsulen në banesën e tyre. Dëshmitaren e pyeten se çfarë kombësie ishte dhe ajo pohoi se ishte shqiptare. Kryesit e veprës filluan të qëllonin atë dhe bashkëshortin e saj. Ajo deklaroi se si e nxorën zvarrë nga banesa bashkëshortin e saj dhe pas kësaj ai menjëherë humbi vetëdijen. Bashkëshorti i saj vdiq si pasoj e këtyre lëndimeve. Ajo nuk ishte në gjendje të ofronte ndonjë hollësi të rëndësishme në identifikimin e kryesve të veprës⁴²².

⁴¹⁸ Sh. C., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 22 prill 2015, para. 57 *et seq.*

⁴¹⁹ A. V., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 13 korrik 2015, para. 103-106 dhe 111-114.

⁴²⁰ E. D., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 22 korrik 2015, para. 61 *et seq.*

⁴²¹ L. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 10 shtator 2015, para. 71-72.

⁴²² H. S.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 16 shtator 2015, para. 98-100 dhe 121-122.

454. Prandaj, në bazë të dëshmimeve të detajuara si më sipër, trupi gjykues nuk mundi të vërtetoj përfshirjen e të pandehurve në këtë sulm.

Ndodhitë në banesën e familjes S.1:

455. Gj. S. ishte në banesën e saj së bashku me bashkëshortin M.S.1, djalin e tyre E.S. dhe fqinjët e tyre – bashkëshortët G. M. dhe N. M.. Atë mbrëmje ata dëgjuan një shpërthim dhe menjëherë pas kësaj një turmë filloi të mbledhej rreth ndërtesës së banesës së tyre dhe po bërtisnin të sharra ofenduese ndaj shqiptarëve etnik. Shumë shpejt pas kësaj, disa njerëz e rrëzuan derën e ndërtesës përtokë dhe hynë në korridor. Dëshmitarët treguan se disa nga sulmuesit pastaj thyen derën e tyre dhe iu hynë në banesë. Ata e rrahën M. S.1, e theren atë me thikë dhe në fund ia vunë një granat nën trupin e tij të shtrirë. M. S. 1 vdiq menjëherë pas kësaj si pasojë e lëndimeve që ai pësoi.⁴²³

456. Dëshmitarët Gj. S. dhe E. S. deklaruan se mes kryesve të veprës (të cilët E. S. i shënoj si të gjashtë) ishin S. Z. dhe S. Zh.. E. S. mendonte se të gjashtë kryesit e veprës ishin pjesë "Rojave të Urës". Ai këtë e kuptoi më vonë dhe bazoi këtë informatë në faktin se të gjashtë ishin parë në urën e Mitrovicës⁴²⁴. Mamaja e tij Gj. S. po ashtu përmendi se ajo vuri re disa nga ata në urë duke përdorur aparate komunikimi⁴²⁵. Trupi gjykues nuk e konsideron këtë sqarim të mjaftueshëm për të vërtetuar se më të vërtet kryesit e veprës i takonin "Rojave të urës. Asnjëri nga dëshmitarët nuk vuri re as **O. I.** ⁴²⁶ apo **D. D.** gjatë këtyre ngjarjeve, dhe as nuk dëgjuan kryesit e veprës t'i kenë përmendur ata në ndonjë mënyrë⁴²⁷.

457. B. S. 2 ishte e martuar me vëllain e M. S. 1. Ajo u njoftua ditën e nesërme për ngjarjen tragjike që shkaktoi vdekjen e M. S. 1. Ajo nuk e ka parë sulmin.⁴²⁸ Prandaj, në bazë të dëshmimeve, nuk mund të vërtetohet asnjë lidhje mes kryesve të veprës dhe të pandehurve.

⁴²³ Gj. S., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 14 maj 2015, para. 33 *et seq.*; E. S., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 9 maj 2015, para. 35 *et seq.*

⁴²⁴ E. S., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 8 maj 2015, para. 73-77.

⁴²⁵ Gj. S., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 14 maj 2015, para. 161-162.

⁴²⁶ G. M., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 17 shtator 2015, para. 82-86.

⁴²⁷ E. S., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 8 maj 2015, para. 79-84.

⁴²⁸ B. S.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 7 maj 2015, para. 92 *et seq.*

Ndodhitë në banesat e familjes B., R.1 dhe H.:

458. Dëshmitarët H. R., Sh. H., I. R.1, N. H., A. S.1 dhe M. H.1 jetonin në banesa të ndryshme që ndodheshin në të njëjtën ndërtesë. Ata në mënyrë unanime deklarojnë se atë natë një turmë e nevrikosur u tubua rreth ndërtesës së tyre dhe filluan të bërtisnin dhe të drejtonin fyerje ndaj shqiptarëve. Pastaj ata rrëzuan përtokë derën e ndërtesës, hynë brenda në shkallët e ndërtesës dhe sulmuan disa nga banesat e tyre. H. R. shpjegon hollësisht se si sulmuesit e hidhen përtokë derën e tij dhe se si ai vuri re dy të rinj duke hedhur granatën brenda banesës së tij. Sipas dëshmitarit, pas sulmit, serbët u tërhoqën dhe ai shkoi jashtë tek shkallët për të kontrolluar fqinjët e tij. Ai deklaroi se ai dhe fqinjët e tij pastaj vunë re se një fqinjë tjetër i tyre, S. B. e kishte derën e thyer. Ajo ishte e shtrirë për tokë e vdekur në banesën e saj dhe dhe në trupin e saj shiheshin shenja të dhunës.⁴²⁹
459. Menjëherë pas kësaj, ai dhe disa nga fqinjët e tij u bashkuan në korridor dhe organizuan mbrojtjen e tyre: ata ndërtuan një barrikadë të bërë nga thasët me rërë dhe ata që kishin armë i sollën ato. Disa orë pas sulmit fillestar, serbët përsëri tentuan të vinin lartë. Dëshmitarët deklaruan se si ata i kërcënuan serbët se do ua kthenin dhe kështu ata më në fund u tërhoqën. Serbët poshtë tek shkallët po ashtu kërkuan lirim të një serbi të ri i cili ishte ndarë nga grupi i tyre dhe ishte izoluar në katin më të sipërm. Të dy grupet negociuan dhe shqiptarët e lejuan këtë të ri të kalonte dhe të largohej.⁴³⁰
460. H. R. po ashtu deklaroi se gjersa ai ishte tek shkallët ai mundi të dëgjonte një nga kryesit e veprës – të cilin dëshmitari e mendoj si udhëheqës- i cili bërtiti në shqipe të pastër: “do të ju vrasim të gjithë juve shqiptarëve”. Ai nuk mundi ta shihte atë sepse ishte errësirë⁴³¹. Edhe pse dëshmitë janë të njëzëshme sa i përket faktit se i pandehuri **O. I.** me të vërtet flet shqip rrjedhshëm, dëshmitë e sipërpërmendura nuk mund të ndihmojnë që të vërtetohet

⁴²⁹ H. R., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 2 korrik 2015, para. 105; A. S.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 korrik 2015, para. 85

⁴³⁰ H. R., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 2 korrik 2015, para. 153 dhe 241; A. S.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 korrik 2015, para. 63-73

⁴³¹ H. R., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 2 korrik 2015, para. 114 *et seq.*

se në të vërtetë ishte i pandehuri ai i cili i shqiptoi këto fjalë. Vetë dëshmitari dëshmoi se ka shumë serb që flasin shqip në veri të Mitrovicës⁴³².

461. H. R. deklaroi se, diku katër orë pas sulmit të parë, arriti KFOR-i për t'i shpëtuar. Pesë apo dhjetë minuta më vonë dëshmitari vuri re **O. I.** i cili erdhi vetëm dhe ishte i veshur me rroba civile. Dëshmitari degjoi fqinjin e tij, M. P., duke iu drejtuar **O. I.** me këto fjalë: *"përse na bëtë këtë neve?"* dhe **O. I.** iu përgjigj; *"unë s'e bëra këtë"*⁴³³. Më pas, sipas dëshmitarit H. R., **O. I.** po ashtu tha këtë: *"kush dëshiron që të kaloj në anën tjetër të lumit Ibër, unë iu garantoj që nuk do iu mungoj as qimja e kokës."*⁴³⁴
462. Sh. H. deklaroi se një grup i serbëve trokiti në derën e tij dhe i bëri thirrje atij që të largohet nga banesa. Ai dhe familja e tij ikën tek banesa e I. R.1 i cili jetonte përball tij. Nga atje, dëshmitari Sh. H. vuri re një grup të serbëve të mbledhur para derës. Mes tyre dëshmitari pa **O. I.**, i cili ishte i veshur në rroba civile dhe kishte një radio aparat mobil.⁴³⁵ Dëshmitari tha **O. I.** po komunikonte me grupet e fqinjëve të tij shqiptar lartë. Ai nuk e dëgjoi përmbajtjen e bisedës, por ai erdh në përfundim se po negocionte me ta lidhur me lirimin e një të riu serb. Për faktin se **O. I.** kishte në posedim radio lidhje, dëshmitari doli në përfundim se ai mund të ketë qenë udhëheqës i grupit.⁴³⁶ Sipas dëshmitarit, ai po ashtu e dëgjoi **O. I.** të komunikonte përmes radio lidhjes me B. R. 2, në atë kohë kryetarin e komunës së Mitrovicës. Sipas dëshmitarit, B. R.2 e luste **O. I.** që ta qetësonte situatën.⁴³⁷
463. Dëshmitari I. R.1 po ashtu deklaroi se ai shikoj përmes vrimës përgjimit dhe se ai pa **O. I.** Kjo ndodhi pak para ardhjes së KFOR-it⁴³⁸. Dëshmitari po ashtu deklaroi se më herët atë mbrëmje ai dëgjoi një zë në korridor të cilin ai e njohu që ishte i **O. I.** Ky zë i thoshte një far C. 2-të të *"ki kujdes se ata mund të kenë armë"*.⁴³⁹ Kjo ndodhi,

⁴³² H. R., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 2 korrik 2015, para. 119.

⁴³³ H. R., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 2 korrik 2015, para. 157.

⁴³⁴ H. R., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 2 korrik 2015, para. 163.

⁴³⁵ Sh. H., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 30 qershor 2015, para. 167 *et seq.*

⁴³⁶ Sh. H., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 30 qershor 2015, para. 170.

⁴³⁷ Sh. H., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 30 qershor 2015, para. 205 *et seq.*

⁴³⁸ I. R.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 9 korrik 2015, para. 155 *et seq.* dhe 360.

⁴³⁹ I. R.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 9 korrik 2015, para. 182 *et seq.* dhe 356 *et seq.*

sipas dëshmitarit, një orë e gjysmë para se ai të shihte **O. I.** përmes vrimës së përgjimit.

464. Dëshmitari E. B. është kunati i I. R.1 dhe ata ishin në të njëjtën banesë natën kritike. Ai deklaroi se e dëgjoi zërin e **O. I.** në korridor. Sipas dëshmitarit, **O. I.** po fliste me një person të ushtrisë së KFOR-it dhe më pas dëshmitari Sh. H. doli përjashta dhe bisedoi me te.⁴⁴⁰
465. A. S. 1 ishte një nga shqiptarët i cili vuri barrikadën dhe mbrojti hyrjen e shkallëve. Gjatë ofensivës, ai nuk e ka parë **O. I.** e as nuk ka dëgjuar dikë ta ketë thirr atë me emër apo sipas nofkës.⁴⁴¹ Ai deklaroi se **O. I.** u paraqit në fund së bashku me komandantin e KFOR-it francez dhe *“ata gjeten një zgjidhje se ata do të siguronin një automjet të blinduar që të i shpëtojnë”* ata.⁴⁴²
466. N. H. po ashtu jetonte në të njëjtën ndërtesë të banesës. Megjithatë, ai nuk ishte në shtëpi kur ndodhen sulmet kështu që ai nuk dha ndonjë dëshmi të drejtpërdrejt apo të rëndësishme.
467. Dëshmitarja M. H.1 ⁴⁴³ ishte në banesën e saj të familjes së bashku me babanë e saj G.2 kur sulmi ndodhi. Në dëshminë e saj me gojë, dëshmitarja mohoi në disa lidhje materiale atë që kishte deklaruar më përpara në një intervistë. Do të thotë, se madje edhe pse ajo deklaroi në deklaratën e saj te procedurës paraprake se kishte vu re të pandehurin **O. I.** para ndërtesës, para gjykatës ajo deklaroi se asaj më nuk i kujtohej ajo gjë.⁴⁴⁴ Kur dëshmitari deklaroi në gjykatë, shfrytëzimi i deklaratave të tij të më hershme është i kufizuar në mënyrë rigoroze me KPP-së. Që do të thotë se deklaratat e më hershme mund të përdoren vetëm për ia përkujtuar dëshmitarit gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejt për drejt dhe për ta sfiduar besueshmërinë e dëshmitarit gjatë marrjes në pyetje nga ana e kundërt (neni 123 i KPP-së). Në të dyja rastet, përmbajtja e deklaratës së më përparshme është përdorur vetëm për të ndihmuar palën për të arritur këto synime dhe nuk mund të pranohet si dëshmi e drejt për drejt e fakteve. Prandaj nuk mund t'i takoj asnjë vlerë e caktuar e dëshmuese deklaratës së M. H.1 në procedurë paraprake.

⁴⁴⁰ E. B., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 21 korrik 2015, para. 85-86.

⁴⁴¹ A. S.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 korrik 2015, para. 106 *et seq.*

⁴⁴² A. S.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 korrik 2015, para. 79

⁴⁴³ M. H.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 korrik 2015, para. 263-264 dhe 312 *et seq.*

⁴⁴⁴ M. H.1, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 korrik 2015, para. 263 *et seq.*

468. Në bazë të deponimeve të H. R., A. S.1 dhe I. R.1, trupi gjykues vërteton përtej dyshimit të bazuar se **O. I.** erdhi në ndërtesën e banesës së tyre kah fundi i ngjarjeve, rreth kohës kur arritën forcat e KFOR-it. Edhe nëse I. R.1 vetëm e pa **O. I.** përmes vrimës së përgjimit, dëshmia e tij përputhet me ato të H. R. dhe A. S.1 të cilët vunë re të pandehurin në mënyrë të drejtpërdrejt. Dëshmitë e tyre megjithatë nuk mund të jenë përfundimtare për faktin se **O. I.** kishte çfarëdo përfshirje në orkestrimin e sulmit. Përkundrazi, madje mund të mbështetet ideja se **O. I.** po përpiqej në të vërtetë të ndihmonte në qetësimin e situatës. Prania e tij në shoqërimin e forcave ndërkombëtare të sigurisë mund të tregojë se ata po vepronin me një qëllim të përbashkët dhe ajo është që të stabilizojnë situatën.
469. Edhe po të jetë e mundur që i pandehuri ishte i pranishëm tek shkallët, trupi gjykues nuk mundet, megjithatë, të bie në përfundim të sigurt, në bazë të njohjes së zërit nga ana e I. R.1, që zëri që ishte i përfshirë në bisedë me atë far C.2-në ishte zëri i **O. I.** Supozimi i dëshmitarit Sh.H. se **O. I.** ishte i përfshirë në negociata me një grup të shqiptarëve nga katet e sipërme nuk mbështetet me asnjë dëshmi konkrete, pasi që dëshmitari nuk e dëgjoi përmbajtjen e bisedës. Përveç kësaj, A. S.1 – i cili ishte tek barrikada dhe kështu i pranishëm në negociata – nuk e ka parë ose dëgjuar **O. I.** apo të jetë përmend emri i tij. Prandaj, deklarata e tij për më tepër e zhvlerësoi supozimin e I. R.1. Trupi gjykues po ashtu ka rezerva lidhur me faktin që dëshmitari Sh. H. pati mundësi që të dëgjonte përmes derës së mbyllur përmbajtjen e bisedës të radio komunikimit me ç’rast ishte i përfshirë **O. I.**, dhe mbi të gjitha, të njoh zërin e bashkëfolësit, B. R.2. Prandaj, nuk i jepet shumë peshë kësaj dëshmie, e cila është si do që të jetë më indikativë për përpjekjen e të pandehurit për të qetësuar situatën.
470. Trupi gjykues bie në përfundim se roli komandues i **O. I.** nuk mund të vërtetohet në bazë të faktit që ai zotëronte një aparat radio komunikimi.
471. Asnjë nga dëshmitarët e sipër përmendur nuk dëshmoi për praninë e **D. D.**
472. Për të përmbledhur dëshmitë, trupi gjykues konsideron se nuk mund të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar se as **O. I.** apo **D. D.** ishin të përfshirë në çfarëdo mënyre në sulm.

Ndodhitë në banesat e familjes R.2 dhe familjes R.3:

473. G. R. ishte në banesën e fqinjtit të tij R. S. kur ata u sulmuan. Të dy banesat, edhe asaj të tij që gjendet në katin e tretë si dhe banesës së S.1 në katin e shtatë u perfshinë nga të shtënat.⁴⁴⁵ Dëshmitarët M. Sh. dhe D. Sh. e vërtetuan shpjegimin e tij.⁴⁴⁶ Megjithatë, në deklaratën e tij, dëshmitarët nuk dhanë ndonjë hollësi lidhur me kryesit e veprës së këtyre sulmeve.
474. Dëshmitari I. R.2 deklaroi se në kohën kur vëllai i tij jetonte në banesën familjare në rrugën Krala Petra në veri të Mitrovicës, dhe derisa ishte në banesë, ai u qellua me një të shtënë. Megjithatë, dëshmitari nuk kishte as njohuri të largëta lidhur me ngjarjet, pasi që në atë kohë ai jetonte në Munih si a refugjatë.⁴⁴⁷
475. Prandaj, në bazë të këtyre dëshmive, nuk mund të vërtetohet asnjë lidhje mes këtyre sulmeve dhe të pandehurve.

Prania dhe sjellja e të pandehurve O. I. dhe D. D. në rrugë:

476. Dëshmitarja P. A. ka parë se si familja e D. G. dhe një zonje të moshuar iu nënshtruan dhunës nga turma në rrugë. Pas kësaj, ajo vuri re të pandehurin O. I. -i cili, për afro 15-20 minuta, ecte rreth e rrotull i përcjellë nga turma e njerëzve, mes të cilëve ishte një person i cili dukej se po incizonte ngjarjet⁴⁴⁸. Ajo nuk vuri re ndonjë gjest të caktuar të ua kishte bërë i pandehuri njerëzve përreth tij. Këto vështrime të dëshmitares vërtetojnë se O. I. ishte i pranishëm në rrugë atë natë. Si do që të jetë, ata nuk japin ndonjë indikacion që ai ishte diçka më shumë se sa një soditës. Për më tepër, fakti që i pandehuri po ndiqej nga një person i cili po incizonte, mbështet versionin e dhënë nga mbrojtja, që do të thotë se atë natë ai ishte në shoqëri me gazetarët.
477. Dëshmitari Y dhe I. M.3 vunë re se O. I. ishte i pranishëm në arenën e ngjarjeve. Dëshmitari Y e pa O. I. duke ecur andej pari tek kryqëzimi mes rrugës 'Ivo Lola Ribar' dhe

⁴⁴⁵ G. R., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 4 gusht 2015, para. 64 *et seq.*

⁴⁴⁶ M. Sh., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 shtator 2015, para. 58 *et seq.*; D. Sh., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 shtator 2015, para. 213 *et seq.*

⁴⁴⁷ I. R.2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 10 shtator 2015, para. 163 *et seq.*

⁴⁴⁸ P. A., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 5 maj 2015, para. 87-117.

'Kralja Petra'. Disa njerëz të panjohur iu afruan atij dhe **O. I.** komunikoi me ata dhe, sipas këtij dëshmitari, ai po bënte me gjepte.⁴⁴⁹ Dëshmia e dëshmitarit Y nuk dha ndonjë fakt fajësues kundrejt **O. I.**

478. Në fakt, në deklaratën e tij, **O. I.** konfirmoi se në natën kritike ai ishte i pranishëm në rrugë rreth kohës së ngjarjeve. Sipas tij, ai ishte në banesën e tij e cila gjendet në rrugën 'Kralja Petra', kur ai dëgjoi për shpërthimin në kafenenë 'Bel Ami'. Ai menjëherë nxitoi për në spital dhe u siguria që djali i tij nuk ishte në mesin e të lënduarve. Pas një apo dy orësh, ai kthehet në shtëpi dhe më pas del në rrugë para banesës së tij, sipas të pandehurit, rreth 1000-2000 persona u mblodhën në rrugë dhe se situata ishte kaotike⁴⁵⁰. Në bazë të dëshmive, **O. I.** bisedoi me disa gazetarë si dhe me qytetarët e pushtuar nga paniku, të cilët ai mundohej që t'i qetësonte.⁴⁵¹
479. Megjithatë, dëshmitari I. M.3 dha një shpjegim i cili e kundërshton qëndrimin e mbrojtjes. Ai deklaroi se natën kritike, ai po mundohej të gjente rrugë nëpërmjet turmës së revoltuar dhe kthehet në banesën e tij që gjendet afër kafenesë 'Vožd'. Ai më pas dëgjoi **O. I.** duke iu drejtuar një grupi të njerëzve duke iu thënë në gjuhën serbe "hidhe bombën përmes dritares". Sipas këtij dëshmitari, ai e vuri re të pandehurin vetëm pasi që dëgjoi zërin e tij të njohur. Më pas ai pa **O. I.** duke bërë me gjepte. Dëshmitari deklaroi se ai nxitoi në shtëpi dhe se nuk pa se çfarë ndodhi më tej⁴⁵².
480. Trupi gjykues ka rezerva domethënëse sa i përket dëshmisë së I. M.3. Pa dashtë të dyshohet në sinqeritetin e tij, trupi gjykues vë në dukje se dëshmia e tij ka vlerë të zvogëluar. Dëshmitari nuk e pa me sy të pandehurin kur ky i dyti nxjerri nga goja ato fjalë, por ai i dëgjoi më parë fjalët- që ishin nga dikush që dukej i njohshëm - dhe vetëm atëherë ai e vuri re të pandehurin. Për më tepër, kur u pyet se automjetet aty pari të KFOR-it a ishin të ndezura apo të ndalura, dëshmitari u përgjigj: "*në atë moment unë nuk kam mund t'i dëgjoi nga zhurma*".⁴⁵³ Kjo, nga pikëpamja e trupi gjykues, lind dyshimet se a ishte në gjendje dëshmitari të kapte saktësisht se çka u tha në atë mjedis aq të zhurmshëm dhe të çrregulluar. Dha ajo që është më me rëndësi, nuk ka asnjë dëshmi tjetër që ta

⁴⁴⁹ Z. Đ., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 14 tetor 2015, para. 256 *et seq.*; N. S. 2, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 14 tetor 2015, para. 43 *et seq.* dhe 67 *et seq.*

⁴⁵⁰ **O. I.**, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 4 dhjetor 2015, para. 180 - 207.

⁴⁵¹ Dëshmitari Y, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 28 korrik 2015, para. 613 *et seq.*

⁴⁵² I. M.3, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 29 qershor 2015, para. 15 *et seq.*

⁴⁵³ I. M.3, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 29 qershor 2015, para. 253 *et seq.*

vërtetohet deklarata e tij. Trupi gjykues nuk mundet me siguri të mbështetet kryesisht në deklarata e tij për të vërtetuar se i pandehuri i nxori nga goja ato fjalë.

481. Është po ashtu shumë domethënëse se dëshmitari nuk dha asnjë informatë lidhur me rezultatin e kërkesës së supozuar nga ana e **O. I.** Nuk ka informatë nëse grupi i cili, sipas dëshmitarit, u nda dhe u largua nga **O. I.**, në të vërtetë hodhi ndonjë bombë. Prandaj, nuk mund të vërtetohet se veprimet e këtij grupi kishin shkaktuar në ndonjë mënyrë pasojat të cilat janë temë e kësaj aktakuze.
482. Prandaj, në bazë të dëshmive të mësipërme, nuk mund të vërtetohet asnjë lidhje mes sjelljes së paraqitur nga ana e të pandehurit në rrugë si dhe sulmeve që janë temë e kësaj aktakuze.
483. Kur bëhet fjalë për të pandehurin **D. D.**, prania e tij në rrugë në natën kritike është vërtetuar në bazë të dëshmive të dëshmitarëve X dhe Y.
484. Në mbrojtjen e tij, **D. D.** paraqiti alibinë e tij dhe beri përpjekje që të argumentoj se ai nuk ishte askund andej pari në rrugët ku ndodhen ngjarjet kritike. **D. D.** përshkroi aktivitetet e tija atë mbrëmje si në vijim: rreth orës 19:15 minuta ai shkoi në 'Srpska Kafana' (Biševac) për të pirë kafe. Sa ishte aty, pronari i kafenesë C. B. dhe kamerieri i treguan atij se dy oficerë të inteligjencies së KFOR-it Norvegjez po e kërkonin një politikanë vendas, Lj. M.. Duke ndjekur kërkesën e tyre, **D. D.** dhe shoku i tij R. Š., i cili sapo kishte ardhur në ndërkohë, iu bashkuan oficerëve në automjetin e tyre dhe shkuan në motel "Izvor" në Grabovac. Kur arritën aty, ai shpjegoi se Lj. M. ishte duke mbajtur një takim me anëtarët e partisë së tij. Ai iu tha atyre që të ktheheshin në Mitrovicë dhe ta prisnin atë në 'Srpska Kafana', ku ai iu bashkua atyre më vonë. Që të pestë- **D. D.**, Lj. M., R. Š. si dhe dy oficerët Norvegjez të KFOR-it – një mashkull dhe një femër – kaluan gjithë mbrëmjen atje, duke diskutuar gjendjen e përgjithshme politike dhe të sigurisë në atë zonë dhe mënyrat për të mbështetur popullatën serbe në enklava.
485. Në një moment u ata dëgjuan një shpërthim. Si pasojë e kësaj, Lj. M. kontaktoi bashkëshorten e vetë me telefon dhe mori vesh që një bombë kishte shpërthyer në kafenenë 'Bel Ami'. **D. D.** dhe R. Š. u larguan nga restoranti dhe vërtetuan këto informatë nga një kalimtar. Ata pas pak u kthyen në kafenenë 'Srpska Kafana'. Të dy oficerët Norvegjez propozuan që të përfundojnë takimin por se Lj. M. i siguroi ata

se nuk ishte nevoja. Ata vazhduan takimin deri në orën 22:00, kur oficerët udhëtuan për në Shkup, ku ishin të vendosur me bazë. Menjëherë pas pak, në orën 22:15 minuta, **D. D.**, Lj. M. dhe R. Š. gjithashtu dolën nga 'Srpska Kafana'. **D. D.** dhe R. Š. u ndanë nga Lj. M. në sheshin 'Šumadija' – ku ishte mbledhur një turmë e madhe - dhe shkuan në një banës e cila gjendet në rrugën 'Sutjeska' e shfrytëzuar nga i pandehuri. Pas pak kohe, rreth orës 23:20minuta që të dy shkuan së bashku në banesën e dëshmitares D. M.3 ku ishte V. R., një shoqe e të pandehurit. Të dyja zonjat ishin gazetare. Banesa e D. M.3 gjendej prapa qendrës shëndetësore Mitrovicë. Që të katërt rrinin së bashku dhe në ndërkohë, **D. D.** u largua nga banesa shpejt për të shkuar në 'Srpska Kafana' dhe e morri çakmakun. Ai u kthye shumë shpejt dhe qëndroi në banesën e zonjës D. M.3 deri në orën 1:30 minuta pas mesnatës kur ai dhe V. R. u larguan dhe shkuan në banesën në rrugën 'Sutjeska'⁴⁵⁴.

486. Mbrojtja u mundua të argumentoj ato që u tha më sipër duke përmendur një numër deklaratash të ngjashme. Dëshmitarët V. V., Lj. M., R. Š. dhe D. M.3 vërtetuan shpjegimin e të pandehurit.⁴⁵⁵ Megjithatë, niveli i hollësive që ata dhanë dhe ngjashmërive të habitshme të deklaratave të tyre zhvlerësojnë dëshmitë e tyre. Pas më shumë se 15 viteve nga ngjarja, dëshmitarët tregonin, pa ndryshime, të njëjtën sekuençe të ngjarjeve, deri në hollësi të cilat në asnjë mënyrë nuk ishin thelbësore, siç është thirrja telefonike që pati Lj. M.. Ata mbanin mend në mënyrë të përkryer madje edhe hollësitë më të vogla të takimit – siç është se kush piu lëng portokalli dhe kush piu kafe, se si dukej çakmaku i **D. D.**, apo kush e morri faturën. Jo vetëm se shpjegimet e tyre duken në mënyrë të përkryer të mirë-kurdisura, por gjatë dëgjimit të tyre, dëshmitarët nuk dhanë këtë informacion në përgjigjen e pyetjeve, por ata vetë vullnetarisht jepnin hollësi. Dukej sikur ata kishin për qellim të përcillnin njëfarë liste të hollësive dhe që t'i përmendnin ato për ti dhënë besueshmëri shpjegimeve të veta. Në vend të kësaj trupi gjykues krijoi bindjen e vetë se, në fakt, dëshmitarët i koordinuan shpjegimet e tyre dhe kështu nuk iu jap ndonjë vlerë të caktuar.

⁴⁵⁴ **D. D.**, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 8 dhjetor 2015, para. 402 *et seq.*

⁴⁵⁵ V.V., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 17 nëntor 2015, para. 31 *et seq.*; Lj. M., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 20 tetor 2015, para. 229 *et seq.* dhe Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 21 tetor 2015, para. 18 *et seq.*; R. Š., Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 27 tetor 2015, para. 16 *et seq.*; D. M.3, Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 24 nëntor 2015, para. 355 *et seq.*;

487. Oficerët Norvegjez – për të cilët i pandehuri **D. D.** dha hollësi të caktuara që mund të kontribuonte në identifikimin e tyre – nuk kishin mundësi të dëshmonin sipas përgjigjes së autoriteteve Norvegjeze.⁴⁵⁶ Prandaj, ata nuk patën mundësi as të vërtetojnë e as të mohojnë atë që u tha më sipër.
488. Një tjetër shqetësim që identifikoi trupi gjykues është se versioni që paraqiten të pandehurit sfidon logjikën. Oficerët e KFOR-it u alarmuan nga shpërthimi por se iu dorëzuan insistimit të Lj. M. dhe ranë dakord që të vazhdonin më tej. Ky nuk është një reagim i zakonshëm nga oficerë të trajnuar të inteligjencies. Ata nuk ishin me bazë në Mitrovicë por në Shkup dhe nuk ishin të njohur me asnjërin nga pjesëmarrësit në këtë takim. Diskutimi në të cilin ata u futën me të pandehurin dhe të tjerët ishte lidhur me krijimin e kontaktit dhe kishte të bënte, sipas dëshmive, çështjeve të përgjithshme se si mund të ndihmonin ata popullatën serbe. Rëndësia e bisedimeve në asnjë mënyrë nuk arsyeton faktin që ata injoruan një incident të sigurisë deri në atë masë sa që të mos mbledhin madje më shumë informata mbi atë që kishte ndodhur. Trupi gjykues ka rezerva për të pranuar një sqarim të tillë.
489. Për më tepër, i pandehuri ishte shef i stacionit të policisë në Mitrovicë. Edhe nëse nuk mund të funksiononte MPB pas qershorit të vitit 1999,⁴⁵⁷ është e vështir të besohet që shefi i policisë nuk do të përpiqej të informohej për një dëmtim domethënës të situatës së sigurisë dhe në vend të kësaj të zgjidhte shmangien me çdo kusht të vendit të incidentit.
490. Për ta përfunduar, alibia e paraqitur nga **D. D.** nuk është bindëse dhe nuk ka mundësi që të ngrit ndonjë dyshim serioz apo të rëndësishëm mbi faktet mbi të cilat mbahet. Dëshmia e përgjithshme as nuk vërteton e as nuk përjashton faktin që **D. D.** ishte në takim atë mbrëmje. Ndërsa mundësia e takimit nuk mund të përjashtohet, trupi gjykues hedh poshtë propozimin e mbrojtjes se **D. D.** e kaloi gjithë mbrëmjen duke e përcjell atë.
491. Ka dëshmi konkrete në të kundërtën.
492. Dëshmitari X dëshmoi se në mbrëmjen kritike, mu para shpërthimit në kafenenë “Bel Ami” ai doli që të shihte se çka kishte ndodhur dhe u nis në drejtim të rrugës ‘Ivo Lola Ribar’.

⁴⁵⁶ Letër e ambasadës e datës 21 shtator 2015, reference DBJN/2013-2249, Dosja e Gjykatës XI, Shqyrtimi Kryesor, lidhja 3.

⁴⁵⁷ *Shih* detaje nga vlerësimi i veprimtarive të MPB-së në paragrafin 529 më poshtë.

Kishte shumë njerëz në rrugë. Ishte diku rreth orës 19:00 kur ai vuri re **D. D.** duke u afruar. Ai ishte në përcjellje të disa anëtarëve të MPB-së. Ai u ndal në rrugën Ivo Lola Ribar, i rrethuar nga anëtarët e MPB-së serbe. Pas kësaj disa anëtarë të “Rojeve të Urës” iu bashkuan atyre, si dhe qytetarët e zakonshëm.⁴⁵⁸ Një person po i tregonte **D. D.** detaje rreth shpërthimit. **D. D.** iu drejtuar grupit të rrethuar me fjalën në vijim: “*Një gjë e tillë nuk duhet të ndodh kurrë, dhe kjo pjesë duhet të pastrohet nga shqiptarët.*”⁴⁵⁹ Veç kësaj, ai i tregoi një personi nga grupi: “*Ju e dini se çfarë është puna e juaj.*”⁴⁶⁰ Më pastaj, njerëzit që e rrethonin **D. D.** u ndanë në më tepër grupe dhe shkuan dhe pastaj, sipas dëshmitarit “filluan të sulmonin banesat e banuara me shqiptarë”.⁴⁶¹ Dëshmitari vërejti se si një grup i udhëhequr nga njëfarë Š. që hyri në hyrjen e parë të ndërtesës 27 në rrugën Ivo Lola Ribar⁴⁶² dhe mund të dëgjohen disa të shtëna më pastaj. Dëshmitari nuk e pa se çfarë ndodhi brenda ndërtesës⁴⁶³ Dëshmitari X u nis për në shtëpi menjëherë dhe gjatë rrugës për në shtëpi ai mund të dëgjonte një shpërthim gjoja që vinte nga banesat e ndërtesës më lart të lulishtes Narcis⁴⁶⁴ Sipas dëshmitarit, Š. ishte anëtar i “Rojeve të Urës”.⁴⁶⁵

493. Në atë kohë, dëshmitari Y ishte anëtar i _____. Në natën kritike, rreth orës 20:00, S. K.2, i cili ishte gjithashtu anëtar i _____, erdhi dhe e mori atë nga shtëpia e tij. Ai i tregoi atij që kishte pasur një shpërthim në qytet kështu që ata duhet të shkojnë dhe të shohin. Në momentin që ata arritën në qendër të qytetit, dëshmitari vërejti që **D. D.** i cili ishte atje, së bashku me R. Š. (gjithashtu anëtar i _____ dhe një shok i ngushtë i **D. D.**) dhe të tjerët. Në një pikë të caktuar, dëshmitari dëgjoi një person duke thënë “*Ka edhe një familje tjetër shqipëtare në këtë ndërtesë*”⁴⁶⁶ përderisa i tregonte ndërtesën e vogël në anën e majt të rrokaqiellit që gjendej në udhëkryq të rrugës “Kralj Petra” dhe “Sutjeska”.⁴⁶⁷ Sipas dëshmitarit Y, **D. D.** u kthye nga R. Š. dhe i

⁴⁵⁸ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 6 korrik 2015, par. 360, dhe Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 7 korrik 2015, par. 237.

⁴⁵⁹ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 6 korrik 2015, par. 360.

⁴⁶⁰ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 6 korrik 2015, par. 525.

⁴⁶¹ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 6 korrik 2015, par. 538.

⁴⁶² Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 korrik 2015, par. 100.

⁴⁶³ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 korrik 2015, par. 114.

⁴⁶⁴ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 6 korrik 2015, par. 546.

⁴⁶⁵ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 korrik 2015, par. 141-142.

⁴⁶⁶ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 581

⁴⁶⁷ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 581.

tha atij “shko dhe kryeje këtë punë”.⁴⁶⁸ Dëshmitari Y pastaj i pa S. K.2, R. Š. dhe M. L. duke hyrë në atë ndërtesë dhe mund të dëgjohej një foshnje duke qarë menjëherë më pas. Ai nuk mund të dëgjonte ndonjë të shtënë apo shpërthim⁴⁶⁹. Më pastaj, ai gjithashtu mund të vërente se si **D. D.** dhe R. Š. u nisën në drejtim të rrugës Ivo Lola Ribar.⁴⁷⁰ Dëshmitari deklaroi që ai kaloi për afërsisht gjysmë ore shoqërim të **D. D.** në atë rrugë.⁴⁷¹ Sipas dëshmitarit, M. L. ishte anëtar i “Rojeve të Urës”.⁴⁷²

494. S. K.2 dhe R. Š. gjithashtu ishin dëgjuar si dëshmitarë në propozim të mbrotjes. R. Š. në tërësi e miratoi llogarinë e paraqitur nga **D. D.** në deklaratën e tij. Ai e përshkroi aktivitetet e përgjithshme të të njëjtit, duke përfshirë takimin me zyrtarët norvegjezë dhe ai deklaroi që dy nga ata ishin së bashku gjatë tërë kohës. Dëshmitari S. K.2 deklaroi që ai nuk ishte në qytet fare atë mbrëmje. Ai bile nuk ishte në dijeni për shpërthim dhe ai mbeti gjatë tërë kohës në shtëpi të tij, që gjendej në zonën Brgjani, për afërsisht 2 km nga qendra e qytetit të Mitrovicës.⁴⁷³
495. Për arsyet e paraqitura më lart në këtë aktgjykim,⁴⁷⁴ trupi gjykues ka rezerva serioze në lidhje me dëshmimin e R. Š.. Prova tregon që ai ishte gjithashtu anëtar i _____ dhe shok i ngushtë i **D. D.**. U paraqit që besnikëritë thelbësore kishin një influencë pas vullnetit të këtyre dëshmitarëve për të thënë të vërtetën në gjykatë rreth çështjeve të caktuara. Gjithashtu është e mundshme që dëshmitarët – të dy vartësit e **D. D.** në atë kohë – përshtatën dëshmitë e tyre në mënyrë që të distancohen vet nga ngjarjet . Veç kësaj, S. K.2 në mënyrë të qartë deklaroi që anëtarët e _____ në Mitrovicën e Veriut absolutisht nuk kishin obligim kthesë ndaj pagave të tyre. Kur u pyetën në mënyrë të veçantë nëse ata duhet të banonin në Mitrovicën e Veriut, ai e mohoi këtë. Qëndrimi i tij është kundërshtuar me një provë tjetër, duke përfshirë deklaratën e **D. D.**: Anëtarët e _____ duhet të mbanin praninë e tyre në Mitrovicën e Veriut.⁴⁷⁵ Kjo është një arsye shtesë pse trupi gjykues e konsideron dëshmimin e S. K.2 me mosbesim.

⁴⁶⁸ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 587.

⁴⁶⁹ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 504.

⁴⁷⁰ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 590 *etj.*

⁴⁷¹ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 303-309.

⁴⁷² Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, para. 219.

⁴⁷³ S. K.2, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 tetor 2015, par. 124 *etj.*

⁴⁷⁴ *Shih vlerësimin e alibisë të D. D.* në paragrafet 484-490 më lart.

⁴⁷⁵ **D. D.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 9 dhjetor 2015, para. 95-100.

496. Mbrojtja ngriti brenga rreth objektivitetit të dëshmitarit Y, pasi që karriera e tij në _____ ishte pezulluar duke pasur parasysh disa procedura disiplinore, në kohën kur **D. D.** ishte drejtues i sekretariatit të punëve të brendshme.⁴⁷⁶ Sidoqoftë, dëshmitari dukej shumë i drejtpërdrejt rreth kësaj. Ai hapur pranoi që kishte hasur disa çështje të caktuara në punë, disa nga ato në lidhje me mos kthimin e _____. Nuk ka dëshmi që dëshmitari i jep ndonjë fajësi **D. D.** apo mban armiqësi kundër atij. Dëshmia e tij u shfaq e barazpeshuar, dëshmitari mbështeti përgjigjet e tij me shembuj. Ai nuk dukej të jap fajësi lehtësisht dhe po tedëshironte t'ia kurdis **D. D.** ai ka mundur të fabrikoj një llogari më inkriminuese. Trupi gjykues vlerëson dëshmimin e tij si të besueshëm.
497. Deklarata e tij u konfirmua nga dëshmitari X.
498. Prandaj, bazuar në deklaratat e të dy dëshmitarëve X dhe Y, trupi gjykues vërteton që **D. D.** ishte i pranishëm në zonën e rrugës “Sutjeska” dhe “Ivo Lola Ribar” në mbrëmjen e 3 shkurtit 2000.
499. Në lidhje me sjelljen konkrete të **D. D.**, trupi gjykues i bën vërejtjet si në vijim:
500. Fjalët që dëshmitari Y deklaroi, ai e dëgjoi **D. D.** të thotë - *“shko dhe kryeje këtë punë”* – nuk janë të qarta, bazuar në faktin që përmbajtja e tyre nuk është domosdo vendimtare prej vetëm një domethënie. Veç kësaj, dëshmitari nuk e vëzhgoi në mënyrë specifike rezultatin.
501. Shqiptimet e atribuuara tek **D. D.** nga dëshmitari X janë shumë më complete. Sidoqoftë, këtij dëshmitari iu ishte miratuar anonimiteti i plotë, prandaj dëshmimi i tij duhet të vlerësohet duke marrë parasysh dispozitën e nenit 262, paragrafi 3, të KPP, i cili thotë, “Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.” Veç kësaj, trupi gjykues parashton vërejtje që nuk ka dëshmi të përmendura në lidhje se çfarë kanë bërë njerëzit të cilët në fakt janë larguar nga **D. D.** në momentin që ata janë ndarë nga ai. Edhe pse në pranim se ata kanë hyrë në dy ndërtesat u treguan nga të dy dëshmitarët X dhe Y, nuk mund të

⁴⁷⁶ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 369 etj.

vërtetohet që ata me të vërtetë në fakt i kanë sulmuar apartamentet të cilët janë lëndë e aktakuzës.

502. Trupi gjykues gjithashtu cek aspektin në vijim të deklaruar nga dëshmitari Y: *“nga ndërtesa përreth kishte pasur shumë të shtëna të cilat më bënë mua të besoj që dëbimet po vazhdonin, por unë nuk e kamë parë atë”*⁴⁷⁷ Fakti që sulmet tashmë po vazhdonin para se dëshmitari Y takoi **D. D.** dhe vëzhgoi sjelljen e tij, jep bile më shumë dyshim mbi përfshirjen e **D. D.** në sulm pasi që nuk ka prova rreth sjelljes së tij para kësaj. Aktakuza e ka ngarkuar **D. D.** me “nxitje”. Për të ekzistuar nxitja , “nxitësi” nuk është dashur të vendos për të kryer veprën. Ai duhet të jetë veprimi i “shtytësit” që sjell zgjidhjen kriminale të zbatuesit.
503. Trupi gjykues nuk mundet në mënyrë të sigurtë të mbështetet ne provat e kufizuara të paraqitura më lart për te vertetuar pertej dyshimit të bazuar që **D. D.** e ka inkurajuar ndonjë person për të kryer sulme të cilat janë lëndë e aktakuzës.
504. Në fund, trupi gjykues përmend që dëshmitari H. B. , një aktivist i të drejtave të njeriut, ka paraqitur disa deklarata të regjistruara dhe fotografi të viktimave dhe ka dëshmuar mbi margjinat e atyre. Disa akuza nga mbrojtja në lidhje me besueshmërinë e tij ishin ngritur kundër dëshmitarit gjatë shqyrtimit. Trupi gjykues nuk i jep shumë peshë këtyre akuzave pasi që ato janë të bazuara në artikujt e shtypit dhe raportet të cilat nuk janë të mbështetura me prova. Sidoqoftë, trupi gjykues i shqyrton dëshminë e këtij dëshmitari me vëmendjen më të lartë. Dëshmimi i tij është i bazuar në informatat “e marra” nga ai nga personat të cilët ai i ka intervistuar dhe prandaj nuk paraqet burim provues primar dhe ai nuk mund të shtoj ndonjë vlerë substanciale dhe definitive të gjendjes faktike.
505. Për të arritur në përfundim, dëshmitë janë konstatuar të pamjaftueshme për të dëshmuar përtej dyshimit të bazuar ndonjë përfshirje të të pandehurve, **O. I.** apo **D. D.** në sulme. Dëshmitë gjithashtu ishin te pamjaftueshme për të dëshmuar identitetin e kryerësve apo ti caktojnë ata në një kategori të caktuar përveç se “Serbët”.

(b) Dëshmia në lidhje me pozitën e O. I. brenda Rojeve të Urës

⁴⁷⁷ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 369 etj.

506. Dëshmia në lidhje me grupin e “Rojeve të Urës” është e pakët dhe kontradiktore për konstatimin definitiv që të bëhet.
507. Ka dëshmi të kufizuar për të na ndihmuar neve për të vërtetuar se kush saktë ishin Rojet e Urës.
508. Fushëveprimi i gjerë i variacioneve ndërmjet llogarive të ndryshme nënvizuan rrethanën e pasigurte të Rojeve të Urës. Ka dëshmime që mohuan bile ekzistimin e Rojeve të Urës,⁴⁷⁸ përderisa të tjerët deklaruan që të gjithë qytetarët në Mitrovicën e Veriut ishin Roje të Urës.⁴⁷⁹
509. Sipas dëshmimeve, Rojet e Urës përbëheshin prej njerëzve të kombësisë serbe, disa prej të cilëve ishin zhvendosur nga Mitrovica e Jugut apo enklavat serbe në Kosovë, disa nga ata nga Mali i Zi.⁴⁸⁰ Detyra e tyre kryesore ishte për të ruajtur urën kryesore në Mitrovicë dhe për të parandaluar popullatën etnike shqiptare nga jugu për të kaluar në Veri të Mitrovicës. Veshja e tyre ishte civile dhe ata kishin vendosur taktika sikurse ndalja e civilëve në urë dhe duke sulmuar shqiptarët të cilët jetonin në veri. Ata ishin të organizuar në nën grupe. Disa prej tyre ishin të armatosur dhe kishin pajisje të radio komunikimit. “Zyra” e tyre ishte në kafenenë “Dolce Vita”. Disa dëshmitarë gjithashtu përmendën afërsinë e Rojeve të Urës me organizatën politike të Këshillit Kombëtar Serb.⁴⁸¹ Akoma, nuk është e qartë nëse ata e ndanin ideologjinë apo në çfarë mënyrë ata ishin të lidhur.
510. Dëshmitari Y, i cili ishte anëtarë i _____, përmendi që ata kishin një shkallë të caktuar të organizimit, që ata paguheshin dhe i përkisnin strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme Serbe.⁴⁸² Sidoqoftë, në fund të dëshmimit të tij, ai bëri një deklaratë që hoqi dyshimin mbi atë që si ishin në fakt të organizuar Rojet e Urës: *“Në atë kohë unë personalisht nuk i njihja shumë rojet e urës. Para se gjithash, nuk mund të thosha rreth komandimit të këtyre njerëzve. Kishte pasur shumë të rinj dhe alkoolistë. Nuk mund të flisja rreth komandimit të këtyre njerëzve të tillë. Ata nuk ishin një grup aq serioz.”*⁴⁸³

⁴⁷⁸ N. K., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 13 tetor 2015, par. 36-37.

⁴⁷⁹ N. S.2, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 14 tetor 2015, par. 108-110 dhe 157.

⁴⁸⁰ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, para. 88 *etj.*

⁴⁸¹ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, para. 340

⁴⁸² Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 390 *etj.*

⁴⁸³ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 563.

511. Kjo dëshmi cek faktin që Rojet e Urës në fakt i mungonte një model i organizimit të fortë dhe disa veprime ishin kryer nga elementet mashtruese të shoqërisë. Ka një dëshmi të ngjashme plotësuese.⁴⁸⁴
512. Dëshmia tjetër cek faktin që “Rojet e Urës” ishin thjeshtë një emër i përdorur nga bashkësia ndërkombëtare për të emëruar njerëzit të cilët po e mbronin urën, të cilët në fakt ishin qytetarë të rregullt.⁴⁸⁵
513. Bazuar në të mësipërmen, së bashku nuk është e qartë nga dëshmia nëse Rojet e Urës në të vërtetë kishin një strukturë të qartë dhe organizim dhe nëse po, farë ishin ato.
514. Në lidhje me rolin e **O. I.**, dëshmitari Y përmendi që ai ishte “*në udhëheqje të rojeve të urës nga pozitat më të larta*” dhe e paraqiti këtë si “*një informatë e njohur më gjerë*”⁴⁸⁶. Dëshmitari i ofroi dy shembuj konkrete që e bënë atë të besojnë që **O. I.** ishte udhëheqësi:
515. Në nëntor 1999, dëshmitari dhe kolegët e tij të _____ pranuan informata që disa shqiptarë dëshironin të kalonin urën në veri. Si pasojë, dëshmitari dhe grupi i tij vrapuan në drejtim të urës. Në atë moment dëshmitari vërejti që **O. I.** ishte duke dalë nga ndërtesa e SNS-së. Sipas dëshmitarit, ai po mbante një armë dore.⁴⁸⁷ Bazuar në faktin që dëshmitari nuk ishte në dijeni për zhvillime të mëtejme, trupi gjykues nuk mund të vërtetoj nëse prania e **O. I.** ishte në ndonjë mënyrë e lidhur me ndonjë ngjarje mbi urën. Më tej, kjo kurrsesi nuk është indikativë për ndonjë udhëheqje të tij mbi rojet e urës.
516. Incidenti i dytë prezentuar nga dëshmitari Y cili ndodhi në janar të vitit 2000. Sipas dëshmitarit, një person M. R., i cili ishte Roje i Urës, kishte qenë i përfshirë në një zënkë në rrugën Kralj Petra. Në shpagim, **O. I.** u paraqit 15-20 minuta më vonë, i pasuar nga 15 – 20 Roje të Urës, disa prej tyre duke ecur përpara, disa në mënyrë paralele me të akuzuarin. **O. I.** kishte një radio të dorës dhe ai dhe grupi i tij thyen xhamat e shitores përgjatë rrugës.⁴⁸⁸ Në lidhje me të mësipërmen, trupi gjykues ushtroi maturi në vërtetimin, vetëm bazuar në dëshminë e dëshmitarit Y, që ata që e shoqëronin **O. I.** me të

⁴⁸⁴ N. S.2 Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 14 tetor 2015, par. 112; Z. Đ., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 14 tetor 2015, par. 387 dhe 470.

⁴⁸⁵ O. M., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 15 tetor 2015, par. 386

⁴⁸⁶ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 330.

⁴⁸⁷ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 362.

⁴⁸⁸ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 442.

vërtetë ishin anëtarë të Rojeve të Urës. Përveç kësaj, nuk ka tregues të asaj se çfarë shkaktoi incidentin dhe nëse kishte ndonjë lidhje me cilësinë e pretenduar të akuzuarit si Roje i Urës apo nëse ajo ishte më tepër si hakmarrje personale. Më tej, pozita e **O. I.** në grup dhe fakti që ai kishte një radio nuk mund të jetë përcaktues të cilësisë së tij si udhëheqës i Rojeve të Urës. Veç kësaj, edhe po të pranonte që personat të cilët e shoqëronin **O. I.** ishin me të vërtetë Roje të Urës, nuk ka prova se si përfaqësuesi i grupit të tyre ishte në lidhje me tërë entitetin e Rojeve të Urës.

517. Përveç kësaj, dëshmitari Y gjithashtu deklaroi që ai shpesh e kishte parë **O. I.** në kafenenë Dolce Vita në shoqërim të Rojeve të Urës.⁴⁸⁹ Përsëri, trupi gjykues konsideron që ky aspekt nuk mund të jetë përcaktues për pozitën e **O. I.** si udhëheqës i Rojeve të Urës apo afërsinë e tij me grupin çfarëdo qoftë. Kjo në veçanti pasi që më vonë dëshmitari specifikoi që Dolce Vita ishte në atë kohë e vetmja kafene në zonën e urës dhe që ai *“e shihte Z. O. I. në kafenenë më së tepërmi me njerëz të nivelit të lartë intelektual.”*⁴⁹⁰
518. Kur kemi të bëjmë me dëshmitarin X, u bë e qartë për trupin gjykues që dëshmia e tij sa i përket rolit të **O. I.** të “komandimit” ishte bazuar në mënyrë të madhe jo më shumë se thashetheme dhe që ai nuk kishte njohuri të besueshme të strukturës së Rojeve të Urës dhe rolit të **O. I.** brenda saj në atë kohë. Ai dëgjoi informatën nga shokët dhe nuk kishte dijeni personale.⁴⁹¹
519. Disa dëshmitarë të tjerë përmendën që ata dëgjuan që rojet e urës udhëhiqeshin nga **O. I.** Kjo, sidoqoftë, ishte përsëri nga mënyra e thashethemeve. Për shembull, dëshmitari B. P. përmendi që **O. I.** ishte udhëheqës i Asamblesë Kombëtare ⁴⁹² dhe që ai ishte udhëheqës i Rojeve të Urës. Dëshmitari deklaroi që ai kurrë nuk e kishte parë **O. I.** në urë. Kur u pyet rreth burimit të njohurisë së tij, ai i referoi informatës si “sekret publik”.⁴⁹³ Trupi gjykues vendos shumë pak peshë në raporte të tilla të pavërtetuara të thashethemeve.

⁴⁸⁹ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 359-360.

⁴⁹⁰ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 24 etj.

⁴⁹¹ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 6 korrik 2015, par. 145 etj.

⁴⁹² Këshilli Kombëtar Serb.

⁴⁹³ B. P., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 11 shtator 2015, par. 205-211.

520. Edhe nëse trupi gjykues do të pranonte që Rojet e Urës ishin disi të ndërlidhur me Këshillin Kombëtar Serb, dëshmia tregon që i akuzuari nuk ishte udhëheqës i tij. Ai ishte vetëm anëtar i Këshillit dhe ai ishte në fakt i përjashtuar nga Këshilli.⁴⁹⁴
521. Dëshmitari F. H. fillimisht është propozuar nga Prokuroria në lidhje me Akuzën 1, por marrja e tij në pyetje preku mbi aspekte që i përkasin të dyja akuzave.
522. Dëshmitari deklaroi se gjatë viteve 1999-2000, ai e pa të Akuzuarin **O. I.** që bartte lloje të ndryshme të uniformave.⁴⁹⁵ Në deklaratën e tij, dëshmitari nuk është shumë koherent dhe nganjëherë kur i shtrohej ndonjë pyetje për ndonjë kohë specifike, ai jepte më shumë përgjigje të përgjithësuara apo i referohej një periudhe tjetër.⁴⁹⁶ Duket se dëshmitari pohoi se para bombardimeve të NATO-s, **O. I.** kishte të veshur një uniformë të gjelbër ushtarake me lara⁴⁹⁷, dhe pas kësaj një uniformë të kaltër të paramilitarëve me simbole Serbe.⁴⁹⁸ Më vonë në deklaratën e tij, ai pjesërisht e tërhoqi qëndrimin e tij fillestar dhe e përmendi se **O. I.** kishte të veshur tuta sportive dhe një jakne të kaltër me simbole Serbe.⁴⁹⁹ Gjatë marrjes së tij në pyetje, dëshmitari e modifikoi pakëz deklaratën e tij, gjithashtu edhe sa i përket simboleve. Edhe pse ai fillimisht tregoi se përfaqësonin simbolin Serb, kur u pyet për detajet më vonë, ai nuk mund të ofronte asnjë detaj dhe shpjegoi se askush nuk guxonte ti afrohej grupit të **O. I.**-it. Ai deklaroi se **O. I.** po udhëhiqte një grup prej 500 personave. Ata ishin të armatosur dhe kishin të veshura të njëjtat uniforma.⁵⁰⁰ Prapë është e paqartë gjatë cilës periudhë dëshmitari pohoi ta ketë parë **O. I.**-in dhe grupin. Fillimisht ai deklaroi se kjo ndodhi në të dy vitet 1999-2000.⁵⁰¹ Më vonë në deklaratën e tij, ai e mohoi ta ketë parë atë në vitin 1999.⁵⁰² Kjo e la trupin gjykues me një ndjenjë konfuzioni dhe dyshimi sa i përket saktësisë së asaj çfarë ka pa ai.

⁴⁹⁴ **O. I.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 4 dhjetor 2015, par. 122 dhe 143; N. K., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 tetor 2015, par. 474-477.

⁴⁹⁵ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, para. 83.

⁴⁹⁶ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 116-125.

⁴⁹⁷ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 96 dhe 85.

⁴⁹⁸ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 83-91.

⁴⁹⁹ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 105 dhe 207-209.

⁵⁰⁰ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 100, 108, 114-115.

⁵⁰¹ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 73 dhe 85-87.

⁵⁰² F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 148-149.

523. Në deklaratën e tij, dëshmitari e ndërlidhi aktivitetin e **O. I.**-it dhe grupit prej 500 personave me bllokimin e urës në Mitrovicë. Çfarë është për tu brengosur është fakti se ai tregoi se kjo ndodhi në prani të KFOR-it Francez. Për më shumë, sipas dëshmitarit, KFOR-i Francez jo vetëm që e kishte vërejtur grupin në uniforma, por bashkëpunonte ngushtë me ta.⁵⁰³ Kjo e vë në pikëpyetje kredibilitetin, që forcat ndërkombëtare të cilat ishin vendosur në rajon për të rivendosur rendin dhe për të promovuar bashkëpunimin ndëretnik, do të merrnin anë, dhe në mënyrë aktive ta pengonin qarkullimin e lirë në urë. Për këtë, trupi gjykues nuk mund ta konsideroj dëshminë e tij si të besueshme.
524. Dëshmimet e tjera të dëshmitarit cekin faktin që **O. I.** disa hera kishte intervenuar tek Rojet e Urës gjatë konflikteve të caktuara.⁵⁰⁴ Dëshmia tregon që ato intervenime të akuzuarit ishin në favor të kombësisë shqiptare. Duket që ai ka ndërmarrë veprime për të qetësuar gjërat, ai në fakt i qetësonte veprimet e Rojeve të Urës. Kjo sigurisht dëshmon që i akuzuari gëzonte një autoritet të caktuar. Sidoqoftë, kjo nuk implikon domosdoshmërisht që ai po ushtronte autoritetin e tij si udhëheqës i Rojeve të Urës. Kjo thjeshtë mund të jetë një reflektim i faktit që ai ishte një person i njohur dhe i respektuar në bashkësinë serbe, sikurse që treguan provat. Mbetet e paqartë nga këto llogari, nëse gjatë të bërit kësisoj, **O. I.** ishte duke ushtruar fuqi disiplinore mbi rojet e urës, sikurse që u paraqit nga prokuroria, apo nëse ai thjesht merrte përparësi të pozitës së tij sociale dhe intervenonte, kur i kërkonin, me qëllim të zgjidhjes së situatës së vështirë personale.
525. Përderisa një konkluzion i përfshirjes së të pandehurit në aktivitetin e Rojeve të Urës mund të nxirret nga këto fakte, në aspektin e trupit gjykues, konkluzione të tjera të cilat nuk janë në përputhje me këtë konkluzion gjithashtu janë të hapura. Ajo domosdo pason, duke pasur parasysh barrën e provave, që nuk është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar nga Prokuroria që **O. I.** ishte udhëheqës i Rojeve të Urës.
526. Disa raporte të KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe memorandumet e portretizojnë **O. I.** si udhëheqës apo komandant të formacioneve paraushtarake / policore ishte paraqitur si dëshmi dokumentuese. Trupi gjykues konstatoi që nuk ka ndonjë tregues sa i përket burimeve të tyre, e as në ndonjë mënyrë nuk është vërtetuar në gjykatë. Shqyrtime të

⁵⁰³ F. H., Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 26 shkurt 2015, paras. 203-217.

⁵⁰⁴ F. J., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 korrik 2015, par. 24 *etj.*; G. M, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 17 shtator 2015, para. 97 *etj.*

ngjashme janë vënë në lidhje me disa artikujt të shtypit të përmendura si prova. Gjithashtu, prokuroria e paraqiti një incizim të bërë nga një televizion japonez i cili e tregon **O. I.** mbi urë. Nuk mund të nxirret një konkluzion i qartë në lidhje me aktivitetet e tija konkrete apo si çështje e faktit në lidhje me periudhën kur incizimi ishte bërë. Prandaj, vlera dëshmuese është bashkëlidhur në këto dokumente dhe ncizimi. Natyra e kësaj prove është e tillë që trupi gjykues nuk mund të bëj ndonjë konstatim pozitiv duke e përshkruar pozitën, nëse ka ndonjë, të **O. I.** brenda Rojeve të Urës.

527. Në fund, trupi gjykues i bën disa shqyrtime të tjera në lidhje me pretendimet në aktakuzë që **O. I.** *“kishte një pikëpamje nacionaliste serbe dhe anti shqiptare, të cilët ai e ka mbajtur deri më sot. Ai gjithashtu mori respekt ndërmjet shokëve të tij serbë duke qenë kritik rreth veprimeve të ndërmarra nga bashkësia ndërkombëtare në Kosovë”*⁵⁰⁵ Trupi gjykues konsideron që këto pretendime nuk mbështeten nga provat. Në të kundërtën, ka dëshmi domethënëse duke cekur faktin që në vitin 2000 i akuzuari në mënyrë të ngushtë ka bashkëpunuar me bashkësinë ndërkombëtare dhe e deklaroi vetën në favor të përfshirjes së popullatës shqiptare.⁵⁰⁶
528. Sidoqoftë, orientimi i tij politik mundet të jetë vetëm tregues. Kjo, natyrisht nuk do të përjashtonte që në mënyrë të fshehur ai ka mundur të fshihet në një lloj tjetër të sjelljes. Sidoqoftë, sipas mendimit të trupit gjykues, dëshmia dështon në vërtetim të udhëheqjes mbi Rojet e Urës të **O. I.** në një masë të caktuar, që është përtej dyshimit të arsyeshëm.

(c) Dëshmia në lidhje me pozitën e D. D. brenda -----

529. Dëshmia tregon që **D. D.** kishte pozitë komanduese brenda _____ në Mitrovicë në atë kohë të sulmit. Dëshmimi më i rëndësishëm është ai i dëshmitarit Y, i cili ishte vet anëtar i

⁵⁰⁵ Aktakuza, f.15, versioni në anglisht.

⁵⁰⁶ B. R.2, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 25 mars 2015, par. 96 etj. dhe 150 etj.; N. K., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 tetor 2015, par. 477-479, 485; N. K., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 13 tetor 2015, par. 121-125; *shih gjithashtu Memorandumine Mirëkuptimit të UNMIK-ut të paraqitur në Gjykatë më 15 tetor 2015, Dosja e Gjykatës IX, Shqyrtimi Kryesor, tab 3*

_____. R. Š. dhe S. K.2, të cilët ishin gjithashtu anëtarë të _____, e vërtetuan këtë.⁵⁰⁷ I akuzuari gjithashtu e pranoi faktin dhe e paraqiti një diagram të cilin ai e kishte vizatuar përafërsisht duke e përshkruar organizatën e MPB-it në regjionin e Mitrovicës.⁵⁰⁸ Ai tregoi që në qershor 1999, kur forcat policore serbe ishin obliguar zyrtarisht të lënë detyrat e tyre, ai ishte emëruar zyrtar ndërlidhës me KFOR-in. Më vonë atë vit, ai u bë komandant i Stacionit të Policisë në Mitrovicë.⁵⁰⁹ Në kushtet praktike, ai ishte personi i cili kishte autoritet mbi stacionin policor në Mitrovicë. Ai ishte në fakt i varur nga zyrtarët në Sekretariatit e Ministrisë së Punëve të Brendshme.⁵¹⁰

530. Përderisa nuk është e dukshme nga provat para trupit gjykues që kishte obligim të raportimit tek Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, megjithatë disi është vërtetuar që strukturat organizative të MPB-së mbaheshin në Mitrovicë të Veriut. **D. D.** bile ishte avancuar. Shpjegimi i ofruar nga dëshmitari R. Š. që avancimi i **D. D.** ishte bërë vetëm sa i përket nevojave të tija financiare, dëmton kredibilitetin.⁵¹¹ Zyrtarët e MPB-së duhej të mbanin praninë e tyre në Mitrovicë të Veriut.
531. Trupi gjykues e konsideron këtë aspekt si dhënie e qartë e provave që, edhe nëse jo haptazi funksional, struktura e MPB-së dhe zinxhiri komandues mbaheshin pas Qershorit 1999. **D. D.** gëzonte një autoritet të caktuar mbi vartësit e tij dhe i ndihmuar nga mbikëqyrësit e tij. Fshehurazi, ata ishin të organizuar në grupe dhe organizonin misione patrulluese, me detyrën e tyre kryesore për të mbrojtur urën kryesore.
532. Përderisa dëshmia më lart me të vërtetë nuk mbështet konstatimin që i akuzuari ishte i akuzuar nga MPB-ja në Mitrovicë, implikimi i mëtejshëm të cilin dëshiron prokuroria të bëjë, që ai ka organizuar operacionin, duket të jetë përtej fushëveprimit të provave, sikurse që u paraqit në detaje më lart në aktgjykim. E qasur në dritën më të favorshme, prova më së shumti ka mundur të dëshmojë që MPB ishte e përfshirë në misione të caktuara patrulluese në Veri të Mitrovicës. Nuk ka dëshmi vendimtare që më datën 3 shkurt 2000 anëtarët e

⁵⁰⁷ R. Š., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 27 tetor 2015, par.12; S. K., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 tetor 2015, par. 73

⁵⁰⁸ **D. D.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 dhjetor 2015, par. 372 *etj.*;

⁵⁰⁹ **D. D.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 dhjetor 2015, par. 382 *etj.*; Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 434.

⁵¹⁰ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 432 *etj.*

⁵¹¹ R. Š., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 27 tetor 2015, par. 12.

MPB kishin ndonjë urdhër për të vepruar kundër shqiptarëve (apo që në fakt ata kanë vepruar kështu), që e kundërshton çdo konkluzion që i akuzuari do të kishte, si komandant i tyre, në çdo mënyrë përcaktoi veprimet e tyre. Nuk ka ndonjë provë që caku i përgjegjesisë së tij të vazhdoj përtej kësaj.

(d) Dëshmia në lidhje me planifikimin apo koordinimin e përbashkët të sulmeve ndërmjet O. I. dhe D. D.:

533. Një konkluzion pretendues nga prokuroria është që sulmet më 3 shkurt 2000 ishin të orkestruara nga MPB dhe në koordinim me Rojet e Urës.
534. Nga fillimi trupi gjykues bën vërejtje që nuk ka prova solide që sulmet ishin planifikuar. Dëshmitari G. R. deklaroi që, ditën tjetër pas sulmit, ai vërejti që kishte pasur emra serbë në dyert e banesave në ndërtesën e tij që ishte në banim nga shqiptarët. Dëshmitari e kuptoi që kjo është një mënyrë në të cilën Serbët deklaruan që ata kishin përvetësuar banesat.⁵¹² Sidoqoftë, nuk ka prova konkrete në çfarë rrethana kanë ndodhur këto apo nëse kjo i paraprinë sulmit apo jo.
535. Pa ndryshim, të gjithë dëshmitarët deklaruan që turma filloi të mbledhej në rrugët menjëherë pas shpërthimit në kafenenë “Bel Ami”. Disa të rinj serbë ishin lënduar shumë në shpërthim dhe ky është konkluzioni i arsyeshëm dhe i qartë që kjo është çfarë ngriti reagimin e menjëhershëm shpagues të serbëve kundër shqiptarëve. Është e pakontestueshme, dhe e njohur në mënyrë publike dhe notore që në vitin 2000 situata ndëretnike në veri të Mitrovicës ishte e tensionuar. Kundër kësaj prapaskene, konkludimi logjik ishte që serbet do t’i jepnin fajin shqiptarëve për sulmin kundër një vendi zakonisht të frekuentuar nga Serbët. Në të vërtetë, epërsia e provave e favorizon pikëpamjen që sulmet ishin spontane.
536. Aktakuza gjithashtu i referohet treguesve që plani pas sulmeve ishte “*për të eliminuar të gjithë shqiptarët të cilët punonin për Sigurimin Shtetëror pasi që ata kishin njohuri të veçantë rreth luftës.*”⁵¹³ M. S.1 ishte punëtor i pensionuar i Sigurimit të Shtetit. N. A.2 gjithashtu

⁵¹² G. R., Procesverbali shqyrtimit kryesor, 4 gusht 2015, par. 67-69.

⁵¹³ Aktakuza, pp.24 dhe 27, versioni në anglisht.

punoj për Sigurimin Shtetëror. Sidoqoftë, mbetet e pa demonstruar dhe e pa vërtetuar nëse ka pasur ndonjë lidhje ndërmjet punës së zyrtarit të sigurimit shtetëror dhe i të qenit cak. Më sa tregon prova, ne nuk mund të vërtetojmë që viktimat ishin të zgjedhura për shkak të asociacionit të mëparshëm të perceptuar me autoritetet serbe. M. S. 1 dhe N. A.2 janë vetëm dy prej 23 viktimave të paraqitura në aktakuzë. Disa nga viktimat – sikurse R. C. apo S. B. ishin bile zonja më të vjetra të cilat vështirë mund të ishin kërcënim për sigurinë e shtetit. Veç kësaj, pasi që N. A.2 ishte lënduar, kryerësit e veprave hynë në banesë të tij. kjo iu dha atyre mundësinë për të vrarë atë nëse kjo ishte ajo çfarë dëshironin ata. Sidoqoftë, ata vetëm kërkuan nga ai të largohej.

537. Prandaj, trupi gjykues konsideron që kjo teori nuk është e vërtetuar.
538. Gjithashtu, trupi gjykues kthehet në vlerësim të deklaratës së dëshmitarit Y në lidhje me këtë aspekt. Ai ishte një anëtar i _____ në atë kohë. sidoqoftë, ai nuk kishte informata të mëhershme të sulmit. Kjo rezulton nga dëshmia e tij që të dytë ai dhe kolegu i tij S. K.2 i cili erdhi për të marrë atë në befasi nga shpërthimi dhe kjo është arsyeja pse ata shkuan në qendër të qytetit. Dëshmitari nuk kishte pranuar ndonjë udhëzim të mëparshëm. Sipas dëshmitarit, S. K. 2 nuk e përmendi që ata kishin marrë ndonjë urdhër.⁵¹⁴ Dhe bile në vend të ngjarjes, ai nuk mori ndonjë urdhër nga **D. D.** Në fakt, dëshmitari deklaroi që nuk ndihej fare i detyruar të shkonte me S.K. 2 dhe që nëse ky i fundit nuk kishte ardhur për të marrë nga shtëpia e tij, ai ka mundur të mos kishte shkuar jashtë.⁵¹⁵ Nuk ka arsyetim të justifikueshëm pse **D. D.** do të fshihte urdhrat nga dëshmitari. Sipas dëshmitarit Y, **D. D.** i besonte atij dhe ata ishin në marrëdhënie mjaft të mira.⁵¹⁶ Ky dëshmim zbardh më tepër dyshimin në faktin që MPB-ja kishte një plan për sulme.
539. Trupi gjykues gjithashtu bën vërejtje që dëshmitari Y përmendi që aktivitetet e përgjithshme të kryera nga _____ ishin kufizuar në mbrojtje të urës.⁵¹⁷ Ai kurrë nuk mori ndonjë detyrë duke përfshirë aksionet kundër shqiptarëve etnikë që jetonin në veri. Kjo e kundërshton edhe një herë idenë që sulmet ishin të planifikuara nga MPB.
540. Veç kësaj, nuk ka ndonjë provë konkrete apo të qartë që **O. I.** dhe **D. D.**, si individë, kishin ndonjë lloj të bashkëpunimit.

⁵¹⁴ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 562.

⁵¹⁵ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 562.

⁵¹⁶ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 653.

⁵¹⁷ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 182.

541. Dëshmitari Y deklaroi që pas qershorit 1999 shtabi kryesor i policisë iu ishte dorëzuar forcës ndërkombëtare. Pas një afati kur ata nuk kishin zyra, në fillim të tetorit 1999, **D. D.** thirri një takim dhe i informoi anëtarët e MPB-së që ata mund të përdornin ndërtesën e Këshillit Kombëtar Serb për nevojat e tyre.⁵¹⁸ Takimi u mbajt në objektin e Këshillit Kombëtar Serb në dhomën që komunikonte me një dhomë tjetër – dhe **O. I.** ishte i pranishëm atje. Sidoqoftë, bazuar në këtë informatë trupi gjykues nuk mund të nxjerrë ndonjë konkludim të caktuar në lidhje me ekzistimin apo natyrën e mundshme të bashkëpunimit ndërmjet të dyve. Gjithashtu, dëshmitari përmendi një të çarë të caktuar në lidhjet ndërmjet **D. D.** dhe **O. I.** që ndodhi në dhjetor 1999, kështu muaj para ngjarjes kritike.⁵¹⁹ Përsëri, prova e mbështetur nga prokuroria për të dëshmuar bashkëpunimin ndërmjet dy të akuzuarve është e varur nga rrethanat prandaj nuk është e mjaftueshme për të dëshmuar pretendimet e menduara.
542. Dëshmia në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet rojeve të urës dhe MPB-së gjithashtu nuk është e mjaftueshme. Kur u mor në pyetje rreth këtij aspekti, dëshmitari X përmendi: *“Kështu, ata bashkëpunuan së bashku me qëllim për të mbrojtur urën, do të thotë ata kanë vepruar krah për krah.”*⁵²⁰ Por, sipas dëshmitarit, qytetarët e rregullt të Mitrovicës gjithashtu kanë marrë pjesë në ngjarje.⁵²¹ Kjo do të ishte më shumë bindëse për faktin që MPB dhe rojet e urës thjeshtë morën aksion krah për krah, së bashku me qytetarët e rregullt për arritur qëllimin e përbashkët: duke penguar popullatën shqiptare për të kaluar urën.

Për të përmbledhur:

543. Bazuar në dëshmitë e vlerësuara më lart ishte vërtetuar përtej dyshimit të bazuar:

⁵¹⁸ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 korrik 2015, par. 109 etj.

⁵¹⁹ Dëshmitari Y, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 30 korrik 2015, par. 638 etj.

⁵²⁰ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 6 korrik 2015, par. 283 etj.

⁵²¹ Dëshmitari X, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 6 korrik 2015, par. 268-269; Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 7 korrik 2015, par. 237.

- I. Që më 3 shkurt 2000 në Mitrovicën e Veriut në orët e mbrëmjes, ndodhi një shpërthim në kafenenë “Bel Ami”, duke lënduar një numër të serbëve.
- II. Që në shpagim, pak kohë më vonë, në kohën e natës, grupet spontane të serbëve hynë në ndërtesat që gjendeshin në rrugën Knjaz Miloš, rrugën Lola Ribar, rrugën Tanaska Rajića, rrugën Sutjeska dhe rrugën Kralja Petra të populluar me familje të kombësisë shqiptare, me qëllimin për dëbim të tyre. Ata i sulmuan ata, i vranë ata dhe i lënduan disa viktimë sikurse që është specifikuar në aktakuzë.
- III. Që i pandehuri **D. D.** ishte në cilësinë e komandantit të stacionit të policisë së Mitrovicës të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Federale të Jugosllavisë (MPB).

544. Bazuar në provat e vlerësuara më lart, çështja në vijim nuk mund të vërtetohet jashtë dyshimit të arsyeshëm:

- IV. Që i pandehuri **O. I.** kishte cilësinë e udhëheqësit të grupit serb paraushtarak të njohur si “Rojet e Urës”.
- V. Që, më 3 shkurt 2000, i pandehuri **O. I.** veprroi në bashkëkryerje me **D. D.**, pas një plani të planifikuar të përbashkët; apo me qëllim për të dëbuar shqiptarët etnik nga shtëpitë e tyre dhe të lëshojnë territorin e Mitrovicës së veriut ai i nxiti/urdhëroi grupin e policisë apo “Rojet e Urës” të sulmojnë disa ndërtesa që gjendeshin në rrugët e përmendura më sipër dhe me forcë t’i pastrojnë ato prej shqiptarëve etnik.
- VI. Që në atë rast grupet e zyrtarëve të policisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Federale të Jugosllavisë (MPB) apo “Rojet e Urës” ishin pjesë e grupit spontan të serbëve të cilët kishin hyrë në ndërtesat e përmendura më sipër.

II. B1. 2. Ligji

545. Ngjarjet e vërtetuara më lart kanë ndodhur në shkurt 2000, kur ligji i aplikueshëm ishte Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK).
546. Të pandehurit janë të akuzuar me tre pika të akuzës “nxitje e vrasjes së rëndë”, ose në formë të përfunduar apo të tentuar.
547. Sipas nenit 30 (2), të LPKSAK:
- 2) *Kushti i burgimit i së paku dhjetë vjet apo dënim me vdekje do të shpallet kundër:*
 - 1) *Kushdo që i merr jetën e një personi tjetër në mënyrë brutale apo mizore;*
 - 2) *Kushdo që i merr jetën e një personi dhe në të bërit kështu në mënyrë të qëllimshme e rrezikon jetën e një apo më tepër personave;*
 - 3) *Kushdo që e merr jetën e një pësoni për përfitim të vet, për të kryer apo për të fshehur vepra të tjera penale për hakmarrje të pa mëshirë apo motive të tjera themelore;*
 - 4) *Kushdo që merr jetën e një personi tjetër për gjakmarrje;*
 - 5) *Kushdo që merr jetën e një personi tjetër me sjellje të pamëshirshme;*
 - 6) *Kushdo që merr jetën e një personi zyrtar apo zyrtari ushtarak gjatë kryerjes së detyrës së tij, apo zbatimit të ligjit, duke arrestuar shkelësin e veprës penale apo duke e ruajtur një person të arrestuar apo personin i cili i merr jetën një personi tjetër gjatë kryerjes së detyrave apo punëve të cilat i kryen ai sipas ligjit apo dispozitave të tjera kur ai e mbron shoqërinë.*
548. Si vërejtje në aktakuzë, nxitja nuk mund të kryhet në lidhje me formën e tentuar të veprës. Nëse faktet dëshmohen, nxitësi ka nevojë të mbahet përgjegjës për nxitje në veprën penale të kryer, bile nëse veprimet e nxitësit janë të ndërprera dhe vetëm arrijnë formën e tentuar.
549. Veç kësaj, kualifikimi ligjor në aktakuzë, ajo e “aktakuzës” e veprës penale është në konflikt me njërin e pretendimeve kryesore të prokurorisë, do të thotë që **D. D.** dhe **O. I.** kanë vepruar si udhëheqës. Nëse rrethana e tillë do të ishte vërtetuar, ata, bazuar në autoritetin e tyre, do të kishin “urdhëruar” veprime, jo “nxitur” në to. Sidoqoftë, pasi që rasti i prokurorisë nuk ishte dëshmuar, diskutimet e mëtejme në çështjen janë të tepërta.
550. Sikurse u shqyrtua më lart, trupi gjykues nuk mundi të vërtetoj si të dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm faktet e ngritura në këto akuza kundër dy të akuzuarve.

551. *Actus reus* në ligjin penal përbën të gjitha elementet e krimit tjetër nga gjendja mendore e të pandehurit.
552. *Actus reus* e veprave penale të pandehurve janë të ngarkuar me tre pika të akuzës në aktakuzë nuk ka mundur të vërtetohet. *Actus reus* është, prandaj nuk ka plotësuar standardin ligjor dhe të dy të pandehurit nuk mund të konsiderohen në mënyrë kriminale përgjegjës.
553. Pasi që elementet objektive të veprave penale në ligjin në fuqi në kohën që janë kryer veprat nuk janë gjetur, kjo është e tepërt për të analizuar çfarë janë elementet përbërëse të veprave të tilla sipas kodeve vijuese penale, pasi që Ligji në fuqi në kohën e veprës penale aplikohet tek kryerësit” (Neni 2(2) i KPK).
554. Prandaj, i pandehuri **O. I.** nuk shpallet fajtor dhe lirohet, sipas nenit 364, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP.
555. Ngjashëm, i pandehuri **D. D.** gjithashtu nuk shpallet fajtor dhe lirohet, sipas nenit 364, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP.

Nënkapitulli B2: Analiza në lidhje me të akuzuarit N. V. 1, I. V. dhe A. (S.) L.:

II. B. 2.1. Faktet

556. Trupi gjykues përsërit që të pandehurit **N. V. 1, I. V. dhe A. (S.) L.** akuzohen vetëm në lidhje me sulmin e banesës së familjes A.1. Veç kësaj, ata janë të akuzuar për kryerje të veprave penale në bashkëkryerje. Në pjesën më të madhe të provave të administruara nga prokuroria kundër atyre, si dhe provave të përmendura nga të pandehurit **N. V.1 dhe I. V.** është e zakonshme. Prandaj, situata e tyre do të adresohet në mënyrë të përbashkët më poshtë. Aktakuza pretendon si në vijim:

“Më 03/02/2000 natën në Mitrovicën e Veriut, duke vepruar në bashkëkryerje sipas planit të mëparshëm të planifikuar dhe në cilësinë e anëtarëve të grupit paramilitar serb i njohur si “Rojet e Urës” i cili ishte nën komandën e **O. I.**, me qëllim direkt për të

mbytur, nisi sulmin me përdorim të pajisjeve shpërthyesë në banesën që gjendej në rrugën Lola Ribar Nr. 3 e banuar nga familjet A. 1 dhe XH. si rezultat i të cilëve disa nga anëtarët e tyre ishin vrarë apo lënduar rëndë dhe në veçanti:

1. Më 03/02/2000 në kohën e natës të pandehurit i kanë vrarë personat në vijim:
 - a. N. A.1
 - b. N. XH.
2. Më 03/02/2000 në kohën e natës të pandehurit kanë marrë veprim ndaj kryerjes së veprës së vrasjes por veprimi nuk ishte kryer dhe rezultoi në shkaktim të lëndimit të rëndë trupor tek personat në vijim:
 - e. R. A.
 - f. N. A.2
 - g. A. A.2
 - h. E. XH.
3. Më 03/02/2000 në kohën e natës të pandehurit kanë marrë veprim në drejtim të kryerjes së veprës së vrasjes kundër personave në vijim por veprimi nuk ishte përfunduar:
 - f. S. A. 2
 - g. U. A.
 - h. Sh. A.
 - i. V. A.
 - e. G. XH.”⁵²²

557. Dëshmitarët kryesor të prokurorisë dëgjuan në lidhje me tre të pandehurit janë banues të banesës së familjes A. 1, do të thotë: G. Xh., R. A., S. A.2, Sh. A., V. A., A. A.2.

558. I pandehuri **A. (S.) L.** zgjodhi mos të administroj ndonjë provë në formë të dëshmimit të dëshmitarit.

559. Të pandehurit **N. V.1** dhe **I. V.** i thirrën shtatë dëshmitarët e njëjtë.

560. Të tre të pandehurit dëshmuan para trupit gjykues dhe në veçanti përgënjeshtuan qëllimin që ata ishin në korridor gjatë sulmeve.

⁵²² Aktakuza, f. 6-7, versioni në anglisht.

561. Për shqyrtimet e paraqitur në detaje më lart në këtë aktgjykim, deklarata e Sh. A. nuk është besuar si e besueshme dhe ajo e V. A. mund të përdoret vetëm për të vërtetuar faktet e vërtetuara nga dëshmitë e tjera të besueshme.⁵²³
562. Dëshmitari G. Xh., R. A., S. A.2 dhe A. A. 2 nuk ofruan ndonjë detaj që mund të lidh tre të pandehurit në sulme. Dëshmitarja R. A. deklaroi që ajo e kishte vërejtur **N. V.1** në turmë të mbledhur para ndërtesës para fillimit të sulmeve. Turma ishte duke kënduar “*Mbyti Shqiptarët*”, por **N. V.1** nuk këndonte me ata.⁵²⁴ Kjo provë nuk mund të jetë bindëse në ndonjë fakt relevant.
563. Dëshmitarja S. A.2 – bashkëshortja e N. A. 2– konfirmoi që ata kishin raporte shumë të mira fqinjësore me të pandehurit.⁵²⁵
564. Asnjë nga dëshmitarët nuk e vlerësoi si një njoftim të sigurt prej tre të pandehurit atë natë.
565. Të tre të pandehurit ishin fqinjë të N. A.2. Të gjithë nga ata jetonin në katin e tretë në banesë të ndërtesës së njëjtë. **I. V.** dhe **N. V.1** janë baba dhe bir dhe ata jetonin në banesë të njëjtë. Banesa e tyre ishte e ndarë vetëm me një mur nga banesa e N. A. 2 Dëshmitarja N. V. 4 është e motra e **N. V.1** dhe respektivisht e bija e **I. V.** Dëshmitarja R. V. është nëna e **N. V. 1** dhe respektivisht bashkëshortja e **I. V.** Ato të dyja dëshmuuan që në natën kritike, ata ishin në shtëpi së bashku me **I. V.** kur ata mësuan rreth shpërthimit në kafenenë Bel Ami. Ata kuptuan që **N. V.1**, që ishte jashtë dhe që shpesh shkonte në atë kafene, ka mundur të lëndohet në shpërthim. Të dyja R. V. dhe N. V. 4 qëndruan në shtëpi.⁵²⁶
566. Pas largimit nga banesa, **I. V.** doli jashtë për të kërkuar të birin e tij. ai e gjeti atë në afërsi të kafenesë. Ai nuk ishte kapur në shpërthim dhe ai kishte ndihmuar me të plagosurit. Ata shkuan në shtëpi së bashku, por në ndërkohë turmat filluan të mblidhen në rrugë. Ata nuk mund të hynin tek shkallët e tyre pasi që persona të panjohur e kishin bllokuar qasjen. Ata kaluan disa orë para ndërtesës përderisa forcat ndërkombëtare

⁵²³ Shih paragrafët 370-433 më lartë

⁵²⁴ R. A., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 24 prill 2015, par. 42 *etj.*

⁵²⁵ S. A.2, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 27 prill 2015, par. 238 *etj.*

⁵²⁶ **I. V.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 dhjetor 2015, par. 9; **N. V.1**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 9 dhjetor 2015, par. 424 *etj.*; R. V., Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 24 nëntor 2015, par. 24 *etj.*; N. V.4, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 nëntor 2015, par. 20 *etj.*

arritën dhe lejuan qasjen. Kur ata arritën në banesë, policia e UNMIK-ut ishte pothuajse atje.⁵²⁷

567. Përderisa në banesë, R.V. dhe N. V. 4 erdhën nën zjarr të armës. Të shtënat erdhën nga drejtimi i derës së përparme dhe një pothuajse e godit N.V. 4. Ata u strehuan në ballkon përderisa Policia e UNMIK-ut arriti.⁵²⁸
568. Dëshmitarët M. T. dhe B. G. konfirmuan që ditën tjetër ata i panë gjurmët e plumbave dhe shrapnel që kishte dëmtuar banesën e V.2.⁵²⁹
569. Sipas mendimit të trupit gjykues, e kundërshton logjikën që dikush të ketë marrë pjesë në një sulm me granatë kundër banesës pranë, duke rrezikuar familjen e tij që ishte në afërsi të sulmit.
570. I pandehuri **A. (S.) L.** gjithashtu mësoi rreth shpërthimit dhe e kaloi natën në spital ku ai dhuroi gjak. ⁵³⁰ Në mbështetje të deklaratës së tij, ai ofroi certifikatën e dhënies së gjakut.⁵³¹ Pas kthimit të tij në shtëpi, ai vërejti gjurmët e sulmit në shkallë. Dera e tij ishte jashtë menteshës.⁵³²
571. Vendimi i të pandehurve për të dëshmuar apo për të administruar nuk ka krijuar ndonjë barrë mbi ata për të dëshmuar pafajësinë e tyre. Disi, trupi gjykues duhej të përcaktonte pavarësisht dëshmive të akuzuarit, provat e prokurorisë janë të mjaftueshme të fuqishme për të plotësuar standardin e kërkuar për dënim.⁵³³ Ky kriter nuk është plotësuar kur ai ka të bëjë me vërtetimin e përfshirjes së të pandehurve në sulme.
572. Veç kësaj, asnjë provë e besueshme nuk ishte paraqitur që ndërlidhte ndonjë aktivitet të pandehurve në aktivitetet e Rojeve të Urës.
573. Bazuar në provat e vlerësuar nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar:

⁵²⁷ **I. V.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 dhjetor 2015, par. 9; **N. V.1**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 9 dhjetor 2015, par. 427; **R. V.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 24 nëntor 2015, par. 64 dhe 77-78; **N. V.4**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 nëntor 2015, par. 26 *etj.* dhe 78.

⁵²⁸ **R. V.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 24 nëntor 2015, par. 56-64; **N. V.4**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 nëntor 2015, par. 20-26

⁵²⁹ **M. T.** Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 nëntor 2015, par. 46 dhe **B. G.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 nëntor 2015, par. 212

⁵³⁰ **A. (S.) L.**, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 dhjetor, par. 254-255

⁵³¹ *Shih* Dosjen e gjykatës X, Shqyrtimi kryesor, tabela 5.

⁵³² **A.(S.) L.** Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 dhjetor, par. 255

⁵³³ *Prokurori v. Vasijlević*, Aktgjykimi i shqyrtimit, par 13.

I. Që **N. V.1, I. V.**, apo **A. (S.) L.** kishin cilësinë e anëtarit të grupit serb paramilitar i njohur si “Rojet e Urës”.

II. Që në atë rast, **N. V.1, I. V.** dhe **A. (S.) L.** kanë vepruar në bashkëkryerje sipas planit të pajtuar më parë dhe nisi sulmin me përdorim të pajisjeve të shpërthimit mbi banesën e përmendur më sipër.

II. B. 2.2. Ligji

574. Ngjarjet e vërtetuara më lart kanë ndodhur në shkurt 2000, kur ligji i aplikueshëm ishte Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK).

575. Tre të pandehurit janë të akuzuar me tre pika të “vrasjes së rëndë” dhe “vrasje të rëndë në tentativë”.

576. Sipas nenit 30 (2), të LPKSAK:

2) Kushti i burgimit i së paku dhjetë vjet apo dënim me vdekje do të shpallet kundër

1) Kushdo që i merr jetën e një personi tjetër në mënyrë brutale apo mizore;

2) Kushdo që i merr jetën e një personi dhe në të bërit kështu në mënyrë të qëllimshme e rrezikon jetën e një apo më tepër personave;

3) Kushdo që e merr jetën e një pësoni për përfitim të vet, për të kryer apo për të fshehur vepra të tjera penale për hakmarrje të pa mëshirë apo motive të tjera themelore;

4) Kushdo që merr jetën e një personi tjetër për gjakmarrje;

5) Kushdo që merr jetën e një personi tjetër me sjellje të pamëshirshme;

6) Kushdo që merr jetën e një personi zyrtar apo zyrtari ushtarak gjatë kryerjes së detyrës së tij, apo zbatimit të ligjit, duke arrestuar shkelësin e veprës penale apo duke e ruajtur një person të arrestuar apo personin i cili i merr jetën një personi tjetër gjatë kryerjes së detyrave apo punëve të cilat i kryen ai sipas ligjit apo dispozitave të tjera kur ai e mbron shoqërinë.

577. Siç u shqyrtua më lart, trupi gjykues nuk mundi të vërtetoj dyshimin e arsyeshëm faktet e ngritura ndaj këtyre akuzave kundër tre të akuzuarve. Nuk është vërtetuar nga prokuroria që ndonjëri nga të pandehurit janë përgjegjës penalisht për ndonjërin nga veprat e bëra në aktakuzë.
578. Pasi që elementet objektive të veprave penale në ligjin në fuqi në kohën kur veprat ishin kryer nuk janë konstatuar, është e tepërt për të analizuar se çfarë elementet përbërë të veprave të tilla janë sipas kodeve pasuese penale, pasi që ligji në fuqi në kohën kur vepra penale ishte kryer i aplikohet autorit të krimit” (Neni 2(2) i KPK).
579. Prandaj, i pandehuri **N. V.1** nuk shpallet fajtor dhe lirohet, sipas nenit 364, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP.
580. Ngjashëm, i pandehuri **I. V.** gjithashtu nuk shpallet fajtor dhe lirohet, sipas nenit 364, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP.
581. Dhe i pandehuri **A. (S.) L.** nuk shpallet fajtor dhe lirohet sipas nenit 364, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP.

III. LLOGARITJA E PARABURGIMIT

582. Për të pandehurin **O. I.**, duke pasur parasysh dënimin për piken 1 të akuzës, koha e kaluar në burg që nga 27 janar 2014 dhe 18 shtator 2015 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 18 shtator 2015 deri më sot do të llogariten në dënimin e shqiptuar, sipas nenit 83 paragrafi (1) dhe (4) i KPK-së lidhur me nenin 365 paragrafi (1. 5) KPP-së.

IV. SHPENZIMET PROCEDURALE

583. Në bazë të nenit 450-457 të KPPK-së dhe nenit 365 paragrafi 1.6 i KPP-së i akuzuari **O. I.** do të paguaj 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale përderisa çdo shpenzim i mbetur i procedurës penale do të paguhet nga burimet e buxhetit.

V. KERKESAT PASURORE JURIDIKE

584. Sipas nenit 365 paragrafi 1.6 i KPP-së, palët e dëmtuara: Xh. S., Sh. K.1, K. A., si dhe R. A., S. A.2, E. Xh., G. Xh., Gj. S., Sh. C.2, L. A. 2, H. S.1, H. R., M. H.1 dhe U. A. udhëzohen se mund të parashetrojnë kërkesat pasurore juridike në procedurë civile sipas nenit 463 Paragrafi (1) KPP.
585. Trupi gjykues nuk do i adresohet kërkesës pasurore juridike të dorëzuar nga M.Ll. pasi që në këtë rast ai nuk është në cilësinë e palës së dëmtuar.

Roxana Comsa
Kryetari i trupit gjykues

Nuno de Madureira
Anëtarë i trupit gjykues
Gjyqtari i EULEX-it

Vitor Pardal
Anëtarë i trupit gjykues
Gjyqtari i EULEX-it

Asja Zujo
Zyrtare Regjistruese

Personat e autorizuar kanë të drejtë të ankohen kundër këtij Aktgjykimi brenda 15 ditëve nga data e pranimit të Aktgjykimit që është dhënë në pajtim me nenin 380, paragrafin 1, të KPK-së.

Hartuar në anglisht versionin origjinal.